



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 28 e 29 JANAR 2010**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
28. i 29. JANUARA 2010. GODINE**

**JANAR – JANUAR
2009**

Seancën e kryesoi Jakup KRASNIQI, Kryetari i Kuvendit.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuari kryeministër, zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,
Hap punimet e seancës së parë plenare të Sesionit pranveror të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Konstatoj se në sallë është numri i mjaftueshëm i deputetëve për të filluar punën. Në sallë janë 71 deputetë. Për fjalë është lajmëruar deputeti Ali Lajçi.

ALI LAJÇI: I nderuar kryetar,
Kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra dhe të nderuar deputetë,
Mendoj që është e udhës që ky kuvend të bëjë një deklaram, mbase e konsideroj si politike, që EULEX-i të mos merret me çështjen e zotëri Albin Kurtit, ta tejkalojë dhe unë mendoj se prek, cenon normat, principet dhe standardet demokratike të jetës sonë në Kosovë dhe jo vetëm në Kosovë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Fjalën e ka kërkuar deputetja Drita Maliqi.

DRITA MALIQI: Faleminderit, zoti kryetar!
Përshëndetje, i nderuari zoti kryetar!
Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,
Ju kolegë të nderuar, deputetë,
Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë reagojmë në seancë plenare lidhur me ngjarjet e ditëve të fundit në skenën politike të Kosovë, ku falë presioneve politike të subjekteve të caktuara po imponohen rirreshtime politike, duke shkuar aq larg, sa shfrytëzohet ekzistenca e mbijetesës dhe mirëqenies së familjeve tona për qëllime politike. Këto presione deri në kërcënime që po bëhen mbi intelektualë, profesionistë të dalluar dhe veprimtarë të shquar dhe të dëshmuar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë apo të afërt me Lidhjen Demokratike të Dardanisë, po e kërcënojnë lirinë dhe të drejtat njerëzore, të drejtën e punës dhe demokracinë edhe ashtu të brishtë në Kosovë. Shembuj të tillë kemi mjaft. Dokumentacionin që e posedoj tregon qartë largimet nga puna të njerëzve anëmbanë Kosovës vetëm pse mendojnë ndryshe dhe vetëm për shkak të bindjeve të tyre politike. Edhe përkundër të gjitha këtyre vendimeve që i ka kthyer në punë Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës, ato ende asnjë nga ato nuk janë të ekzekutuar. Andaj, shtroj pyetjen pse shkelen të drejtat e këtyre njerëzve të pafajshëm? Pse në ditët e sotme lihen pa bukë këta njerëz? A jemi duke punuar për demokraci, shtroj pyetjen, apo për komunizëm? Për shembull, kemi shumë raste, kemi të gjitha vendimet

KRYETARI: Faleminderit!
Ndërkohë, Kryesisë së Kuvendit, në pajtim me Rregullën 23 pika 1 të Rregullores së Punës, në mbledhjen e mbajtur më 26 janar 2010, Kryesia ka vendosur që Kuvendit t'i propozojë edhe dy pika shtesë:

1. Rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe të Komisionit për Administratë Publike dhe Media për ndarjen e mjeteve financiare për Radiotelevizionin e Kosovës, dhe

2. Propozim-vendimi i Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale.

Lus deputetët që me një votim formal të deklarohen për propozimet e Kryesisë për pikat shtesë.

Kush është “për”? Faleminderit! A ka “kundër”? 5 vota “kundër”, do të thotë Kuvendi i radhitë në rend dite dy pikat shtesë.

Pikat shtesë do të radhiten për shqyrtim si pikat 14, përkatësisht 15 të rendit të ditës.

Fillojmë me rendin e ditës:

1. Miratimi i Procesverbalit të seancave plenare, të mbajtur më 29 dhjetor 2009

Pyes, nëse keni vërejtje në procesverbal? Konstatoj se Kuvendi miratoi Procesverbalin e seancës plenare, të mbajtur më 29 dhjetor 2009.

Pika e radhës është:

2. Koha për pyetje parlamentare,

Në bazë të Rregullës 26.1 të Rregullores së Punës së Kuvendit, koha për pyetje të deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 50 minuta.

Deputetja Suzana Novobrdaliu, pyetje për ministrin Fatmir Limaj, i cili nuk është këtu, as deputetja nuk është.

Deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin Nenad Rashiq. Ministri është këtu, deputeti është këtu, deputet e ke fjalën!

Regjia, fjalën deputetit Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuar zoti kryetar,

Zoti ministër Rashiq,

Nga kontaktet me qytetarë, ndër të tjera kam informata të konfirmuara se Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale, të cilën aktualisht ju e administroni, fillimisht në procedurë administrative personave të caktuar me aftësi kufizuar ju njeh të drejtën për pension deri në 5 vjet, por rrjedhimisht, para se të bëheshin 5 vjet, të njëjtëve me një vendim pa bazë ligjore, apo jo, në kundërshtim edhe me parimet elementare të së drejtës administrative të procedurës së përgjithshme administrative, madje edhe aktvendimet e formës së prerë i abrogon edhe personave të tillë jua mohon të drejtën të cilën më parë kjo ministri jua ka pranuar. Ju lutem, si qëndron gjendja, ku është si të them, çfarë politikash janë këto, aq më parë kur janë në kolizion me të drejtën aplikative pozitive dhe për aq obligative. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče!

Gospodine premijeru,

Gospodo zamenici premijera,

Dame i gospodo narodni poslanici,

Drage kolege ministri,

Gospodine Smaka,

Kao što ste i vi sami rekli, u našem sistemu, u kome mi podržavamo osobe sa ograničenim sposobnostima je takođe i ta penzija koju ste sami spomenuli. I ja ću po onome što je 1.7.2004. godine, doneta uredba na osnovu koje se ovo pravo i ostvaruje, i na bazi toga citiram jednog od članova unutar tog uputstva, to je član 7.5 koji kaže: Ministarstvo ili autoritet koji je određen za implementaciju procedura monitorisanja regulativa u vezi osoba koje dobijaju penziju za osobe sa ograničenim sposobnostima, mora da potvrđuju stalnu ograničenu sposobnost da bi nalazio mogućnost zapošljavanja ili samo zapošljavanja istih. I sve to osobe koje su korisnici te penzije sa ograničenom sposobnošću moraju stalno da se podvrgavaju lekarskim kontrolama da je njihovo stanje onako kao što su oni predložili, tako da na bazi administrativnog uputstva koje je doneseno br. 03/2005, kaže se da će Ministarstvo utvrditi načine, odnosno posebne tačke praćenja te njihove ograničene sposobnosti. Tako, po tačkom 3.2 kaže se da Ministarstvo ima pravo da sve korisnike ove vrste penzije može u bilo koje vreme pre isteka roka da pozove i da još jednom pred lekarskom komisijom proveri njihovo stanje. Ovo se sve radi u cilju da bi ljudi koji imaju mogućnost da se zaposle ili oni koji ozdrave ili na neki drugi način mi nađemo mogućnost njihovog angažovanja, budu van te liste. Znači, svaka njihova promena od momenta kada je donošena odluka da oni mogu da budu korisnici, do isteka roka je moguće, i sve zavisno.....

KRYETARI: Faleminderit!

A ke pyetje shtesë, deputetë?

RIZA SMAKA: Nuk ka mundësi ligjore që me akt nënligjor të revidohen dispozitat ligjore dhe aktvendimet me të cilat u mohohen të drejtat e njohura më parë në procedurë të rregullt edhe plotfuqishëm, nuk mund të abrogohen. Pyes si është e mundur që Ministria të miratojë aktvendime të mbështetura në aktet nënligjore, të cilat janë në kundërshtim flagrant me dispozitat ligjore. Kjo nuk mund të bëhet, kjo mund të bëhet në praktikë, ama juridika dhe rendi juridik nuk e toleron këtë dhe është e kundërligjshme. Me pastaj, a është e mundur që një person i cili shpallet pikërisht nga mjekët, nga komisioni mjekësorë prej 5 vetave, invalidi i kategorisë së parë, që mbas 3 – 4 vjetëve pa kurrfarë kurative, plus edhe 5 vjet apo disa vjet moshë që të quhet ai me....

KRYETARI: Faleminderit! Ministër, vazhdo!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Kao što sam već rekao, gospodine Smaka, ovo su zakoni koji su na snazi. Ja ću ponoviti još jednom. Imate Zakon 2003/23 ili 23/2003, verovatno je tehnička greška ovde. To je akt 7,5, i pored toga imate Administrativno uputstvo 03/2005, tačka 3,2, koje takodje kaže ono što sam već pomenuo. Znači, odgovorno tvrdim da na osnovu zakonske osnove mi utvrđujemo ko ispunjava uslove, ko ne. A još jednom ponavljam, kaže u toku tog petogodišnjeg perioda, pre isteka roka na osnovu informacija koje imaju inspektori ministarstva, mogu ka pozovu korisnika na ponovni pregled. Možete dobiti u pismenoj formi, tako da nema problema. Hvala!

KRYETARI: Vazhdojmë me pyetjen e radhës. Deputeti Driton Tali, pyetje për ministrin Enver Hoxhaj.

DRITON TALI: Faleminderit!

Zoti ministër, më 16 dhjetor të vitit të kaluar, pra më 2009, u publikua lajmi se MASHT-i ka shpallur fitues të tenderit për pajisjen e shkollave me teknologjinë informative konzorciumin InterAdria, Elfwalk, Avantix dhe IPKO, i cili ishte 24 milionë euro, në

realitet 24.100.000 euro më i shtrenjtë se sa ofertuesi më i lirë. Po ashtu, u bë publike se të nesërmen ky tender është anuluar. Pyetja është kjo: - Sa ka qenë saktësisht çmimi për kabinet nga konzorciumi fitues dhe, nëse ka pasur gabime në tenderdhënie, a është marrë dikush në përgjegjësi? Faleminderit!

KRYETARI: Ministër e ke fjalën!

MINISTRI ENVER HOXHAI: i nderuar zoti kryetar,

I nderuar zoti kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,

Shumë të respektuar deputetë,

Shumë i respektuar deputet Tali,

Më lejoni që në mënyrë telegrafike t'ju informoj për pyetjen të cilën e bëtë. Shpallja e kësaj shprehjeje të interesit ka ndodhur më 5 tetor të vitit 2009 dhe është vlerësuar nga ekspertë të jashtë ndërkombëtarë dhe vendorë. Më 13 nëntor është bërë përzgjedhja e kompanisë, të cilën ju e përmendët dhe në të njëjtën kohë ka pasur ankesa nga dy kompani të tjera. Si rrjedhojë e kësaj, më 10 dhjetor 2009 organi i shqyrtimit të prokurimit publik e ka vlerësuar lëndën në formë negative dhe ka rekomanduar anulimin e tenderit ose të shprehjes së interesit dhe kjo ka ndodhur më 10 dhjetor 2009. Dua t'ju informoj që çmimi për njësi, sipas informatave që kam nga administrata, çmimi më i lirë ka qenë 15.070 euro për një kabinet, çmimi i cili është përzgjedhur nga Ministria e Arsimit ka qenë 28.081 euro për një kabinet, ndërsa çmimi më i shtrenjtë ka qenë 54.353 euro për një kabinet. Unë jam në dispozicion që krejt dokumentacionin që e kam me veti ta merrni, ta shikoni, po dua t'ju informoj që ajo se çfarë është botuar si lajm, flet për atë që një tender i tillë asnjëherë nuk është kontraktuar nga Ministria e Arsimit, është përzgjedhur, mirëpo paraprakisht, para se të botohet lajmi, ka qenë i rekomanduar nga organi i shqyrtimit të prokurimit publik që të anulohet dhe në asnjë mënyrë dallimi prej 24 milionë eurosh, më i shtrenjtë se sa ofertuesi më i lirë, nuk qëndron. Ma merr mendja që mund të merret dokumentacioni dhe ta shihni, edhe vetë ta bëni një kalkulim. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputet, ke pyetje shtesë?

DRITON TALI: Zoti ministër, ky çmim po del edhe më i madh se sa është publikua, nëse ju thoni se 28.000 euro ka qenë për kabinet dhe, me sa kam informatë, 1842 kabinete është dashur të furnizohen dhe këtu del çmimi edhe më marramendës, 51.000.000 e diçka, do me thënë dallimi është 35.000.000 euro. Janë disa reagime të juaja në media, është edhe reagimi i OSHP-së, ku thotë se Ministria nuk i kishte ofruar të gjitha të dhënat e plota dhe këto janë jo me të 10-tin, ashtu siç thoni ju, madje edhe informata është publikuar, nëse nuk gaboju unë, më 17 dhjetor, në realitet më 18 dhjetor, se është anuluar, të paktën kështu është publikuar zyrtarisht në Web-sajtin e organit përgjegjës. Atë që e the ti tash, apo ju zoti ministër, i bie ajo "më rrove, të ...

KRYETARI: Faleminderit! Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI ENVER HOXHAI: I nderuar zoti deputet,

Nuk është fjala për 1800 kabinete, po është fjala për 1200 kabinete, se janë 1200 shkolla në Republikën e Kosovës. Përderisa unë jam në gjendje për shkak të hapësirës kohore t'ju dorëzoj komplet fajlin, dokumentin ta keni në dispozicion se si ka ndodhur rrjedha e anulimit të shprehjes së interesit. Mirëpo, dua t'ju them që shpeshherë mënyra se si është

prezantuar një ngjarje e tillë, ka qenë selektive, e pasaktë dhe ju mund ta bëni një kalkulim dhe tuajin, që realisht nuk mbërrin vlerën të cilën ju e përmendët. E kam ndërmend t'ju informoj që Komisioni Evropian, i cili mbështet Ministrinë e Arsimit në procesin e kompjuterizimit të shkollave, të digjitalizimit, të zhvillimit të platformave elektronike ka qenë dhe do të jetë i kyçur në një proces të tillë, i cili shpeshherë mund të bëhet lajm ditor, absolutisht nuk ka asnjë bazë legale dhe nuk ka asnjë arsye që të interpretohen në formën se si është interpretuar në mediat e shkruara. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputeti Naim Rustemi, pyetje për ministrin Zenun Pajaziti.

NAIM RRUSTEMI: Po e lexoj pyetjen, se pyetjen e kam të destinuar që të lexohet para vitit të ri sa për humor me drita, me kerre. Dy milionë banorë të trajtohen thua se je pushtetar i një vendi me 500 milionë banorë, të vendit të pasur për një vend të varfër. Pyetja është: - Kohëve të fundit vërehen mjete të shumta me përparësi kalimi në komunikacion të pajisura me mjete, me drita dhe të zërit me intensitet të ndryshueshëm. Me fjalë të tjera, thua se po bëhet ndonjë intervenim. Sigurisht që është intervenimi për të shkuar deri te dreka dhe, me gjasë, posedojnë autorizim nga shefi i Shërbimit Policor të Kosovës. Pyetja ime i është drejtuar ministrit, si e keni rregulluar se kush ka të drejtë në përdorimin e këtyre dritave dhe cilat pozita zyrtare kanë të drejtë të përdorin pajisje të tilla? Ndoshta i mbetet borxh opinionit publik që ta sqarojnë se na trenuan me drita dhe me zë.

KRYETARI: Mirë, faleminderit! Ministri s'është këtu, kalojmë.

Deputetja Myrvete Pantina, pyetje për ministrin Ahmet Shala.

Deputetja nuk është këtu. Deputetja Teuta Hadri, pyetje për ministrin Alush Gashi.

TEUTA HADRI: Çështja është se jeni ekzekutiv i shëndetësisë kosovare dhe katër kujdestaritë e vitit 2009 të punëtorëve shëndetësorë nuk i keni paguar ende edhe tani në vitin 2010. Pyetja: - Pse nuk e keni paguar dhe pse po i mblidhni dhe po i përcillni problemet nga viti në vit?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI ALUSH GASHI: I nderuari zoti kryetar,

I nderuari zoti kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar deputetë,

E nderuara zonja deputete, mjeke, gjinekologe,

Përgëzoj për këtë përkujdes. Më lejoni që Kuvendin ta informoj se deri në fillim të mandatit tonë çështja e kujdestarive nuk ka qenë e rregulluar. Herën e parë në dhjetëditëshin e fundit në vitin 2009, kujdestaritë në institucione shëndetësore paguhën përmes pagave dhe administrimi bëhet përmes Ministrisë së Administratës Publike. Të dhënat e juaja nuk janë plotësisht të sakta, sepse vetëm në ato institucione shëndetësore ku për vitin 2009 nuk ka qenë planifikimi i mirë, ekziston ngecje. Në institucionet shëndetësore ku planifikimi ka qenë i mirë, siç ka qenë rasti i Prizrenit, i Pejës, i Gjakovës e kështu me radhë, janë të paguara të gjitha kujdestaritë. Aty ku ju punoni në Qendrën Klinike Universitare, planifikimi që është bërë për vitin 2009, ka pasur të holla që të paguhën aq sa i kanë planifikuar. Prandaj, mbetja për disa muaj ka filluar që të paguhet në janar të këtij viti dhe në muajt e ardhshëm, besoj për një muaj a dy do të jetë nën zero. Vështirësitë janë në planifikim. Përmirësim të planifikimit dhe të menaxhimit kemi dhe kemi një sistem ku kujdestaritë paguhën përmes pagës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!
Deputete, ke pyetje shtesë?

TEUTA HADRI: Nuk e di pse i erdhi keq ministrit pse jam gjinekologe. Shënimet dhe të dhënat janë, katër kujdestari nuk janë të paguara. Është fakt që edhe punëtorët shëndetësorë na përcjellin dhe unë jam si zëdhënës që i përcjell kërkesat e tyre, si deputete. Mirëpo, ju nuk i keni paguar. Mua më intereson se kamatën që e mbani nga 3 muaj ditë, kush e shfrytëzon atë kamatë?

KRYETARI: Ministër!

MINISTRI ALUSH GASHI: Faleminderit, zonja deputete, mjeke - gjinekologe, kjo është fakti i pamohuar, nuk ka kurrgjë të keqe në te. Spitalet e kanë vinë e vetë buxhetore. Të gjitha mjetet e vendit tonë mblidhen në një thes, që është në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave. Qeveria i merr kërkesat e planifikuara, ia sjell Kuvendit, Kuvendi miraton buxhetin. Prandaj, ata që e kanë planifikuar, ata gjatë vitit 2009 për herë të parë në dekadën e fundit janë pagua me rregull. Kjo ngecje në Qendrën Klinike për 4 muaj, që është me vlerë prej 504.000 euro, është mungesë e planifikimit dhe kjo do të kompensohet që nga ky muaj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputetja Gjylnaze Sylja, pyetje për ministrin Zenun Pajaziti. Ministri nuk është këtu, mund ta bëni pyetjen deputete, nëse doni.

GJYLNAZE SYLA: Zoti kryetar, me qenë se kreu i Qeverisë është këtu, mbase kryeministri mund t'i përgjigjet pyetjes, po që se do të përgjigjet. Nëse jo, unë do ta pyes në seancën e ardhshme ministrin e Punëve të Brendshme, por e ftoj kryeministrin.

KRYETARI: Deputete, kryeministri nuk e ka pyetjen. Ministri nuk është këtu, pyetjen mund ta lexoni ose ta pritni seancën e radhës.

GJYLNAZE SYLA: Me qenë se sipas Rregullores kam të drejtë që pyetja të kalojë në seancën e radhës, unë edhe juve si kryetar i Kuvendit, për të satën herë, edhe një herë ju ftoj që të siguroni që ministri të jetë këtu, se është e pesta herë që kam pyetje për ministrin dhe nuk është këtu. Për atë thashë, me qenë se kreu i qeverisë është këtu, që është edhe shefi i tij, thashë t'ia bëj pyetjen atij. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetja Drita Maliqi, pyetje për ministrin Enver Hoxhaj. Deputete, e ke fjalën!

DRITA MALIQI: Faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndetje, i nderuari zoti ministër,

Çfarë jeni duke bërë për ndryshimin e Kurrikulit, në mënyrë që të përfshihet perspektiva gjinore në tekstet shkollore dhe ta shqyrtoni mundësinë të vendosën eksperte gjinore, sepse ju e dini, edhe ju edhe ne e dimë që është themeluar komisioni, mirëpo në komision është shkel Ligji për barazi gjinore. Besoj që pajtoheni edhe juve, sepse janë, nëse s'gaboju, afërsisht 20 anëtarë, prej tyre vetëm një është femër, kur e dimë se në Kosovë eksperte për këtë lëmi ka me qindra e qindra zonja të respektuara. Mundësisht, ju lus zoti ministër, që të ketë hapësirë, si për shembull, nëse e marrim Abetaren, është për çdo shembull, këtë edhe e kemi thënë, edhe pse ka kushtuar shumë shtrenjtë, por prapë se

prapë Abetarja e ka kualitetin e saj, kështu që Kurrikula të ndryshohet edhe në libra të tjerë, e kam një kërkesë, duke filluar nga niveli parafillor e deri në klasat e nënta. Ju faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën!

MINISTRI ENVER HOXHAI: I nderuar zoti kryetar,
Zoti kryeministër, zëvendësministra, ministra,
Shumë e respektuara zonja deputete,
Të nderuar deputetë,

Mendoj që pyetja është vërtet një shqetësim edhe për Ministrinë e Arsimit, mirëpo nga pozita ime jam shumë i interesuar që ta bëj një sqarim të plotë. Ne si Ministri e Arsimit kemi hartuar Kornizën e re të Kurrikulit, e cila është një lloj kushtetute e shkollave fillore dhe të shkollave të mesme dhe e cila së shpejti do të jetë në debat publik në Republikën e Kosovës. Pyetjen të cilën ju e shtroni ka të bëjë me plan-programet lëndore dhe ne jemi shumë të interesuar që në procesin e vlerësimit të plan-programeve lëndore të ketë vërtet përfaqësim gjinor, se shumë tekste shkollore të cilat përdoren sot në Republikën e Kosovës zakonisht janë tekste ku reflektojnë praninë e fuqishme të burrit ose të mashkullit, por për shumë përmbajtje nuk është i pranishëm përfaqësimi i nevojshëm gjinor. Unë ju premtoj që për një gjë të tillë, në momentin kur fillon procesi i rishikimit të plan-programeve lëndore, do t'ju informoj, ndërsa tash për tash ne vetëm kemi përfunduar procesin e hartimit të Kornizës së Kurrikulit si kur është shkruar Kushtetuta e Republikës së Kosovës, jo pa tjetër duhet të zgjidhen ekspertët në bazë të gjinisë, po në bazë të kapaciteteve të tyre që kanë mundësi ta prodhojnë një dokument të tillë. Procesin e rishikimit të plan-programeve do të ndodhë paralelisht me nevojën e hartimit të teksteve të reja dhe paralelisht edhe me nevojën e vendosjes së standardeve të reja për tekstet kombëtare, edhe për tekstin e klasës së nëntë, edhe për provimin shtetëror të maturës e për integrim të gjinisë dhe barazim dhe përfaqësim divers do të ketë në rishikim të plan-programeve, nëse s'ka pasur siç duhet deri më tash në Kornizë të Kurrikulit.

KRYETARI: Faleminderit, ministër!
Deputete, ke pyetje shtesë?

DRITA MALIQI: Falënderoj ministrin, vetëm e kam prapë edhe një lutje, zoti ministër, kërkoj nga Ministria e Arsimit të respektohet Ligji për barazinë ligjore. Kjo ishte sepse sa u përket eksperteve, të cilat kërkova që të jenë nëpër komisione adekuate, eksperte gjinore, për shembull, e thashë edhe më herët, kanë qenë shumë pak pjesëmarrëse, do me thanë prej 20-ve, vetëm një, andaj ju lutem, kërkesa jonë është që të respektohet së paku Ligji për barazinë ligjore në të ardhmen, mos të mbetet vetëm fjalë nga ana e juaj. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI ENVER HOXHAI: Mendoj që ky ligj respektohet edhe në çështje punësimi, edhe në çështje të trajtimit, edhe të përfaqësimit të gjinisë femërore në krejt punët dhe aktivitetet që i ka Ministria e Arsimit. Po, dua të jem shumë specifik. Jam duke biseduar për hartimin e një dokumenti, siç është Korniza e Kurrikulit, e cila është e njëjtë si me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Jo pa tjetër dikush që i takon një gjinie, ka përgatitje të domosdoshme profesionale që të jetë i pranishëm. Në grupin punues ne kemi pasur simbolikisht një përfaqësim të tillë, por dua të them që Republika e Kosovës nuk ka ekspertë të kësaj fushe. Edhe shumë vende të rajonit janë në zhvillim e sipër të

ekspertizës, që vërtet e kuptojmë se çka do të thotë hartimi i një kurrikulumi të ri për një vend të ri, siç është Republika e Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputetja Donika Kadaj - Bujupi, pyetje për ministrin Enver Hoxhaj.

DONIKA KADAJ - BUJUPI: Faleminderit!

Së paku 20 shkolla të reja kanë projektin e njëjtë, mirëpo për çdo shkollë ju paguat projektin enkas. Pyetja është: - Nga sa herë është paguar i njëjti projekt?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI ENVER HOXHAI: E nderuara zonja deputete,

Më lejoni t'ju them që ne si ministri e Arsimit kemi punuar që të ndryshohet edhe dizajni i shkollave, meqë shkollat tona kanë qenë në dizajn shumë të luftës së ftohtë dhe ka pasur nevojë që të duken ndryshe shkollat e reja të Republikës së Kosovës. Në një drejtim të tillë kemi blerë edhe projekte të reja dizajnuese dhe dua ta sqaroj opinionin që këtu është fjala për projekte të reja të dizajnit. Këto projekte janë kontraktuar vetëm një herë, janë blerë vetëm një herë dhe kjo mund të vërtetohet edhe nga publikimet të cilat janë bërë në shtypin ditor, në gazetat ditore nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe absolutisht një projekt nuk është blerë disa herë, si mund të aludojë mënyra se si ju keni shtruar pyetjen parlamentare.

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputete, ke pyetje shtesë?

DONIKA KADAJ - BUJUPI: Ministër, faleminderit, po megjithatë janë mbi 20 shkolla që janë komplet të njëjta dhe në Projektligjin për buxhet çdo herë është deklaruar, realisht, që është paguar çdo projekt enkas. Sidoqoftë, mbasi jemi te ndërtimib gjatë fushatës zgjedhore keni pasur katër tender në komunën e Suharekës për ndërtimin e shkollave të reja moderne, siç po thoni ju, të cilët menjëherë me datën 23.12.2009, janë anuluar pa asnjë arsytim. A është kjo ndonjë ndëshkim për humbjen eventuale në Suharekë a çka po ndodhë?

KRYETARI: Ministër!

MINISTRI ENVER HOXHAI: Mendoj që ky Parlament është i nivelit shtetëror nacional, kështu që nuk merreni me çështje të cilat janë të karakterit lokal. Po dua t'ju informoj të gjithëve, si Kuvendi i Kosovës, që Ministria e Arsimit në vitin 2009, në krahasim me vitin 2009, për vitin 2010 ka 10 milionë më pak buxhet. Ne i kemi 36 milionë buxhet, buxheti është shkurtuar meqë ka pasur nevojë që ministritë tjera të përfitojnë nga ky buxhet. Për një arsye të tillë ka ndodhur edhe anulimi i shprehjes së interesit jo vetëm në komunën të cilën ju e përmendët, por edhe në shumë komuna. Unë isha para 3 ditësh në Pejë dhe një gjë e tillë vlen edhe për Pejë, edhe për rajonet tjera për shkak të buxhetit 10 milionë më pak që ka Ministria e Arsimit për vitin 2010 dhe ju, si deputetë, këtë punë mund ta vërtetoni nga buxheti, i cili është më i vogël se sa vitin e kaluar.

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputeti Emrush Xhemajli, pyetje për ministrin Nenad Rashiq.

EMRUSH XHEMAJLI: Faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndetje të gjithëve!

I respektuar ministër Rashiq,

Dialogu social mes Qeverisë, përfaqësuesve të punëmarrësve dhe të punëdhënësve, përkatësisht të ministrisë suaj, të sindikatave edhe të Odës Ekonomike është me rëndësi për shoqërinë tonë, posaçërisht për momentin që po kalojmë. Pyetja ime konkrete është: - Pasi që ka pasur shumë vështirësi në këtë lëmi, deri ku ka mbërri Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale që të vendos në normalitet dialogun social për funksionimin e Këshillit Ekonomik dhe Social të ministrisë suaj.

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Hvala, gospodine predsedniče!

Dame i gospode narodni poslanici,

Poštovani poslaniče Xhemajli,

Mi smo već od samog početka mandata mogli, mandat ove Vlade odmah inicirali taj socijalni dijalog i jedno od prvih tehničkih stvari koja je primenjena je bio sam naziv onog ko je bio tripartitni ranije, sad je Këshilli Ekonomiko Social, znači Ekonomsko socijalni savet. Od samog početka smo pokrenuli razgovore i sa svim kandidatima, odnosno predstavnicima koji su pre bili u tripartitnom sastavu i onih koji će eventualno biti zajedno sa ostalima u ovom novom savetu i stigli smo do jedne uredbe koju je donela Vlada, na osnovu koje se utvrđuje ko su kandidati, odnosno koje su organizacije koje ispunjavaju uslove da bi ušle u taj savet, Socijalno ekonomski savet, prema tome mi smo dobili u ovom slučaju četiri kandidata, odnosno dva poslodavca, dva predsednika sindikata, znači imamo BSPK, koji sa tri predstavnika od strane radnika ili sindikata, imamo takođe dva predsednika radnika, to je KSLK, i s druge strane Oda Ekonomike, koja ima tri predstavnika i AKB, koja ima takođe dva predsednika. Mi smo od samog početka pa do zadnjeg sastanka, koji je bio u novembru, naglašavali taj početak tog dijaloga. Na žalost, da budem iskren, kod nas ljudi malo uvek shvate to nekako lično i uvek misli da su jedini oni predstavnici koji mogu da predstavljaju određenu grupaciju. Ali u poređenju sa ostalim sistemima u rejonu i van rejona, znači u Evropskoj uniji, svako društvo ima najmanje više sindikata, kad kažem najmanje, i više sindikata, i više predsednika poslodavaca. Prema tome, uz to na čelo, da bi taj savet bio što kvalitetniji, mi smo pokušali da uključimo više ljudi, više predstavnika, naravno onih koji ispunjavaju osnovne uslove i kriterijume koji su bili utvrđeni od strane i tehničke ekipe, od strane Ministarstva i same vlade koja je usvojila te predloge. Ja sam u novembru išao korak napred, rekao sam da moramo da budemo funkcionalni, da imamo konkretne rezultate, pa sam u novembru pozvao i predstavnike poslodavaca, i predstavnike radnika da razmisle o tome da konsultuju svoje članove....

(Ndërprerje nga rexia)

KRYETARI: Edhe një minutë, ministrit!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Hvala, gospodine predsedniče!

Tako da onu stavku koju smo uvek imali kao naznačenu a nikad implementiranu, a to je kolektivni ugovor ili minimalna zarada, da već jednom pokrenemo da to bude funkcionalno. Opet još jednom kažem, mi smo to imali na papiru kolektivni ugovor, ali na žalost do sad nikad nije poštovan. U februaru nadam se da će ovi predstavnici imati konkretne svoje predloge jer ćemo mi kao Ministarstvo imati konkretne predloge za kolektivni ugovor ili za minimalnu zaradu. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!
Urdhëro, deputet, ke pyetje shtesë?

EMRUSH XHEMAJLI: U sqarua këtu mirë sa i përket mos pjesëmarrjes së BSPK-së. Mirëpo, aty edhe Oda Ekonomike nuk është duke marrë pjesë. Kjo nuk u sqarua.

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Na zadnjem sastanku smo imali jednu od tačaka dnevnog reda i bilo je pokretanje pregovora sa oba partnera koji do sada svojim prisustvom nisu dali saglasnost da to tako nazovem. Ti pregovori su u toku. Takođe ja znam da intenzivno i OESC i neke druge organizacije rade na tom dijalogu, pre svega razgovaraće se sa njima i pokazujući im konkretne primere iz ostalih regiona. Bez obzira, mi ćemo i dalje nastaviti, jer ja verujem da dijalog kao što i sam savet znači, taj socijalni dijalog, ukoliko treba da počnemo naš konkretan dijalog, mi smo tu. Absolutno, ja uvek dajem preporuke, dajem sugestije, dajem svoja mišljenja kao nešto....

KRYETARI: Faleminderit!
Deputetja, Njomza Emini, pyetje për ministrin Skender Hyseni. Deputetja s'qenka këtu. Vazhdojmë, deputeti Shkumbin Demaliaj, pyetje për kryeministrin.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Me qenë se është aktuale shumë në mediat e Kosovës, por kryesisht edhe në qarqet qeveritare dhe politike në Kosovë lidhur me pranimin e strukturave paralele në mbarë territorin e Kosovës, dihet se pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës dy pikat doganore 1 dhe 31 më nuk funksionojnë, se janë djegur nga dikush. Dihet mirëfilli se ka policë ndërkombëtarë të vrarë me rastin e uzurpimit të Gjykatës në Mitrovicë, dihet se në mbarë territorin e Kosovës janë mbajtur zgjedhje nga dikush jashtë ligjshëm, duke shkelur Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Qeveria e Kosovës vetëm ka heshtur në këtë rast dhe nuk i ka kundërshtuar ato, pavarësisht heshtja është pranim.

KRYETARI: Besoj që kryeministri e dinë pyetjen. Ju lutem, bëne pyetjen, ju e dini kohën sa kohë keni. Kryeministër, e ke fjalën.

KRYEMINISTRI HASHTIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë, Kabinet qeveritarë,

I nderuar Demaliaj,

Do të dëshiroja me dëshirën më të madhe të kuptoja pyetjen tuaj, se sinqerisht nuk e kuptova se kush është ai dikush, nga dikush, nga dikush, cila është pyetja juaj konkrete?

KRYETARI: Deputet, bëje pyetjen, po bëje pyetjen me kohë. Fjalën e ka deputeti Demaliaj. Regjia, fjalën deputetit Demaliaj, kontrolloje kartelën, shtype butonin!

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, zoti kryetar, edhe një herë!

Po them nga dikush, sepse me rastin e vizitës së tij, kryeministri i Kosovës në Prizren thotë se në Kosovë nuk ka struktura paralele, por janë vetëm disa individë. Pikërisht e thashë dikush, se ai nuk e ka kuptua këtë, dhe pyetja është: - A ka struktura paralele në Kosovë apo jo, zoti kryeministër, apo vartësit tu janë kah e gënjejnë popullin apo dikush tjetër është kah rren. Vartësit tu thonë se ka, edhe atëherë pse i duhet strategjia e Kosovës për zhbërjen e strukturave paralele me qenë se në fjalën, deklarin tuaj publik thoni se nuk ka.

KRYETARI: Deputet, tjera herë pyetjen e bë me kohë edhe të kesh kujdes fjalorin parlamentar. Zoti kryeministër, e ke fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuari Demaliaj,

Ju e dini që në Kosovë që nga viti 1999 ka pasur individë të cilët nuk kanë pasur vullnet për të pranuar realitetin pas vitit '99, realitetin për t'i pranuar institucionet legjitime të Republikës së Kosovës. Këtë periudhë e kemi kaluar bashkërisht me autoritetet ndërkombëtare. Ndërsa, dua të theksoj se roli i këtyre individëve tashmë është zbehur maksimalisht dhe dëshmia më e mirë për këtë çështje është organizimi i suksesshëm i zgjedhjeve dhe formimi i komunave të reja dhe zgjedhja e liderëve të rinj të komunitetit serb. Unë para pak ditësh isha edhe në vizitë në këto komuna, kam taktuar këta kryetarë, i kam takuar edhe sot para se të vijë në këtë takim. Prandaj, nëse krahasojmë të kaluarën me të sotmen, mund të them se kemi ndryshime radikale në kuptimin më pozitiv të mundshëm. Tanimë dua të theksoj se këta individë nuk do të kenë as edhe ndikimin më të vogël në institucionet apo në pretendimet e tyre të cilat kanë qenë të nxitura. Dua të theksoj se pikërisht në kuadër të kësaj, edhe formimi i komunave të Graçanicës, të Ranillugut, të Klllokotit dhe të komunës së zgjeruar të Artanës ka qenë një sukses i jashtëzakonshëm, sukses ky që do të vazhdojë tash me implementimin e strategjisë, e cila nënkupton sundimin e ligjit pikë së pari, e dyta, zgjedhjet në komunën e re të Mitrovicës, funksionalizimi i rendit demokratik me tri komunat tjera dhe investimi në çështjet socio-ekonomike. Është strategji që është punuar nga qeveria e Kosovës, nga institucionet ndërkombëtare të mbështetura dhe sot ju konfirmoj se do të punoj për t'i integruar edhe angazhimet profesionale opozitare që kjo strategji të jetë një strategji unike e shtetit të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, kryeministër!

Deputet, ke pyetje shtesë, edhe pse po ta vazhdojmë kohën?

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Po i përgjigjem kryeministrit në atë, se unë i thashë dikush, ai tha individ. Tash s'po dimë për kënd po flasim, por citoj vetëm nga Kushtetuta dhe ligjet që i kemi në fuqi. Ne e kemi Ligjin për decentralizimin, shpjegoi prej pakos, nuk ma dha përgjigjen e drejtë se a ka struktura paralele në Kosovë apo jo, edhe atë po them të Serbisë, unë po e them tash – të Serbisë në Kosovë. Ata janë duke i mbajtur me ligj edhe publikisht mediat e Beograd, japin se kanë organizuar edhe gjyqtarë për gjykatat e Kosovës, edhe mjete buxhetore që nuk vinë kur drejtë institucionit të Kosovës, ashtu siç jemi marrë vesh nëpërmjet ligjeve që burojnë nga pakoja. Edhe ato vinë, hynë në Kosovë asnjëherë pa..., edhe pse ekziston tash një marrëveshje që Qeveria e Kosovës ka thënë se është e jashtëligjshme dhe i ka ngul këmbët deri në fund për mos t'u bërë marrëveshja protokulare mes EULEX-it, Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Qeverisë së Serbisë, ato të gjitha po ndodhin dhe ne i shpjegojmë ligjet që i kemi në fuqi dhe marrim amendamente kushtetuese, ju themi edhe deputetëve. Faleminderit shumë, gjithçka është e papërgjegjshme.

KRYETARI: Kryeministër, e ke fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Zoti Demaliaj, ju e dini se unë e çmoj shumë kështu patriotizmin tuaj të vazhdueshëm. Në anën tjetër, dua të potencoj se unë kam përgjegjësi shtetërore dhe ata njerëz të cilët nuk respektojnë Kushtetutën dhe ligjin e Kosovës do të ballafaqohen me ligjin e Kosovës, pra me sundimin e ligjit dhe me të gjitha angazhimet që i kemi shtetërore. Gjithashtu, dua të theksoj se formulimi

“strukture” është një nocion shumë i gjerë dhe bëje këtë dalim. Në anën tjetër, unë nuk mund t’i qesë hi syve opinionit publik, por do të ballafaqohem me gjendjen jo të pëlqyeshme në Veri të Mitrovicës dhe pikërisht kjo është edhe arsyeja që kemi nxjerrë strategjinë, që unë e quaj integruese për demokratizimin edhe të asaj pjese të Republikës së Kosovës dhe integrimin e të gjitha komuniteteve dhe kjo përfshin, i përmenda, 4 pika të cilat ju ftoj të gjithëve të jeni ndihmues dhe angazhues në realizimin e këtij projekti të rëndësishëm, por e theksoj edhe sot, nuk do të lejojmë të përdoret dhuna, siç pretendoni në angazhimet që i keni prezantuar.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Deputetja Qamile Morina, pyetje për kryeministrin Thaçi.

QAMILE MORINA: Jo, unë nuk kam për kryeministrin Thaçi, për ministrin e Shëndetësisë.

Ju faleminderit, zoti kryetar!

Vdekshmëria nga sëmundjet kardiale zë vendin e parë në botë, por edhe në Kosovë. Andaj, themelimi i kardio-kirurgjisë publike ka qenë dhe mbetet një nga projektet më prioritare të interesit të lartë shtetëror. Që nga viti 2004, ekziston memorandum bashkëpunimi dhe projekti: “Një zemër ndihmon tjetrën”, që është arritur në mes të Ministrisë së Shëndetësisë tonë dhe palës italiane me përfaqësuesit e spitalit me renome ndërkombëtare “San Donato”.

Pjesa obliguese e projektit nga pala italiane është kryer me sukses ngase janë shpenzuar me qindra mijëra euro për përgatitjen dhe edukimin e kuadrit kardio-kirurgjik. Pjesa e projektit që e obligon palën kosovare, po prolongohet pa kuptim. Qeveria e Kosovës, nga buxheti i Kosovës, nga të hollat e qytetarëve tanë ka shpenzuar me miliona euro për këtë projekt. Kërkesat e mia të deponuara tash e sa muaj në Ministrinë e Shëndetësisë për qasje në dokumente zyrtare lidhur me të dhënat e sakta për investimet e gjertanishme për projektin e kardio-kirurgjisë, nuk më janë mundësuar. Zoti ministër, përse po prolongohet një projekt aq i rëndësishëm për qytetarët e Kosovës, për buxhetin e Kosovës, ngase vetëm vitin e kaluar keni shpenzuar 2.5 milionë për trajtimin e këtyre pacientëve jashtë vendit?

KRYETARI: Deputete, adresimin e ke pasur për kryeministrin, por pyetja qenka bërë për ministrin. Urdhëro, ministër, e ke fjalën!

MINISTRI ALUSH GASHI: E nderuara zonja deputete, për Qeverinë e Republikës së Kosovës, shëndetësia është një ndër prioritetet kryesore. Unë jam i vetëdijshëm që shëndetësia është sfidë jo vetëm për Kosovën, por edhe për shumë vende në zhvillim. Janë shumë faktorë rëndues që determinojnë cilësinë e shërbimeve shëndetësore për popullatën, janë faktorët ekonomik, janë menaxherial, analitik, profesionalizmi mjekësor e tjera. Megjithatë, sukseset dhe mossukseset në shëndetësi, pa marrë parasysh këto që i thashë më parë, janë shqetësim dhe angazhim i imi personal dhe, besoj, edhe i juaj si mjeke, deputete dhe sinqerisht e vlerësoj lartë kërkesën tuaj për ndryshime pozitive në këtë drejtim dhe shpresoj se kontributi juaj për angazhime konkrete nuk do të jetë në të ardhmen vetëm konkludues, por do të jetë prezantues së bashku me Ministrinë e Shëndetësisë, Grupin parlamentar, menaxherët, do të jenë aktiv në drejtim të ndryshimit të gjendjes në sektorë vital për popullatën tonë.

Projekti që ju keni përmendur në pyetjen, nga mjekët e San Donatos, nga Milano të Italisë, është i qartë, siç janë të qarta edhe projektet e Universitetit të Manhajmit, në

Gjermani, të mjekëve nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, “Shpresa e Jetës” në Francë, spitalet universitare të Çekisë, spitalet universitare të Turqisë, Qeveria e Luksemburgut, Qeveria e Shqipërisë dhe kështu me radhë. Këto janë projekte shumë të rëndësishme për popullatën dhe për Qendrën Klinike Universitare të Republikës së Kosovës, në veçanti. Për këtë qëllim, Kardio-kirurgjia që ju e përmendët, është sinqerisht një angazhim personal, një projekt të cilin ju e dini mirë se në çfarë gjendje e kam gjetur. Për këtë qëllim, Ministria të cilën unë e drejtoj me bekimin tuaj, vetëm gjatë vitit të kaluar ka investuar 750.000 euro për përgatitjen e hapësirave për Kardio-kirurgji. Për këtë vit ne do të angazhohemi që ta kompletojmë me aparaturë, së bashku me Qeverinë italiane, ku i kemi vu inicialet në marrëveshjen ndërshtetërore, ku Qeveria italiane në tri vitet e ardhshme do ta ndihmojë shëndetësinë e Republikës së Kosovës me një vlerë 3.5 milionë dhe në kuadër të kësaj - 1.7 milionë për pajisje për kardio-kirurgji. Për sa i përket...

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër! Deputete, ke pyetje shtesë?

QAMILE MORINA: Zoti ministër, pyetja ime ka qenë shumë konkrete. Përgjigjen tuaj të përgjithësuar unë e konsideroj cinike karshi përgjegjësisë që keni për projektin aq të rëndësishëm për qytetarët tanë. Faktet janë: Infrastruktura për këtë projekt është kryer mbi 90%, stafi i edukuar dhe i përgatitur tash e sa vite në Itali, është i përgatitur të fillojë punën. Përkrahja profesionale dhe financiare vazhdon të premtohet nga Qeveria italiane... Pyetja ime është: - A mundeni sot qytetarëve të Kosovës t’ju tregoni se kur konkretisht Ministria e Shëndetësisë planifikon ta hap kardio-kirurgjinë e aq prituri për qytetarët tanë?

KRYETARI: Ministër, e keni fjalën!

MINISTRI ALUSH GASHI: Zonja deputete, përshkrimin e cinizmit, sado që nuk më vjen mirë, kur është nga ju - tingëllon bukur. Vetëm mund t’ju them se institucionet shëndetësore të Republikës së Kosovës 98% të buxhetit për shërbime shëndetësore e realizojnë brenda vendit. Qytetarët e vendit tonë aktualisht për trajtim jashtë vendit shkojnë për radio-terapi, e cila do të funksionalizohet në Republikën tonë herën e parë, shpresoj më së largu deri në fillim të marsit dhe për kardio-kirurgji ne i kemi bërë të gjitha përgatitjet për fillim të kardio-kirurgjisë në këtë vit.

Kuvendi i Republikës së Kosovës me Buxhetin për vitin 2010, ka lejuar rritjen e numrit të punëtorëve shëndetësorë dhe në kuadër të saj do të jetë punësimi, bërja pjesë e sistemit të atyre që kanë shkuar në specializim, të cilëve me sistem të vjetër të specializimeve nuk ju ka garantuar vendi i punës. Ne jemi të ndërgjegjshëm se kjo pjesë nuk është e lehtë, është çështje e një dije të nivelit më të lartë, e cila nuk ka sekret, nuk ekziston. Ju jeni të ndërgjegjshëm se nuk e keni atë dije. Prandaj, ne do të vazhdojmë që këtë ta zhvillojmë gjatë këtij viti dhe, besoj, do ta kemi Kardio-kirurgjinë publike, por edhe Kardio-kirurgjinë private në kuadër të partneritetit publiko-privat. Sa i përket deklaratës për qasje në dokumentet zyrtare, zonja deputete, ju e dini se deklarata juaj nuk qëndron. Jeni të mirë se ardhur në çdo moment që atë ta merrni dhe jeni të ftuar si Komision parlamentar për Shëndetësi dhe do ta keni në zyrën në ministri të Shëndetësisë...

KRYETARI: Ju faleminderit!

Pyetja e fundit, deputetja Njomza Emiri, pyetje për ministrin Skender Hyseni. Kam respektuar, çdo deputeti t’ia japë të drejtën për pyetje.

NJOMZA EMINI: Ju faleminderit, kryetar!

I nderuari Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Çështja: sipas raportimeve në media, në Haiti punojnë disa kosovarë, përderisa Ligji për Ministrinë e Punëve të Jashtme thekson qartë se arsyeja e kësaj ministrie që të mbrojë, në mes tjerash, edhe shtesat që jetojnë jashtë vendit. Pyetja: - A ka informacion Ministria e Punëve të Jashtme për gjendjen e kosovarëve që punojnë në Haiti? Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI SKENDER HYSENI: I nderuari kryetar!

Të nderuar deputetë,

E nderuara deputete Emini,

Përgjigja është e shkurtër. Ministria e Punëve të Jashtme ka informacion të bollshëm dhe ai informacion në thelb thotë që, fatbardhësisht, asnjë qytetarë i Kosovës nuk ka pësuar në tërmetin në Haiti. Nga listat që Ministria e Punëve të Jashtme ka në dispozicion, listat edhe të të vdekurve, por edhe të të lënduarve në tërmetin katastrofal që ka goditur kryeqytetin e Haitit Porto Princ, nuk figuron asnjë qytetar i Kosovës.

Në anën tjetër, siç e thatë edhe ju, në funksion të mandatit të Ministrisë së Punëve të Jashtme për përfaqësim dhe mbrojtje të interesave të shtetasve të Republikës së Kosovës dhe në cilësinë time, si drejtues i këtij shërbimi, kam urdhëruar marrjen e menjëhershme të të gjitha masave në dispozicion për mbledhjen e informacioneve rreth qytetarëve të Kosovës në Haiti. Më saktësisht, kam angazhuar Ambasadën e Republikës së Kosovës në Uashington dhe Konsullatën e Përgjithshme të Republikës së Kosovës në Nju Jork për të kontaktuar edhe misionin e OKB-së në Haiti, por edhe vetë OKB-në në Nju Jork. Natyrisht, kjo është bërë përmes misioneve mike të Republikës së Kosovës në Nju Jork. Informatat e fundit flasin për 44 qytetarë të Evropës të vdekur në misionin e OKB-së në Haiti. Fatbardhësisht, edhe një herë po e përsëris, në mesin e këtyre 44 evropianëve, nuk ka qytetarë të Kosovës.

Ministria e Punëve të Jashtme dhe ambasada jonë në Uashington, edhe Konsullata kanë ofruar për opinionin e gjerë tre numra telefoni, të cilët Ministria e Punëve të Jashtme në Prishtinë ua ka shpërndarë të gjitha medie, përmes të cilëve anëtarët e familjeve që i kanë të afërmit e tyre në Haiti, mund të interesohen direkt për fatin e tyre, sepse është rregull strikët i misioneve të OKB-së që mos të japin informacione për qytetarë të asnjë vendi pa e specifikuar qytetarin me emër dhe mbiemër. Në anën tjetër, të gjithë qytetarët e Kosovës që mund të jenë...

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër! A ke pyetje shtesë, deputete? Më duket se nuk pati nevojë. Mirë, ju faleminderit!

Pyetjet e deputetëve që nuk marrin përgjigje në dy seanca plenare, do të publikohen në revistën e Kuvendit.

Vazhdojmë me pikën e radhës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Kryqin e Kuq të Kosovës

Në bazë të Rregullës 35 pika 1 të Rregullores të Punës janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij Projektligji. Ftoj ministrin e Shëndetësisë, zotin Alush Gashi, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë Projektligjin.

MINISTRI ALUSH GASHI: I nderuar zoti kryetar,
Të nderuar ministra,
Zëvendëskryeministra,
Deputetë,

Projektligji i Kryqit të Kuq të Kosovës adreson çështjet që kanë të bëjnë me fushën e humanitetit, të shëndetësisë, të çështjeve sociale dhe të drejtat humanitare ndërkombëtare, rregullimin ligjor dhe përmbushjen e detyrave të Kryqit të Kuq të Kosovës në rast të fatkeqësive natyrore, të fatkeqësive tjera në përmasa të gjëra, të epidemive, të konflikteve të armatosura.

Me këtë projektligj krijohet infrastruktura ligjore për Kryqin e Kuq të Kosovë si shoqatë kombëtare humanitare, vullnetare, jo përfituese dhe ndihmëse e autoriteteve qeveritare në fushën humanitare. Në çdo shtet ekziston një Kryq i Kuq apo një Gjysmë Hane e Kuqe dhe kanë ligjet e veta. Me këtë projektligj rregullohet statusi, veprimtaria dhe burimet financiare të Kryqit të Kuq kombëtar të Kosovës. Projektligji rregullon pozitën dhe autorizimet e Kryqit të Kuq të Kosovës, si të vetmit Kryq të Kuq në tërë territorin e Republikës së Kosovës në fushën humanitare, në veprimtarinë e vetëdijesimit, të promovimit dhe të edukimit shëndetësor të popullatës, të mbrojtjes sociale, respektimin e të drejtës humanitare ndërkombëtare, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si dhe promovimin e vlerave humanitare.

Kryqi i Kuq i Kosovës me këtë projektligj rregullon, realizon veprimtari humanitare dhe promovon njohuri mbi lëvizjen e Kryqit të Kuq të Kosovës dhe edukimin shëndetësor të popullatës, mbrojtjen sociale, respektimin e të drejtës humanitare ndërkombëtare. Kryqi i Kuq i Kosovës me veprimtari të posaçme angazhohet në situata të fatkeqësive natyrore, ekologjike, të fatkeqësive tjera, të epidemive dhe të konflikteve të armatosura, duke i përmbushur detyrat e veta konform konventave të Gjenevës, të 12 gushtit të vitit 1949, për mbrojtjen e viktimave të luftës dhe të protokolleve shtesë.

Kryqi i Kuq i Kosovës bashkëpunon dhe zhvillon marrëdhënie me komponentë të lëvizjes ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmë Hënës së Kuqe, organizatat ndërkombëtare humanitare, shëndetësore dhe sociale. Kryqi i Kuq i Kosovës bashkëpunon me autoritetet shtetërore të të gjitha niveleve. Për realizimin e detyrave dhe të obligimeve të përcaktuara me këtë projektligj, Kryqi i Kuq i Kosovës siguron mjete financiare të specifikuara me këtë projektligj. Projektligji posedon tërë infrastrukturën juridike të përcaktuar për hartim, procedim dhe miratim të ligjeve në Kuvendin e Kosovës. Andaj, propozoj miratimin në parim dhe procedimin e mëtutjeshëm të Ligjit të Kryqit të Kuq të Kosovës. Ju faleminderit për vëmendje!

Drejtimin e seancës e merr anëtar i Kryesisë, zoti Naim Maloku

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti ministër!

Hapi debatin për diskutim, në parim. Në emër të Komisionit funksional për Punë, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, nuk shoh që ka kërkuar dikush fjalën. Kryetarët e komisioneve të tjera, unë i kam disa emra. Në emër të grupeve parlamentare, ftoj deputeten, Flora Brovina, që në emër të Grupit parlamentar të PDK-së ta marrë fjalën.

FLORA BROVINA: I nderuari kryesues,
Zotëri ministra,

Zonja ministre,

Kolegë dhe kolege,

Sot po e shqyrtojmë një projektligj në fushën humanitare me shumë rëndësi në lëmin e vetëdijesimit, të promovimit, të edukimit shëndetësor dhe të vetëdijes solidarë, të respektimit të mbrojtjes sociale dhe të respektimit të së drejtës humanitare, të drejtave të njeriut dhe të përmirësimit të vlerave humanitare, e ky është Ligji i Kryqit të Kuq të Kosovës.

Kosova ka pasur një organizim të Kryqit të Kuq që nga viti '45 deri më '91, kur u suspendua ky organizim ose Kryqi i Kuq i Kosovës. Më vonë, u vetorganizuan aktivistët e Kryqit të Kuq, por tani në formë të një organizate joqeveritare, që nuk përkon me vetë detyrat dhe obligimet që duhet t'i ketë Kryqi i Kuq i një vendi, pra jo si një organizatë nacionale, masovike dhe qeveritare, qysh funksionojnë kryqet e kuqe në secilin shtet. Përpjekjet për ta nxjerrë një ligj për Kryqin e Kuq të Kosovës kanë qenë të vazhdueshme që në fillim të formimit të Kuvendit të Kosovës, por kjo nuk ka qenë e mundur për shkak të vetë statusit të Kosovës. Pra, kjo u bë e mundur vetëm pas shpalljes së pavarësisë dhe tani këtë ligj po e shqyrtojmë për herë të parë.

Ky Projektligj është i qartë, i saktë dhe është përpiluar në bazë të Rregullores ndërkombëtare për organizimin nacional të Kryqit të Kuq të shteteve të caktuara dhe, natyrisht, edhe në bazë të modelit të këtij organizimi në shtetet e regjionit. Unë kujtoj madje që, duke e krahasuar këtë legjislacion me shtetet e regjionit, kujtoj që është më i mirë se sa në këto shtete dhe si i tillë, pajtohem edhe në emër të Grupit Parlamentar, se Projektligji i plotëson kushtet për shqyrtim të parë dhe nuk ka nevojë për shumë amendamentim, vetëm nëse ne duam ta plotësojmë me specifikat tona të vendit. Këtu e kam fjalën, në radhë të parë, me shënimin e datave të caktuara që për ne mund të jenë edhe karakteristike. Për shembull, është dhënë një propozim nga organizatat që mbrojnë fëmijët jetimë të Kosovës, sidomos fëmijët luftës. Kjo kërkesë është dorëzuar edhe te Presidenti, që 20 maji të quhet dita e jetimëve të Kosovës dhe besoj që Kryqi i Kuq mund të solidarizohet dhe ta marrë për sipër këtë datë. Gjithashtu, mund ta marrim një datë për ta përkrahur dhe për të qenë solidar, pra Kryqi i Kuq ta marrë një datë tjetër për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës. Kryqi i Kuq duhet, gjithashtu, ta shënojë datën e personave të zhdukur, që është në gusht.

Këtë, natyrisht, do ta arsyetojmë në komision dhe pas një arsyetimi të mjaftueshëm ose jo, mund ta plotësojmë me këto kërkesa. Vërejtja ime tjetër kishte për të qenë për detyrat që Kryqi i Kuq nacional i ka në lidhje me burgjet, me kontrollimin e burgjeve, kushtet e burgjeve dhe një sërë detyrash tjera që janë të domenit social, por edhe të komunikimit, të kontrollimit të higjienës, të plotësimit të nevojave me medikamente e tjera, e tjera. Në këtë aspekt, edhe komunikimi i Kryqit të Kuq të Kosovës me Kryqin e Kuq Ndërkombëtar dhe Kryqin e Kuq Nacional në shtetet ku qytetarët e Kosovës ndodhen në burgje për ndonjë arsye dhe për të lidhë komunikimin e tyre me familjarët në Kosovë. Kujtoj që këto ishin vërejtjet që pata për t'i thënë sa u përket principeve themelore që Kryqi i Kuq i ka, këto janë përfshirë, 7 principet kryesore: paanësia, neutraliteti, pavarësia, vullnetarizmi, uniteti dhe univerzaliteti janë përfshirë në këtë projektligj dhe gjithashtu parashihet edhe nxjerrja e shenjave nacionale të Kryqit të Kuq të Kosovës, e që janë flamuri dhe emblema dhe kjo sigurisht do të nxirret me Ligjin që në rend dite është i veçantë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputete! Në emër të Grupit parlamentar të LDK-së, ftoj deputeten Nurishahe Hulaj ta marrë fjalën.

NURISHAHE HULAJ: Ju faleminderit!

I nderuar kryesues i Kuvendit,

Kabinet qeveritar,

Deputetë të respektuar,

Para nesh kemi një e projektligj shumë të rëndësishëm për herë të parë në shtetin e Kosovës.

Grup parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për Kryqin e Kuq të Kosovës dhe e konsideron se është nevojë e domosdoshme për rregullimin ligjor të pozitës dhe autorizimet e Kryqit të Kuq të Kosovës si shoqatë kombëtare në përmbushjen e misionit të vet në rrafshin kombëtar dhe pranimit ndërkombëtar. Me këtë projektligj krijohet infrastruktura ligjore e Kryqit të Kuq të Kosovës, si shoqatë vendore, humanitare, vullnetare, joprofitabile, por edhe ndihmesë e autoriteteve qeveritare në fushën humanitare. Gjithashtu, me këtë projektligj adresohen çështjet që kanë të bëjnë me fushën e humanitetit, të shëndetësisë, të sociale dhe të të drejtave humanitare ndërkombëtare, rregullimin ligjor në përmbushjen e detyrave të Kryqit të Kuq të Kosovës në rast të fatkeqësive natyrore, ekologjike, të fatkeqësive të tjera në përmasa të gjëra, të epidemive dhe të konflikteve të armatosura si dhe formimi i shërbimit të kërkimit.

Qëllimi i Projektligjit është: 1) rregullimi i statusit, 2) veprimtaria dhe 3) burimet financiare të Kryqit të Kuq të Kosovës. Çështjet e strukturara në Projektligjin për Kryqin e Kuq të Kosovës iu janë referuar modeleve të ligjeve të Kryqit të Kuq slloven dhe të Zyrës ligjore të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq në Gjenevë, konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949, dhe protokolleve shtesë, si dhe rregulloreve të lëvizjeve. Projektligji është në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si dhe është me interesin e përgjithshëm të Kosovës dhe të popullit të saj. Andaj, Kryqi i Kuq i Kosovës obligohet që me ligj t'i përmbushë detyrat e lëvizjes ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmë Hënës së Kuqe, si komponentë e saj dhe si anëtare e Federatës Ndërkombëtare të Shoqatave të Kryqit të Kuq dhe Gjysmë Hënës së Kuqe.

Është me rëndësi të ceket se me këtë projektligj rregullohet përkrahja institucionale, respektivisht Qeveria e Republikës së Kosovës i siguron mjete Kryqit të Kosovës që të veprojë si ndihmëse në sferën humanitare për përmbushjen e detyrave sipas nenit 10 të këtij projektligji. Në këtë referohet edhe ndikimi i vlerësimit buxhetor. Projektligji është adoptuar në nivel të Bashkimit Evropian.

Kryqi i Kuq, si shoqatë kombëtare, siguron mjete financiare nga anëtarësimi në Kryqin e Kuq të Kosovës, nga aktivitetet tradicionale - javët e Kryqit të Kuq, nga donacionet, nga 1% nga vlera e sigurimit të automjeteve, nga 50% nga fondi i ndarë për përmbushjen humanitare nga Lotaria e Kosovës dhe 50% nga lojërat e fatit. Kryqi i Kuq i Kosovës lirohet nga doganat, tatimet dhe taksat.

Vlerësimi i ndikimit buxhetor do jetë në varësi të mundësive buxhetore të Buxhetit të Republikës së Kosovës dhe të vendimeve që mund të merren përmes procesit të rregullt buxhetor për nivelin e financimit për Kryqin e Kuq të Kosovës.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrah, në parim, Projektligjin për Kryqin e Kuq të Kosovës dhe ne do japim kontributin tonë në përpunimin e mëtejshëm të këtij projektligji. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete!

Në emër të Grupit parlamentar të AAK-së, ftoj deputeten Gjylnaze Syla ta marrë fjalën.

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar qeveritarë,

Deputetë të nderuar,

Më lejoni së pari të shpreh kënaqësinë që e kemi këtë projektligj sot në shqyrtimin e parë, por njëkohësisht po filloj menjëherë me një pyetje për zotin ministër, se ky projektligj është planifikuar në vitin e kaluar me Strategjinë legjislative të Qeverisë, diku në shtator të vitit 2009, dhe kemi një vonesë prej 4 muajve. Prandaj, kisha dashur që zoti ministër të na informojë pse kemi një vonesë prej 4 muajve. Pra, me këtë projektligj sigurohen rregullat ose formohet korniza ligjore me të cilën do të rregullohet statusi dhe veprimtaria e Kryqit të Kuq të Kosovës, do të thotë si shoqatë e vetme humanitare, joprofitabile, vullnetare, por që është edhe ndihmesë e organeve publike për çështjet e ndryshme humanitare në Kosovë.

Deri më tani, Kryqi i Kuq i Kosovës ka vepruar si OJQ, por duke marrë parasysh nevojën që Kryqi i Kuq të veprojë brenda vendit, por gjithashtu të jetë pjesë e organizmave ndërkombëtarë, do të thotë të pranohet në lëvizjen ndërkombëtare të Kryqit të Kuq, atëherë është e nevojshme që kjo të rregullohet me ligj. Janë në nivelin kombëtar, unë dëshiroj të përmendi sidomos dy aktivitete të vonshme të Kryqit të Kuq, siç janë përmbytjet në Shqipëri, kurse sa i përket aktiviteteve me rastin e tërmetit katastrofal në Haiti, unë besoj se Kryqi i Kuq i Kosovës mbase nuk mund të zhvillojë sa duhet aktivitetin, meqenëse nuk është pjesë e mekanizmave ndërkombëtar. Po e përmendi domosdoshmërinë e hartimit të këtij projektligji dhe pranimin në parim sot, sidomos për shkak të pranimit ndërkombëtar, se duhet të plotësohen tri kritere në nivelin ndërkombëtar dhe këto tri kritere janë: e para, duhet të krijohet në territorin e një shteti të pavarur, e dyta, Kryqi i Kuq të jetë i vetmi Kryq i Kuq kombëtar ose Gjysmë Hënë e Kuqe, pastaj duhet të njihet nga Qeveria e vendit dhe, natyrisht, duhet të respektohen shtatë parimet themelore të lëvizjes së Kryqit të Kuq dhe Gjysmë Hënës së Kuqe. Meqenëse duhet të plotësohen këto kritere që Kryqi i Kuq i Kosovës të jetë pjesë e organizmave, atëherë natyrisht që ky ligj është i domosdoshëm.

Me qenë se me aktivitetet e veta Kryqi i Kuq ndërkombëtar ndihmon gjithashtu dhe zhvillon programe me Qeverinë dhe sidomos me Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Punës dhe të Mirëqenies, por edhe me Ministrinë e Transportit përmes Ligjit për sigurimin e komunikacionit, Ministrinë e Forcës dhe ministritë e tjera, është me rëndësi që të ruhet autonomia e kësaj organizate. Po ashtu, veprimtaria e Kryqit të Kuq, sikurse edhe veprimtaria e Kryqit të Kuq të organizatave tjera dhe të Kosovës mbështeten kryesisht në Konventën e Gjenevës të vitit '49, por edhe në protokollet e vitit '77 dhe 2005.

Sa i përket fushëveprimtarisë, pra në esencë është humanitare, por zhvillohen edhe veprimtari të tjera, sidomos ato që kanë të bëjnë me çështje shëndetësore, por edhe në rastet e fatkeqësive natyrore, ekologjike të epidemive, të konflikteve të armatosura, çështjet sociale dhe mos ta harrojmë një çështje shumë të rëndësishme të cilën sot e vuan Kosova e kjo është çështja e personave të pagjetur, kurse Kryqit i Kuq i Kosovës i bën shërbimet e kërkimit, do të thotë e bën rivënien e lidhjeve familjare.

Sa i përket përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së, kjo fushë nuk rregullohet me një ligj të posaçëm, por është përgjegjësi e shteteve të veçanta anëtare të BE-së, ndërsa mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji e bëjnë ministrat e veçanta. Një problem që unë e shoh dhe sfidë në zbatimin e këtij projektligji, është sidomos mënyra ose burimet e financimit, mbase ministri mund të na japë një sqarim, ose të atyre burimeve të financimit që ka nga aktivitetet tradicionale, pastaj nga 1% i vlerës së sigurimit të automjeteve dhe 50% nga fondi për mbështetje humanitare nga Lotaria e Kosovës dhe lojërat e fatit, megjithatë vlerësimi i ndikimit buxhetor thotë se mund të sjellë probleme dhe mund të ketë ndikime ose efekte negative në buxhet.

Nga ana tjetër, thuhet se në deklaratë është bërë harmonizimi i Projektligjit të Kryqit të Kuq të Kosovës me Kodin doganor të Republikës së Kosovës, Ligjin për lojërat e fatit dhe Ligjin për tatimin në të ardhurat e korporatave. Zoti ministër, a është kështu për arsye se mendoj që problemi në zbatimin e projektligjit mund të jetë pikërisht për shkak të mënyrës së financimit.

Në fund, dëshiroj t'i përmend edhe disa mangësi të këtij projektligji, të cilat gjithashtu duhet evituar. Është e paqartë se cilat akte nënligjore do të nxirren dhe kush do t'i nxjerrë këto akte nënligjore. Vërejtja e përgjithshme është se duhet më saktë të definohet institucioni i Kryqit të Kuq, është e paqartë se a është shoqatë e vetme qendrore, në nivel qendror, apo është bashkësi e shoqatave nëpër komuna. Neni 2, duhet të përmirësohet, sepse është e definuar si e vetmja shoqatë humanitare, kombëtare, vullnetare e tjerë, mirëpo ky formulim përjashton ekzistimin e organizatave tjera, që është në kundërshtim, pra, me Kushtetutën dhe me Konventën ndërkombëtare për të drejtën e asociimit dhe të organizimit në shoqata. Prandaj, mendoj që vetëm aspekti i formulimit më të mirë duhet të jetë dhe kjo duhet të bëhet në komision. Po ashtu, sa i përket nenit 6, i cili flet për emblemën e Kryqit të Kuq, pasi që kjo është e definuar më shumë në vetë Projektligjin e veçantë për emblemën e Kryqit të Kuq, mendoj që dispozitat e nenit 6 duhet të kalojnë në Projektligjin për emblemën e Kryqit të Kuq. Me gjithë mangësitë të cilat i përmenda, për shkak të rëndësisë që e ka ky projektligj dhe domosdoshmërisë, po ahtu për shkak të interesit që ka Kosova, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës në parim e përkrah. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, ftoj deputeten Rita Hajzeraj ta marrë fjalën.

RITA HAJZERAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i AKR-së e ka shqyrtuar Projektligjin për Kryqin e Kuq të Kosovës. Po ashtu, duke pasur parasysh edhe fushëveprimtarinë e këtij Projektligji, kemi konsideruar se ky projektligj është shumë i nevojshëm dhe duhet të përkrahet, në parim.

Qëllimi i projektligjit është rregullimi i statusit, veprimtarisë dhe burimet financiare të Shoqatës Kombëtare të Kryqit të Kuq të Kosovës. Rëndësia e projektligjit është krijimi i infrastrukturës ligjore të Kryqit të Kuq të Kosovës, si shoqatë kombëtare, humanitare, vullnetare, joprofitabile për ndihmesa autoriteteve qeveritare në fushën humanitare. Në çdo shtet ekziston një Kryqi i Kuq apo Gjysmë Hënë e Kuqe dhe i ka ligjet e veta. Po ashtu, ky projektligj rregullon pozitën dhe autorizimet e Kryqit të Kuq të Kosovës. Gjithashtu, ky ligj adreson çështje që kanë të bëjnë me fushën e humanitetit të shëndetësisë, sociale dhe të drejtave humanitare kombëtare.

Pra, Kryqi i Kuq i Kosovës realizon veprimtari humanitare dhe promovon njohuri mbi lëvizjen e Kryqit të Kuq dhe Gjysmë Hënës së Kuqe, edukimin shëndetësor të popullatës, mbrojtjen sociale, respektimin e të drejtës humanitare ndërkombëtare, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të vlerave humanitare, të konventave të Gjenevës dhe të konventave të tjera ndërkombëtare. Pra, këtë projektligj Grupi Parlamentar i AKR-së e përkrah, në parim.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+” ftoj deputeten Shpresa Murati ta marrë fjalën. Më falni, ju lutem, kërkoj falje. Në radhitje është Grupi Parlamentar i LDD-së, ftoj deputeten Qamile Morina ta marrë fjalën. Ju faleminderit!

QAMILE MORINA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Kabinet qeveritar,

Deputetë të nderuar,

Lidhja Demokratike e Dardanisë, Projektligjin për Kryqin e Kuq të Kosovës e konsideron me rëndësi për vendin ngase rregullon bazën ligjore të pozitës dhe të autorizimeve të Kryqit të Kuq në Kosovë, të vetmin në vendin tonë, në përmbushjen e misionit të vet humanitar në rrafshin kombëtar dhe pranimin ndërkombëtar.

Ky Projektligj është hartuar për herë të parë në Kosovë, edhe pse Kryqi i Kuq është themeluar në vitin 1945 dhe ka vepruar gjer në vitin 1991, kur është suspenduar me dhunë nga pushteti okupues serb. Kryqi i Kuq i Kosovës ka arritur të riorganizohet në vitin 1999 dhe vazhdon veprimtarinë e vet si organizatë humanitare vullnetare proqeveritare. Projektligji në fjalë rregullon statusin, veprimtarinë dhe burimet financiare të Kryqit të Kuq në Kosovë. Vërejtjet tona lidhur me këtë projektligj janë, faktikisht, formulimi që në paragrafin hyrës të Kryqit të Kuq, përkufizohet si e vetmja shoqatë kombëtare, vullnetare humanitare. Ky përkufizim përjashton mundësinë e ekzistimit të organizatave të tjera humanitare, çfarë do të ishte në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës dhe me konventat ndërkombëtare. Andaj, përkufizimi si e vetmja shoqatë humanitare kombëtare, është i paqëndrueshëm.

Dilemat dhe sfidat që kanë të bëjnë me financimin e Kryqit të Kuq të Kosovës, që sipas këtij projektligji parashihihen të bëhen nga kontributet, sigurimi i mjeteve financiare, nga burimet e ndryshme, donacionet, si dhe lehtësirat nga doganat, tatimet përcillen me paqartësi dhe me rreziqet financiare. Kostoja buxhetore që është përgatitur dhe vlerësuar, duke mos marrë në konsideratë disa nga dispozitat në këtë projektligj, krijojnë paqartësi që mbeten çështje për t’u shqyrtuar në komisionet funksionale.

Në fund, Lidhja Demokratike e Dardanisë me kënaqësi do ta votojë këtë projektligj, në parim, ngase ky projektligj rregullon pozitën dhe autorizimet në fushën humanitare, promovon vlerat humanitare, të drejtat njerëzore, mbrojtjen sociale, promovon edukimin shëndetësor të popullatës dhe respektimin e të drejtës humanitare ndërkombëtare. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputete!

Unë jam i detyruar ta ndërpres debatin, për atë i ramë ziles për shkak se mungon kuorumi me Rregulloren të Punës për debat. Në sallë janë 39 deputetë tani, me hyrjen e deputetes Teuta Hadri.

Vazhdojmë debatin. Ftoj shefat e grupeve parlamentare që të kujdesën për kuorum dhe për debat. Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, ftoj deputeten Shpresa Murati ta marrë fjalën.

ŠPRESA MURATI: Hvala, gospodine predsedavajući!

Pozdrav svima!

Nacrt zakona o Crvenom krstu Kosova uredjuje status, delovanje i finansiranje Nacionalnog društva Crvenog Krsta Kosova. Crveni Krst Kosova je jedino humanitarno dobrovoljno i neprofitabilno društvo i obavlja svoje aktivnosti na celoj teritoriji Kosova. Crveni Krst vrši svoju misiju u skladu sa osnovnim principima Međunarodnog Crvenog krsta i Crvenog polumeseca, a to su humanost, nepristrasnost, neutralnost, nezavisnost, dobrovoljnost, jedinstvo i univerzalnost. Nacrt zakona je uglavnom dobro izrađen, sadrži zakonske odredbe koje sadrže i zakoni koji uređuju ovu oblast i u zemljama regiona. Međutim, ono što bi smo mi, Parlamentarna grupa „7+“ ovde želeli da istaknemo, jeste naslov zakona. Ako međunarodna društva kao što su Međunarodni pokret Crvenog krsta i Crvenog polumeseca i Međunarodna federacija Crvenog krsta i Crvenog polumeseca, u svom nazivu imaju crveni polumesec, predlažemo da se i predloženi zakon zove Zakon o Crvenom krstu i Crvenom polumesecu.

Inače, Parlamentarna grupa „7+“, podržaće ovaj Nacrt zakona u načelu i daće svoj doprinos u toku njegove dalje procedure. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Ju njoftoj se prezenca në sallë është 52 deputetë. Janë kushtet e parapara me Rregullore të Punës të Kuvendit që debati të vazhdojë.

Për Grupin Parlamentar SLS, nuk shoh të lajmëruar për fjalë. Kalojmë te deputetët sipas radhë së paraqitjes. Fjalën e ka deputeti Nauman Baliq.

NUMAN BALIĆ: Ju falemidnerit, zoti kryesues!

Selam svima koji su prisutni u sali, i javnosti, naravno!

Ovde bih hteo samo obratiti pažnju na jedan aspekt vezano za zakon, a koje je vezano za terminologiju, simboliku i civilizacijski značaj te simbolike. Riječ je o nazivu, odnosno o imenu Crveni Krst, koji u svojoj podlozi ima ne samo kategoriju koja se tiče dobročinstva, dobrotvorstva, humanizma, internacionalizma, socijalni aspekt, te druge aspekte, nego je osim toga i prije svega bazični znak kršćanstva i trans atlantske, Severno-atlantske civilizacije.

Podsjetio bih vas na praksu koja je uobičajena u državama koje imaju muslimansku većinu, a u kojima se koristi termin Crveni polumesec. Takođe bih vas podsjetio na praksu koja se koristi u zemljama koje imaju miješano stanovništvo, gde se ravnopravno koriste termini Crveni polumesec i Crveni krst. Moji bi prijedlog bio i smatram ga sasvim umesnim i koji bi uključio opravdane zahtjeve devet desetina populacije Kosova, odnosno 90% stanovništva ove zemlje, koja je uglavnom muslimansko i što ne trebamo nikako zaboraviti, da se upotrebi naziv ravnopravnog tretiranja oba imena Crveni polumesec i Crveni krst Kosova. To bi bilo opravdano ne samo sa civilizacijskog aspekta, nego i sa aspekta opravdanosti jedne promene politike koja bi podrazumijevala da smo konačno shvatili da ne živimo u 1989. godini, da ne živimo u vreme kada postoji samo jedna super sila i jedan pogled na svet, nego da živimo u jednom multipolarnom svetu, a u tome svetu ima mnogo civilizacija, ne samo sjeverno - atlantska i trans - atlantska, nego postoji i latino - američka, islamska i istočno - azijska, jugo - istočna azijska, indijska, kineska i tako dalje.

Dakle, razumjeću sve te stvari u obzir, mislim sa civilizacijskog aspekta prijedlog je da naziv i znakovlja i simboli, to se tiče potom druge tačke i to neću ponavljati, bude Zakon o Crvenom polumesecu i Crvenom krstu Kosova. Hvala vam lepa!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Mahir Yagcilar, le të përgatitet deputeti Riza Smaka.

MAHIR YAGCILAR. Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuari kryesues,

I nderuari zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Projektligji për Kryqin e Kuq ka një rëndësi të veçantë dhe është shumë i rëndësishëm që shoqata të organizohet në mënyrë institucionale. Si shoqatë kombëtare, vullnetare, humanitare, jofitimprurëse, është ndihmesë për çështje humanitare në vendin tonë. Unë përgëzoj Ministrinë për iniciativën që veprimtaria dhe financimi të rregullohet përmes ligjit.

Të nderuar deputetë,

Sa i përket ligjit, edhe unë mendoj se duhet të jetë shumë i dobishëm në qoftë se titulli i ligji plotësohet edhe të bëhet Ligji për Kryqin e Kuq dhe Gjysmë Hënën e Kuqe. Duke u nisur nga rëndësia e organizatës, gjithashtu mendoj se nenet 15 dhe 16 duhet të jenë më të sakta, duke mbështetur organizatën, por gjithashtu duke kërkuar edhe përgjegjësi nga ana e organizatës ose nga ana e shoqatës, kështu që duhet të ekzistojnë raportet financiare, të shikohet mundësia se si do të bëhet zgjedhja e kryetarit të shoqatës dhe parimet themelore për administrimin dhe menaxhimin e organizatës, ndërsa detajet tjera sigurisht do të përcaktohen siç parashikohet me ligj dhe me aktet nënligjore. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputeti Riza Smaka, le të përgatitet për fjalë deputeti Naser Rugova.

RIZA SMAKA: I nderuari zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Deputetë të respektuar,

Në parim, emërtimi pa kurrfarë dyshimi sipas gjykimit tim, do të duhej të riformulohej, se nuk është fjala për formë, por për përmbajtje, kështu që do të duhej të inkludohej edhe Gjysmë Hëna e Kuqe. Konsideratat kolegët e nderuar i thanë më parë dhe, tek e fundit, ky ligj e ka edhe intencën për të pasur një funksion humanist, apo jo, edhe civilizues dhe, si i tillë, do të akceptohej shumë më mirë dhe do të ishte edhe më funksional. Kjo është, një.

Dy, te neni 1, po e zëmë, do të duhej të hiqej kjo praktikë e gabuar, ku thuhet: “ky ligj” me germë të vogël. I cili ligj? Sepse është fjala për nenin 1, nuk ka këtu ligj, ... i cili ligj, prandaj do të duhej të thuhej medoemos emërtimi i plotë edhe në kllapë, tutje ligj, “L” i madh e jo “l” i vogël, se kjo është çështje substanciale, nuk është çështje..., se kur themi “ligj”, nënkuptohet korpusi i të gjitha akteve ligjore. Te neni 2, nuk duhet, do duhej të fshihej “e vetmja”, ku thuhet: “Kryqi i Kuq i Kosovës është e vetmja shoqatë kombëtare, vullnetare”, por në qoftë se është vullnetare, atëherë do të ishte në kolizion me të drejtën ndërkombëtare që të eskluzohej çfarëdo shoqate tjetër. Mjafton të themi,

ju lutem, Kryqi i Kuq i Kosovës dhe i Gjysmë Hënës së Kuqe, është shoqatë kombëtare, vullnetare, humanitare e tjera, e tjera, por jo e vetmja.

Te paragrafi i tretë i nenit 2, bëhet apelimi në Konventën e Gjenevës. E cila Konventë e Gjenevës? Një, dy, thirret në vit dhe në datë të adoptimit. Por, meqenëse konventat plotësohen, ndryshohen, modifikohen edhe nuk do të duhej kurrësesi në praktikën tonë të nomoteknikave që të thirremi në aktet ekzistuese, se ato mund të ndryshohen. Më pastaj do të duhej automatikisht ta ndryshonim ligjin tonë, në këtë rast këtë akt ligjor, që nuk do të ishte edhe nuk praktikohet kërkund, por duhet të thirremi në konventa, në fillim, edhe më pastaj nuk ka nevojë që të bëjmë këtë me dispozita konkrete.

Te neni 4, paragrafi 2, Institucionet qeveritare. Ky nuk është term që e njeh Kushtetuta, prandaj duhet të përshtatet me këtë edhe kur thuhet: "në të gjitha kohërat duhet të respektojmë". Respektimi është diçka tjetër, përfillja është diçka tjetër, se mund ta respektoj ligjin, mos ta përfilli. Pra, përfillje medoemos dhe jo në të gjitha kohërat, do me thënë, duhet, jam i bindur që në procedurat që na presin, na do t'i bëjmë disa amendime që do të aprovohen. Edhe kjo dispozitë bie ndesh konkretisht me Konventën e Vjenës për të drejtat e traktateve, të miratuar në vitin 1969, ku sipas asaj konvente të gjitha aktet ligjore, të të gjitha shteteve sovranë anëtare të OKB-së, janë automatikisht të subordinuara nën traktatet ndërkombëtare, prandaj është fjala për dispozitë, e cila nuk ka nevojë të thuhet, se del si naive.

Neni 6, Emblema e Kryqit të Kuq të Kosovës. Këtu mëpastaj e kemi Projektligjin për emblemën, i cili ka 16 nene. Nuk do të duhej fare të ishte kësi soji, por do të duhej të rregullohej esenca dhe në paragrafin e tretë të mos thuhet që: "përdorimi i emblemës dhe emri i Kryqit të Kuq, e tjera, të rregullohet me ligj". Jo me ligj, por me akt nënligjor. Atë ministri, ju lutem, do ta rregullonte kësi soji të praktikohet kudo. Të mos bëjmë shumë ligje, se mëpastaj nuk mund të gjendet askush në to, as juristët më të mirë, mos të flasim për të tjerët. Ne e dimë se juristët janë pakicë absolute, e ata të mirë janë pakicë absolute e pakicës absolute.

Te neni 13, paragrafi 1, Gjatë javës së Kryqit të Kuq, Javës së luftës të tuberkulozit, "Javës së luftës kundër...", duhet të thuhet, të shtohet. Edhe te dispozita 19, ku thuhet: Dispozitat ndëshkuese, këtu thuhet: "dënimi me gjobë", do të duhej "dënimi me të holla" edhe duhet të precizohet i cili organ, se ndryshe do të mbetej vetëm dispozitë në letër, e synimi është që akti ligjor të aplikohet, të zbatohet, ndryshe nuk do ta kishim bërë krejt këtë punë që po e bëjmë këtu edhe punë që na pret për ta bërë. Edhe përfundimisht, zotëri kryesues, do të kisha propozuar, mendoj se kam të drejtë. Shikoni, akti ligjor ka më pak se një të tretën e faqeve, derisa letra shtesë më tepër se 2/3 dhe nëse e lexojmë me kujdes, e shohim se është si shkumë e sapunit, nuk kanë përmbajtje. Këto do të duhej që hiqeshin, do të kursenin, se herë 120, po thuaj se tonelata letra do të kursenim, edhe tonera, pak kush i lexon. Ata/ato që do të ishin kureshtarë, duhet mund të merreshin ose në ueb ose, po e zëmë, në shërbim. Prandaj, t'i heqim këto praktika dhe të dalin para nesh se ku po marrin vëltime të letrave kaq apo jo, apriori po e kemi një droje se ka kush mund t'i lexoj. Edhe këto janë me të vërtetë të panevojshme, propozoj që t'i heqim këto praktika. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet! Fjalën e ka Naser Rugoava, le të përgatitet për fjalë deputetja Luljeta Shehu.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Vërtet, në vitin e 11-të të lirisë së Kosovës dhe në prag të dyvjetorit të pavarësisë së vendit, ka qenë nevojë imediate që Shoqata e Kryqit të Kuq të Kosovës, që ka një begrand disa dekadësh, e në veçanti duhet respektuar punën e Kryqit të Kuq dhe të Gjysmë Hënës së Kuqe dhe të mijëra aktivistëve në periudhën e okupimit klasik të Kosovës. Ka qenë momenti i fundit tani pasi që jemi shtet sovran dhe i pavarur, që ta rregullojmë statusin, veprimtarinë, burimet financiare të Shoqatës Kombëtare të Kryqit të Kuq. Shtetet sovraane kanë një shoqatë të tillë nacionale dhe kjo duhet të rregullohet me ligj dhe shoqata e tillë nacionale e Kryqit të Kuq të Kosovës thjeshtë duhet të ndihmohet nga institucionet e vendit që të jetë anëtare e të gjitha mekanizmave, federatave dhe asociacioneve të tjera, sepse kështu i mundësohet edhe kësaj shoqate tonë nacionale që ta ushtrojë veprimtarinë e vet konform atyre shtatë parimeve, që në një farë forme edhe e mbështet bazën e veprimtarisë së vet.

Andaj, unë i dëgjova me vëmendje edhe vërejtjet e deputetëve dhe të ekspertëve të legjislacionit dhe vërtet janë disa nene që duhet të shqyrtohen dhe të draftohen, të amendohen në procedura të tjera, por vërtet është një ligj i mirë, është një ligj konkret dhe është një ligj që, më në fund, Shoqatës nacionale të Kryqit të Kuq të Kosovës ia hapë rrugët që të jetë sikur homologët e vendeve të tjera dhe shteteve të tjera të pavarura.

Dihen problemet që kanë qenë 99 deri më tani, me tendencat e funksionimit edhe të shoqatave të tjera që nuk e kanë njohur shoqatën tonë nacionale. Andaj, zoti ministër, po edhe ministritë tjera, sepse nuk është vetëm Ministria e Shëndetësisë këtu, edhe ministritë e tjera që kanë akses të drejtpërdrejtë duhet ta përkrahin, të mbështetin që Shoqata nacionale e Kryqit të Kuq të Kosovës ta ushtrojë veprimtarinë e vet në tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe, po e nënvizoj edhe një herë, është një ligj pragmatik, konkret, i cili në bërthamë rregullon tërë infrastrukturën e nevojshme të kësaj shoqate nacionale. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Luljeta Shehu, le të përgatitet për fjalë deputetja Vezira Emrush.

LULJETA SHEHU: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Sa i përket këtij projektligji, mendoj se duhet bërë edhe këto plotësime. Në fillim, titulli mendoj se duhet të jetë “Projektligji për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës”, e jo Projektligji për Kryqin e Kosovës. Mandej, në nenin 2, te fusha e zbatimit duhet shtuar edhe një paragraf, të ceket se Kryqi i Kuq është organizatë joqeveritare dhe jopartiake. Gjithashtu, në nenin 10, ku ceken detyrat e këtij institucioni, mendoj se duhet shtuar edhe disa paragrafë, siç janë:

1. I aftëson qytetarët për kujdes shtëpiak të të sëmurëve dhe organizon shërbime dhe aftëson kuadro për këtë veprimtari;

2. Aftëson kuadro për siguri nëpër male dhe merr pjesë në dhënien e ndihmës së parë mjekësore në male.

Prandaj, mendoj se ky ligj do të funksionalizohet dhe do të jetë më gjithëpërfshirës në qoftë se i bëjmë edhe këto plotësime. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Deputetja Vezira Emrush, e ka fjalën, le të përgatitet deputetja Drita Kadriu.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepa na datu reč! Ja sam se spontano javila, tako da kažem da podržavam sve prethodne kolege, naročito kolege koji su setili da pored imena Nacrta zakona o Crvenom krstu obavezno da stoji i dodatak Nacrt zakona o Crvenom krstu i Crvenom polumesecu. Ovo podržavam posebno iz jednog razloga za to što se nalazimo u jednom nacionalnom okruženju i nacionalna pripadnost naša, gde će biti prepoznatljiva sa ovim simbolima.

Sam Nacrt zakona potrudila sam se da ga pročitam, ali da kažem da taj zakon, da sam Nacrt zakon kada ga čitam, nemamo jasnu sliku o kakvoj se organizaciju radi. Ovde se definiše Crveni krst kao jedna nevladina organizacija, nije dosta rađeno sa strukturalnom šemom same organizacije, da li je to nevladina organizacija i ako je nevladina organizacija, po prvi put ovde na Kosovu mora to biti zakonski regulisano. Da li će to biti centralna organizacija humanitarna, znači mora da ima spoljašnju i unutrašnju organizaciju, jednu šemu jako definisanu sa članovima i sa stavovima.

Jako je ovo, nedefinisani su naročito podzakonski akti sa jako nedovoljnom devinisanosti i sa namenom zaštita su to podzakonski akti doneti. Pošto je to jedina humanitarna organizacija, mi znamo da sa ovim zakonom imamo obavezu učlanjivanja u Međunarodnu organizaciju Crvenog krsta i, normalno, plaća će se članarina, jer se za svaku pripadnost imamo i finansijsku obavezu.

Ovde isto nije definisano i finansiranje samog Crvenog krsta. Kao prvo, nedostaje fond koji mora sa članom da se stavi namenski za Crveni krst. Zašto ovo kažem, moram da vam kažem. Jedna od koleginica, Gjylnaze Sylja, spomenula je jedan stav da kada je Crveni krst na snagu kada su u pitanju elementarne nepogode u regiji ili bilo gde. Mi smo nedavno imali elementarnu nepogodu, poplavu u Albaniji, gde smo čuli i medijima da je 200.000 evra Vlada pomogla iz svog budžeta, iz budžeta Kosova humanitarnu nepogodu. Isto to desilo se svakom od 70 hiljada radnika koliko ima Kosovo zaposlenih, svakome je u ovom ličnom dohotku koji je dobio za januar skinuto 3 evra, što znači 70.000 radnika po 3 evra 210.000, što nama radnicima nije jasno. Ako smo mi svi finansirali, da li je Albanija dobila 400.000 ili je dobila 200.000 evra. Da li je skinuto na ime odluke Vlade. Evo zbog toga kažem mora da ima fond namenski kada Vlada izdvaja, mora da ima fond kojoj organizaciji, da se ta organizacija bavi sa namenski humanitarnom pomoću. Ja se izvinjavam ako se mi danas borimo da budemo deo Evrope, ako se borimo protiv korupcije, moramo jako dobro da analiziramo zakone koje ovde donosimo. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Drita Kadriu, le të përgatitet, e fundit, deputetja Nekibe Kelmendi.

DRITA KADRIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje për zëvendëskryeministrin,

Për ministrat,

Kolegë deputetë,

Mendoj se ligji për të cilin po diskutohet, është një ligj i hartuar mjaft mirë. Në këtë rast unë kisha dashur t'i përcjell vetëm dy vërejtje të mia dhe besoj se Komisioni funksional do t'i ketë parasysh. Vërejtja e parë është te mënyra dhe struktura e organizimit dhe udhëheqjes së Kryqit të Kuq të Kosovës e cila mënyrë nuk është paraparë me ligj, me

përrjashtim të një pike, që është pika 6 e nenit 5, po organizimi administrativ dhe qeverisës, është paraparë të rregullohet me akte dhe me Rregulloren e brendshme të Kryqit të Kuq. Mendoj që është shumë më e udhës që këtë organizim ta rregullojë ligji. Dhe, sugjerimi i dytë është që të bëhet më e specifikuar mënyra e grumbullimit të fondeve gjatë ditëve të veçanta që i ka paraparë ligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka ministrja dhe deputetja Nekibe Kelmendi.

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë kam koment vetëm lidhur me nenin 20, i cili ndërlidhet me nenin 1 të këtij ligji. Në fakt, ju jeni të gjithë në dijeni se prej përfundimit të luftës e këndeje nuk është nxjerr as nga UNMIK-u, as nga ky Kuvend, asnjë akt nënligjor apo Rregullore e UNMIK-ut, që e ka rregulluar këtë çështje, që nënkupton se kjo veprimtari plotësisht është zhvilluar në bazë të Ligjit për Kryqin e Kuq të Kosovës që ka ekzistuar para rrënimit të autonomisë së Kosovës e i cili sipas Rregullores së UNMIK-ut 1999/24 është ligj në fuqi deri sa ta shfuqizojë ky ligj. Kështu, së paku rezulton edhe nga neni 1 i këtij ligji ku thotë – ky ligj rregullon statusin, veprimtarinë dhe burimet financiare të Kryqit të Kuq të Kosovës e nuk thotë se me këtë ligj themelohet Kryqi i Kuq i Kosovës si organizatë humanitare. Meqë çështja qëndron kështu, do të thotë, ne kemi vepruar në kontinuitet gjithmonë me atë ligjin e atëherëshëm dhe për hir të precizimit se cili ligj shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij ligji, atëherë do të doja që të qartësohet dhe të precizohet neni 20, që bën fjalë për shfuqizimin e akteve dhe të thuhet thjesht që me këtë ligj shfuqizohet ligji numër kaq, kaq, i datës kaq, i ish -autonomisë së Kosovës e cila, siç dihet, është rrënuar në mënyrë të dhunshme, antikushtetuese e tjera, e tjera. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Ministri, Alush Gashi e ka fjalën.

MINISTRI ALUSH GASHI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Me këtë rast desha të falënderoj në debat shumë konstruktiv, t'ju falënderoj në mbështetje në parim dhe t'i përgëzoj grupet punuese në ministri dhe në Qeveri për ofrimin e një ligji të shkurtër i cili ka një porosi të qartë. Sa për korrektësi ky ligj ka kaluar njëzëri në Qeveri. Sot me ëndje dëgjova kontributin e dy deputetëve – ministra, besoj që kjo në ndërkohë kanë fituar dije të reja dhe e begatojnë këtë proces, por në Qeveri kemi qenë të gjithë njëzëri për këtë formë.

Sa i përket një porosie të përgjithshme, bëhej pyetja se formulimi ku është, ekziston vetëm një Kryq i Kuq i Republikës së Kosovës. Kjo nuk i përjashton organizatat tjera humanitare jo qeveritare, nuk e përjashton Kryqin e Kuq në nivele komunale e tjera, por si në çdo shtet sovran ashtu edhe në vendin tonë ekziston një Kryq i Kuq.

Ju i dëgjuat format, i keni edhe të hartuara format e financimit, por për një rezymë të përgjithshme, miratimi i këtij ligji krijon obligime për Ministrinë e Shëndetësisë, si administrative ashtu edhe financiare, e tjera, sepse nga shumë propozime se ku do të jetë i lidhur ky Kryq i Kuq, sugjerimet e ekspertëve thonë që të jetë në Ministrinë e Shëndetësisë. Ky ligj është në tërësi në duart e Kuvendit të Kosovës dhe unë nuk kam dyshim që ne të gjithë së bashku se s'do ta bëjmë edhe më të mirë.

Në pyetjen e zonjës deputete Gjylnaze Syla për kohën, ne ligjin e kemi proceduar më 1 tetor të vitit 2009. Kemi pasur shumë edhe vullnet edhe në vitin e kaluar, por sinqerisht

nuk kemi pasur mbështetje nga Kryqi i Kuq Ndërkombëtar që kjo punë të kryhet edhe para një viti. Nëse është ndonjë vonesë, mua më vjen keq, por ju jeni të ndërgjegjshëm se sivjet e kemi pasur një epidemi e cila thjesht neve na ka shqetësuar shumë dhe ka kërkuar angazhime shtesë. Si do qoftë, ky debat për ne në Ministri dhe në Grupin Parlamentar është i mirëseardhur. Unë sot i kam mësuar disa çështje të cilat nevojitet që t'i studioj edhe më qartë dhe me Grupin Parlamentar, besoj që në leximin e dytë, ky do të jetë një ligj në interes të vendit tonë. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Të nderuar deputetë, kërkoj deklarinimin me votim për miratimin në parim të këtij projektligji.

Ftoj regjinë dhe deputetët të bëhen gati për votim dhe votojmë tash.

Me 63 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 2 abstenime, konstatohet se Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për Kryqin e Kuq të Kosovës.

Në bazë të Rregullores së Punës, Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale,
- Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
- Komisionin për Buxhet e Financa,
- Komisionin për Komunitete, dhe
- Komisionin për Integritet Evropian

që brenda dy muajve nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandimet. Ju faleminderit!

Në sallë ishin të pranishëm 66 deputetë. Ju faleminderit!

Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përdorimin dhe mbrojtjen e emblemës së Kryqit të Kuq, emblemave tjera dalluese dhe sinjaleve.

Konstatimet hyrëse: Në bazë të rregullës 35, pika 1 të Rregullores së Punës janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji.

Ftoj ministrin e Shëndetësisë, Alush Gashi, që para deputetëve të Kuvendit të Kosovës, të prezantojë Projektligjin . E keni fjalën zoti ministër!

MINISTRI ALUSH GASHI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Ky projektligj rregullon përdorimin, mbrojtjen e emblemës së Kryqit të Kuq, Gjysmëhënës së Kuqe, Kristalit të Kuq në prapavi të bardhë, emërtimet e Kryqit të Kuq, Gjysmëhënës së Kuqe dhe Kristalit të Kuq dhe shenjat dalluese për identifikimin e njësive mjekësore transportuese në kohë të konflikteve, konflikteve të armatosura dhe në paqe. Rëndësia e projektligjit është krijimi i bazës ligjore për përdorimin dhe mbrojtjen e emblemës së Kryqit të Kuq dhe emblemave tjera dalluese. Me këtë projektligj rregullohet përdorimi dhe mbrojtja e emblemës së Kryqit të Kuq, emblemave tjera të mbrojtjes dalluese dhe sinjaleve. Është rregullimi me ligj për përdorimin dhe mbrojtjen e emblemave të Kryqit të Kuq, Gjysmëhënës së Kuqe dhe Kristalit të Kuq.

Kryqi i Kuq i Kosovës bashkëpunon me autoritetet e Republikës së Kosovës në përpjekje për parandalimin e çfarë do lloji të keqpërdorimit, njofton autoritetet kompetente për keqpërdorimet eventuale dhe merr pjesë në seancën gjyqësore penale civile apo administrative.

Ministria e Forcës së Sigurisë dhe Ministria e Shëndetësisë mbajnë përgjegjësinë për zbatimet e këtij ligji dhe nxjerrjen e akteve nënligjore.

Financimi për sigurimin dhe mbrojtjen e emblemës bëhet nga buxheti i Kosovës përmes procesit të rregullt të planifikimit dhe aprovimit të buxheti të Kosovës dhe në pajtim me burimet buxhetore, nëse nuk sigurohet ndonjë burim tjetër i financimit i paraparë me ligj.

Projektligji posedon tërë infrastrukturën juridike të përcaktuar për hartim, procedim dhe miratim të ligjeve në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Propozoj miratimin në parim dhe procedimin e mëtutjeshëm. Faleminderit në vëmendje!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti ministër!

Më lejoni të hap debatin për diskutim në parim. Në emër të Komisionit funksional nuk shoh të paraqitur, kryetar në emër të komisioneve të tjera. Kryesore, jo. Në emër të grupeve parlamentare, ftoj deputeten Teuta Hadri që në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së ta marrë fjalën.

TEUTA HADRI: Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

I nderuar zoti kryesues,

Projektligji për përdorim dhe mbrojtje të emblemës së Kryqit të Kuq, Gjysmëhënës së Kuqe, Kristalit të Kuq dhe shenjave tjera dalluese, hartohet për herë të parë në Kosovën e pasluftës. Ky ligj ka rëndësinë e vet se krijon bazën dhe infrastrukturën ligjore për përdorim dhe mbrojtje të emblemës së kuqe të Kryqit të Kuq, shenjave tjera identifikuese.

Duke u mbështetur në Kushtetutën e Kosovës, ky ligj me rëndësinë e vet që e ka, tregon se Kosova, pas pavarësisë së saj, ka të drejtën ndërkombëtare të përfaqësojë vendin e vet dhe shtetin e saj me shenjat dhe simbolet identifikuese të Kryqit të Kuq, ashtu siç përfaqësojnë edhe shtetet e tjera të gëzojnë të drejtat e konventave ndërkombëtare. Pra, projektligji në fjalë rregullon: përdorimin, mbrojtjen e emblemës së Kryqit të Kuq, Gjysmëhënës së Kuqe, Kristalit të Kuq dhe shenjat e sinjalet tjera dalluese, identifikuese për t'i mbrojtur objektet shëndetësore, ekipet mjekësore, objektet transportuese si dhe fetare në rast të konfliktit të armatosur apo gjendje paqeje gjatë katastrofave natyrore, epidemive dhe gjendjeve emergjente.

Qëllimi dhe nevoja e madhe për zbatim e këtij ligji është se me këtë ligj eliminohen të gjitha format e keqpërdorimit dhe shfrytëzimit të shenjave të Kryqit të Kuq si formë keqpërdoruese ndaj Kosovës, prandaj Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, në parim e miraton këtë ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së ftoj deputeten Nurishahe Hulaj, ta marrë fjalën.

NURISHAHE HULAJ: Faleminderit i nderuari kryesues i Kuvendit, Ministra dhe deputetë të respektuar,
Projektligji për përdorimin dhe mbrojtjen e emblemës të Kryqit të Kuq, emblemave tjera dalluese dhe sinjaleve është një ligj i punuar shumë mirë dhe e përgëzoi grupin që e ka punuar këtë projektligj, si në përmbajtje dhe në cilësi.

Projektligji rregullon përdorimin, mbrojtjen e emblemës së Kryqit të Kuq, Gjysmëhënës së Kuqe, Kristalit të Kuq në prapavijë të bardhë, rregullon emërtimet e Kryqit të Kuq, Gjysmëhënës së Kuqe, Kristalit të Kuq dhe shenjat dalluese për identifikimin e njësive mjekësore dhe transportuese në kohë të konflikteve të armatosura dhe në paqe.

Me këtë projektligj eliminohen keqpërdorimet e shenjës së Kryqit të Kuq, Gjysmëhënës së Kuqe dhe Kristalit të Kuq në fushën shëndetësore, në paqe dhe në kohën e konfliktit të armatosur. Burimet specifike të legjislacionit të referuar janë përdorur dhe konsultuar modelet e ligjeve për emblemën nga ligjet e Kryqit të Kuq slloven dhe Kryqit të Kuq kroat, konventat e Gjenevës të 12 gushtit 1949 dhe protokollet tjera shtesë. Dispozitat më të rëndësishme në këtë projektligj janë.

- 1.Përdorimi i mbrojtjes së emblemës nga shërbimet mjekësore të Forcave të Sigurisë, nën kontrollin e Ministrisë së Forcës së Sigurisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë,
2. Përdorimi i mbrojtjes së emblemës nga spitalet dhe njësitë tjera civile mjekësore,
- 3.Përdorimi i mbrojtjes së emblemës nga Kryqi i Kuq i Kosovës,
- 4.Përdorimi tregues i emblemës nga Kryqi i Kuq i Kosovës për të treguar se një person apo objekt i takon Kryqit të Kuq të Kosovës,
- 5.Përdorimi i emblemës nga ana e organizatave ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe në çdo kohë dhe për të gjitha aktivitetet e tyre,
- 6.Dispozitat kontrolluese. autoritetet e Republikës së Kosovës në çdo kohë sigurojnë zbatim të rregullave për përdorimin e emblemës dhe emërtimeve të Kryqit të Kuq, Gjysmëhënës së Kuqe, Kristalit të Kuq dhe shenjat e tyre dalluese. Ministria e Forcës së Sigurisë dhe Ministria e Shëndetësisë mbajnë përgjegjësinë e zbatimit të këtij ligji dhe nxjerrjen e akteve nënligjore. Projektligji bazohet në parimet e legjislacionit të BE-së.

Vlerësimi i ndikimit buxhetor. Mjetet buxhetore do të sigurohen përmes procesit të rregullt buxhetor vjetor dhe theksohet se do të jenë të përballueshme.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrah në parim këtë projektligj dhe në kuadër të Komisionit funksional do japim kontributin tonë . Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Të nderuar deputetë, ju ftoj që të jepen vërejtje në projektligj nëse ka dhe jo të na lexohet projektligji. Pra, është shqyrtimi në parim dhe në bazë të Rregullores së Punës të Kuvendit, ftoj deputetët, qoftë në emër të grupeve parlamentare ose personalisht të japin vërejtjet në nene nëse ata kanë plotësime ose ndryshime diçka që ata mendojnë që janë të dobishme të përfshihen në amendamentim ose në shqyrtim të mëtejshëm. Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së ftoj deputeten Gjylnaze Syla ta marrë fjalën.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Deputetë të nderuar,

Edhe në vazhdimësinë e projektligjit të parë që patëm për Kryqin e Kuq, tani kemi emblemën dhe konsideroj se formimi i kornizës ligjore për mbrojtjen e emblemës së

Kryqit të Kuq, por të edhe emblemave tjera dalluese dhe shenjave dalluese është i rëndësishëm, në radhë të parë për të siguruar përdorimin e drejtë, pra parandalimin dhe eliminimin e keqpërdorimeve të emblemës, qoftë në kohën e paqes ose në kohën e luftës. Do të thotë krijimi i kësaj strukture ligjore është i nevojshëm në Kosovë.

Në projektligj janë paraparë edhe aktet nënligjore, kurse për zbatimin e këtij projektligji janë kryesisht dy ministri, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Unë e kam këtu një vërejtje, sepse është e metë, nuk është e definuar qartë se cilat janë çështje dhe nga cila ministri ose institucion rregullohen me akte nënligjore, çka do të rregullojë Ministria e Shëndetësisë dhe çka do të rregullojë Ministria e Forcës dhe Sigurisë? Megjithatë, projektligji i përmbush kriteret siç janë dispozitat ndëshkuese e që parashohin varësisht nga shkalla e keqpërdorimit ndëshkimin me gjobë apo sipas ligjeve në fuqi. Ndërsa, sa i përket përputhshmërisë me parimet e legjislacionit të BE-së, legjislacioni i BE-së nuk e rregullon këtë çështje, por është çështje e shteteve anëtare të veçanta dhe kjo kryesisht rregullohet me konventa ndërkombëtare. Implikimet buxhetore mund të ngjajnë në qoftë se duhet siguruar emblema e Kryqit të Kuq dhe shenjat dalluese, mirëpo besoj se edhe ministri tha se kjo do të jetë e përballeshme për buxhetin, prandaj për shkak të rëndësisë që ka, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, në parim e përkrah, megjithatë mendojmë se kërkohet një përpunim i mëtejshëm i këtij projektligji në komisionin përkatës. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së deputetja Rita Hajzeraj e ka fjalën.

RITA HAJZERAJ: Faleminderit, kryesues!

Projektligji për përdorimin dhe mbrojtjen e emblemave të Kryqit të Kuq dhe emblemave tjera mbrojtëse, e shenjave edhe sinjaleve, është shqyrtuar nga Grupi Parlamentar i AKR-së. Po ashtu e shohim të rëndësishëm këtë projektligj i cili tanimë e kompletion edhe më shumë legjislacionin në përgjithësi. Gjithashtu, kemi të bëjmë me shumë gabime teknike të cilat besoj që në komisionin përkatës do t'i shqyrtojmë dhe do t'i evidentojmë. Po ashtu, Grupi Parlamentar i AKR-së e mbështet dhe përkrah në parim këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së ftoj deputeten Qamile Morina ta marrë fjalën.

QAMILE MORINA: Faleminderit, zoti kryesues! Me Projektligjin për përdorimin dhe mbrojtjen e emblemës të Kryqit të Kuq, në kombinim me Projektligjin për Kryqin e Kuq të Kosovës kompletionet infrastruktura ligjore për veprim dhe funksionim të suksesshëm të Kryqit të Kuq në Kosovë. Projektligji qartë adreson çështjen e përdorimit të emblemës në paqe dhe gjatë luftës, konfliktit të armatosur si shenjë mbrojtëse dhe si çështje që kanë të bëjnë me keqpërdorimin e emblemës. Ajo që bie në sy në këtë projektligj është se nuk ka saktësim të mjaftueshëm se cili institucion mbetet përgjegjës për hartimin dhe aprovimin e akteve normative. E drejta e legjislacionit evropian nuk e rregullon këtë çështje, por kjo mbetet kompetencë e shteteve anëtare të Bashkësisë Evropiane, brenda juridiksionit të tyre, andaj Lidhja Demokratike e Dardanisë, konsideron se edhe për vendin tonë është me rëndësi të krijohet baza ligjore për përdorimin e emblemës të Kryqit të Kuq dhe emblemave të tjera dalluese. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar 7+, ftoj deputeten Shpresa Murati të marrë fjalën.

ŠPRESA MURATI: Hvala! Ovaj nacrt zakona koji je danas pred nama, reguliše upotrebu, zaštitu emblema Crvenog krsta, Crvenog polumeseca i crvenog kristala, kao i prepoznatljive znake za identifikaciju medicinskih jedinica i transporta u vreme oružanog sukoba i miru. Ono što smo istakli i prilikom razmatranja prethodnog zakona, važi i za ovaj zakon. Smatramo da je neophodna izmena naslova i ovog nacrt zakona i da naslovi ovih zakona koji regulišu istu oblast, budu uskladjeni. Inače, Parlamentarna grupa “7+” podržaće ovaj nacrt zakona uz ove naše primedbe. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të SLS, nuk ka të lajmëruar. Deputetët sipas radhës. Fjalën e ka deputeti Mahir Yagcilar, të përgatitet deputeti Bahri Hyseni.

MAHIR YAGCILAR: Po, edhe një herë, faleminderit zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Edhe në këtë rast mendoj se do të jetë shumë dobishëm në qoftë se titulli i ligjit plotësohet dhe të bëhet ligji për përdorimin dhe mbrojtjen e emblemës të kryqit të kuq dhe gjysmëhënës së kuqe. Unë dëshiroj edhe me këtë rast të shfrytëzoj të drejtën si deputet të propozoj. Rastësisht, në takimin e Qeverisë nuk kam qenë prezent, kështu që ndoshta nuk munda me atë rast të dërgoj vërejtje, por në këtë rast shfrytëzoj rastin si deputet dhe mendoj prapë do të jetë dobishëm të bëhet titulli edhe për Gjysmëhënën.

KRYESUESI: Ju faleminderit deputet! Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni, të përgatitet për fjalë deputeti Eqrem Kryeziu.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Çështja e ligjit që e diskutuam, për rëndësinë diskutuan shumica e kolegëve dhe unë do të përsëris që është një rrugë e mirë që ka ndjek Ministria e Shëndetësisë për me sjell ligjin dhe për ta rregulluar një sferë e cila nuk ka qenë e rregulluar deri më tani me ligj. Nëse ato që kemi pas rast me pa ligjin, ligji është hartuar mirë, sikurse edhe ligji që kaloi pak më parë në parim. Mirëpo, vlen të përmendet që ndoshta është mirë të shikohen pak te përkufizimet, nëse ka mundësi Komisioni funksional të shikojë që projektligji të ketë më shumë përkufizime, sepse janë vetëm 2-3 përkufizime dhe konsideroj se ka diçka që duhet sqaruar edhe brenda ligjit. Vlen të përmendet edhe një fakt. Të gjithë deputetë që po diskutojnë po e përmendin edhe çështjen e Gjysmëhënës së Kuqe që po përdoret në dispozitat e ligjit, mirëpo nuk është në titullin e ligjit. Për deri sa është brenda dispozitave të ligjit, ndoshta është mirë ta mendojmë, sepse gjitha pjesët normative, të gjitha nenet ku po përmendet po përmendet edhe kjo pjesë, prandaj është mirë ndoshta që për shkak të asaj fuqisë normative duhet të shikojmë që ta ketë edhe në pjesën normative.

Një vërejtje ndoshta është mirë që në Komisionin funksional ta shikojmë termin që është përdorur – dispozitat kontrolluese. Ne juristët nuk e përdorim shumë dhe nuk e di, ndoshta është mirë që ta mendojmë një modifikim ta bëjmë, sepse ka dispozita shfuqizuese, ka dispozita të hyrjes në fuqi, por dispozita kontrolluese, për herë të parë së paku unë me qindra ligje kemi pasur nëpër dorë për se s’e kemi pasur rastin, ndoshta është mirë ta mendojmë. Edhe çështja atje, ku është paraparë – krimet e luftës, kur dikush përdor emblemën, ndoshta është mirë që të theksohet me ligjet të cilat janë në fuqi për këtë çështje, sepse nëse lexojmë nenin komplet, domethënë, nenin 9, na lë përshtypje që

dispozitat e këtij ligji po rregullojnë apo po e dënojnë atë që bie ndesh me dispozitat gjatë aplikimit të ligjit.

Dhe, krejt në fund, duke përgëzuar edhe një herë ministrin dhe Ministrinë e Shëndetësisë për punën që e ka bërë është mirë ndoshta edhe nenin 15 ta modifikojmë, sepse thotë – zbatimi i këtij ligji. Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Ministria e Shëndetësisë mbajnë përgjegjësinë e zbatimit të këtij ligji dhe nxjerrjen e akteve nënligjore. Nuk i shkon. Neni 15 duhet të modifikohet se përgjegjës për ta zbatuar këtë ligj jemi të gjithë, të gjitha institucionet, natyrisht edhe qytetarët, kurse Ministria e Forcës së Sigurisë dhe Ministria e Shëndetësisë, marrin obligim me pjesë normative që t'i nxjerrin aktet nënligjore, natyrisht edhe ndoshta marrin obligim që edhe ta monitorojnë zbatimin në praktikë. Me këto vërejtje, unë e përkrah ligjin dhe natyrisht do të jap ndoshta edhe me shkrim në Komisionin funksional, që sa më parë ta kemi në leximin e dytë. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Eqrem Kryeziu, të përgatitet i fundit për këtë pikë të rendit të ditës, deputeti Riza Smaka.

EQREM KRYEZIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje për ministrat e rralluar, por si do qoftë të vlefshëm!

Përshëndetje edhe të gjithë të pranishmëve këtu!

Unë do të pajtohesha me fjalimin e zonjës Sylja, ose të paktën të bëjmë një kompromis se në këtë projektligj, në rastin e parë kur përmendet emblema e Kryqit të Kuq do të duhej, të paktën, t'i referohemi ligjit pararendës se emblema e Kryqit të Kuq është t'i referohemi patjetër. Kaq sa për këtë.

Mirëpo, unë e kam një propozim tani konkret këtu. Neni 11, unë besoj se përhap më shumë konfuzion se sa që e zhdavaritë konfuzionin. Në fakt neni 11 thotë – nuk mund të jetë kryq i bardhë në sfondin e kuq, sepse preken zvicranët. A mund të jetë pra kryqi gri, ose kryqi blu ose kryqi i verdhë dhe prandaj, në qoftë se ligji përcakton se emblema e Kryqit të Kuq janë pesë katrorë të barabartë të kuq në prapavijën e bardhë, atëherë nuk kemi nevojë të shkojmë më tutje, të themi - jo nuk bën të jetë i bardhë. Po ajo veç i kuq është, e përcakton ligji. Përndryshe, unë vetëm në qoftë se kemi ndonjë detyrim të trejdmartë që thuhet, për shkak se Zvicra është edhe gjeneza e idesë së Kryqit të Kuq, ajo është tjetër gjë, por në qoftë se kemi detyrime të tilla historike atëherë më mirë t'i referohemi konventave të caktuara se sa të shpjegojmë gjëra të tilla. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Mirë, faleminderit! Fjalën e ka deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri kryesues!

Në parim te titulli është formuluar në njëfarë kakofonie dhe përsëritje të panevojshme. Ligji për përdorimin dhe mbrojtjen e emblemës e Kryqit të Kuq, emblemave të tjera dalluese dhe sinjaleve, se ju lutem ekzistojnë këto ... Këto duhet në gjuhën shqipe, me të vërtetë nuk kemi shprehje, përpos shenjave, po së paku këtë të fundit, këtë alinenë e fundit, do ta kishim zëvendësuar me shenja tjera dalluese. Edhe do të isha angazhuar, jo tash, nuk është edhe as etapa po të merret në konsideratë ngritja e çështjes nga zoti ministër Yagciilar dhe zotëri deputeti Numan Baliq, që unë e mbështes. Nuk është fjala për religjionin absolutisht, por për konsideratat, për sentimentet e qytetarëve të Kosovës. Prandaj, kjo duhet të merret me ma seriozitet se sa si vërejtje kalimtare. Edhe te neni i parë këtu, te neni 1, ku thuhet

KRYESUESI: Lus deputetët të kthehen në sallë se nuk kemi kuorum për votim dhe ju lutem, mos e lëshoni Kuvendin, sallën.

RIZA SMAKA: ... Do të kisha përsëritur shkurtimisht vërejtjen paraprake të adresuar në ligjin që e trajtuam se neni 1, kur thuhet neni 1, domethënë, ai fillon aty e kur thuhet ky ligj, do të thotë i cili ligj, prandaj do të duhej në fillim të cilitdo nen të jepej plotësisht titulli i ligjit dhe më pastaj në kllapë ligji me shkronjën e parë të madhe. Vërejtje 3 do të ishte kjo. Me nenin 6, ligji për Kryqin e Kuq është përcaktuar emblema dhe emblemat. Do të ishte racionale dhe do të ishte ekonomike që këto dispozita të inkludoheshin në po atë ligj, se fundi i fundit është fjala për 4 a 5 dispozita. Hiq këto që janë më parimore, fillestare dhe këto përfundimtare, 4 a 5 nene, neni 6, 7, 8 dhe do të kishim një ligj, mos të bëjmë shumë ligje, sepse zakonisht edhe më pastaj ato janë edhe si me thënë, shpeshherë bien në kolizion njëri me tjetrin dhe s'ka nevojë. Ky ligj e ka mangësi kaptinën për dispozitat ndëshkimore. Do të mbetej ky i paaplikueshëm, do të mbetej në nivelin e parimeve etike – duhet, do të duhej, do të ishte mirë, do të ishte mirë, do të ishte, ligji me ato s'ka, do të duhej po e cakton. Dispozicioni juridik i ka dy komponente, e ka dispozitën dhe e ka sanksionin. Dispozita juridike e ka sanksionin, nëse s'e ka mbetet më tepër si premisë morale, etike që fundi i fundit varet nga vullneti i mirë, a ligji nuk ka nevojë për vullnetin e mirë, ai është i mirëseardhur, po domethënë jepet rregulla dhe po qe se nuk aplikohet sanksioni.

Te definimet ka shumë vërejtje, po e zëmë e ngriti zotëri Hyseni këtë me vend, po e zëmë dispozita kontrolluese, term i fabrikuar, konstruksion juridik i pa vlera kritike, analitike. Do të duhej të zëvendësohej, tash nuk do të propozojmë, por në etapat vijuese do ta kishim propozuar. Faleminderit! Në parim, natyrisht po, por unë do të isha angazhuar që këto dispozita gjatë etapës së dytë t'i fuzionojmë me ligjin për Kryqin e Kuq dhe ta bëjmë një ligj se thuaja është tema bosht është ligji, prandaj emblema është një nga, element nga pjesët e shumta të korpusit për ligjin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Të nderuar deputetë, ju ftoj të deklaroheni me votim për miratimin në parim të Projektligjit. Ftoj deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Në sallë janë 62 deputetë. Votojmë tash:

Konstatoj se me 60 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për përdorimin dhe mbrojtjen e emblemës së Kryqit të Kuq, emblemave tjera dalluese dhe sinjaleve.

Në bazë të Rregullores së Punës, Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale,
- Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
- Komisionin për Buxhet e Financa,
- Komisionin për Komunitete, dhe
- Komisionin për Integritet Evropian.

Komisionet duhet që brenda dy muajve nga shqyrtimi i parë Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandimet. Ju faleminderit!

Kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për produktet dhe pajisjet medicinave.

Konstatimet hyrëse: Në bazë të rregullës 35, pika 1 të Rregullores së Punës janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji.

Ftoj ministrin e Shëndetësisë Alush Gashi që para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin. E keni fjalën ministër!

MINISTRI ALUSH GASHI: I nderuar, zoti kryesues!

Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Projektligji për produkte dhe pajisje medicinave është i hartuar sipas standardeve. E veçantë e punës së këtij projektligji është pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e farmacistëve në të gjitha fazat e përgatitjes së ligjit. Me këtë projektligj përcaktohen rregullat për prodhimin, kontrollin e cilësisë, regjistrim, etiketim, pullat e sigurisë, import, eksport, vënien në treg, përshkrimin mjekësor, efikasitetin, sigurinë e përdorimit të produkteve dhe pajisjet medicinave në Republikën e Kosovës. Nevoja për këtë projektligj qëndron në rregullimin e sektorit farmaceutik të Republikës së Kosovës pasi përfshin fushën e furnizimit me barna dhe pajisjen medicinale të tregut si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat.

Me këtë projektligj është bërë plotësimi i dispozitave ligjore që rregullojnë përdorimin e produkteve medicinale dhe pajisjet medicinave, kushtet për prodhimin dhe vënien e tyre në qarkullim si dhe shërbimin dhe sigurimin e kushteve për cilësi dhe sigurinë dhe efikasitetin e vet. Me këtë projektligj përcaktohen masat për t'i siguruar cilësinë, sigurinë dhe efikasitetin e produkteve dhe pajisjeve medicinave në Republikën e Kosovës.

Ky projektligj ka ndikim direkt në rregullimin e sektorit farmaceutik të Republikës së Kosovës pasi që përfshin fushën e prodhimit dhe furnizimit me barna dhe pajisje medicinale si të sektorit publik ashtu edhe të sektorit privat. Projektligji sjell risi në krahasim me ligjin aktual, sepse përmes normave ligjore, me këtë rregullohen procedurat e regjistrimit konform legjislacionit të Bashkimit Evropian të plasimit dhe përdorimit të produkteve dhe pajisjeve medicinale. Projektligji posedon tërë infrastrukturën ligjore të përcaktuar për hartim, procedim dhe miratim. Për prezantim në Kuvend si ligj të ri kemi qenë të shtyrë nga përcaktimet e udhëzimeve administrative siç është 17/2008 ku nëse mbi 40% të ndryshimeve që ekzistojnë në atë projektligj mund të quhet ligj i ri dhe ne ju ofrojmë këtë si ligj të ri për miratim në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit zoti ministër!

Të nderuar deputetë,

Më lejoni të hap debatin për diskutim në parim.

Nga Komisioni funksional nuk shoh të paraqitur. Kryetarët e komisioneve tjera kryesore jo, përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së ftoj deputeten Teuta Hadri ta marrë fjalën.

TEUTA HADRI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Ligji për produktet medicinale është një ndër ligjet e para të aprovuara në Parlamentin e Kosovës, më 4 dhjetor 2003/26 dhe ka vepruar, është shpallur sipas Rregullores së UNMIK-ut numër 2004/23 të 7 korrikut, por propozuesi i këtij ligji ka hasur në vështirësi dhe pengesa të reflektuara gjatë zbatimit të ligjit në fuqi. Njëra nga vështirësitë është se ligji nuk është i harmonizuar plotësisht me direktivat e BE-së. Njëherit ky ligj nuk rregullon plotësisht shumë çështje që Ministria, përkatësisht Agjencioni i Kosovës për

produktet medicinale merret, prandaj, shumë çështje, si licencimi i prodhuesve farmaceutikë, licencimi i qarkulluesve farmaceutikë me shumicë dhe pakicë, regjistrimi i barnave dhe i pajisjeve medicinale, kontrolli dhe garantimi i cilësisë së barnave nuk ka pasur kontroll të vlerësimit shkencor të barnave dhe politikë të caktimit të çmimeve. Vetëm një shembull vlen të përmendet, sipas Zyrës së Auditorit që ka bërë raportin transparent auditori gjeneral ka bërë përcjelljen e shpërndarjes së mallrave esenciale, ka gjetur një mori shkeljesh nga Departamenti Farmaceutik që është përgjegjës në Ministrinë e Shëndetësisë. Ky auditor në 2008 ka gjetur dobësi në të gjitha aspektet e programit në shpërndarjen dhe transparencën e listës esenciale. Duke ngritur rrezikun që barnat esenciale të mos jenë në dispozicion për nevojat e pacientit kur atij i nevojiten, pastaj çrregullime dhe mospërputhje serioze të sasive aktuale të barnave të gjetura dhe atyre të kërkuara nga institucionet shëndetësore. Nuk ka pasur qasje sistematike në porositjen e sasive të reja dhe shumë dobësi tjera që auditimi i ka gjetur gjatë vitit 2008. Vetëm një shembull vlen të përmendet nga menaxhimi i keq gjatë vitit 2008 që QKUK ka kërkuar edhe planifikuar 26 mijë e 220 ampula oksitocin dhe gjithashtu Departamenti Farmaceutik i Ministrisë së Shëndetësisë ka porositur 40.000, pastaj adilizin ampula 3 miligram, QKUK ka planifikuar 1.940, Departamenti Farmaceutik i QKUK ka planifikuar 80.000. Ky nivel i mbingarkimit apo i mbi planifikimit

KRYESUESI: Nëse bën, të ktheheni në temë, zonja deputete.

TEUTA HADRI: Po, po, në temë dhe në lidhje me temën është kjo, ky nivel i mbingarkimit apo mbingarkimit dhe i planifikimit do të krijon dhe rezulton me sasi të mëdha të stoqeve të këtyre barnave dhe rezultati i prishjes së tyre. Pra këtu ka përgjegjësi prandaj edhe ky ligj ka pasur nevojë edhe për ndryshime dhe plotësime, prandaj, rëndësia është se ky ligj tani i ri me këtë formën që na vjen diku në rregullimin e sektorit farmaceutik të Kosovës përfshin fushën e furnizimit me barna, pajisje medicinale, si të tregut privat dhe atij publik. Rëndësia e miratimit të këtij ligji është me qëllim për të përcaktuar masa për sigurinë e cilësisë dhe sigurimin si dhe efikasitetin e produkteve medicinale. Prandaj, Grupi Parlamentar i PDK-së në miratim si ligj i rëndësishëm e pranon.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Ftoj deputeten Nurishahe Hulaj që në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së ta marrë fjalën.

NURISHAHE HULAJ: Faleminderit!

I nderuar kryesues i Kuvendit, ministra dhe deputetë të respektuar, Ky projektligj paraqet një segment shumë të rëndësishëm në furnizimin me barna, mbikëqyrjen, kontrollin dhe cilësinë e tyre për qytetarët e Kosovës. Agjencioni Kosovar për Produkte dhe Pajisje Mjekësore është ballafaquar me problemet e ndryshme në lidhje me mbikëqyrjen, cilësinë dhe kontrollin e barnave dhe strukturimi i këtij projektligji është një hap më me rëndësi dhe më përpara se sa ligji ekzistues. Dhe, unë kisha thënë personalisht që pasqyrës së Kushtetutës së Republikës së Kosovës në fuqi, agjencitë parashihen të jenë të pavarura sikurse siç janë disa agjenci të pavarura në Republikën e Kosovës, prandaj kisha propozuar që në të ardhmen të bëhet një ligj i veçantë që do të rregullojë të gjithë çështjen e agjencive të pavarura në Republikën e Kosovës.

Sa i përket ndikimeve të vlerësimeve buxhetore, kostoja nuk parashihet në kufijtë buxhetor për një segment shumë të rëndësishëm, por rekomandohet që përmes Ministrisë së Shëndetësisë për vitin 2010 për banderola të ndahen mjete shtesë e cila do të mbulojë këtë fushë të rëndësishme për barnat.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe në parim e përkrah dhe ne si komision funksional do të shqyrtojmë dhe do të ndryshojmë disa çështje që janë të rëndësishme për Agjencionin Kosovar për Pajisje dhe Produkte Mjekësore dhe do të japim kontributin tonë në këtë komision. E rëndësishme është se Agjencioni Kosovar për Produkte dhe Pajisje Mjekësore çdo vit krijon të hyra vetjake që janë të rëndësishme për buxhetin e Republikës së Kosovës rreth 1 milion e 200 mijë euro ashtu mesatarisht parashihet që të ketë çdo vit të hyra vetjake. Prandaj, edhe një herë po e ceku që në të ardhmen do të ishte mirë që me një ligj të veçantë të rregullohet çështja e agjencive të pavarura në Republikën e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së deputetja Gjylnaze Sylja e ka fjalën.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar qeveritarë,

Deputetë të nderuar,

Unë kam mbase një mendim tjetër nga koleget e mia. E para është se me qenë se në Kosovë ne kemi ligjin ekzistues 2003/26 për produktet medicinale dhe pajisjet medicinale, nga projektligji i ri që është sjell nuk është e qartë se çka nuk ka funksionuar. Unë kisha dashur ta di, zoti ministër, konkretisht se çka nuk është zbatuar nga ligji aktual, cilat kanë qenë pengesa dhe pse ne duhet ta kemi një ligj të ri dhe të mund pastaj ta përkrah këtë ligj. Cilat kanë qenë, thjeshtë mangësitë e ligjit ekzistues, se për t'u bërë ligji i ri atëherë duhet ditë se cilat mekanizma nuk kanë funksionuar saktësisht. Tjetra është se, meqenëse ky projektligj është shumë i rëndësishëm pasi që masat të cilat përcaktohen dhe mekanizmat të cilat ndërmerren dhe cilat duhet të rregullojnë sektorin e farmakologjisë po duhet të sigurojnë edhe cilësinë sigurinë dhe efikasitetin e produkteve dhe pajisjeve medicinale ashtu që të ruhet shëndeti i popullatës, atëherë nuk i plotëson me të vërtetë as kushtet të cilat këtu parashtrihen se sipas këtij projektligji kryesisht iniciativa ka ardhur nga AKPM-ja. Në qoftë se qëllimi ka qenë me iu afrua dispozitave të BE-së megjithatë ky ligj nuk i afrohet, është pak më i avancuar projektligji i ri por megjithatë parashihen shumë dispozita nënligjore të cilat këtu thotë me i marrë parasysh aktet normative të BE-së, do të thotë prapë nuk është i avancuar ose nuk i plotëson plotësisht ato kushte të cilat i parashtron BE-ja.

Nga ana tjetër, unë e kam edhe çështjen, mendoj që është ligji shumë i paqartë, nuk është më i qartë së paku se ai ligji paraprak dhe zgjedhjet e ofruara nuk na bindin se ky ligj do të arrijë qëllimin e vet. Apo, në nenin 35, zoti ministër unë kisha dashtë ju më mirë të ma sqaroni ku thotë – rregullimi i çmimit të barnave. A duhet vetëm Qeveria gjegjësisht Ministria e Shëndetësisë dhe ministritë tjera të bëjnë rregullimin e çmimit të produkteve medicinale. E kuptoj caktimin e marzhave por rregullimin e çmimit të barnave ku janë të tjerët, do të thotë, të cilët duhet të merren me këtë çështje.

Prandaj për shkak të dilemave të cilat i përmenda dhe nga ana tjetër edhe një çështje tjetër para se të përfundoj është kostoja financiare. Në qoftë se parashihet që në vit shpenzohen diku 170 mijë euro ose nga ana tjetër të hyrat e AKPM-së së paku në vitin 2009 janë paraparë diku 1 milion e 200.000 euro atëherë a do t'i marrë përsipër Ministria e Shëndetësisë këto apo do të bëhen nga të hyrat vetjake të AKPM-së.

Për shkak të dilemave të cilat i paraqiti Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës konsideron se ky ligj duhet të përpunohet më tej që të arrijë qëllimin e vet. Prandaj, në parim nuk e përkrahim. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së ftoj deputeten Rita Hajzeraj, të marrë fjalën.

RITA HAJZERAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Ligjet janë pjesë e ndryshimeve dhe përshtatjeve ndaj kohës dhe rrethanave dhe drejt arritjes së nivelit sa më gjithëpërfshirës. I ngjashëm është edhe ky projektligj që po diskutojmë dhe para aprovimit të tij unë desha të bëj disa vërejtje që besoj se janë të efektshme dhe të nevojshme të merren në konsideratë para aprovimit të këtij projektligji.

Së pari dua të diskutoj se çështja është thelbësore për Agjencionin për Produktet Medicinale të Kosovës dhe pyetja ime është – a duhet ky Agjencion të jetë i pavarur apo të veprojë si i varur nga Ministria e Shëndetësisë.

Unë mendoj që me këtë rast duhet të kemi diçka të ndërmjetme dhe ky agjencion të ketë një pavarësi më të madhe veprimi, veçanërisht në fushën profesionale ku vlen të përmendet:

- licencimi i barnatoreve dhe depove të jetë kompetencë e drejtpërdrejtë e AKPM-së;
- inspektorati farmaceutik të jetë organ ekzekutiv i AKPM-së dhe jo i Ministrisë së Shëndetësisë;
- revokimi, anulimi i licencave për barnatore depo si dhe personeli që punon në to të jetë përgjegjësi e AKPM-së;
- aktet nënligjore të përgatiten dhe propozohen nga AKPM-ja në bashkëpunim me shoqatat e ndryshme profesionale, vendore ose personat fizikë juridikë që preken drejtpërdrejtë nga këto akte nënligjore ose veprojnë në lëmin ku këto akte nënligjore kanë efekt dhe të miratohen nga Ministria e Shëndetësisë, pra duke siguruar një bazë më të gjerë vendimmarrjeje;
- autonomi më të madhe buxhetore për AKPM-në e cila do të përdoret për trajtimin e stafit dhe kjo të sigurohet nga një përqindje e caktuar e të hyrave vetjake që AKPM gjeneron gjatë aktiviteteve të saj.

Unë mendoj se këto pika janë thelbësore për krijimin e një klime më të mirë pune me AKPM-në dhe mos të kemi përplasje të vazhdueshme të AKPM-së dhe Ministrisë së Shëndetësisë siç kemi pasur më herët.

Një gjë tjetër që kërkoj me ngulm që të jetë pjesë e këtij ligji është edhe një nen i cili e përcakton se në Republikën e Kosovës ka të drejtë pjesëmarrje në tenderë vetëm produktet që kanë autorizim marketingu nga AKPM dhe kanë aplikuar për autorizim marketingu në AKPM dhe jo në institucione tjera.

Besoj se kërkesat tona janë të efektshme, gjithashtu janë edhe të rëndësishme dhe specifike dhe të arsyeshme. Po ashtu në leximin e dytë dhe në punën e mëtutjeshme do të japim kontributin tonë si Grup Parlamentar edhe në Komisionin përkatës ndërsa në parim e mbështesim këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Ftoj deputeten Qamile Morina që në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së ta marrë fjalën.

QAMILE MORINA: Faleminderit, zoti kryesues!

Lidhja Demokratike e Dardanisë e ka analizuar me vëmendje Projektligjin e ri për produkte medicinale dhe pajisje mjekësore. E kemi shumë të qartë se niveli tejet frustrues në të cilin ndodhet sistemi farmaceutik kërkon legjislacion të zbatueshëm. Edhe pse u miratua Ligji për produkte medicinale dhe pajisje mjekësore që nga viti 2003 fatkeqësisht ky ligj nuk arriti të zbatohet në masë të madhe. Andaj dilemat tona për këtë projektligj të ri bazohen në faktin se nuk kemi shpjegime të analizuara, të studiuara nga ana e Ministrisë, përse ligji paraprak nuk është zbatuar dhe cilat janë arsyet, a ka qenë ligji i pazbatueshëm apo ka qenë çështje e neglizhencës së organeve kompetente. Argumentet konkrete nevojiten që Ministria mendon që ky projektligj i ri do të zbatohet.

Çështja tjetër është se projektligji është i përcjell me paqartësi të disa neneve dhe ato përcaktohen që me akte normative të bëhet plotësimi i mëtutjeshëm. Kjo e bën që ky projektligj obligon nxjerrjen e një mori udhëzimesh administrative dhe sipas nenit 36 të këtij ligji nxjerrja e këtyre neneve parashihet të bëhet në interval kohor prej 2 vjetëve, kjo do ta vështirësojë tej mase zbatimin e këtij projektligji. Çdo projektligj i miratuar në Kuvend është shumë e pëlqyeshme që të jetë në pajtueshmëri me legjislacionin e Bashkësisë Evropiane duke pasur parasysh synimet e shtetit tonë për integrim në Bashkësinë Evropiane. Projektligji si i tillë parasheh nxjerrjen e një mori akteve nënligjore gjatë hartimit të tyre, Ministria duhet të marrë parasysh aktet normative të BE-së për ndryshe ky projektligj nuk do të jetë në pajtueshmëri me legjislacionin e Bashkësisë Evropiane.

Dilema tjetër është se ligji në fuqi për produkte dhe pajisje mjekësore rregullon çështjen e produkteve medicinale për njerëz dhe veterinar. Projektligji i ri tërësisht eliminon pjesën për produkte medicinale për veterinar. Do të duhej që ju zoti ministër të sqaroni se kompetencë e kujt do të mbetet kontrolli e këtij sektori dhe kush e bën autorizimin për marketing për këto produkte.

Ajo që vërehet është se ky projektligj mbetet në masë të madhe i ngjashëm me ligjin paraprak. Ndryshimet që i kemi vërejtur janë: lehtësirat e parapara për prodhuesit vendorë në nenin 5, ku një ndër kriteret delikate që duhet përmbushur për licencim si praktika e mirë e prodhimit u mundësohet prodhuesve vendorë që në afat prej 3 vjetësh të arrihet përmbushja e këtij standardi si kusht për licencim. Këtë ndryshim në projektligj e konsiderojmë të arsyeshëm për dhënien e mundësisë për arritjen e standardit në afat kohor për prodhuesit vendorë duke pasur parasysh vështirësitë e tyre objektive.

Ndryshimi tjetër në këtë projektligj është nxjerrja e tërë akteve normative mbeten kompetencë e Ministrisë së Shëndetësisë gjë që me ligjin në fuqi në fuqi është në masë të madhe kompetencë e AKPM-së si agjencion i pavarur.

Ajo që është plotësisht e papranueshme në këtë projektligj është se në kapitullin – autorizim për marketing për produkte mjekësore neni 11 parasheh konfidencialitetin e këtyre dokumenteve. Përse duhet zoti ministër të mungojë transparenca për këto dokumente. Në ligjet referente të rajonit nuk ekziston një dispozitë e tillë.

Gjithashtu, e papranueshme është që në ligjin paraprak, edhe në këtë projektligj mungojnë dispozitat ligjore që obligon udhëzimet për përdorim. Çdo produkt, që ofrohet në shitje në vendin tonë duhet të jetë shënuar në paketimin e jashtëm informata për produktin në gjuhën shqipe gjegjësisht gjuhën zyrtare dhe çdo medikament që vendoset në treg duhet të posedojë udhëzimin për përdorim që është në përputhje me karakteristikat e produktit.

Në fund ne konsiderojmë se projektligji i ri për produkte dhe pajisje mjekësore përkundër lehtësirave të parapara për prodhuesit vendorë është i përcjell me mjaft paqartësi nga se shumë çështje të rëndësishme në këtë projektligj mbetet të rregullohen me akte normative që mbeten e vetmja kompetencë e Ministrisë së Shëndetësisë. Kështu mendojmë që ky projektligj duhet të përpunohet më mirë për ta arritur qëllimin e vet. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar 7+, deputeti Sadik Idriz e ka fjalën.

SADIK IDRIZ: Hvala predsedavajući!

Parlamentarna grupa “7+” u načelu podržava ovaj nacrt zakona, jer smatramo da je veoma značajan, jer se njime reguliše jedna oblast koja je značajna za javno zdravlje građana Kosova, a znamo da je i u ovom trenutku a i ovih proteklih godina na Kosovo mogu i legalno i ilegalno da ulaze značajne količine lekova i medicinskih proizvoda zbog, da tako kažem, poroznosti granica Kosova a i zbog drugih stvari. Nacrt zakona određuje pravila za proizvodnju, kontrolu kvaliteta, registraciju, uvoz, izvoz, trgovinu, recepte, efikasnost, bezbedno korišćenje proizvoda i medicinskih sredstava na Kosovu. Komisija, na čijem sam čelu, mada je ministar dao reč na početku, verovatno sam se kasno javio, je razmatrala prije ovog prvog čitanja zakona i imala je određenih dilema – zašto novi zakon, pošto je već postojao zakon, da li je moglo da ti nedostaci koji su uočeni u toku rada mogli da budu prevaziđeni izmenama i dopunama postojećeg zakona. Medjutim, to nije neki problem zato što nije preko 50% izmena, to se radi kada se vrši izmena i dopuna postojećeg zakona ukoliko promene iznose više od 50%, onda treba novi zakon. Sponzor je smatrao da je potreban novi zakon, da bi bila jasnija slika, to ćemo mi na komisiji raditi. Ja ovde pred Parlament, znači u ime komisije... ima kapacitete da radi na ovom zakonu i da će najverovatnije biti možda organizovana javna debata po ovom zakonu. Razgovaraćemo sa zainteresovanim stranama, sa Ministarstvom, sa Agencijom za lekove, takodje razgovaraćemo i sa udruženjima farmaceuta na Kosovu, znači sa svim zainteresovanim stranama. Komisija će dati svoj doprinos i mislim da ćemo napraviti jedan dobar zakon u interesu građana Kosova. Mi ćemo ga u principu, u načelu podržati i daćemo svoj doprinos u toku daljeg rada. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Radhën e kanë deputetët. I vetmi për fjalë është lajmëruar deputeti Riza Smaka e ka fjalën.

RIZA SMAKA: I nderuar, zotëri kryesues!

Dy-tri vërejtje parimore. Një, gjobat, dënimet me të holla duhet, patjetër. Ja, ju lutem, ky formulim do të duhej të pësonte ndryshim, sepse është në kolizion me parimet themelore kështu juridike të them kësisoj. Ja ç’thuhet. “Shkelja e dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore”. E tash, me këtë formulim Ministrisë do t’i jepej funksioni legjislativ, sepse supozohet se do të caktonte dispozita të funksionuar me ligj, që është kolizion ju lutem, që nuk mund të bëhet. Ekzekutivi atë funksion nuk mund ta ketë në shtetin demokrat ku janë pushtetet fundamentale të ndara reciprokisht të kontrolluara. Më pastaj, paragrafi i dytë, thotë – gjobat e përcaktuara me këtë ligj do të kenë parasysh shkallën e shkeljes së

ligjit dhe detyrimin e tjera... Kjo çështje është e rregulluar me ligj special, se aty ka shumë elemente të cilat ndikojnë në përcaktimin e dënimit edhe të masës dënimore. Prandaj ajo nuk është tematikë e këtij ligji se aty vjen a është bërë me qëllim dovus mallu, dollus mitus apo me pa hiri e janë tri a katër gradacione, culpa levis, pacuel pallata... prandaj kjo çështje duhet t'i koncedohet atij ligji që është lex-specialis, derguet lex-generalis, në këtë rast ky ligj nuk mund t'i superpunohet atij po e kundërta.

Edhe, në nenin 36 është dhënë autorizimi të them shkurt kësisoj, që aktet nënligjore në aplikimin e këtij ligji do të bëheshin brenda dy vjetëve. Nuk o fare mirë ky komoditet është tepër i madh. Bile 3 muaj janë tepër..., së paku do të ishte 3 muaj ditë, se në shtetet e përparuara përgatiten aktet nënligjore krahas projektligjit të caktuar, kështu që miratohet, po e zëmë projektligji, shëndrrohet në ligj dhe ato rishikohen pak a shumë në harmoni me amendamentet e miratuara dhe bile, bile brenda një muaj dite aktet nënligjore, domethënë, rregulloret, rregullat e udhëzimet që bëhen, a këtu dy vjet, po dy vjet ndoshta ky ligj do të ndryshohet edhe dy-tri here, prandaj nuk do të ishte zgjidhje racionale.

Neni 38, dihet fare mirë se Ministria e Shëndetësisë, ministri është kompetent dhe është i autorizuar i vetëm për miratimin e akteve nënligjore, prandaj kjo dispozitë është me të vërtetë e panevojshme. Dhe, përfundimisht thuhet me hyrjen në fuqi të këtij ligji pushon – pushon ligji që e cakton. Po dihet fare mirë, ligji i mëvonshëm e shfuqizon ligjin e mëparshëm dhe ky formulim do të duhej të kompozohet te dispozita e nenit 36. Dhe, këtu ku thuhet neni 36 – marrëveshje tranzitore, ky është një term i shpikur, i pa përshtatshëm, se të ishte bile në njëfarë logjike, po s'ka kurrfarë logjike, kurrfarë kuptimi s'ka dhe nuk gjendet kjo në terminologjinë juridike moderne kurrkund, as më parë as tash, prandaj ose është fjala për marrëveshje, te akti ligjor s'ka marrëveshje, te akti ligjor ka imperativ, e jo marrëveshje. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit deputet! Ministri e ka kërkuar fjalën për do sqarime që u kërkuar nga ai gjatë debatit.

MINISTRI ALUSH GASHI: Faleminderit shumë për pjesëmarrje në debat. Vetëm shkurtimisht.

Në hartimin e këtij ligji, të cilin si tha edhe kryetari i Komisionit Parlamentar për Shëndetësi, ne kemi ofruar si ligj të ri vetëm për shkak të asaj se ka kaluar mbi 40% të përmbajtjes së saj. Në këtë ligj, përveç grupit punues, kanë marrë pjesë shoqatat farmaceutike, Katedra Farmaceutike dhe profesionistë më të mirë të vendit. Një pyetje që u bë këtu ishte kush do të merret me produktet e veterinës? Me produkte të veterinës do të merret Agjencioni i Veterinës. Kjo është kompetencë e tyre.

Një prej çështjeve që u përsërit disa herë ishte çështja e këtij agjencioni – a duhet që ky agjencion t'i përgjigjet Ministrisë së Shëndetësisë apo kujt, apo cili është niveli i pavarësisë? Ne duhet të jemi korrekt. Ky ligj për produkte dhe pajisje medicinale nuk e rregullon çështjen e agjencioneve të Republikës së Kosovës. Sugjerimet e Fridomit që e bën rishikimin funksional lidhur me këtë çështje për Ministrinë e Shëndetësisë thotë se Agjencioni i Produkteve Medicinale duhet t'i përgjigjet Ministrisë së Shëndetësisë, ndërsa Kuvendit i përgjigjen agjencionet që i themelon Kuvendi. Një prej pyetjeve të shpeshta të diskutuesve ish se pse këtu parashihet që të ketë shumë akte nënligjore, nuk janë rregulluar me ligj? Këtë debat e kemi pasur, sikur këtu të parashihet e tëra ajo

materie, ky me të vërtetë do të ishte një ligj shumë i gjerë dhe si ligj është më mirë që të ketë më pak dhe të jetë më i qartë.

Ne do të bëjmë përpjekje që këtu ta ofrojmë një kulturë të re të miratimit të akteve nënligjore dhe jemi shumë të interesuar që aktet ligjore nga Ministria, të hynë në Qeveri dhe në se ka nevojë edhe në Kuvend. Qëllimi i këtij ligji është që në vendin tonë të ketë sa më shumë produkte nga Bashkimi Evropian, nga Zvicra, nga SHBA-ja, Kanadaja e tjera.

Dhe, në fund u paraqit një çështje shumë me rëndësi, të cilën diskutuesi nuk i kushtoi shumë kohë, por për ne ka qenë preokupim një kohë bukur të gjatë dhe ende nuk kemi arritur, prandaj shpresojmë se të jetë në ligj.

Është pyetja në zë – pse duhet vetëm qytetarët e Kosovës ta paguajnë një produkt medicinal më shtrenjti në Evropë? Sepse, demagogjia dhe influenza e industrisë nuk e ka lejuar deri më sot që të caktohet një marzhë. Ne ende kemi në treg barna që kushtojnë për 100 – 200% më shtrenjtë se sa në vendet e Bashkimit Evropian për shkak të ndikimeve të grupeve jo formale. Nuk është çështje, se këtu është treg i lirë dhe gjithkush mund të bëjë çka të donë. Jo në asnjë vend të lirë nuk mundet që një produkt brenda dite, një produkt i cili është i interesit vital për popullatën që të ndërron çmimin dhe mu për atë kemi filluar, faza e parë është çështja me banderola që të jetë çmimi prandaj kemi kërkuar me ligj që kjo çështje e marzhit të rregullohet si në vende tjera që është. Importuesit me shumicë e kanë një limit që e rregullo ligji, këta me pakicë e kanë një limit tjetër. Por ne kemi pa që brenda një dite bari ka lëviz deri në 200 – 300% çmimi, prandaj ju lutem që këtë çështje ta merrni pak më but.

Çështja e konfidencialitetit të atyre që regjistrojnë është e rregulluar me ligj dhe kjo është një pjesë substanciale e reformave dhe fal mbështetjes së Kuvendit dhe Qeverisë kemi arritur që t'i kemi 70% të barnave dhe produkte tash nga Bashkimi Evropian. Para 2 vjet kanë qenë vetëm 30% andaj miratimi i këtij ligji, ngritja e kapaciteteve si dhe fuqizimi i inspektorateve besoj që qytetarëve do t'u ofrojnë garanci më të mira që barnat do t'i kanë të sigurta dhe çmimet do t'i kenë të pranueshme. Ju faleminderit shumë në mbështetjen në parim. Ligji është në duar të Kuvendit dhe besoj që do të jetë një ligj i mirë në interes të qytetarëve të vendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, ministër!

Në fund kërkoj deklarinimin me votim nga deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji. Ftoj deputetët dhe regjinë të përgatitet për votim dhe votojmë tash. Në sallë janë 70 deputetë.

Faleminderit! Pa kartelë kush janë “për”? Janë 2, 3. A ka kundër pa kartelë? Jo. Abstenime? Nuk ka.

Konstatohet se me 53 vota për, 10 kundër dhe 5 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për produktet dhe pajisjet medicinale.

Në bazë të Rregullores së Punës Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale,
- Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
- Komisionin për Buxhet e Financa,
- Komisionin për Komunitete dhe
- Komisionin për Integritet Evropian.

Që brenda dy muajve nga shqyrtimi i parë Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandimet. Ju faleminderit!

Pauzë deri në orën 15:00. I lus deputetët që vazhdimi i seancës të fillojë në ora 15:00 për shkak të ngarkesës së rendit të ditës që e kemi për sot. Ju faleminderit!

Vazhdimi i seancës pas pauze

Seancën e drejton kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë, po vazhdojmë seancën.

Para se të vazhdojmë e kam një kërkesë që në rend të ditës tani menjëherë të fusim pikën 14:

- Rekomandimi i Komisionit për Buxhet e Financa për ndarjen e mjeteve financiare të përkohshme për RTK-n, dhe
- Propozim-vendimi i Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Komisionit për Miniera dhe Minerale.

Janë dy çështje të ngutshme që realisht ia vlen dhe mendoj që duhet t'i kryejmë sot. Po para se të vazhdojmë duhet një votim formal i seancës.

Kush është “për”? Faleminderit! Shumica është. A ka kundër? Nuk ka. Abstenim? 2. Faleminderit! Vazhdojmë.

Pra, vazhdojmë me pikën e katërmëdhjetë:

- **Rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa për ndarjen e mjeteve për financimin e përkohshëm të Radiotelevizionit të Kosovës.**

Dy komisionet parlamentare, ai për Buxhet e Financa dhe Komisioni për Administratë Publike dhe Media e kanë shqyrtuar kërkesën e RTK-së për ndarjen e mjeteve për financimin e përkohshëm të Radiotelevizionit të Kosovës për periudhën 1 janar deri më 30 qershor 2010 dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportin me rekomandime.

Ftoj raportuesin e këtyre dy komisioneve, zotin Gani Koci, që të paraqesë arsyetimin.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Pa dashur të futem në çështjen për të cilën të gjithë e dimë, çështjen e financimit të Radiotelevizionit të Kosovës dhe gjendjen financiare në këtë medium publik, pas vendimit të përkohshëm për masë të përkohshme të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Bordi i Radiotelevizionit të Kosovës ka bërë kërkesë dhe ka kërkuar nga Kuvendi që të gjejë mënyrën e mundshme për tejkalimin e kësaj gjendjeje financiare. Them zgjidhje të mundshme dhe të menjëhershme, për shkak se me vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, ka përfunduar ai burimi financiar për Radiotelevizionin e Kosovës, që ishte nëpërmjet Korporatës Energjetike të Kosovës.

Ne si Komision paraprakisht kemi kërkuar planin e biznesit të Radiotelevizionit të Kosovës për këtë periudhë. Kemi kërkuar po ashtu një raport rreth gjendjes së mundshme

financiare në llogaritë bankare që i ka Radiotelevizioni i Kosovës. Kemi kërkuar që të definohen qartë borxhet që i ka Korporata Energjetike e Kosovës ndaj Radiotelevizionit, jo vetëm për periudhën e vitit 2009, deri me datën kur është marrë vendimi në Gjykatën Kushtetuese, po prej fillimit të aplikimit të kësaj takse nëpërmjet të faturës së konsumatorëve të Korporatës Energjetike të Kosovës. Përgjigjen në këtë të fundit nuk e kemi marrë edhe meqë ka qenë nevoja urgjente, ne kemi mbajtur një mbledhje të përbashkët me dy komisionet që ta tejkalojmë këtë gjendje dhe kemi ardhur në këto përfundime: Kërkesa e tyre që financimi të bëhet nga 1 tetori i vitit të kaluar deri më 30 mars të këtij viti, Komisioni ka shqyrtuar dhe këtë kërkesë e ka zhvendosur në një periudhë tjetër, do të thotë, në periudhën kohore prej 1 janar të këtij viti deri më 30 qershor, ndërsa për sa i përket shumës së kërkuar për periudhën tjetër paraprake edhe në këtë rast nuk ka ndryshuar shuma e kërkuar, me të vetmin ndryshim është sepse është konstatuar se Radiotelevizioni i Kosovës ka një obligim ndaj partnerëve për periudhën 2009, që është në vlerën 600.000 euro, që ajo shumë të përfshihet në këtë kërkesën përfundimtare, si pjesë e kësaj, duke pasur parasysh se, në qoftë se gjatë kësaj periudhe Radiotelevizioni nga burimet ose borxhet që i ka Korporata Energjetike ndaj këtij mediumi që të pasqyrohen kohë pas kohe me raporte të ndryshme që të dimë se vërtet çka është realizuar nga të hyrat që është dashur të realizohen në vitet paraprake. Prandaj, Komisioni ka ardhur në këtë përfundim dhe para Kuvendit del me këto rekomandime.

Nën 1. I rekomandohet Kuvendit të miratojë kërkesën për financimin e përkohshëm të Radiotelevizionit të Kosovës për periudhën 1 janar 30 qershor 2010, në shumën prej 5 milionë e 264 mijë euro, në të cilën shumë përfshihet edhe borxhi i RTK-s për vitin 2009 ndaj partnerëve gjatë veprimtarisë në këtë periudhë, do të thotë, prej kur ka mbetur pa financim.

Obligohet Qeveria, respektivisht Ministria e Ekonomisë dhe Financave që për mbulimin e kësaj shume të ndajë mjete financiare nga Buxheti i Republikës së Kosovës të vitit 2010, nga kategoria ekonomike – mallra dhe shërbime në të gjitha nivelet.

Këtë e kemi bërë në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, sepse kemi dashur të dimë saktë se ku mund Qeveria të gjejë burimet e veta për këtë ndërhyrje të them financiare, ndihmë financiare Radiotelevizionit të Kosovës, deri në gjetjen e një zgjidhjeje të përhershme dhe që siguron një financim të sigurt ndaj Radiotelevizionit të Kosovës? Dhe, Ministria e Ekonomisë dhe e Financave ka qenë e pajtimit, prandaj me këtë rekomandim obligohet Ministria që proporcionalisht në linjen mallra dhe shërbime të ndajë këtë shumë të mjeteve dhe t’ia dedikojë Radiotelevizionit të Kosovës sipas Ligjit të menaxhimit të financave publike.

Rekomandimi i dytë është ky:

2. Obligohen RTK, KEK-u dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave t’i definojnë borxhet e KEK-ut ndaj RTK-s për faturat e papaguara në të gjitha periudhat që është aplikuar kjo taksë deri në datën e vendimit të Gjykatës Kushtetuese për masën e përkohshme për parapagimin e RTK-s.

Duhet të sqaroj Kuvendin se ne në Komision kur kemi vendosur dhe kemi kërkuar për këto borxhe kemi ftuar edhe përgjegjësit e Korporatës Energjetike të Kosovës, por ata na e kanë dërguar vetëm një letër dhe nuk kanë që të vijmë dhe të na japin shpjegime dhe sqarime në kërkesat tona.

Rekomandimi i tretë, që të dy komisionet kanë menduar dhe kanë vlerësuar si të drejtë, por jo vetëm tani, por edhe më herët gjatë shqyrtimit të raporteve financiare të Radiotelevizionit të Kosovës, është se deri më 15 mars të këtij viti, Kuvendit të Republikës së Kosovës, duhet t'i dorëzohet një raport i auditimit nga auditor i jashtëm dhe i pavarur për pasqyrat financiare dhe performancën e Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2009. Kostoja e shpenzimeve të këtij auditimi që duhet të kryhet deri më 30 mars është në shumën nga rekomandimi 1 i këtyre rekomandimeve të dy komisioneve. Nuk kemi dashur të lëshohemi vërtet në aspektin e menaxhimit të financave me Radiotelevizionin e Kosovës. Shpresoj se kjo do të duhej të ishte një temë e veçantë, pas paraqitjes së këtij raporti të auditimit për të cilën gjë edhe kemi thënë këtu në Kuvend, por edhe kemi ende që të themi.

Prandaj lus deputetë e Kuvendit që të miratohen këto rekomandime të dy komisioneve.

KRYETARI: Radha është e shefave të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike e do fjalën Ramë Buja.

RAMË BUJA: I nderuar zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ministra dhe zëvendëskryeministër,

Meqë e dimë të gjithë se cili është pozicioni i Radiotelevizionit të Kosovës, Televizionit të vetëm publik, atëherë ne si Grup Parlamentar i mbështesim natyrisht këto rekomandime, edhe pse për Televizionin, vërtet Radiotelevizionin e Kosovës, do të duhej vërtet bërë debat në Parlament që të sqarohen shumë gjëra që meritojnë për t'u sqaruar. Por, ne jemi tash për ta mbështetur këtë ndihmesë që edhe e rekomandojnë dy komisionet tona. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Lidhjes Demokratike, Lutfi Haziri e ka fjalën.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Zëvendëskryeministër, ministra,

Të dashur kolegë deputetë,

Falënderoj Komisionin për punën që e ka bërë. Radiotelevizioni i Kosovës po vazhdon të jetë preokupim joni si themelues, preokupim serioz edhe në kuptimin e zbatimit të politikave për të cilin e ka misionin edhe në kuptimin menaxherial. Përkundër besimit të madh që bordi i ri do të arrijë ta stabilizojë Televizionin Publik, po shihet që problemet janë serioze atje dhe zhvillimet e fundit na kanë shqetësuar seriozisht. Ne e ndajmë mendimin sa i përket rekomandimit të parë, ndërsa rekomandimin 2 dhe 3 e mbështesim plotësisht si zgjidhje të përkohshme duke besuar se ky Kuvend mund ta tejkalojë krizën financiare në RTK nëse ndanë mjete buxhetore për 3 muajt e parë, jo deri më 30 qershor, por deri në fund të muajit mars, nëse këto mjete Kuvendi ia huazon RTK-së, nuk i jep, nuk i falë, sepse jep atributë Televizionit të ndikuar apo të ndikuar politikisht apo shtetëror që është në kundërshtim me rregullat e IBUS dhe që Kuvendi t'i obligojë komisionet dhe mekanizmat e vet që të bëjnë një zgjidhje afatgjate financiare për RTK-n, gjatë kësaj kohe, brenda 3 muajve, sepse nuk mund ta mbajmë gjallë Televizionin me infuzione financiare dhe duke shpenzuar mjete buxhetore, realisht, sepse një praktikë e tillë është filluar me KEK-un dhe disa ndërmarrje vetëm për një vit ose vetëm për një moment ose për rast të caktuar e ka vazhduar, është bërë pjesë e traditës për të ndërhyrë financiarisht me buxhet qeveritar për t'i shpëtuar nga problem që e kanë. Në rastin e RTK-së është shumë më i ndjeshëm dhe ne besojmë që nëse përmirësohet rekomandimi i parë që mbështetja financiare të jepet për tre muajt e parë që të jetë në formën e huazimit

dhe që Kuvendi këtë periudhë kohore prej 3 muajve e ofron një zgjidhje afatgjate financiare për RTK-n besojmë që do të arrijmë ta përballojmë situatën atje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk e di a keni pas ju në këto dy komisione anëtarë....? Në rregull! Urdhëro, Gani! Po e lëmë në fund, le ta kryejnë shefat e grupeve.

(Ndërhyrje, pa kyçje)

Gani, prit në fund e jep sqarimin. Fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të AAK-së Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës.

Faleminderit për këtë përmirësim, janë më shumë se dy grupe parlamentare në Kuvend dhe duhet të prononcohen shefat ... para se të kalojnë në debat në mes dy partive në pushtet. Do të tentoj me pak fjalë ta paraqes pozicionin e Aleancës në lidhje me këtë çështje. Mendojmë se duhet të përkrahen rekomandimet e Komisionit, përkundër faktit, se ne i kemi disa vërejtje serioze. Do t'i jap disa premisa prej të cilave ne nisemi. Premisa e parë është se Radiotelevizioni i Kosovës si i vetmi transmetues publik nuk guxon që të pësojë kolaps për shkak se është investuar shumë gjatë në këtë institucion që të arrijë në pozitë që për shkak të disa çështjeve të cilat në fund të fundit edhe janë parimore ne të shkaktojmë dëm i cili mund të jetë i pariparueshëm për Radiotelevizionin e Kosovës. Kjo është çështja e parë.

Çështja e dytë është se edhe një herë jemi të indinjuar, irrituar me sistemin qeverisës në Kosovë. Çka do të thotë kjo? Situata në Radiotelevizionin e Kosovës nuk është e re, nuk ka ndodhur para dy jave. Është diçka që po ndodh për disa muaj. Mos harroni se ne buxhetin e Kosovës e kemi kaluar para pak më shumë se një muaj dhe çka po bëjmë sot është një rishikim i buxhetit. Do të thotë, sistemi qeverisës në Kosovë është i atillë konfuz, i paaftë për të paraparë edhe çështjet të cilat i ka pasur para hundës. Problemin e financimit të Radiotelevizionit të Kosovës, Kosova, Kuvendi i Kosovës dhe Qeveria e Kosovës e ka pasur para hundës që disa muaj dhe nuk ka arritur për ta anticipuar në kohën kur ne kemi debatuar për buxhetin e Kosovës, në atë kohë është anticipuar dhe është biseduar vetëm për shpërndarjen e tenderëve dhe tani ne arrijmë në pozicion totalisht të çuditshëm që vetëm një muaj pas aprovimit të buxhetit, bëjmë rishikim të buxhetit për shkak se e kemi parë se diku na ka ngecur çështja e Radiotelevizionit të Kosovës. Kjo do të thotë është një çështje për të cilën Kosova duhet të jetë e vetëdijshme, opinionin publik në Kosovë duhet të jetë i vetëdijshëm, ne duhet të jemi të vetëdijshëm se kjo nuk është mënyrë për të udhëhequr shtet. Nëse një çështje e cila vetëm se nuk ka bërë titull, është neglizhuar, paramendoni sa çështje tjera shumë serioze mund të mbesin të pa adresuara për shkak se në Kosovë nuk ka sistem të qeverisjes, nuk ka proces të menduarit për qeverisje.

Çështja tjetër për të cilën do të flas pa e zgjatur për shkak se fjalën e fundit e thash të parën dhe e thash me qëllim që ne si Aleancë e mbështesim, i mbështesim rekomandimet për hir të transmetuesit publik, jo për hir të dikujt tjetër, është se ne sot, tani dëgjojmë që ende nuk ka esencialisht marrëveshje e cila ka qenë dashur të jetë marrëveshje demokratike për shkak se partitë në pushtet kanë shumicën në Kuvend dhe tek sot e marrim vesh që nuk ka esencialisht marrëveshje për këtë çështje dhe është tepër brengosëse për ne. Posaçërisht e mbështesim rekomandimin e Komisionit për një

auditim serioz në Radiotelevizionin e Kosovës, i cili duhet të vijë te ne për shkak se ne jemi duke u sjell në vorbull që më shumë se një vit dhe nuk kemi i arritur asnjëherë që ta kemi një raport të qartë të auditimit dhe që të kuptojmë se çka po ndodhë në institucionin të cilin e kemi themeluar ne dhe i cili realisht është në pozitë shumë të keqe pa dashur për të politizuar skajshëm për shkak të politikës. Keni marrë raporte pa dashur që të hyj edhe një herë tek këto. Fundi i fundit, po them se le të jetë e qartë për Kuvendin, por edhe për opinionin publik se nuk kemi të bëjmë ne këtu me problem të Radiotelevizionit të Kosovës ... Problemi i Radiotelevizionit të Kosovës është krijuar për shkak të qeverisjes të paaftë për të menaxhuar me sistemin në këtë shtet, totalisht të paaftë për shkak të një qeverisjeje e cila tenton për të konkurruar me gjithë çka është e pavarur dhe ta fusë nën thundër të veten gjithë çka është e pavarur. Fundi i fundit, një ditë do të shihen të gjitha. Ky problem që ne sot e mbështesim zgjidhjen e tij, është krijuar për shkak të pushtetit, nuk është krijuar për shkak të RTK-s, as për shkak të njerëzve në RTK. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit Ardian... edhe për leksionin që ia dhe koalicionit qeverisës. Në emër të AKR-së fjalën e ka kërkuar Ibrahim Gashi.

IBRAHIM GASHI: Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i AKR-s duke pasur parasysh gjendjen e vështirë financiare kritike ta quajmë ashtu të Televizionit publik, të vetëm publik, ka pasur parasysh këtë dhe ka dhënë mendimin që të mbështet ky propozim i dy komisioneve, po natyrisht t'iu bashkohet shqetësimeve që u ngritën nga parafolësit se kjo mënyrë e financimit të Televizionit të vetëm publik urojmë që të jetë e përkohshme dhe afatshkurtër se përndryshe do të thotë atëherë ai nuk do të jetë, për fat të keq, s'do të jetë Radiotelevizion publik. Publik po se e shikojmë të gjithë, po jo publik se shpreh interesat e barabarta të gjithë audiencës që e shikon. Faleminderit! E mbështesim!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të LDD-s deputeti Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zotëri kryetar!

Si Grup Parlamentar ndiejmë obligimin, ashtu siç e ndien edhe Kuvendi i Kosovës, që çështjet dhe obligimet të cilat dalin nga Ligji për RTK-n të adresohen në mënyrë fundamentale. Ajo çka ka për obligim Kuvendi i Kosovës dhe tash është mirë që po hapet një debat i tillë, t'ia sigurojë qëndrueshmërinë financiare këtij mediumi dhe mediumi të vetëm publik në vend dhe e mbështesim në plotni të gjitha rekomandimet e Komisionit – dy komisioneve funksionale, në mënyrë si masë emergjente të tejkalohet kjo krizë e cila është krijuar në këtë medium publik. Por, konsiderojmë edhe një çështje se çështja e garantimit të pavarësisë së editorialit të këtij mediumi publik që asnjëherë nuk është trajtuar seriozisht nga ana e Kuvendit të Kosovës, mbetet si çështje preokupuese që duhet seriozisht të merret Kuvendi i Kosovës, më këtë rast. Prandaj, besojmë që pas kësaj periudhe do të gjejë mekanizma dhe do të gjejë frymë konsensuale Kuvendi i Kosovës që ta adresojë me kohë dhe me përgjegjësi këtë fenomen. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Në emër të Grupit 7+, Myfera Shiniq e ka fjalën.

MYFERA SHINIK: Teşekkür ederim,

Sayın Başkan, Bakanlar, milletvekilleri,

Kosova Radyo Televizyonunun sunmuş olduğu taleb, bütçe komisyonunda da bugün kabul ettik. Ve komisyonun Meclise sunmuş olduğu önergeleri de, 7+ Parlamenter Grubu olarak kabul ediyoruz, Kosova Radyo Televizyonuna da başarılar dilerken, Kosova toplumuna katkılarını artırarak sunmalarını diliyoruz.

Teşekkür ederim.

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, vazhdojmë. Në vazhdim kërkohet deklaram me votim për miratimin e Rekomandimit të dy komisioneve parlamentare për ndarjen e mjeteve financiare për RTK-n për financimin emergjent për periudhën 1 janar deri 30 qershor 2010.

Në sallë janë 72 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

(Ndërhyrje nga deputetët)

E mbylla debatin se shefat e grupeve i thanë fjalët e tyre. Shumica e mbështetën, unë ju falënderoj për mbështetjen.

Me 49 vota “për”, 11 “kundër”, 2 abstenime, miratohen rekomandimet e Komisionit.

(Ndërhyrje nga deputetët)

Faleminderit edhe prej teje! Vazhdojmë pikën e radhës. Ju lutem, u krye pika, nuk mund të kthemi, kemi votuar. Unë ju respektoj shumë, sidomos juve opozitën po... Jo opozitë edhe bile-bile shumë më të përgjegjshëm se sa opozita dhe i falënderoj shumë për sot.

Pika e pesëmbëdhjetë e rendit të ditës:

- Propozim-vendimi i Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës, ka shqyrtuar propozim-vendimin e Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Komisionit për Miniera dhe Minerale dhe ka rekomanduar shqyrtimin e tij në seancë plenare.

Para se të procedohet për votim, ftoj kryetarin e Komisionit funksional, zonjën Muzejene Selmani, apo raportuesin e Komisionit, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

MUZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryetar! Përsëritet për zëvendëskryeministrin dhe ministrat që janë prezentë dhe të gjithë deputetët që janë prezentë këtu në këtë seancë.

Në pajtim me rregullën 41 të Rregullores së Punës të Kuvendit, Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, më 25.1.2010 e shqyrtoi vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, numër 02-104 të 16.1.2010 për emërimin e anëtarëve të Komisionit për Miniera dhe Minerale dhe Kuvendit ia paraqet këtë rekomandim:

Kuvendi i Republikës së Kosovës, të mbështesë vendimin e Qeverisë së Kosovës për emërim të anëtarëve të Komisionit për Miniera dhe Minerale si vijon:

- Ahmet Tmava,
- Xhevdet Kastrati,
- Ibush Jonuzi,
- Shaip Latifi.

Duke marrë parasysh se Komisioni për Miniera dhe Minerale deri më tani dhe me të gjitha vërejtjet dhe rekomandimet të cilat iu kanë dërguar Qeverisë, në mungesë të funksionimit të këtij Rregullatori të Pavarur të Minierave, më në fund erdhën emrat e tyre dhe tash i mbetet Kuvendit ta japë mendimin e vet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit të Partisë Demokratike e ka kërkuar fjalën deputeti Gani Koci, ose veç i paska mbetur emri, si duket. Deputetja Salë Berisha-Shala e ka fjalën. Regjia. Kartelën a e keni në rregull?

SALA BERISHA-SHALA: Po! Faleminderit, zoti kryetar!

Përsëritje për Kabinetin qeveritar dhe juve kolegë deputetë, Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për anëtarë të Komisionit për Bord për Miniera dhe Minerale e kemi shqyrtuar dhe si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, të cilin e mbështesim fuqishëm. Këtë vendim e kemi shqyrtuar edhe në Komision parlamentar i cili është votuar me shumicë votash. Prandaj në emër të Grupit Parlamentar i mbështes kandidatët në fjalë dhe uroj që Bordi në këtë përbërje të jetë më shumë në nivel të detyrës se sa bordi i kaluar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës kush e do fjalën? Në rregull, jeni ju! Në emër të AAK-së, deputeti Et'hem Çeku e ka kërkuar fjalën.

ET'HEM ÇEKU: Faleminderit, zoti kryetar!

Duhet të theksoj se në Komision nuk ka qenë një konsensus për kandidatët të cilët i ka deleguar Qeveria për sot në Parlament. Më vjen keq të them se ne me këtë rast në qoftë se bëjmë aprovimin e këtyre kandidatëve kemi të bëjmë me një shkelje të ligjit që është në fuqi për emërimin e anëtarëve në bord, sepse këtu i keni biografitë e tyre dhe i shihni që vijnë të gjithë të pasur nga vija politike. Ne si Komision kur kemi diskutuar për ndërtimin e Bordit për Hekurudha duhet t'ju informoj se për shkak se vijnë, ka pasur emra që vijnë nga vija politike, nuk i kemi aprovuar. Të njëjtën gjë sot e bëjmë prapë. Ne e shohim të nevojshme se kemi nevojë të themelohet bordi i ri, është gjithçka në rregull, mirëpo ne nuk jemi dhe nuk do të dom të jemi pjesë e shkeljes së Ligjit për minierat. Dhe, unë ftoj, që mbasi jemi duke hartuar ligjin e ri dhe që është për një periudhë të shkurtër që do të vijë në Parlament, ta shtyjme aprovimin dhe të presim ligjin e ri për miniera të cilin llogaritet që deri në fund të shkurtit mund ta kemi në aprovim. Përndryshe, ne kemi të bëjmë me një emërim të bordeve të cilët vijnë nga vija e pasur politike, bile në shaka i kam thënë kolegëve nga Lidhja Demokratike të kishin propozuar dikë nga Vushtrria që i ka fituar zgjedhjet, do të ishte shumë e mirë, mirëpo Ibushi i ka humbur zgjedhjet në Vushtrri. Dhe, duhet të them se kemi një përbërje të pasur politike e cila nuk mendoj se do të mund të qeverisë me minierat e Kosovës. Si Grup Parlamentar kërkojmë që të shtyhet dhe nuk jemi për aprovimin e tij. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Po edhe kur ke qenë ministër, ka qenë deputet Ibush Jonuzi. Vazhdojmë. Muzejene Selmani e ka kërkuar fjalën.

MUZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Duke marrë parasysh CV- të e katër kandidatëve nga ana profesionale mund të them se atë konditë e plotësojnë, ndërsa në rast se e marrim ligjin dhe e shikojmë Ligjin për Rregullatorin e KPM-së si organ i pavarur në bazë të Kushtetutës së Kosovës kishte me qenë vërejtje shumë esenciale a janë këta rregullatorë të pavarur a janë rregullatorë politikë? Në rast se katër anëtarët vijnë nga vijat politike, mirëpo janë njerëzit profesional, atëherë këtu si kryetar i Kuvendit që është organi më i lartë kisha propozuar që katër anëtarët të mos jenë pjesë e politikës, ana profesionale e tyre është shumë e lartë, me gjithë mirëkuptimin që e kanë, mirëpo në rast se edhe me Kushtetutë i kemi agjencionet e pavarura, atëherë nuk e di pse iu lëmë vija buxhetore dhe si vendosim brenda një ministrie. Për këtë arsye unë s'mund të them që janë në linjë me ligjin për këta katër kandidatë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të LDD Lulzim Zeneli e ka fjalën.

LULZIM ZENELI: Grupi Parlamentar i LDD-së do të votojë kundër dhe nuk e përkrah propozimin e Qeverisë. Faleminderit!

KRYETARI: Tjerët? Në emër të Grupit ” 7+” jeni dakord? Faleminderit! Atëherë, lus deputetët... Sa jemi në sallë, a kemi numër të caktuar? Jo, duhet konstatuar një herë prezencën. Do të thotë kemi 73 deputetë. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Faleminderit! Me 45 vota “për”, 22 “kundër”, 2 “abstenime”, Kuvendi miraton vendimin e Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale në përbërje:

- Ahmet Tmava,
- Xhevdet Kastrati,
- Ibush Jonuzi dhe
- Shaip Latifi, me mandat katërvjeçar. Urime, edhe në emrin tuaj. Faleminderit!

Pika e radhës është pika e gjashtë:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare

Në bazë të rregullës 35 pika 1 të Rregullores së Punës janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin në parim të këtij projektligji. Ftoj ministrin e Punëve të Jashtme zotin Skënder Hyseni, që para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin.

MINISTRI SKËNDER HYSENI: Faleminderit shumë, zotëri kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kam nderin që sot para jush të paraqes këtë projektligj për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare dhe që në fillim kërkoj miratimin në parim të tij.

Më lejoni që t'i shtjelloj krejt shkurt arsyet pse dhe domosdoshmërinë e miratimit të këtij projektligji. Hartimi dhe miratimi i një ligji të këtillë është detyrim që buron nga zotimet tona të shprehura në Deklaratën e Pavarësisë dhe dispozitat përkatëse kushtetuese. Në

Deklaratën e Pavarësisë ne kemi pranuar plotësisht marrjen përsipër të detyrës së anëtarësisë së përgjegjshme në bashkësinë ndërkombëtare. Këto zotime që i kemi shprehur para bashkësisë ndërkombëtare dhe si rrjedhojë detyrimet ndërkombëtare që i kemi marrë përmes Deklaratës së Pavarësisë, u kemi dhënë karakter detyrues në rendin e brendshëm ligjor përmes Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Paragrafi 2 i neni 17 të kësaj Kushtetute përcakton se, citoj: “Republika e Kosovës merr pjesë në bashkëpunimin ndërkombëtar për promovimin dhe mbrojtjen e paqes, sigurisë dhe të drejtave të njeriut”, mbyll citatin. Sanksionet ndërkombëtare janë masat të cilat kanë për qëllim të sigurojnë paqen, sigurinë dhe të drejtat e njeriut. Zbatimi i sanksioneve ndërkombëtare është pra detyrim kushtetues i Republikës së Kosovës. Për këtë qëllim Republika e Kosovës ka nevojë që të krijojë bazë të hollësishme ligjore e cila do të përcaktonte rregullat të cilat garantojnë zbatimin e këtyre sanksioneve. Sanksione të cilat i vendos Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Zbatimi me kohë dhe në mënyrë të duhur i sanksioneve ndërkombëtare përmes një baze të qartë ligjore që synohet të arrihet përmes këtij projektligji do të kontribuonte në stabilitetin dhe sigurinë ndërkombëtare, përfshirë mbrojtjen e bashkësisë ndërkombëtare nga terrorizmi, konfliktet etnike e fetare si dhe konfliktet e tjera në shtete të caktuara. Njëkohësisht, zbatimi me kohë dhe i duhur i sanksioneve, do të siguronte mbrojtjen e interesave të sigurisë dhe të interesave të tjerë strategjikë të Republikës së Kosovës. Dhe, ky është, po ashtu, demonstrim i konsolidimit të mëtejshëm të shtetësisë së Kosovës në planin ndërkombëtar. Derisa ne shohim kah dita kur Kosova do të zë vendin e saj në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, instrumentet ligjore si ky për zbatimin e sanksioneve të vëna nga Kombet e Bashkuara, demonstrojnë qartë këtë vullnet.

Si përfundim. Përveç përmbushjes së detyrimeve të brendshme, pra kushtetuese dhe të atyre ndërkombëtare që ne i kemi marrë me Deklaratën e Pavarësisë, miratimi i këtij projektligji demonstroi bërjen realitet të zotimeve dhe përkushtimit të palëkundur të Republikës së Kosovës që të marrë pjesë në veprimtaritë ndërkombëtare si një anëtar aktiv i përgjegjshëm dhe serioz i bashkësisë ndërkombëtare, i bashkësisë së kombeve të lira të botës. Ju faleminderit shumë dhe ju kërkoj që ta miratoni këtë projektligj në parim.

KRYESUESI NAIM MALOKU: Faleminderit, zoti ministër!

Të nderuar deputetë, më lejoni të hap debatin për diskutim në parim të këtij projektligji. Radhitja e diskutuesve, në emër të Komisionit funksional për Punë të Jashtme, fjalën e ka deputeti dhe anëtar i Komisionit, Ibrahim Gashi.

IBRAHIM GASHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar zëvendëskryeministër, ministra,

Kolegë deputetë,

Komisioni Parlamentar për Punë të Jashtme e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe konsideron se me këtë projektligj pasi ky të bëhet ligj po kompletohet ajo pjesa e legjislacionit të shtetit të Kosovës që buron nga e drejta ndërkombëtare dhe obligimet e shteteve karshi saj. Rrjedhimisht ne si komision e kemi shqyrtuar dhe në parim e kemi mbështetur aprovimin e këtij ligji. Konsiderojmë se bëhet fjalë për një projektligj të përgatitur mirë dhe që në fazën e amendamentimit nuk do të ketë shumë amendamente. Ndoshta, do të doja shumë shkurt që t'i them disa fjalë lidhur me nenin 2 i cili, paragrafi 1, e njëjta përmbajtje, por në mënyrë më të qartë thuhet në paragrafin e dytë, pra 2.2. dhe mund të bisedojmë për heqjen e paragrafit 2.1, pastaj te neni 3 ka një kolizion se kush është kompetent për zbatimin e sanksioneve, specifikimin dhe ndryshimin e tyre, pra këtu thuhet se është Qeveria e Kosovës dhe menjëherë neni vijues 4 thotë se Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për përjashtimin e

sanksioneve të caktuara që edhe këtë duhet menduar për ta rregulluar. Ka disa paqartësi në përkthimin e titullit të neni 5 në versionet shqip, anglisht dhe serbisht, pastaj te neni 9, po ashtu edhe këto janë të gjitha ato vërejtje që Komisioni në leximin e parë, domethënë, i ka vërejtur dhe do t'i amendamentojë nëse ka nevojë dhe ka konsensus dhe t'i përgatisë për leximin e dytë. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Kryetarët e komisioneve tjera, nuk shoh që janë lajmëruar. Kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, ftoj deputetin Ramë Buja të marrë fjalën.

RAMË BUJA: I nderuar zoti kryesues,
Të nderuar kolegë deputetë,
Zotëri ministra, zëvendëskryeministër,
Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka parë me kujdes këtë projektligj dhe natyrisht që ka ndjenjën se duhet të përkrahet për arsyen që dimë që ne kemi marrë obligime, siç tha edhe ministri në bazë të kryeligjit tonë, Kushtetutës dhe kjo po përplotëson anën legale të gjitha veprimeve tona dhe detyrimeve tona për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare, andaj si i tillë mendojmë dhe si i hartuar çfarë është, është me një strukturë solide i bërë dhe ne e mbështesim dhe natyrisht kontributin tonë do ta japim duke i përplotësuar këto mangësi që i ka eventualisht në ato fazat tjera të përpunimit të tij. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së ftoj deputetin, profesor Sabri Hamitin ta marrë fjalën.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zotëri kryesues! Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike e mbështet këtë ligj duke e konsideruar si njërin të rëndësishëm dhe të domosdoshëm të krijimit të korpusit të ligjeve për marrëdhëniet ndërkombëtare të vendit tonë dhe për obligimet ... njëkohësisht që i merr shteti ynë karshi bashkësisë ndërkombëtare. Ligji është i hartuar mirë dhe unë jam i bindur po si kolegu Gashi, sepse e kemi biseduar te Komisioni për punë të Jashtme që para këtij leximi. Pra, jam i bindur që nuk do të ketë shumë amendamente dhe mendoj që është mirë që të kalohet në procedurë, jo të shpejtuar, por me procedurë me tempo të vërtetë. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!
Zoti ministër i Punëve të Jashtme,
Deputetë të nderuar të Kuvendit të Kosovës,
Prapë fjala e fundit e para dhe Grupi Parlamentar i Aleancës së Ardhmërisë së Kosovës nuk do ta votojë këtë ligj dhe tani do të provojë t'ju tregoj se pse nuk do ta votojmë këtë ligj. Para se t'i jap sqarimet para jush, do ta lexoj nenin 6 të këtij ligji në tërësi. Neni 6, titulli i nenit, thotë: "niveli i zbatimit të vendimeve rekomanduese dhe të organizatave ndërkombëtare" dhe vazhdon. Vendimet e Asamblesë të Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, të organizatave tjera ndërkombëtare, anëtare e të cilave është Republika e Kosovës ose në të cilat Republika e Kosovës është pjesëmarrëse, të cilat rekomandojnë vënien e sanksioneve ndërkombëtare për entitete të veçanta, zbatohen nga Republika e Kosovës në mënyrën e përcaktuar në nenin 3 të këtij ligji, i cili siguron që zbatimi i këtyre sanksioneve është në përputhje me

interesat e politikës së jashtme dhe sigurinë kombëtare të Republikës së Kosovës deri në një masë të domosdoshme për të arritur qëllimet të cilave i referohet neni 1 i këtij ligji.

Realisht, edhe nëse të gjitha çështjet tjera kishin për të qenë në rregull, a po më kallëzon mua ndokush, qysh kur Kosova është anëtare e Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë dhe e disa organizatave tjera? Nëse këtu është menduar të flitet në një të shkuar të tejkrer, atëherë të paktën neni ka qenë dashur të figurojë dhe të thotë pak më ndryshe, të lë të kuptohet që organizatat në të cilat do të jetë ose diçka ngjashëm, kishim mund pak të besojmë, por me kësi farë neni të vendosen sanksione ndërkombëtare pa qenë anëtar i organizatave ndërkombëtare, me të vërtetë ... prapë po flasim për sistemin e qeverisjes, prapë po flasim për konceptet qeverisëse në Kosovë, a mendon dikush, a ka dikush që ulet e merr e lexon dhe mendon, a ka zinxhir të njerëzve të cilët e lexojnë disa herë dhe në fund përfundon edhe pa gabime gjuhësore. Shihni, nuk mund të ndodhë që draftuesi i dokumentit ta nxjerrë një dokument pa gabime, është e pamundshme. Në çdo institucion ka sistem të lexuarit, e lexojnë disa njerëz me radhë dhe secili prej tyre i përmirëson gabimet dhe, në fund të fundit, del një dokument i cili eventualisht nuk e ka asnjë gabim ose shumë, shumë pa gabime. A e ka lexuar ministri këtë ligj dhe a i ka rënë në sy se neni 6 thotë se Kosova është anëtare e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, për shembull. Tash ne mund ta votojmë ligjin sot edhe të themi, kur të bëhemi ne anëtarë, ligji është i gatshëm. Mirëpo, a po ju duket pak që është qesharake kjo punë, ne të votojmë ligj i cili përmban një provizion kështu.

Do me thënë, jemi kah flasim për strukturën qeverisje, për qeverisje në vend.

(Ndërhyrje)

(merre fjalën mandej, merre fjalën mandej, mos fol prej vendit, me gisht a me të dytë ta bëj, merre fjalën mandej). Është sistemi qeverisës në vend, nuk ka të menduar këtu. Dikujt i ka shkuar ndërmend, i ka shkuar ndërmend dikujt, hajde bre ta biem një ligj në Kuvend, se s'kemi ligje hiq prej kësaj ministrie dhe i ka rënë në mend të bëjë ligj për vendosjen e sanksioneve ndërkombëtare nga ana e Kosovës. Unë po ju them, kjo është t'ia qitësh kulmin hala pa ia qitur themelin, mund t'ju them që është një farë çështjeje goxha qesharake, kështu. Vazhdoni votoni, veç po ju them edhe një herë, nëse ka diçka më qesharake se kjo, çuditna, ndoshta ka edhe ma shumë. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Për replikë është lajmëruar ministri Skender Hyseni. E keni fjalën, zoti ministër. Replika është, do të thotë, në fjalën e para folësit.

MINISTRI SKENDER HYSENI: Faleminderit, shumë, zoti kryesues!

I nderuar deputet Gjini,

Unë ju siguroj që nuk më ka kapur asnjë krizë besimi, e cila më thotë që Kosova nuk do të bëhet anëtare e OKB-së. Përkundrazi, kam besim 100% që Kosova do të bëhet anëtare e OKB-së. Unë vetëm do të rikujtoj nënshkrimet në një deklaratë pavarësisë, të cilat i kemi vënë që të gjithë këtu dhe zotimet që kemi marrë me ato nënshkrime në vendosjen e atyre nënshkrimeve nën atë deklaratë kushtetuese. Atje shumë qartë thuhet që Kosova si një shtet i përgjegjshëm, anëtar i bashkësisë së përgjegjshme ndërkombëtare, do të marrë për obligim të gjitha obligimet që para nesh si shtet shtrun bashkësia ndërkombëtare.

Sanksionet ndërkombëtare janë vetëm një pjesë e atyre obligimeve dhe duke kaluar këtë projektligj në Qeveri, duke e kaluar këtë projektligj në Parlament, Republika e Kosovës,

një shtet i cili e ka në proces konsolidimin ndërkombëtar të shtetësisë së vet, dërgon mesazhe të një shteti të përgjegjshëm, të një anëtar të përgjegjshëm të Bashkësisë së kombeve të lira. Nuk bëhet ky demonstrim dhe ky veprim sot këtu sa për të improvizuar ose sa për të dërguar mesazhe do si do se, hajde veç mu ka tekë, po e paraqes një projektligj sa për të thënë që po punohet diçka. Përkundrazi, çdo veprim në hartimin e këtij ...

KRYESUESI: E keni kaluar kohën, zoti ministër.

Po, për kundër replikë, një minutë, Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

Nëse ministri nuk e ka lexuar ligjin, po ia përsëris edhe një herë paragrafin e parë: “Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, të organizatave të tjera ndërkombëtare, anëtare e cilave është Republika e Kosovës...”, thotë në ligj, zoti ministër, dhe leni këto farë frazash patriotike, kemi për të qenë e s’kemi për të qenë. Po na shti ta votojmë një ligj, i cili thotë se ne sot jemi anëtar të Kombeve të Bashkuara dhe ne nuk jemi. Ose jemi, ose s’jemi! Me krejt respektin, leni këtë cinizëm, unë nuk e kam hequr dyshimin, unë e kam hequr dyshimin. Këqyre çfarë ligji na ke pru këtu! A jemi ne hajgarexhi këtu krejt, a jemi ne njerëz që nuk dimë as të lexojmë, as të shohim kurrgjë apo çka është puna jonë këtu, të dilni e të na flisni - jo unë kam harruar, unë s’kam harruar, unë e kam mbajtur, unë s’e kam mbajtur. Faleminderit, zoti ministër!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit parlamentar të AKR-së, deputeti Riza Smaka e ka fjalën.

RIZA SMAKA: i nderuar zotëri kryesues,

Disa vërejtje parimore. Fillimisht neni 1, teksti i nenit 1, nuk është koherent me vet titullin, sepse përfshin edhe obligimet ndërkombëtare, e ato derivojnë nga kontratat që mund të jenë bilaterale, mund të jenë multilaterale. Ato janë çështje tjera, do me thënë, atje ka rregulla tjera, kjo është, një.

Te neni 2, shikoni ju lutem, është fjala për definim të gabueshëm, thotë: Përkufizimet - Entiteti nënkupton një shtet, që është në rregull, se shteti është entitet legal, në rregull. Pjesa e tij, nuk mund të jetë pjesa e shtetit - entitet. Më pastaj, një territor, në kllapë thotë, një zonë me status të veçantë. Si mund të jetë entitet një zonë me status të veçantë apo një pjesë e shtetit dhe, një person fizik ose juridik, ama person juridik, personi juridik është entiteti legal edhe është shteti, që duhet të jetë. Të jemi koherent, nëse përdoret personi juridik, atëherë duhet personi fizik, nëse përdoret entitet, entiteti legal, entiteti natyral. Kjo është terminologji bashkëkohore, kështu ndërkombëtarisht e pranuar. Edhe për të qenë dështimi edhe më i madh, çdo organizatë tjetër ose një grup i personave fizikë, ju lutem, kjo është do me thënë një shkallë më e ulët e injorancës së atij/të asaj apo të atyre që e kanë hartuar këtë tekst. Qysh mund të jetë një grup i personave fizikë – entitet, sidomos kur i referohet relacionit ndërkombëtar.

Më pastaj, te neni 6. Gazeta zyrtare, sipas Ligjit për Gazetën zyrtare, në faqen e parë shkruan kurdoherë se aktet ligjore të publikuara në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës në shqip, në serbisht, boshnjakisht, në anglisht janë autentike, e për të qenë autentike ajo, në rregull, edhe duhet të jetë, mirëpo nuk mund të jenë përderisa tekstet përmbajtësisht janë të ndryshme. Ja po e zëmë, vetëm fjalën e parë, neni 5, në shqip thotë: “niveli i zbatimit të sanksioneve”, niveli, një. Në anglisht “scope”, do me thanë fushë,

rreth veprimi, ndërsa në serbisht “cilj”. Do me thënë, tri terma substancialisht diferente. Ky është gabim i madh, ju lutem, këtu nuk do mend shumë. Le të përpiqen, le të bëjnë punë më serioze ata që e kanë hartuar këtë draft, nëse e kanë hartuar. Nëse e kanë kopjuar, le ta kopjojnë mirë, se nuk është mjeshtri e lartë që kërkohet.

Te neni 13, ju lutem, qe çka thotë, po e zëmë, që nuk mund të jetë kesi soji dhe nuk mund të përmbajë një tekst ligjor. Është fjala për ligjin, akti më i rëndësishëm i një shteti. Personat fizikë dhe juridikë, a gjithnjë e përdor atje entitet, entitet, këtu persona, mbajnë përgjegjësi për shkeljet e këtij ligji, në përputhshmëri me procedurat e përcaktuara me ligjet e Republikës. Me cilat ligje janë përcaktuar këto procedura, ju lutem, qysh është, edhe përfundon. me këtë, do me thënë, kurrëgjë kërkujt, asgjë kërkujt, sepse nuk janë përcaktuar as sanksionet, as procedurat, a këto duhet të përcaktohen me këtë ligj.

Krejt ky tekst duhet të rishikohet në konformitet me Konventën e Vjenës, të vitit 1969, për të drejtën e traktateve ndërkombëtare, pikërisht me nenin 29 të saj. Këtë po e kursej, po e lë, do me thënë, e dhashë identifikimin dhe, përfundimisht, ky dokument është në parim, apo jo, është në funksion të integriteteve ndërkombëtare të Kosovës, të shtetit tonë, që është entitet legal, është në funksion të komplementaritetit, të rendit juridik të Republikës së Kosovës në të drejtën ndërkombëtare dhe është në funksion të kontributimit të Republikës së Kosovës në aplikimin, në implementimin e zbatimit efikas dhe eficient të së drejtës ndërkombëtare që u referohet sanksioneve. Ato mund të jenë politike, mund të jenë sociale, mund të jenë ekonomike, mund të jenë publike, por jo edhe të burimeve që shkruan në dispozitën e nenit 1 të këtij dokumenti. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, ftoj deputetin Lulzim Zeneli ta marrë fjalën.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zoti ministër i Punëve të Jashtme,

Që ta kemi këtë ligj, është e nevojshme për vetë faktin se Kosova ka pranuar obligimet me përgjegjësi ndërkombëtare me rastin e kurorëzimit të shtetit të Kosovës. Ajo çka mund të thuhet sa i përket këtij dokumenti që e kemi përpara, kemi të bëjmë me një dokument i cili ka diku 10 nene përmbajtësore dhe brenda këtyre 10 neneve ka shumë çka të intervenohet nga ana e komisionit parlamentar.

Nuk do t'i precizoj ato çka i thanë parafolësit, mirëpo dola këtu vetëm për një çështje që është krijuar një praktikë jo e mirë kur procedohen ligjet në Kuvendin e Kosovës. Po e lexoj vetëm nenin 9, Pasojat ligjore për mospërmbushjen e obligimeve, ndërsa në pikën 1 dhe 2 i liron të gjitha, do të thotë, nuk ka kurrfarë pasojash sa i përket mospërmbushjes së obligimeve, të sanksioneve ndërkombëtare. Prandaj, nëse Qeveria e Kosovës është autoriteti i cili zbaton sanksionet ndërkombëtare përmes mekanizmave të vet, atëherë do të duhej që së paku të theksohet në këtë rast.

Ndërsa, ajo çka figuron në nenin 9, është një diskrepancë e madhe në mes titullit dhe përmbajtjes. Do të duhej që përfundimisht grupet punuese të cilat janë thirrur të hartojnë ligje të tilla, të kenë konsideratë se çka po shkruajnë dhe çka procedojnë në Kuvendin e Kosovës.

Si Grup Parlamentar, ne e mbështesim qëllimin e mirë politik që Kosova sa më parë ta ketë një ligj të tillë, në mënyrë që të demonstrojë fuqishëm ato ambicet e veta të cilat i ka proklamuar më herët. Mirëpo, në anën tjetër kemi një dokument që me të vërtetë është

një vërejtje që do të duhej të adresohet në Qeverinë e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, ftoj deputetin Sadik Idriz ta marrë fjalën.

SADIK IDRIZ: Hvala predsedavajući!

Parlamentarna grupa “7+” u načelu podržava ovaj nacrt zakona zato što Kosovo zaista ima obaveze prema međunarodnoj zajednici, ali ima kao entitet, kao država koja želi da poštuje pravila međunarodne zajednice, moguće da postoje neki nedostaci u ovom zakonu, ali verovatno će funkcionalna komisija i druge komisije da rade na tome i mislim da ćemo ga mi podržati i da ćemo dati svoj doprinos u daljem toku rada. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Nga grupi Parlamentar SLS, nuk shoh të lajmëruar për fjalë.

Kalojmë në marrjen e fjalës së deputetëve, sipas radhës. Gani Kocin e kam të lajmëruar këtu. Jo, deputetja Gjylnaze Syla e ka fjalën, të përgatitet deputeti Bahri Hyseni.

GJYLANZE SYLA: Faleminderit, zoti kryesues!

Zoti ministër,

Më lejoni të shpreh edhe shqetësimin, por njëkohësisht edhe kuriozitetin tim, të na shpjegoni se në cilin koncept është mbështetur Qeveria ose Ministria e Punëve të Jashtme dhe në cilat politika gjatë hartimit të këtij projektligji. A është konsideruar si prioritare, sidomos duke marrë parasysh se ne të gjithë, natyrisht, jemi për integrimin e Kosovës në botë dhe marrjen e përgjegjësive, sidomos për politikën në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare, por kështu si është projektligji, nuk mund të rregullojë çështjen e sanksioneve ndërkombëtare, e para, sepse një ligj kështu si është, nuk është preciz, nuk është i saktë dhe nuk është i lehtë, thjeshtë, për ta kuptuar atë. Në praktikë nuk mund të zbatohet se Kosova nuk mund t’i marrë obligimet e veta pa qenë anëtare e organizmave të caktuara, me këtë do të thotë në praktikë nuk mund t’i zbatojë as sanksionet. Thjeshtë, sipas mendimit tim, ky projektligj nuk i përmbush kriteret e ligjit që të mund të votohet në shqyrtimin e parë.

Zoti ministër,

Edhe një herë ju kisha ftuar të na shpjegoni se sipas cilit prioritet e keni marrë vendimin, ose brenda Qeverisë, që ky projektligj të sillet dhe cili është koncepti i Qeverisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Për replikë, ministri Hyseni. E keni fjalën, zoti ministër. Jo, është replikë, zoti ministër, se nuk ka shpjegim këtu në këtë Rregulloren e Punës së Kuvendit.

MINISTRI SKENDER HYSENI: Kërkoj sqarim, prandaj unë po e quaj sqarim, jo replikë, zoti kryesues.

Sipas cilit prioritet? Deklarimi përkatësisht demonstrimi i qartë i përkushtimit të Kosovës për të marrë përgjegjësitë ndërkombëtare, është nevojë kruciale, është nevojë urgjente që bota të bindet që Kosova është një shtet që do të marrë përgjegjësitë e çfarëdo lloj anëtarësimi që kërkon në strukturat ndërkombëtare. Deri sa ne përgatitemi të bëjmë kërkesë, të bëjmë aplikacion zyrtar për anëtarësim në shumë struktura ndërkombëtare, në shumë organizata ndërkombëtare - deri te organizata e Kombeve të Bashkuara, me hartimin dhe aprovimin e legjislacionit përkatës duam të dërgojmë mesazhe të qarta që Kosova është shtet i përgjegjshëm, shtet që kërkon anëtarësim dhe do të marrë

përgjegjësitë e të gjitha anëtarësimeve. Ky është i vetmi motiv që Ministrinë e Jashtme e ka shty t'i propozojë Qeverisë ta aprovojë këtë projektligj dhe ka arritur këtu. Unë prapë kërkoj nga ju që ta votoni, sepse duke e votuar, do të dërgojmë mesazhe të qarta, duke mos e votuar, po ashtu do të dërgojmë mesazhe të qarta.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Deputeti Bahri Hyseni e ka fjalën, le të përgatitet deputeti Arsim Rexhepi.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje zëvendëskryeministër, ministra, të nderuar kolegë deputetë, Nuk e kisha ndërmend ta marr fjalën, mirëpo nga një herë mendoj që edhe ne deputetët duhet të jemi, po them, pak më real dhe nëse një projektligj vjen i hartuar mirë, nuk është mirë së paku t'i shtrembërojmë ato që nuk kemi nevojë. Konsideroj se projektligji është i hartuar mirë dhe duhet të bëhemi real se çdo kush mund ta interpretojë si të dojë. Nëse dikush po kërkon përmbajtjen dhe ministri nuk po e thotë, atëherë unë po deklaroj. Na obligon Kushtetuta e Republikës së Kosovës t'i zbatojmë të gjitha vendimet e organizatave ndërkombëtare, nëse se keni ditur, çështja e parë. Siç na obligon t'i kemi të gjitha ligjet konform standardeve evropiane dhe të gjitha vendimet që dalin duhet t'i zbatojmë pavarësisht a jemi anëtar apo nuk jemi anëtar.

Por është edhe një çështje tjetër. Po ndalem te neni 6. Ne mund ta lexojmë si të doni, mirëpo ekspertët kur e kanë krijuar, e kanë thënë shumë qartë: "Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë dhe organizatat e tjera ndërkombëtare, anëtare e të cilave është Republika e Kosovës". Nëse ma japin mua për ta interpretuar si jurist, atëherë kjo nënkupton që, nuk po themi që është anëtare e Organizatës së Kombeve të Bashkuara as e Bashkimit Evropian, por anëtare e organizatave atje ku jemi anëtar, në Fondin Monetar e në organizata tjera. Prandaj, ju kisha lutur, njerëzit të cilët japin mund për t'i punuar këto ligje, mos t'ua qesim mundin, se mendoj edhe komisioni funksional ka pasur të drejtë dhe duhet ta përkrahim, në parim, sepse projektligji, natyrisht që çdo projektligj duhet të ketë ndonjë amendament, por mos t'i kundërshtojmë atje ku s'kemi të drejtë. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Deputeti Arsim Rexhepi e ka fjalën, le të përgatitet deputeti ...

ARSIM REXHEPI: Faleminderit, zoti kryesues!

Desha fillimisht shkurt ta përkujtoj kolegun tim shumë të nderuar, zotin Gjini, që në teorinë e shtetit dimensiononi i katërt që arsyeton shtetësinë, është përfaqësimi ndërkombëtar, përveç judikativit, ekzekutivit dhe legjislativit. Si i tillë, ai nuk lejon ekskluzivitete, do të thotë, nuk mund të zgjedhë kë të dua dhe atë tjetrin nuk e dua ose e përjashtoj. Dhe, në kuadër të kësaj, ky ligj vetëm iu përgjigjet implikimeve dhe kërkesave të këtij dimensiononi të katërt, që definon shtetin. Andaj, është i pashmangshëm dhe ky Kuvend nuk ka rrugë tjetër pos që ta votojë sa më shpejt dhe t'iu hapë rrugë procedurave deri në përmirësimin e lëshimeve eventuale të cilat mund t'i ketë. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Për replikë Ardian Gjini, 2 minuta.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë, sinqerisht, jam shumë i interesuar për t'i kuptuar këto farë dimensionet e kolegut të nderuar që i përmend. Mund t'i them që kur duam ne t'ia komplikojmë jetën vetës, ia komplikojmë sa të duam dhe unë për respektin që kam për kolegët, nuk po e marr edhe një herë për ta lexuar me presje e me pika nenin 6. Mendoj se kush do që tenton tash ta shpjegojë që diçka është në rregull aty, po një pjesë e deputetëve nuk po e kuptojnë, e realisht nuk po tregojnë respekt për deputetë. Ne dimë të lexojmë, e kemi lexuar të gjithë dhe nëse synimi është për t'i tregua dikujt atje në publik që sheh përmes televizorit edhe nuk e ka lexuar ligjin, se dikush prej nesh është gabim, nuk është i mirë, në fund të fundit, nuk është i mirë për shtetin, nuk është i mirë për demokracinë. Lëri dimensionet Arsim, hiqu dimensioneve, e ke të shkuar që Kosova është anëtare e OKB-së, për çfarë dimensionet të shtetformimit je kah flet. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Deputeti Ramadan Avdiu, e ka fjalën, le të përgatitet deputeti Sabri Hamiti.

RAMADAN AVDIU: Faleminderit, zoti kryesues,
I nderuar zëvendëskryeministër,
Të nderuar ministra, kolegë të respektuar deputetë,
Që në fillim dua të theksoj për të hequr dilemat apo konfuzionin e shkaktuar nga një diskutues paraprak, të cilit nuk po ia përmend emrin që t'i jap rëndësinë replikës, por nuk kemi të bëjmë këtu për Ligjin për vendosjen e sanksioneve ndërkombëtare, po për Ligjin për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare, të cilat vendosen nga Organizata Ndërkombëtare. Në momentin kur Republika e Kosovës është shpallur shtet i pavarur dhe sovran, ne kemi marrë dhe jemi zotuar për të respektuar edhe obligimet ndërkombëtare. Prandaj, duke pasur parasysh intencën e Republikës sonë që sa më shpejt të jemi pjesë e marinizmave ndërkombëtarë, ne domosdoshmërisht do të duhet t'i respektojmë edhe vendimet, ndonëse nuk jemi anëtarë të OKB-së ose të ndonjë mekanizmi tjetër, por do të duhej t'i respektojmë vendimet në rast se do të merren për zbatimin e sanksioneve qoftë politike, qoftë ekonomike, qoftë publike ndaj ndonjë shteti tjetër.

Prandaj, konsideroj se ky ligj është i domosdoshëm dhe është i hartuar mirë. Me këtë rast do të dëshiroja vetëm të tërheq vëmendjen e komisionit funksional që të ketë parasysh gjatë shqyrtimit të mëtutjeshëm në procedurën e mëtejme paragrafin 1 të nenit 1, kur kemi të bëjmë me përkushtimin e Kosovës në luftë kundër terrorizmit ndërkombëtar, aty vazhdon terrorizmi ndërkombëtar nga ana e komunitetit ndërkombëtar. Është e tepërt kjo fjali, ose do të duhet të riformulohet dhe të sqarohet, sepse është sidomos pjesa e 2-të e paragrafit 1, është pak konfuzion sikurse edhe paragrafi i fundit i nenit 2, kur kemi të bëjmë me përkufizimet, me përkufizimin e importit, sepse aty definohet territori i Kosovës si zonë brenda kufirit doganor të Kosovës. Prandaj, është mirë që territori i Kosovës të definohet si brenda kufirit të Kosovës për mallrat, shërbimet ose informatat të cilat qarkullojnë jashtë territorit ose brenda territorit. Prandaj, tek definimi i nocionit – import do të duhet të kihet parasysh, sepse në një vend lihet të kuptohet sikur për eksportin e jo për importin. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet!
Fjalën e ka deputeti Sabri Hamiti, le të përgatitet deputeti Gani Buçinca.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryesues!
Meqë po flasim për letra e letrat janë të shumëzuara për kaq vetë sa jemi në Kuvend, më lejoni, kolegë të nderuar, ta lexoj nenin 6 të plotë, që e ka titullin - Niveli i zbatimit të vendimeve rekomanduese të organizatave ndërkombëtare. Pra, tash nis neni: "Vendimet e

Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, të organizatave të tjera ndërkombëtare, anëtare e të cilave është Republika e Kosovës ose në të cilat Republika e Kosovës është pjesëmarrëse, të cilat rekomandojnë vënien e sanksioneve ndërkombëtare për entitetet e veçanta, zbatohen nga Republika e Kosovës në mënyrën e përcaktuar me nenin 3 të këtij ligji, i cili siguron që zbatimi i këtyre sanksioneve është në përputhje me interesat e politikës së jashtme dhe të sigurisë kombëtare të Republikës së Kosovës deri në një masë të domosdoshme për të arritur qëllimet të cilave iu referohet neni 1 i këtij ligji”. Unë u përpoqa edhe me pauza ta lexoj, në mënyrë që të jetë e qartë. Ky nen nuk thotë që është Kosova as anëtar i OKB-së, as i OSBE-së, as i kurrçillës organizatë, por thotë që do t’i zbatojë sanksionet nga të gjitha këto organizata dhe në organizata të tjera në të cilat është anëtarë ose në të cilat merr pjesë dhe s’është anëtarë. Merr njeriu pjesë edhe në organizatë që s’është anëtar dhe ne po marrim dhe do të marrim. Faleminderit, unë nuk kam tjetër.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Deputeti Gani Buçinca, e ka fjalën, le të përgatitet deputeti Berim Ramosaj.

GANI BUÇINCA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë e mora fjalën vetëm për të shprehur opinionin tim në lidhje me ligjin të cilën po e trajtojmë tani.

Zoti ministër, keni bë mirë që e keni proceduar në Kuvend një ligj të tillë për faktin se Kosova, pavarësisht a është anëtare e ndonjë organizmi ndërkombëtarë a nuk është, duhet t’i marrë të gjitha obligimet sikur të ishte anëtar i plotë i të gjitha organizmave ndërkombëtarë. Kjo padyshim duhet të jetë si një premisë, nga e cila duhet edhe ta shqyrtojmë ligjin të cilën e kemi përpara.

Kur trajtohen ligje të tilla edhe kur manifestohet një vullnet politik për t’i çua një mesazh faktorit ndërkombëtar që legjislativi i Kosovës ka për qëllim dhe e bën të detyrueshëm të drejtën ndërkombëtare në territorin e Kosovës, besoj se do të duhej të ishim të gjithë të lumtur që na u ka dhënë rasti që të aprovojmë ligje të tilla. Ligjin të cilin ju e keni paraqitur në këtë seancë plenare për miratim, përkatësisht ligji është në frymën e të drejtës humanitare pozitive ndërkombëtare dhe, pa dyshim, e ngrit prestigjin dhe nivelin e shtetit të Kosovës në arenën ndërkombëtare.

Unë i lus deputetët të cilët diskutuan, që ta aprovojmë ligjin, kurse kisha apeluar që gjatë procedimit të mëtutjeshëm të konsultohen edhe ekspertët të drejtës ndërkombëtare, që ndoshta të saktësohen disa nene të këtij ligji edhe të bëhet sa më shumë i zbatueshëm.

Unë do ta mbështes me kënaqësi ligjin e ofruar për miratim.

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet. Fjalën e ka deputeti Berim Ramosaj dhe, i fundit për këtë pikë të rendit të ditës le të përgatitet Shkumbin Demaliaj.

BERIM RAMOSAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë vërtetë atë që desha ta them në aspektin e interpretimit, jo të ndonjë eksperti ligjor, se s’ka nevojë të jesh ekspertë ta interpretosh ligjin në fjalë. Por, mua më duket se zoti Gjini është ngatërruar në aspektin gjuhësor dhe e them këtë me plotë kompetencë. Vetë fakti i shtjellimit në këtë mënyrë të kësaj fjalie të zgjeruar, nuk prejudikon anëtarësimin

tonë në këto organizata. Mirëpo, në qoftë se në parim të gjithë po e pranojmë se ky ligj është i nevojshëm duke marrë parasysh pozitën e Kosovës në marrjen e obligimeve, qoftë ndaj shteteve si entitete në mënyrë individuale, qoftë asociacioneve ndërkombëtare, atëherë duke marrë parasysh, prapë po e them, pozicionin e Kosovës në këtë periudhë dhe marrjen e përgjegjësive, qoftë politike, qoftë të përgjegjësive tjera, unë them se është më se i nevojshëm ligji dhe të pranohet, në parim. Mirëpo, në qoftë se kanë dilema, qoftë linguistike, qoftë të tjera dilema, të japim kontributin se kemi shans, se është fjala për projektligjin në leximin e parë, kështu që i kisha lutur të gjithë ata deputetë të nderuar kolegë, të japin kontributin e tyre qoftë në komisione funksionale, apo në forma tjera ekspertësh dhe të ecim më tutje. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Deputeti Shkumbin Demaliaj e ka fjalën.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Kabinet qeveritarë, me gjithë një vërejtje që kam për kabinetin, është mirë para se të hyjnë në Kuvend, t'i pastrojnë këpucët se shumë keq po duken në televizor ajo pjesa ku ata lëvizin prapa foltores, nuk po kallëzojnë kulturë se jemi përgatitur për të ngritur infrastrukturë, bile as te institucionet, në këtë rast edhe te institucioni më i lartë në shtet. Është temë po, po duket keq edhe në televizor.

Kështu që lidhur me projektligjin në fjalë unë kisha menduar që ky projektligj të kthehet mbropa dhe atëherë kur të fillojmë ne t'i marrim obligimet, sepse jemi i vetmi popull në rajon edhe në botë që mendojmë ta sanksionojmë veten me ligj ende pa i marrë obligimet ndërkombëtare për të cilat po veprojmë. U ngopëm duke kërkuar ta sanksionojmë veten në këtë rast. E gjithë kjo çka u fol deri më tash shihet mirë, sepse edhe neni 1, po edhe memorandumit shpjegues bien kundërshtim lidhur me qëllimin e projektligjit. Kështu që në qëllimin këtu do të thotë: "Krijimi i kushteve për Republikën e Kosovës që të kontribuojë në mënyrë efikase në ruajtjen e paqes dhe të sigurisë ndërkombëtare, si dhe të luftojë terrorizmin ndërkombëtarë nga ana e komunitetit ndërkombëtar". Ndërkaq, te memorandumit shpjegues, fusha e veprimit të projektligjit: "Ky projektligj zbatohet nga Republika e Kosovës tek obligimet ndërkombëtare me rastin e implementimit të sanksioneve ndërkombëtare jo ushtarake të imponuara nga organizata e Kombeve të Bashkuara dhe organizata tjera". Ky bie në kontest ndërmjet vetes, atëherë ne nuk kemi nevojë ta luftojmë terrorizmin, sepse vetë me këtë qëllim shpjegues e kemi ndaluar pjesën, sepse i kemi thënë jo ushtarake, edhe s'mundet jo ushtarakisht të luftohet terrorizmi me ndonjë memorandum bashkëpunimi ndërmjet shteteve të rajonit apo më gjerë.

Kemi pjesën tjetër te neni 11, pika 1.5, për mbikëqyrjen e zbatimit të sanksioneve publike, institucione përgjegjëse janë Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në koordinimin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave. Përfshihet komplet Ministria e Drejtësisë, s'di kush duhet që këtyre institucioneve t'ua interpretojë, bile edhe nomenklaturën e ligjeve bartëse në proces, por edhe pjesën tjetër, interpretimin e sanksioneve penale apo të drejtën penale ndërkombëtare. Kështu që unë mendoj që duhet të kthehet dhe ne kur marrim obligime atëherë të pranojmë sanksione. Ne po kërkojmë paraprakisht të sanksionohemi, e dikur t'i marrim obligimet tjera, se janë më se të nevojshme. Faleminderit, zoti kryesues!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Dhe, në fund, përfaqësuesi i Qeverisë, ministri e ka fjalën. A e ke kërkuar fjalën? Jo, faleminderit!

Atëherë, të nderuar deputetë, në sallë janë prezentë 62 deputetë, kërkoj deklarinimin me votim për miratimin në parim të projektligjit.

Regjia, deputetët, bëhemi gati për votim, votojmë tash:

Konstatohet se me 45 vota “për”, 8 “kundër” dhe 4 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare.

Në bazë të Rregullores së Punës, Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Punë të Jashtme,
- Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
- Komisionin për Buxhet dhe Financa,
- Komisionin për Komunitete, dhe
- Komisionin për Integritet Evropian, që brenda dy muajve nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t’i paraqesin raportet me rekomandime. Ju faleminderit!

Kalojmë në pikën e shtatë të rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Inspektoratin e tregut dhe mbikëqyrjen inspektuese**

Konstatime hyrëse:

Në bazë të Rregullës 35.1 të Rregullores së Punës, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji. Ftoj ministrin e Tregtisë dhe të Industrisë, zotin Lutfi Zharku, që para deputetëve të Kuvendit të prezantojë projektligjin. E keni fjalën, ministër!

MINISTRI LUTFI ZHARKU: I nderuar kryesues!

Zëvendëskryeministër,

Të nderuar kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

Misioni i Inspektoratit të Tregut është mbikëqyrja dhe rregullimi i tregut në tërë territorin e Republikës së Kosovës, me qëllim të krijimit të kushteve sa më të favorshme dhe konkurruese për lëvizjen e lirë të mallrave dhe shërbimeve për vendosjen e produkteve të sigurta në treg, në interes të mbrojtjes së jetës, shëndetit, interesave dhe të drejtave të konsumatorëve.

Përkundër të arriturave të mëdha në këtë fushë, janë vërejtur shumë vështirësi sa i përket zbatimit të Ligjit në fuqi e të cilat janë të domosdoshme të ndryshohen me qëllim të avancimit të mëtejshëm të mbikëqyrjes inspektuese të tregut dhe harmonizimit me legjislacionin e BE-së. Kryerja e afër 4000 inspektimeve gjatë vitit të kaluar, ka qenë bazë e fortë për evidentimin e shumë mangësive të cilat jemi përpjekur t’i korrigjojmë me hartimin e ligjit të ri në këtë fushë.

Më lejoni që në vazhdim të paraqes në pika të shkurta disa nga dispozitat e Ligjit aktual të cilat nuk kanë gjetur zbatueshmëri të plotë, kurse disa janë në kundërshtim me njëra tjetrën duke shkaktuar dilema në implementimin e tyre, si dhe disa nga propozimet tona për eliminimin e këtyre paqartësive. Inspektimi i tregut ka hasur në vështirësi sa i përket

funksionimit sipas Ligjit aktual për shkak të mënyrës të organizimit dhe funksionimit të tij.

Me dispozitat e nenit 3 të ligjit aktual, është e përcaktuar se Inspeksioni i tregut i kryen punët në dy shkallë atë komunal dhe qendror e që nënkupton hierarki të organizimit dhe subordinimit, por me nenin 7 ky organizim vihet në dilemë pasi që inspektorët komunalë emërohen nga kuvendet komunale dhe natyrisht i raportojnë dhe i subordinojnë pushteteve komunale e jo Inspektoratit Qendror, siç do të duhej të ishte. Në realitet neni 7.4 kurrë nuk është zbatuar, sepse inspektorët komunalë nuk janë emëruar nga kuvendet komunale, por janë punësuar si shërbyes civilë të zakonshëm. Vetvetiu ky dualizëm ka shkaktuar vështirësi në ndarjen e detyrave dhe kompetencave të Inspektoratit të tregut. Me dispozitat e nenit 5 të Ligjit aktual, po ashtu është paraparë që për kryerjen e punëve të caktuara, ministri mund të caktojë inspektorë të një administrate tjetër komunale në një komunë tjetër, por që për shkak të dualizmit të lartpërmendur gjatë emërimit, gjegjësisht të punësimit të inspektorëve të tregut nga pushtetet komunale, nuk ka mundur asnjëherë të zbatohet në praktikë.

Neni 4 b i Ligjit aktual, në mënyrë të përgjithësuar ka përcaktuar se Inspektorati Qendror mund t'i kryejë punët që nuk mund të realizojë nga inspektorët përkatës komunal, e që në praktikë nuk ka mund të përcaktohet se cilat janë ato punë specifike. Të gjitha këto të meta në Ligjin aktual, në praktikë kanë rezultuar me dy inspektorate gati pak të pavarura duke zbatuar plane të ndryshme veprimi, strategji të ndryshme të mbikëqyrjes dhe shpesh dyfishim të aktiviteteve, gjegjësisht inspektimeve.

Duke pasur parasysh të gjitha këto të meta në Projektligjin që po paraqesim për shqyrtim para jush, kemi propozuar integrimin e plotë inspektorateve komunale të tregut dhe atij Qendror nën një ombrellë të vetme dhe funksionim në mënyrë vertikale si alternativë e vetme për mbikëqyrje efikase dhe unike në tërë territorin e Kosovës. Mos definimi i qartë i punëve të inspektoratit të Tregut në Ligjin aktual, ka bërë që në disa raste të kemi edhe ndërhyrje me kompetencat e Inspektoratit të Tregut nga institucioneve të tjera, si ndërhyrja e doganave në tregun e brendshëm lidhur me origjinën e mallit, ndërhyrja e Inspektoratit sanitar lidhur me cilësinë, etiketën dhe deklaracionin e produkteve.

Dispozitat e nenit 22 të ligjit aktual lidhur me përcaktimin e lartësisë së pasurisë së fituar në kundërshtim me ligjin e cila duhet të merret, nuk ka qenë e mundur të zbatohet nga inspeksioni i tregut, duke marr parasysh se kjo është kompetencë e institucioneve tjera, gjegjësisht gjykatave, kurse çështja e konfiskimit të dobisë pasurore të fituar me anë të kryerjes së veprës penale, është rregulluar me Kodin Penal të Kosovës. Po ashtu, mos definimi i qartë i dispozitave të nenit 23, ka bërë që i njëjti të zbatohet pjesërisht, sepse Inspektorati i tregut ka marrë mostra vetëm të produkteve në qarkullim e jo edhe atyre në prodhim.

Të nderuar deputetë,

Miratimi i Projektligjit për Inspektoratin e tregut dhe mbikëqyrjen inspektues, do të ndikojë në rritjen e efikasitetit, rritjen e transparencës së punës së Inspektoratit të Tregut, duke garantuar produkte të sigurta dhe të besueshme në tërë tregun e vendit, trajtim të barabartë të prodhuesve dhe importuesve sa i përket vendosjes së produkteve të tyre në treg dhe lëvizjes së lirë të mallrave dhe shërbimeve, si dhe forcimin e besimit të konsumatorëve dhe operatorëve të tjerëve në treg për sigurinë e produkteve.

Rëndësia e Projektligjit për Inspektoratin e tregut është e pakontestueshme në ekonominë e tregut, duke marrë parasysh se Inspektorati i tregut është një nga shtyllat themelore të mbikëqyrjes së tregut, cilësisë dhe sigurisë së produkteve si dhe mbrojtjes së konsumatorit. Duke pasur parasysh rëndësinë e rregullimit juridik të inspeksionit në Kosovë dhe nevojën evidente për krijimin e një baze të mirëfilltë ligjore për mbikëqyrjen e tregut, rekomandoj që pas shqyrtimit ta miratoni këtë projektligj. Me këtë projektligj, Kosova do ta avancojë kuadrin e saj ligjor në përgjithësi, kurse fusha e mbikëqyrjes inspektuese në Kosovë do të fitojë një kornizë adekuate juridike për veprim dhe zbatim në veçanti. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti ministër!
Më lejoni ta hapi debatin për diskutim në parim. Nga Komisioni funksional, nuk ka. Kryetarët e komisioneve tjera nuk shoh të lajmëruar. Përfaqësuesit e grupeve parlamentare, ftoj deputeten Nerxhivane Dautin, që në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, ta marrë fjalën.

NERXHIVANE DAUTI: Ju faleminderit, zoti kryesues!
Të nderuar deputetë,
Në vazhden e përpjekjeve për të kompletuar bazën ligjore për rregullimin e çështjeve financiare dhe ekonomike, është edhe Ligji për Inspektoratin e tregut dhe mbikëqyrjen inspektoriale. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e mirëpret dhe e përshëndet sjelljen në Kuvend të këtij ligji me rëndësi të veçantë. Me këtë ligj përcaktohen parimet organizimi, kompetencat dhe procedurat e mbikëqyrjes inspektuese të tregut në territorin e Republikës së Kosovës.

Mbikëqyrja e tregut paraqet aktivitet të kryer dhe masat e mara nga autoriteti publik për të siguruar që produktet janë në përputhje me kërkesat ligjore të përcaktuara në legjislacionin përkatës dhe nuk rrezikojnë shëndetin, sigurinë ose çështje të tjera që lidhen me mbrojtjen e interesit publik. Me nenin 30 të këtij ligji, buron obligimi ligjor i Inspektoratit që të bashkëpunojë me organet e administratës shtetërore, organet komunale, Doganën, Policinë, Gjyqësorin, Prokurorinë, inspektorët e fushave e përkatëse dhe shoqatat e qytetarëve të cilët kujdesen për mbrojtjen dhe avancimin e interesave të konsumatorëve. Rëndësia e veçantë. Rëndësia e veçantë i këtij ligji manifestohet në faktin se me hyrjen në fuqi të këtij ligji, të gjitha përgjegjësitë të drejtat dhe detyrimet e Inspeksionit të tregut dhe inspektorëve komunalë të tregut, kalojnë në Inspektoratin e tregut për mbikëqyrje inspektuese. Të gjithë inspektorët e Inspeksionit të tregut dhe inspektorët komunal të tregut, bëhen inspektorë të Inspektoratit të tregut për mbikëqyrje inspektuese në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Projektligji i propozuar, duhet të harmonizohet me Ligjin për mbrojtjen e konsumatorëve sa i përket dispozitave ndëshkuese, konkretisht neni 32, 33, 34 dhe 35. Projektligji i propozuar, marrë në përgjithësi përmban një teknike juridike të mirë. Sa i përket gjuhës juridike, propozoj që terminologjia juridike latine në disa nene të këtij ligji të zëvendësohet me terminologji juridike në gjuhën shqipe që mundëson që ligji të jetë më i lehtë për t'u zbatuar në praktikë.

Unë e përshëndes Ministrinë për punën e bërë, për intensitetin e shtuar në drejtim të miratimit të ligjeve funksionale, të ligjeve të cilat na nevojiten për ekonominë e lirë të tregut.

Në emrin tim personal dhe Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, konsiderojmë se Ligji i propozuar duhet të miratohet në shqyrtim të parë. Ju falënderoj për vëmendje.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, ftoj deputetin Kolë Berisha ta marrë fjalën.

KOLË BERISHA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, pas shqyrtimit me kujdes të Projektligjit për Inspektoratin e tregut dhe mbikëqyrjen e Institutit konstaton.

Nën 1, duke pasur parasysh se fusha me të cilën rregullohet, vihet nën kontroll dhe sanksionohet, është i një rëndësie të veçantë për Kosovën, projektligji në fjalë, ndonëse i vonuar është i mirë se ardhur. Për dallim nga disa ligjet tjera për aftësimin e të cilëve kërkohen më shumë amendamente se sa nene që ka ligji, ky ligj ka një gjuhë të pastër dhe të pasur juridike. Lënda që shtjellohet, është mirë e sistemuar dhe krijon lehtësi në interpretimin e tij në praktikë. Andaj, Grupi Parlamentar i LDK-së, mendon se me një intervenim të lehtë në procedurën e mëtejme, do ta kemi një ligj solid, prandaj edhe e miraton në parim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, ftoj deputetin Xhevdet Neziraj ta marrë fjalën.

XHEVDET NEZIRAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra dhe kolegë të çmuar deputetë.

Ky projektligj ka për qëllim të përcaktojë kompetencat, masat që duhet të ndërmarë Ministria e Industrisë dhe e Tregtisë, konkretisht Inspektorati i Tregtisë për të siguruar produktet a janë në përputhje me kërkesa ligjore dhe produktet a e rrezikojnë shëndetin dhe sigurinë dhe aktivitetet tjera me interes publik? Është e mirë që ministri i elaboroi të metat e ligjit të kaluar, i cili ka pasur të meta të shumta dhe tentohet që me këtë ligj të eliminohen të gjitha ato pengesa, që në parim do ta mbështesim.

Vërejtjet e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës janë në këto nene: neni 32, te dispozitat ndëshkuese, konkretisht neni 35 për të njëjtin delikt, për të njëjtën shkelje, dënimi fillestar dhe dënimi përfundimtar është shumë i madh në mes njëri - tjetrit, prandaj i lehet në mëshirë inspektorit apo sipas dëshirës ta dënojë në shumë prej 3000 deri 9000, do të thotë është mirë që këtu shuma minimale dhe maksimale të jetë e nivelizuar edhe jo t'i lihet në dorë inspektorit të dënojë sipas dëshirës dhe qejfit të tij. Një problem tjetër që do të kisha cekur, është edhe implikimet buxhetore që do t'i ketë ky projektligji për arsye se Inspektorati do të dëshironte dhe duhet të ketë që të vepron, duhet të ketë automjete, duhet të ketë ndoshta edhe inspektorë shtesë. Gjithashtu, duhet të ketë edhe shpenzime tjera të cilat nuk janë paraparë me buxhetin e vitit 2010, gjithashtu nuk janë paraparë edhe me kornizën afatmesme të qarkores buxhetore të vitit 2010-2012. Mirëpo, në parim Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës përkrah dhe kontributin e vet do ta jap në komisionet funksionale dhe nëpër komisionet tjera që do të kalon ky projektligj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit parlamentar të AKR-së, ftoj deputeten Myzeje Selmani, ta marrë fjalën.

MYZEJENE SELMANI. Ju faleminderit, zoti kryesues!

Në këtë aspekt dua ta përshëndes ministrin për Projektligjin për Inspektoratin e tregut dhe mbikëqyrjen inspektuese që e sjellë në Kuvend kur më së shumti Kosovës i duhet tash ky ligj, duke marrë parasysh se në kohën e fundit u pa nga mosfunksionimi i shumë neneve të ligjit të mëparshëm erdhën edhe produktet nga vendi fqinjë që është shumë e rrezikshme për qytetarët e Kosovës dhe përgjegjësia do të mbetej prapëseprapë te kjo Ministri.

Në parim Grupi Parlamentar i AKR-së e përkrah këtë projektligj, mirëpo unë dua t'i sqaroj disa vërejtje gjatë shqyrtimi të këtij Projektligji që kam hasur në të.

Te neni 7 i këtij projektligji, paragrafi 8- procedurat dhe mënyra e verifikimit të ardhurave profesionale të inspektorëve përcaktohet me akte nënligjore të cilin e nxjerr ministri, të bëhet më e qartë përmbushja e objektivave se me akte nënligjore, ministër nuk do të di sa do të jenë e qartë kjo. Te neni 8, Inspektorati, punët dhe detyrat nga kompetencat e veta i kryen përmes drejtorit dhe inspektorëve të tregut, dhe këtu më duhet një sqarim më i qartë se ligji duhet të jetë shumë i prerë që të kuptohet prej të gjithë njerëzve.

Paragrafi 2, organizimi, funksionimi dhe detyrat e inspektorit përcaktohen me akte nënligjore të cilin e nxjerr ministri. Le të prezantohet, ministër a do të jetë departament apo si do të rregullohet kjo çështje? Do të shkoj me rend te secili nen ku i kam vërejtjet..

Te neni 17, Inspektorati në rastet e përcaktuara me këtë ligj dhe ligjet tjera nxjerr vendim për asgjësimin e produkteve. Kush e nënshkruan vendimin? Duhet të jetë e qartë kush e nënshkruan vendimin për asgjësimin e produkteve? Çështje tjetër, duhet të jetë edhe te neni 23, paragrafi 5- kryerja e analizës së parë dhe super analizës nuk mund të bëhet në të njëjtin laborator profesional të akreditimit, nuk di çfarë super analize duhet të kryhet në një laborator tjetër. Këtu duhet pas sqarime më tepër, ministër.

Te neni 26, drejtori është i detyruar që në afat prej 30 ditësh të vendos sipas ankesës së ushtruar kundër vendimit të Inspektoratit. Shumë, disa gjëra janë të paqarta në këtë ligj, dhe te neni 23 kryerja e analizës së parë, e potencon prapë, nuk di pse?

Neni 26, drejtori është i detyruar që në afat prej 30 ditësh, e tash këtë edhe një herë. Neni 28, drejtori nxjerr vendime dhe urdhëron ekzekutivin e tij në rast se konstaton se subjekti ekonomik ushtron veprimtari në kundërshtim me masën mbrojtëse mbi ndalimin e veprimtarisë së lëshuar nga ana e organit kompetent gjyqësor. Inspektorati kërkon mbështetje nga Ministria e Punëve të Brendshme gjatë inspektimit dhe ekzekutimit të vendimit në rast të nevojës. Në këto raste, Ministria e Punëve të Brendshme, është e obliguar të ofrojë mbështetje. Për çdo ligj që e nxjerr Qeveria, atëherë Qeveria është një kabinet i tërë i cili duhet të jetë në mbështetje të ligjeve të veta. Dhe, më e dhimbshmja është te neni 35 ku ceken gjrobat edhe parafolësi im e ceku pak më parë me gjobë prej 3000 deri 9000 euro ndëshkohet subjekti ekonomik i cili nuk e zbaton vendimin e Inspektoratit konform nenit 16, paragrafi 1 dhe neni 19, paragrafi 1 të këtij ligji. Këtu duhet të bëhet një përcaktim më strikt, kështu thash në parim e përkrahim këtë projektligj dhe besoj që do të rregullohet shumë shpejtë për të mirën qytetarëve, duke marr parasysh se në Kosovë hyjnë mallra pa afate dhe përbërje jo të sakta. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDD- së ftoj deputeten Synavere Rysha, ta merr fjalën!

SYNAVERE RYSHA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, me kujdes e ka shqyrtuar Projektligjin për Inspektoratin e tregut dhe mbikëqyrjen inspektuese. Me këtë projektligj, përcaktohen parimet, organizimi, kompetencat dhe procedurat e mbikëqyrjes inspektuese në territorin e Republikës së Kosovës. Edhe pse në strukturën dhe përmbajtjen e tij, ka disa mangësi, ne do ta mbështesim në parim nga fakti se përmes këtij projektligji do të krijohet mundësia për eliminimin e ekonomisë joformale, parandalon praktikën mashtruese tregtare, krijon mundësi për konkurrencën fer dhe mbron të drejtat e konsumatorit. Po ashtu, krijon një sistem më efikas të mbikëqyrjes dhe rregullimit të tregut në territorin e Republikës së Kosovës.

Grupi Parlamentar i LDD-së, projektligjin në fjalë e mbështet dhe kontributin tonë do ta japim përmes përfaqësuesit tonë në Komisionin funksional. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, ftoj deputetin Zylfi Merxha ta merr fjalën.

ZYLFI MERXHA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Ju përshëndes juve dhe stafin e juaj,

E përshëndes zëvendëskryeministrin dhe të gjithë ministrat që janë këtu.

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Unë në emrin tim dhe në emrin e Grupit Parlamentar “7+” e përkrah këtë ligj se kështu një ligj na vyen edhe tash është forcuar edhe me 40% ashtu që nuk ka mbetur kurrë mangu, për atë na jemi që të përkrahim dhe ta votojmë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Nga Grupi Parlamentar SLS, nuk kemi të lajmëruar. Shkojmë deputetët me radhë. Fjalën e ka deputeti Adem Hajdaraj, përgatitet deputeti Lutfi Haziri

ADEM HAJDARAJ: Zotëri, kryesues,

Deputetë të nderuar,

Zëvendëskryeministër dhe ministra,

Unë desha të vë në dukje disa çështje përkitazi me këtë ligj, po që në fillim të them se ligjin e përkrah në tërësi. Këtë e kemi bërë edhe brenda Grupit Parlamentar dhe këtu unë si individ, mirëpo, ndonëse ligji ka në përgjithësi një gjuhë të rrjedhshme, përsëri po bëhen gabime. Disa janë teknike, disa jo, po çështja e parë që duhet të them këtu është përdorimi i shkronjës së madhe dhe i shkronjës së vogël, që ne nxënësve jua shpjegojmë edhe nxënësit që në shkollën fillore dhe të mesme e dinë se ku përdoret shkronja e madhe e ku përdoret shkronja e vogël.

Për shembull, thuhet në nenin 37, të gjithë inspektorët e Inspeksionit e tjerë e tjerë, pse inspektorët me shkronjë të madhe, po në dash le të jenë inspektorë e në dash drejtorë, në dash shefa, kur përdoret në shumës, përdorohet me shkronjë të vogël dhe dihet cili emër, i cili funksion përdoret me shkronjë të madhe? Domethënë, në faqen 29, pastaj titulli: ”koordinimi me ministratë tjera”, duhet: ”koordinimi me ministratë e tjera”. Dhe, ministratë është emër i tipit të emrit që përfundon me zanore të gjatë: ministrisë, shtëpisë, ministratë, shtëpitë e jo pa ë, që duhet t’u jepen lektorëve këto e të përmirësohen, përndryshe, janë shumë brengosëse kur shihen këto gabime. Unë nuk fola

për të tjerët se ndoshta ligjet tjera kanë gabime edhe më shumë, por u ndala në këtë, në këtë pikë.

Qe edhe një shembull për përdorimin e shkronjës së madhe ku përdorët. “Inspektorati bashkëpunon me organet e administratës, me shkronjë të vogël, “Shtetërore” me të madhe. Pse “administratës” me të vogël e “shtetërore” me të madhe, pse është shtet, prandaj nuk është në rregull kjo. Dhe, në fund fare, i kisha lutur deputetët të jenë të durueshëm se unë qe disa herë po i theksoj këto gjëra, por nuk po merr kush parasysh. Disa herë kemi thënë se nuk duhet të përdoret nënkuptohet, nënkuptohet, nënkuptohet njëqind mijë herë. Ajo është fjalë në fjalor, por në këtë ligj 20 herë janë dhënë nocionet me sqarim nënkuptohet, nënkuptohet, nënkuptohet, kështu që 20 herë të thuhet nënkuptohet, pa e përdorur ndonjë term tjetër është, do të thotë, madje, madje ka edhe nocione këtu që s’ ka pasur nevojë të përdoren fare e as të sqarohen, por janë dhënë ashtu sa për të thënë që, domethënë, po e marrim, po e sqarojmë këtë nocion. Vetëm shihni prej nenit 2 e tutje nënkuptohet, nënkuptohet, secilin nocion. Autorizim, çka ka nevojë të jepet sqarimi për fjalën autorizim, dihet çka është autorizim çfarë fjale, ose çfarë nevojë ka të thotë drejtori? Çfarë nënkupton drejtori, drejtori dihet drejtori kush është? Ose për shembull ministër, nënkupton ministrin, ministri dihet kush është edhe kush është i këtyre. Domethënë, të gjitha këto nocione me nënkupton është edhe pa nevojë janë dhënë. Domethënë, tri faqe janë dhënë nënkupton, nënkupton, nënkupton edhe për fjalët që dihen shumë mirë, dihen jo veç nga ne, por edhe nga një lexues i thjeshtë. Prandaj i kisha lutur të gjithë këta që i bëjnë ligjet e po i lut qe disa herë, që të kenë kujdes ndaj gjuhës, sepse gjuha, ligji me një gjuhë të mirë, është shumë më i vlefshëm edhe kryen funksione të caktuara, pranohet më lehtë e tjera e tjera. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputeti Riza Smaka e ka fjalën.

RIZA SMAKA: I nderuar zoti kryesues!

Dihet fare mirë se tregu kosovar është i atakuar nga të gjitha anët, aq më parë kur vendi ynë është kryesisht vend importues edhe eksportojmë pothuaj se 5 apo 6% edhe në tregun tonë hyjnë artikuj edhe mallra po dihet fare mirë, sa e sa here është konstatuar edhe konkluduar me keqardhje të dyshimta, me vlera të ulëta, surrogate e kështu me radhë. Prandaj, edhe qytetari jonë është i rrezikuar edhe në aspektin shëndetësor, përpos të tjerave rreziqe.

Ky dokument juridik gjykoj është i qëlluar edhe për aq konsideroj se zotëri Zharku meriton mirënjohje që e ka iniciuar këtë, e ka përgatitur dhe e ka prurë edhe në parim është një dokument i përgatitur seriozisht edhe do të duhej të kalonte sa më parë që është e mundur në aplikim. Do të isha angazhuar në parim, zotëri kryesues, që inspektori si organ administrativ i instancës së parë të ketë më tepër ingjerenca, autorizime, juridiksion që të jetë më efikas edhe më eficient, që të ketë autorizim për të dhënë urdhëresa dhe aktvendime ekzekutive, pavarësisht nga ankesa. Kjo është 1 edhe lidhur me nenin 33 nëse nuk gaboj 35, ku është thënë atje gjërat, do të thotë, që të thuhet eksplicite jo implicite se inspektori është ai i cili i zbaton sanksionet. Mos të ketë dilema në praktikë se mund të paraqiten në interpretime se ka shumë interpretime të tipeve të ndryshme e tjera e tjera, domethënë shprehimisht që inspektori është ai apo ajo tash inspektori që miraton aty për aty, do të thotë, urdhëresën apo aktvendimin. Natyrisht, pala e pakënaqur duhet të ketë të drejtë ankese, është e drejtë elementare, mirëpo ankesa që nuk e shtyn ekzekutimin. Kjo është punë shumë e rëndësishme. Edhe

përfundimisht angazhohem që këtë dokument ta bëjmë sa më parë që është e mundur dhe ta miratojmë. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Pasi që nuk ka të paraqitur më për fjalë në lidhje me këtë projektligj, të nderuar deputetë, i nderuar ministër më lejoni që të kufizohem nga roli i kryesuesit të kësaj seance dhe t'i them disa fjalë si deputetë në lidhje me këtë projektligj.

Zoti ministër,

Duke e lexuar me vëmendje këtë projektligj të na e keni ofruar, në nenin 7, kam vërejtje te paragrafi 5, 6, 7 dhe 8. Këta paragrafë parashohin verifikimin, pra testet e verifikimit të inspektorëve, paragrafi 5 në çdo 3 vjet, pastaj paragrafi 6, në qoftë se testi është negativ i jepet edhe 6 muaj afat inspektorit për t'u përmirësuar. Pastaj, paragrafi 7 edhe nëse testi i serishëm i verifikimit është negativ e humb vendin e punës. Kjo do të thotë që, a do të thotë kjo zoti ministër që pas 3 vjet 3 e 6 muajve punë të një inspektori verifikohet se ai nuk është i aftë për ta kryer punën e vet. Këtë e kisha kuptuar në qoftë se do të kishte ndonjë paragraf që para se të fillojë puna t'i nënshtrohet obligatiavisht kandidati, pra një test, me të cilin praktikisht ai dëshmon se është i aftë për ata kryer punën, pra jo që 3 vjet e 6 muaj një inspektor të punojë dhe pastaj të vërtetohet se ai nuk është i aftë dhe e humb vendin e punës.

Zoti ministër,

Te nenit 13, është te subjekti ekonomik i cili nënshtrohet inspektimit. Paragrafi 3, subjekti ekonomik i cili e mbikëqyr konsiderohet që nuk i ka mundur inspektorit kryerjen e mbikëqyrjes nga paragrafi 1 i këtij neni, nëse edhe brenda afatit të përcaktuar, me procesverbalin e inspektorëve nuk siguron qasje në produkte. Gjatë leximit të kësaj projektligji, zoti ministër, unë nuk has në ndonjë nen ose paragraf që e detyron subjektin afarist për ta pranuar inspektimin dhe kjo mundëson, që po supozoj se një subjekt afarist, për shembull një dyqan i argjendarisë i ka në dyqan diku rreth 2-3 kilogram metale të çmuara që janë ilegale, nuk i kanë kaluar doganat-akcizat. I shkon inspektori i tregut dhe ai e refuzon inspektorin e tregut që ta bëjë mbikëqyrjen. Pra, gjatë kohës sa shikohet procesverbali që nuk e ka lejuar dhe pastaj pas 30 ditëve t'i shkojë prapë inspektori i tregut i jepet mundësia që atë produkt, atë prodhim, qoftë që është ilegal, pra ta shmangë, ta largojë subjekti afarist dhe kështu i ikë zoti ministër, edhe do të thotë, funksionit të ligjit që ky ligj e ka për shembull për ndalimin e tregtisë informate, ndalimin e tregut të metaleve e tjera të prodhimeve të cilat nuk i kanë kryer obligimet ndaj Qeverisë, ndaj Ministrisë së Financave e tjera.

Te dispozitat ndëshkuese, zoti ministër, ndëshkimi më i madh është 9000 euro. Po që se edhe ndëshkohet ai subjekt afarist me 9000 euro, sigurisht ka pasur llogari ai për ta refuzuar inspektorin e tregut për shkak se brenda ndoshta ka pasur mallra që janë me vlerë shumë më të madhe dhe që është dashur inspektori i tregut t'ia konfiskojë. Zoti ministër, mendoj se brenda këtyre neneve të këtij ligji, duhet të ketë nene që ligji përkufizon dhe jep fuqi obligative që subjekti afarist t'i nënshtrohet inspektimit kur inspektori, pra pa paralajmërim, ju e keni cekur këtu që pa paralajmërim i shkon, ka të drejtë pa paralajmërim subjektit afarist, të ketë obligativisht qasje në dokumentacion ose produkte për të cilat ka shkuar inspektori i tregut po ka marrë detyrë për ta inspektuar subjektin afarist. Kjo ishte vërejtja ime, zoti ministër, mendoj shumë qëllimshëm. Më kujtohet zoti ministër, në mandatin e kaluar kur ministri paraprak i juaji shkon, i dërgon inspektorët për të verifikuar peshoret apo njësitë matëse të volumit të pompave të benzinës nga 9 ka hasur në 6, nuk kanë treguar volumen, pra volumi nuk ka

qenë konform sasisë së furnizuar të produkteve, kur ka shkuar te e dhjeta, ka pasur rezistencë me armë, në shtyp ka qenë dhe inspektorët janë detyruar të largohen. Mendoj që duhet brenda këtij ligji të ketë nene që obligativisht obligohet subjekti afarist që në atë moment që të shkojë inspektori i tregut, të ketë qasje qoftë në dokumentacion, qoftë në produkte të atij subjekti afarist. Unë e mbështes në parim këtë projektligj.

Për fjalë është lajmëruar tani, mendova që është në fund edhe deputetja Nekibe Kelmendi e ka fjalën, e fundit.

NEKIBE KELMENDI: Desha vetëm të cek diçka se jo në secilin ligj mundemi çdo gjë për ta sanksionuar dhe për ata konsideruar si vepër penale ose pak ose shumë. Nëse ky ligj parasheh sanksione, të jeni të bindur se me Kodin Penal të Kosovës, këto veprime në veti përmbajnë edhe elementet e veprave penale dhe çdo person i nënshtrohet përgjegjësisë penale, e në atë procedurë, sipas Kodit të Procedurë Penale, bëhet edhe konfiskimi i pasurisë, kështu që nuk do t'i kushtojë 9000 euro, por do t'i kushtojë ndoshta edhe dhjetë fish më shumë, varësisht prej vlerës të mallit që po konfiskohet. Vetëm kaq. Nuk dua të insistojmë në secilin ligj që të parashihet edhe sanksione penale, sepse vetëm një ligj parasheh sanksione penale, të tjerat parashohin gjoba dhe ato gjoba i nënshtrohen edhe përgjegjësisë për kundërvajtje.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete!

Unë mendoj se patët vërejtje në fjalën time. Unë mendova dhe po e them prapë se ky ligj duhet të përmbajë nene që përkufizojnë që detyrimisht subjekti afarist është i obliguar t'i lejojë qasje, qoftë në dokumentacion, qoftë në produkte, inspektorit, në momentin kur ai troket në derën e subjektit afarist. Nuk është kjo vepër penale as ndëshkuese, por obligativisht detyrohet që të ketë, t'i lejojë qasje. Ju faleminderit!

Pasi që nuk ka të lajmëruar për fjalë, kërkoj deklarinimin me votim për miratimin në parim të këtij projektligji.

Në sallë janë 61 deputetë.

Regjia dhe deputetët, të përgatiten për votim.

Votojmë, tash.

Ju faleminderit! Ka dikush që nuk ka kartelë dhe do të votojë, një “për”. Ju faleminderit! Konstatohet se me 56 vota “për”, 2 “kundër” dhe 4 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për inspektoratin e tregut dhe mbikëqyrjen inspektuese.

Në bazë të Rregullores së Punës, Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion,
- Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
- Komisionin për Buxhet dhe Financa,
- Komisionin për Komunitete, dhe
- Komisionin për Integritet Evropian, që brenda dy muajve nga shqyrtimi i parë Kuvendit, t'i paraqesin raportet me rekomandime.

Ju faleminderit!

Për fjalë është lajmëruar për një kërkesë deputeti dhe shefi i Grupit Parlamentar të LDK-së, Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Ju faleminderit, zoti kryesues! Unë propozoj që seanca e sotme të shtyhet për vazhdim, nesër në mëngjes sipas orarit që e përcakton kryesuesi apo kryetari i Kuvendit, në mënyrë që të punojmë sipas kësaj agjende që sot e kemi përcaktuar. Ju kisha lutur ta keni parasysh këtë kërkesën time. Nesër vazhdojmë me seancë.

KRYESUESI: A ka dikush nga shefat e grupeve parlamentare që lajmërohen për fjalë? Unë jam i detyruar ta qes në votim. Kush është “për”? Sa janë? A ka kundër? Nuk ka. Konstatoj se seanca për sot i mbyll punimet. Vazhdimi i seancës nesër në ora 10. Ju faleminderit!

E premte, 29 janar 2010, ora 10:00

Seancën drejton: kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar deputetë,
Të nderuar zëvendëskryeministra, kryeministër, ministra,
Vazhdojmë punimet e seancës të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të filluar më 28 janar 2010, për pikat e mbetura.

Vazhdojmë me pikën e tetë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje

Në bazë të Rregullës 35 pika 1 të Rregullores së Punës, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji.

Ftoj zëvendëskryeministrin, Ramë Manaj, që para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI RAMË MANAJ: I nderuar kryetar i Kuvendit, Krasniqi,
I nderuar kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Kam nderin që në këtë sesion plenar të Kuvendit të Republikës së Kosovës para jush të paraqes Projektligjin për mbrojtje nga dhuna në familje. Kompletimi i infrastrukturës në fushën e legjislacionit vazhdon të jetë një nevojë imediate në kontekstin e përmbushjes së detyrimeve kushtetuese nga plani i rregullimit dhe i përmbushjes së materies juridike edhe në fushën e mbrojtjes nga dhuna në familje.

Qëllimi themelor i këtij projektligji është mbrojtja nga dhuna në familje me anë të masave të posaçme ligjore, krijimi i mekanizmave adekuat për mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave. Gjithashtu, ky projektligj ka për qëllim edhe trajtimin e kryerësve të dhunës në familje dhe lehtësimin apo zbutjen e pasojave të tyre. Në mënyrë që të reflektojë realitetin e tanishëm të shoqërisë kosovare është paraqitur nevoja për rregullimin e mbrojtjes nga dhuna në familje me legjislacion si masë paraprake për evitimin e ushtrimit të dhunës në familje. Ky projektligj parasheh avancime në mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe si rrjedhojë me miratimin e këtij projektligji pushon së zbatuari Rregullorja e UNMIK-ut numër 12/2003 kundër dhunës në familje.

Projektligji përbëhet prej gjithsej 30 neneve dhe, ndër të tjera, ka për qëllim hartimin edhe të programit të Kosovës kundër dhunës në familje, me qëllim që të ketë mbështetjen dhe ngritjen e strukturave ndihmëse dhe të infrastrukturës së nevojshme, gjë që shërben për mbështetjen dhe plotësimin e nevojave për personat ndaj të cilëve është

ushtruar dhuna në familje, përfshirë këtu asistencë sociale, financiare si dhe shërbime mjekësore, natyrisht në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Projektligji për mbrojtjen nga dhuna në familje është përgatitur nga Zyra e Kryeministrit dhe është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me standardet e BE-së. Miratimi i këtij projektligji ka për qëllim përmbushjen e obligimeve që kanë dalë si sfida në planin e veprimit për vitin 2009 për implementimin e partneritetit evropian për Kosovën.

Unë bëra përpjekje dhe pata rastin t'ju informoj në pika të shkurtra në përmbajtjen e këtij ligji, në fakt projektligji tepër të rëndësishëm për vendin tonë dhe ju propozoj që këtë ta miratoni, në mënyrë që çështjet të cilat rregullohen me këtë fushë, me këtë projektligji të vihen në suaza të kornizës ligjore adekuate, natyrisht edhe me plotësimet që mund të bëhen në mes të dy leximeve. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit zëvendëskryeministër! Kryetarët e komisioneve më duket s'janë të disponuar. Po shkojmë me shefat e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike deputetja Nerxhivane Dauti e ka kërkuar fjalën.

NERXHIVANE DAUTI: Faleminderit zotëri kryetar!

I nderuari zotëri Kryeministër, kabinet qeveritar,

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës dhe në cilësinë e raportueses së Komisionit parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore dhe Peticione do të shpreh mendimin lidhur me Ligjin për mbrojtjen nga dhuna në familje. Në vazhden e përpjekjeve për të kompletuar bazën ligjore për rregullimin e çështjeve familjare, është edhe Ligji për mbrojtjen nga dhuna në familje. Ligji të cilin jemi duke e shqyrtuar shënon një nga hapat më të sigurt përafrimin e legjislacionit të Republikës së Kosovës me standardet ndërkombëtare në fushën e legjislacionit kundër dhunës në familje. Ky ligj përbën njëkohësisht një kontribut të rëndësishëm në kuadrin e legjislacionit antidiskriminim dhe atij të barazisë gjinore, të cilët janë thelbësor për çdo shtet jo vetëm si detyrim kushtetues, por edhe për zbatimin e akteve të ndryshme ndërkombëtare, veçanërisht Konventës për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave, Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve, Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut. Duke përkufizuar dhunën në familje dhe duke e konsideruar atë si një akt apo qëndrim të një personi ndaj një personi tjetër që cenon integritetin fizik, moral, psikologjik, social dhe ekonomik të individit, ky ligj siguron mbrojtjen e anëtarëve nga dhuna në familje në të gjitha format me të cilat ajo mund të shfaqet. Ligji synon të parandalojë dhe minimizojë dhunën në familje si dhe të garantojë mbrojtje ligjore për të gjithë anëtarët e familjes që janë viktimë të dhunës duke i kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve. Mbrojtja e ofruar nga ligji u përket të gjithë subjekteve që janë viktimë të dhunës, pavarësisht nga gjinia e tyre. Me përcaktimin e pjesëtarëve të familjes që mbrohen nga ky ligj, ai e shtrin mjaft efektin e tij duke filluar nga subjektet e marrëdhënieve bashkëshortore, të gjinisë, adoptimit, kujdestarisë deri tek ato të bashkëjetesës dhe ish- marrëdhënieve martesore. Në ligj vendosen qartazi detyrimet e autoriteteve përgjegjëse shtetërore që do të hartojnë politikën dhe strategjitë konkrete të parandalimit dhe të reduktimit të dhunës në familje.

Autoriteti përgjegjës që mundëson zbatimin e këtij ligji dhe merr përsipër hartimin e politikave dhe strategjive në parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje është Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, ndërsa aktorët tjerë të cilët do të bashkërendojnë

punën me të janë: Policia e Kosovës, Ministria e Shëndetësisë, me qendra shëndetësore dhe gjykatat kompetente. Ligji është një kontribut i rëndësishëm për forcimin e pushtetit gjyqësor përmes sanksionimit të masave mbrojtëse kundër dhunës në familje. Parashikohen si masa mbrojtëse të marra nga gjykata, urdhrat e menjëhershëm mbrojtës dhe urdhrat mbrojtës. Këto urdhra shërbejnë për të parandaluar një krim të mundshëm që mund të ndodhë ë të ardhmen. Në këtë mënyrë ky ligj ka shkuar tej masave të parashikuara në Ligjin e familjes pasi parashikon një gamë më të gjerë të masave kundër dhunës dhe procedura të detajuara. Në këtë mënyrë ai do të ofrojë siguri dhe mbrojtje më të lartë si dhe shërbime më të shpejta për viktimat e dhunës dhe të afërmit e tyre. Masat mbrojtëse që merren me urdhër të Gjykatës shërbejnë edhe si masa alternative për paralizimin dhe shmangien e dhunës pa qenë nevoja që personi t'i nënshtrohet medoemos masave të sigurimit në procedurën penale duke i lënë hapësira veprimi të strukturave për rehabilitimin e viktimës së dhunës. Ligji të cilin po e shqyrtojmë sjell garanci të reja jo vetëm për faktin se ka parashikuar detyrimin e shtetit për të marrë masa mbështetëse e rehabilituese, por edhe për faktin se parashikon një ligj të gjerë alternative që rregullon një gamë më të gjerë marrëdhënies midis familjarëve. Kjo do të bëjë më të lehtë punën e gjyqtarit për aplikimin e njërës prej masave nëse nuk është e mundur të zbatohet realisht masa më e rëndë.

Në emrin tim personal, të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike dhe të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore dhe Peticione konsideroj se ligji i propozuar duhet të miratohet në shqyrtim të parë. Ju falënderoj për vëmendjen!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, kush flet në emër të Grupit. Janë paraqitur shumë këtu. Luljeta Shehu.

LULJETA SHEHU: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuari Kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar deputetë,

Projektligji për mbrojtje nga dhuna në familje është mëse i domosdoshëm për vendin tonë, sepse me këtë do t'u sigurohet familjeve të qytetarëve mbrojtja me ligj e familjes nga dhuna. Ky projektligj është i një rëndësie sepse synon të parandalojë dhunën në familje, si një dukuri e cila është prezent edhe në shoqërinë kosovare. Ky projektligj po ashtu ka për qëllim krijimin e mekanizmave të nevojshëm për rehabilitimin e viktimave të dhunës në familjeve si dhe trajtimin e kryerësve të dhunës në familje. Prandaj, Grupi parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrah në parim këtë projektligj, ndërsa vërejtjet dhe sugjerimet do t'i japim në komisionet përkatëse. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së kush e kërkon fjalën? Deputetja Zylfije Hundozi.

ZYLFIJE HUNDOZI: Faleminderit, zoti kryetar!

Zotëri ministra, zotëri deputetë,

Qëllimi i këtij projektligji është mbrojtja nga dhuna në familje nëpërmjet të masave speciale ligjore, vendosja e mekanizmave adekuat të mbrojtjes, përkrahja dhe rehabilitimi i viktimave. Gjithashtu tenton të caktojë trajtim të kryerësve të dhunës në familje dhe zbutjes së pasojave për ata që e kanë përjetuar dhunën. Ky ligj do të zëvendësojë Rregulloren e UNMIK-ut numër 2003/12 për mbrojtjen kundër dhunës në familje, substancë kryesore e së cilës mbetet edhe në këtë projektligj. Ndryshimet kryesore nga Rregullorja e UNMIK-ut janë vetëm përmasat mbrojtëse dhe trajtimin, ndërsa procedurat

janë gati krejtësisht të pandryshuara. Mendimi ligjor i bashkëngjitur në projektligj sa i përket përputhshmërisë me asquis communautaire me të cilën vërtetohet se çdo shtet individualisht e rregullon këtë materie, është korrekte. Edhe pse kjo fushë nuk është e rregulluar me asquis communautaire, megjithatë është ngushtë e lidhur me proceset e integritimeve evropiane në Kosovë se mbrojtja nga dhuna në familje është e përfshirë në kriteret politike të cilat duhet të plotësohen që Kosova të integrohet në Bashkimin Evropian. Përmbushja e kriterëve politike është element me rëndësi për procesin e integritimeve evropiane dhe është parakusht për fillimin e procesit të negociatave në të ardhmen. Gjithashtu duhet theksuar se miratimi i legjisllacionit nuk është e vetmja detyrë të cilën Kosova duhet të përmbushë drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Implementimi i legjisllacionit është faktor edhe më i rëndësishëm dhe sa i përket mbrojtjes nga dhuna në familje. Komisioni Evropian në raportin e progresit të vitit 2009 është shumë kritik duke shprehur se shumë raste të dhunës në familje nuk janë paraqitur, shumë pak raste të paraqitura janë proceduar në gjyq, shumica e viktimave të trafikuar janë gra, vonesa në shqiptimin e masave mbrojtëse janë çështje për t'u brengosur. Edhe pse korniza institucionale për të drejtat e grave është forcuar, por dhuna në familje është mjaft e përhapur dhe është çështje për brengosje, citohet në raportin e progresit të Komisionit Evropian.

Për shkak të rëndësisë që e ka ky projektligj dhe zbatimi i tij në praktikë, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah në parim dhe do të japë kontributin e vet në Komisionin funksional. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit deputete! Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deputeti Ibrahim Makolli e ka kërkuar fjalën.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë,

Ligjin të cilin po e trajtojmë përmbledh një fushë shumë të rëndësishme për shoqërinë tonë. Ligji përpos tjerash duhet dhe do të duhej të parasheh edhe mekanizma për parandalim të dhunës në familje dhe jo vetëm marrjen me pasojë të saj, prandaj do të ishte mirë që ligji të titullohet – edhe Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje. Ne si Grup Parlamentar gjithsesi e mbështesim këtë projektligj dhe do të japim kontributin tonë në procedurat e mëtutjeshme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë Drita Maliqi e ka kërkuar fjalën.

DRITA MALIQI: Faleminderit, zoti kryetar!

Përsëritje për të gjithë!

Edhe Grupi jonë Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e kanë shqyrtuar me vëmendje të posaçme Projektligjin për mbrojtjen nga dhuna në familje, i cili ka për qëllim krijimin e mekanizmave për mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave, me qëllim të lehtësimit të pasojave dhe parandalimit të saj ku u cek edhe nga kolegu im paraprak Makolli, domethënë, të jetë e mundshme që në rend të parë të parandalohen përmes këtij ligji, kërkoj edhe unë, kam një propozim.

Ky projektligj është i një rëndësie të veçantë, sepse synon të parandalojë dhunën në familje, mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje si dhe hartimin e programit të Kosovës kundër dhunës në familje, andaj edhe Grupi jonë e përkrah në parim

projektligjin. Kontributin tonë do ta japim në Komisionin funksional. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYETARI: Faleminderit deputete! Në emër të Grupit Parlamentar” 7+” Shpresa Murati e ka fjalën.

ŠPRESA MURATI: Hvala Predsedniče!

Pozdrav svima!

Cilj ovog nacrta zakona je zaštita od nasilja u porodici pomoću posebnih zakonskih mera, stvaranje adekvatnih mehanizama za zaštitu, podršku i rehabilitaciju žrtava kao i tretiranje počinitelja nasilja u porodici. U izradi ovog nacrta zakona korišćeno je zakonodavstvo Hrvatske i Austrije. Agencija za ravnopravnost polova u saradnji sa odgovarajućim ministarstvima i drugim institucijama izrađuje kosovski program protiv nasilja u porodici u roku od 6 meseci nakon stupanja na snagu ovog zakona. Cilj ovog programa biće podržavanje i podizanje pomoćnih struktura i potrebne infrastrukture koja će služiti žrtvama nasilja, uključivši socijalnu, finansijsku kao i lekarske usluge.

Parlamentarna grupa „7+“ smatra da se radi o jednom sveobuhvatnom zakonu koji detaljno reguliše pitanje iz ove oblasti i u načelu ga podržava. Funkcionalna komisija za ljudska prava i ravnopravnost polova, a verujem i uz nesebičan doprinos neformalne grupe žena parlamentarki učiniće sve kako bi smo dobili jedan zakonski dokument koji će biti sprovodljiv u praksi. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të SLS a ka të... Nuk ka. Vazhdojmë me diskutuesit e radhës. Sipas radhës, fjalën e ka deputetja Melihate Tërmkolli.

MELIHATE TËRMKOLLI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Mendoj se ky ligj është i formuluar mirë, formalisht, por shpreh dyshimet e mia se ky formulim i mirë formalisht do të mbërrijë edhe t’i realizojë qëllimet të cilat i ka paraparë projektligji në praktikë.

Në fund tekstit të projektligjit, dhe unë mendoj se i përkrah disa mendime që u dhanë deri tash këtu, në tërë tekstin kemi pas përsëritjes, domethënë, fjalitë pas përsëritjes së dhunës, nëse përsëritet dhuna e tjera, e tjera, që do të thotë se ky ligj referohet apo ky projektligj referohet shumë më tepër rasteve kur kemi të bëjmë me përsëritje të dhunës në familje se sa parandalimit apo ndalimit të dhunës në familje.

Është një çështje tjetër që ka të bëjë me përgjegjësinë e policisë dhe e cila në projektligj thuhet se policia duhet t’i përgjigjet secilit njoftim, por asnjëherë nuk thuhet koha dhe afati, sepse policia mund t’i përgjigjet edhe pas 5 muajve një kërkesë të viktimës të dhunës në familje, por jo në kohën e duhur dhe në kohën e paraparë.

Çështja e cila mendoj se është preokupim jo vetëm në këtë ligj, por një preokupim jo vetëm në këtë ligj, por një preokupim i vazhdueshëm ka të bëjë se sa herë përmenden çështjet e familjes, mendohet vetëm se këto janë probleme të grave dhe edhe sot këtu dhe edhe në ditë tjera po kur po trajtohet kjo çështje mendohet që dhuna në familje, kjo nënkupton dhunën ndaj grave. Mendoj se është gabim dhe duhet të shihet në tonalitetin, në tërësinë e saj, në kompleksitetin e saj, ka dhunë edhe ndaj fëmijëve, besa ka edhe ndaj meshkujve raste të caktuara, kështu që nuk është mirë me paragjykime ta marrim as këtë ligj dhe asnjë ligj tjetër të kësaj natyre. Një çështje që mendoj se lidhet me aspektin

kundër ligjor të këtij ligji ka të bëjë me nenin 27 – programin e Kosovës kundër dhunës në familje. Sipas këtij projektligji është paraparë që programin kundër dhunës ta bëjë Agjencia për Barazi Gjinore edhe po më duket që Qeveria e ka gjet një viktimë për ta bërë këtë program dhe ajo viktimë është Agjencia për Barazi Gjinore. Mendoj se Qeveria është mirë ta gjejë një tjetër viktimë ta bëjë, sepse në Ligjin për barazinë Gjinore kjo nuk është kompetencë e Agjencisë për Barazi Gjinore. Nuk hyn në kuadër të fushëveprimit dhe kompetencave të saj, prandaj me një ligj nuk mund të shkelet ligji tjetër. Mund t'i shtohet, të ndryshohet ai ligj që është për barazinë gjinore dhe t'i shtohet edhe kjo kompetencë kësaj agjencie, por përderisa është kështu në fuqi ai ligj, atëherë kjo nuk vlen. Dhe, atë çka është dashtë me bë kjo agjenci, nuk e ka bë asnjëherë. Kjo agjenci është dashur ta bëjë programin e Kosovës për barazi gjinore, është një obligim edhe kushtetues edhe ligjor dhe obligim të cilin nuk e ka realizuar asnjëherë. Asnjëherë ky Parlament nuk është marrë me programin e Kosovës për barazi gjinore, që është dashur të jetë shumë kohë më herët në debat, në Parlament. Janë bërë 6 vjet që kjo agjenci po ashtu nuk ka kryesues, nuk ka kryeshef, ka një ushtrues detyre. 6 vjet, Qeveria e Kosovës edhe ajo më herët edhe kjo qeveri nuk kanë mbërri ta bëjnë një kryeshef ekzekutiv të kësaj agjencie për ta përmbushur misionin e vet që ka dhe ajo që fola për mentalitetin e më hershëm, më vjen keq që ministri i Arsimit nuk është këtu, ishte, pata qejf të jetë dhe të me dëgjoj. Dje e dha një deklaratë shumë cinike në përgjigjen e një deputete, sepse nuk ka në komisionet për kurikulume nuk ka edhe gra dhe ministri u përgjigj. Tha që Kushtetuta parasheh që në ato komisione duhet të ketë njerëz të aftë dhe njerëz profesionistë dhe njerëz të aftë dhe profesionistë nuk paska gra kurrkund në këtë tokë dhe në këtë Kosovë. Kjo është shumë cinike, kjo është kultura politike e ministrit dhe fatkeqësisht është kultura politike e ministrit të Arsimit. Mendoj që kjo nuk guxon të ndodhë në shoqërinë tonë e cila dhe thjesht nivelet drejtuese as formalisht sa e kanë devalvuar deri në fund çështjen e trajtimit që do të duhej të jetë një trajtim shumë serioz, jo veç të barazisë gjinore por edhe të çështjeve të tjera. Unë mendoj problemi kryesor del në zbatimin e ligjeve, sepse po ta dinte, po ta njihte kjo qeveri, po t'i njihte ligjet, nuk kishte me prurë këtë ligj dhe t'ia ngarkoj Zyrës apo Agjencisë për Barazi Gjinore këtë çështje. Pra, për deri sa nuk zbatohen ligjet atëherë kemi ngatërresa edhe në hartimin e ligjeve të reja, kemi ngatërresa edhe në kuptimin apo keqkuptimet e mëdha që po krijohen gjatë hartimit të ligjeve dhe zbatimit të tyre. Unë do të them që neni 27 duhet të hiqet krejt, sepse është kundërligjor. Një ligj nuk mund të imponojë fushëveprimin e një institucioni i cili është i rregulluar me ligjin tjetër. Faleminderit, kaq!

KRYETARI: Për fjalë është lajmëruar deputetja Edita Tahiri, deputete mundësisht në kuadër të ligjit se për ligjin jemi kah flasim.

EDITA TAHIRI: Zoti kryetar, a me mua e patët a me parafolësen? Apo je duke i parandaluar tash. Nëse është për parandalim, së pari që ky ligj është dashur të flasë për parandalim, e ndoshta ishte parandaluar edhe kjo ndërhyrje, mandej. Faleminderit, për humor!

Ju përshtes të gjithëve! Mendoj se ka qenë koha e fundit që të kemi një ligj për të parandaluar dhe mbrojtur sigurisht njerëzit të cilët mund, janë viktimë e dhunës në familje. Është interesante se në Kosovë dhuna në familje është në rritje, po kjo nuk është vetëm në Kosovë, përfshin madje ndoshta gjithë rajonin, mirëpo kemi një fenomen këtu që raportimi i dhunës nuk është në nivelin e duhur, madje statistikat na dalin se gjoja dhuna është në rënie. Kjo për mendimin tim tregon që jo vetëm kjo fushë nuk është e rregulluar me ligj dhe nuk veprojnë mekanizma për ta adresuar këtë fenomen, por janë disa çështje të cilat në fakt duhet trajtuar veçanërisht në këtë ligj. E para, problemi i

rasteve të raportimit të dhunës mendoj se duhet të ketë një hapësirë të mjaftueshme për të inkurajuar viktimat që të raportojnë për dhunën, mirëpo kjo duhet të shoqërohet edhe me masa mbrojtëse, sepse ma merr mendja se hezitimi për raporte ndërlidhet me mungesën e masave për mbrojtje. Tjetra mendoj se në kuadër të mekanizmave që janë paraparë në këtë ligj nuk përmendet Ministria e Punëve të Brendshme, përmendet vetëm Policia e Kosovës, Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe Ministria e Shëndetësisë. Pse mendoj që duhet të inkadrohet edhe Ministria e Punëve Brendshme? Mendoj se për ta adresuar mirë këtë dukuri duhet të krijohet një institut për hulumtime të dukurisë së dhunës në familje që më pas do të dalë edhe me statistikën, në mënyrë që ne të dimë shkallën e këtij problemi dhe krahas asaj do të dimë t'i japim edhe përgjigjen e duhur.

Për sa i takon ligjit, unë e lexova, nuk jam juriste, mirëpo masat nuk i pash të qarta, masat të cilat do të ndërlidheshin me ndëshkimet me kryerësit e dhunës. Për shembull do të përmendja nenin 22 pika 2 ku thuhet që kohëzgjatja e urdhrit të përkohshëm emergjent skadon në fund të ditës së ardhshme gjatë së cilës gjykata punon. Kjo do të thotë që, në qoftë se kryerësi i dhunës kryen një dhunë, nesërmen, deri nesër ai edhe mund të kthehet në shtëpi dhe ta përsëris dhunën, sepse çështjet e gjykatave, duke marrë parasysh brishtësinë e sundimit të ligjit në Kosovë nuk garantojnë shumë efikasitet në këtë drejtim. Unë pata rastin ta lexoj një lajm nga Hungaria pardje ku thuhej se Gjykata Kushtetuese e kishte kthyer Ligjin për ndalimin e dhunës në familje prapa në Parlament, sepse ishte paraparë që kryerësi i dhunës nuk mund të kthehej në shtëpi vetëm pas 72 orëve, ndërkohë që gjykata kishte kërkuar 30 ditë, pra ndëshkim për kryerësin e dhunës. Ky ligj nuk ka qartësi të tilla, të gjitha ia jep gjykatës komunale. Për mendimin tim, futja në burokracitë gjyqësore- komunale, nënkupton ma shumë dhunë ndaj viktimës, prandaj, ata që do të punojnë sigurisht versionin final të këtij ligji, edhe unë besoj që do të thërras dhe së bashku me Grupin e grave një tryezë për të përgatitur amendamentet dhe për t'i dhënë qartësi disa gjërave, veçmas në mënyrë se si kryerësi i dhunës, pra të jetë i penguar që të përsëris këto çështje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit deputete! Radhën e ka deputetja Sanije Aliaj.

SANIJE ALIAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë, Kabinet qeveritar,

Dhuna në familje gjithnjë më shumë është duke u bërë pjesë e debateve publike, e cila shfaqet në format e ndryshme në shtetet e ndryshme, varësisht nga kontekstet, kulturat dhe lidhjet ndërfamiljare, prandaj është përgjegjësi për krijimin e infrastrukturës ligjore dhe mekanizmave institucional që i zbatojnë këto ligje për t'iu përgjigjur akteve të dhunës në familjeve brenda kornizës së ligjeve të BE-së dhe konventave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Në Kuvendin e Kosovës janë miratuar një numër ligjesh, që po ashtu rregullojnë në formë të ndryshme dhunën në familje, por procedimin e Projektligjit kundër dhunës në familje e konsideroj një të arritur, sepse Projektligji ka për qëllim mbrojtjen nga dhuna në familje me anë të masave të posaçme ligjore dhe krijimin e mekanizmave për parandalimin e torturës dhe degradimin poshtërues të viktimës si pasojë e dhunës në familje. Përmbajtja e projektligjit nuk përkon me emërtimin, sepse në përmbajtje përcaktohen vetëm masat mbrojtëse, të caktuara nga gjykata komunale, përgjegjësitë e Policisë dhe masat ndëshkuese për mosrespektimin e masave mbrojtëse nga kryesit e veprave, kurse asnjë nen nuk definon masat për parandalimin e dhunës në familje kur dihet se vetëm masat ndëshkuese nuk zvogëlojnë dhunën në familje, por më të efektshme do të ishin masat parandaluese.

Mendoj se projektligji duhet të emërtohet – Projektligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje. Me këtë projektligj gjykatat komunale lëshojnë dy lloj urdhrash – urdhrat për mbrojtje emergjente dhe urdhra për mbrojtje që dallojnë për kah kohëzgjatja për zbatimin e këtyre masave. Masat mbrojtëse me këtë projektligj garantojnë mbrojtjen e viktimës pasi të ndodhë dhuna. Me këtë rast propozoj që të shtohen disa dispozita me masat të cilat parandalojnë dhunën në familje duke krijuar parakushtet siç janë: aftësimi, edukimi, ngritja arsimore, aftësimi profesional dhe punësimi, ngase si pasojë e dhunës në familje është rritur numri i shkurorëzimeve që duhet të jetë shqetësim për institucionet e Kosovës. Me rastin e vizitës së bërë strehimoreve të grave dhe fëmijëve nga anëtarët e Bordit të grave deputete është vlerësuar si shqetësim nga udhëheqëset e këtyre strehimoreve se cili do të jetë fati i viktimave pas kalimit të afatit të paraparë me masat mbrojtëse të garantuara dhe me këtë projektligj. Njëherit shqetësimi i tyre ishte ku do të sistemohen viktimat kur janë në pyetje gratë dhe fëmijët si pasojë e dhunës në familje dhe kujt do t'i takojnë përgjegjësitë për përkujdesjen e tyre. Masat ndëshkuese për shkeljen e urdhrave mbrojtëse konsideroj se janë simbolike, sepse dënimi me 200 euro, 2000 dhe pamundësia për t'i paguar këto ndëshkime financiare dhe dënimi me 6 muaj burg nuk e ndalë dhunën në familje, sepse në njërin anë shkelja e urdhrave mbrojtëse vlerësohet me projektligj si vepër penale, kurse masat ndëshkuese janë kundërvajtëse.

Neni 26 definon se shkelja e urdhrit për mbrojtje edhe e urdhrit për mbrojtje emergjente do të ndiqet ex-officio. Konsideroj se ndjekja ex-officio duhet precizuar me disa paragrafë se cilat janë masat ndëshkuese me këtë rast. Më projektligj definohet se pas hyrjes në fuqi të këtij projektligji në afatin prej 6 muajsh, Agjencioni për Barazi Gjinore harton programin për mbrojtjen nga dhuna në familje. Me këtë rast propozimi im është se Agjencioni për Barazi Gjinore, së bashku me ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministrinë e Kulturës dhe Ministrinë e Shëndetësisë të hartojnë një program i cili deri më tani veç ai program është dashur të vijë në miratimin në Kuvendin e Kosovës, por mua më habit fakti se si deri më tani Qeveria e Republikës së Kosovës nuk ka strategji dhe plan veprimi për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje.

Projektligjin e përkrah në parim me një shpresë se pas një dëgjimi publik dhe pas amendamentimit në Komisionin funksional do të bëhet një ligj që krijon kushtet në radhë të parë për parandalimin e mandej edhe për mbrojtjen nga dhuna në familje. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Radha është për deputeten Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar qeveritarë,

Deputetë të nderuar,

Çështja e dhunës në familje është një çështje e rëndësishme për faktin se jo vetëm që ndikon në shëndetin dhe mirëqenien e individit dhe të familjes, por edhe të shoqërisë në tërësi. Nëse kjo çështje nuk trajtohet seriozisht atëherë edhe vetë shoqëria do të pësojë. Prandaj krijimi i infrastrukturës ligjore për këtë çështje, por sidomos për parandalimin, reduktimin dhe luftimin e dhunës në familje është e rëndësishme për një shoqëri të shëndoshë. Në Kosovë nuk ka të dhëna të sakta lidhur me nivelin e dhunës në familje, për faktin se nuk raportohen të gjitha rastet por është evidente se dhuna ekziston dhe se është në rritje.

Projektligjin që është sjell sot e konsideroj vetëm si një iniciativë të parë, por kurrësi jo si një ligj i cili mund të arrijë qëllimin e minimizimit së paku të dhunës në familje. Edhe

pse me këtë projektligj më tepër ka masa ligjore mbrojtëse se sa masa parandaluese, megjithatë e shoh të nevojshme dhe në parim e përkrah. Deri më sot dhuna kundër familjes është rregulluar kryesisht me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/12, e cila po ashtu nuk e ka rregulluar në tërësi këtë fushë, por vetëm pjesërisht. E meta e madhe e këtij ligji është se masat parandaluese nuk janë paraparë, gjithashtu nuk janë paraparë edhe masat pasi që kryerësit e veprës i nënshtrohen ligjit apo edhe viktimat e dhunës çka do të ngjajë me viktimat e dhunës pasi që ato trajtohen me masa ligjore mbrojtëse? Do të thotë, po ashtu një metë e madhe dhe të cilën e theksoj tani është se nuk ka pasur sa duhet mbështetje të qendrave për mbrojtjen e grave, do të thotë, ato të cilat përkujdesen dhe ofrojnë strehimore për gratë, por përkundrazi më tepër OJQ-ët ndërkombëtare janë marrë me këtë çështje. Meqenëse Kryeministri është këtu unë e ftoj Kryeministrin që më me seriozitet ta shtrojë dhe çështjen e programit për mbrojtjen kundër dhunës, për arsye se ky është qenësor në realizimin e këtij qëllimi.

Meqenëse Projektligji ... nenin 27 sipas të cilës Agjencioni për Barazi Gjinore realisht është udhëheqëse e kësaj çështje të këtij programi atëherë ky nen duhet ndryshuar plotësisht, unë propozoj që Kryeministria të bëhet udhëheqëse e ministrive tjera, edhe Ministrisë së Shëndetësisë edhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë edhe Ministrisë së Punës dhe i Mirëqenies Sociale, Ministrisë së Drejtësisë e tjerë, në mënyrë që të mundë të zhvillojë një dokument të politikave të harmonizuara të Qeverisë e cila duhet të jetë edhe e harmonizuar me shoqërinë civile. Esenca e arritjes së këtij dokumenti, e këtij qëllimi, gjegjësisht luftimi i dhunës në familje është pikërisht hartimi i këtij dokumenti, natyrisht shqetësimin e shpreh sidomos në zbatimin e dokumentit për shkak të mungesës financiare, meqenëse sidomos Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale....

KRYESUESI NAIM MALOKU: Nëse mundeni të ktheheni në temë deputete, në ligj. Pika e rendit të ditës është... Po, të lutem....

GJYLNAZE SYLA: Temë është kjo, programi është pjesë e temës, kryesues, neni 27 pjesë e temës është. Sa i përket kostos financiare, do të thotë, shqetësimi është se a mund të zbatohet ligji, sidomos atëherë kur Ministria e Shëndetësisë nuk ka buxhet të mjaftueshëm për trajtimin mjekësor nga varësia prej alkoolit dhe substancave psikotrope.

Siç e thashë në fillim, duke marrë parasysh se këtë e konsideroj vetëm si iniciativë të parë për luftimin kundër dhunës, në parim e përkrah. Kryesues, neni 27 është pjesë e ligjit.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Unë i njoftoj deputetët se pika e rendit të ditës është – shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe jo debat për dhunën në familje që kanë të drejtë deputetët ose mund të jetë temë e rendit të ditës. Në radhë deputeti Driton Tali e merr fjalën, të përgatitet deputeti Hydajet Hyseni-Kaloshi.

DRITON TALI: Faleminderit zoti kryesues!

Unë, më lejoni që fillimisht të deklaroj se e përkrah këtë projektligj, ndonëse i kam disa vërejtje dhe këto vërejtje janë më shumë në kuptimin përmbajtësor dhe gjuhësor për shkak se e kam përshtypjen se adaptimi në gjuhën shqipe nuk është bërë ashtu siç ka mund të bëhet. Ata të cilët e kanë lexuar e shohin, po them përshtypja është se është përkthyer nga gjuha angleze për shkak se shumë nene në anglishte japin kuptimin e plotë, gjersa në gjuhën shqipe ka mangësi. Domethënë atë që do ta bëj sot është, atë që deputeti i nderuar zoti Adem Hajdaraj e bëri dje për Ligjin mbi inspeksionin.

Të fillojmë. Faqe 4, te neni 1.2.1 mendoj se pa nevojë është përdorur dy herë një fjalë, domethënë, është përdorur, po e lexoj siç është këtu. Është “përdorimin e forcës fizike ose presionin psikik të ushtruar ndaj anëtarit tjetër të familjes”. Mendoj se duhet të jetë “përdorimin e forcës fizike ose presionit ndaj anëtarit tjetër të familjes”, por nuk ka nevojë që të jetë fjala “e ushtruar” në gjuhën angleze në këtë nuk është, po supozoj se është përkthyer nga anglishtja.

Pastaj shkojmë te 1.2.5, “offence” është përkthyer si “sharje” që nuk është, mund të jetë “fyerje” që është fyerje, nuk është “swearing”, domethënë nuk është sharje. Pra ofendimi – fyerje duhet të jetë, jo sharja, thirrja me emra ofenduese e tjera, e tjera.

Pastaj, faqja 5, neni 1.2.9, thuhet “dëmtimi” apo shkatërrimi i pasurisë”. Nuk përdoret këtu fjala “assets” por është “property” që do me thënë “prona”. Domethënë duhet të jetë dëmtimi apo shkatërrimi i pronës.

Pika 1.2.11 është shumë e përzier, është e pakuptimtë, nëse e lexoni, thuhet se është “hyrja apo largimi me dhunë nga banesa e përbashkët apo banesën e personit tjetër”. Lexoni 2-3 herë, s’ mund e kuptoni, duhet të jetë: “hyrja me dhunë në pronën e personit tjetër apo largimin me dhunë të personit tjetër nga rezidenca apo nga banesa e përbashkët”. Kështu jep kuptim.

Pastaj nuk di pse fjalën “petition” shqip e kanë përkthyer “kërkesë” kur ne fjalën “petition” e përdorim dhe këtu do me thënë ka të bëjë me petition, pra nuk kemi të bëjmë me “request” apo “klain” që është në gjuhën angleze, por kemi të bëjmë me “petition”, dhe fjalën petition ne e përdorim në gjuhën shqipe. Kjo fjala “kërkesë” gjithkund është përsëritur. Mendoj se kemi të bëjmë me petition.

Pastaj faqe 7. “urdhër mbrojtjen e përkohshme emergjente”, është shpjeguar që nënkupton urdhrin e lëshuar jashtë orarit të punës së gjykatave, por në anglishte këtu shpjegohet deri kur vlen. Pra vlen deri në ditën e nesërme sa gjykata është duke punuar, domethënë, me fjalë tjera gjykata të nesërmën duhet të merret me këtë rast se përndryshe këtë kuptim e ka në gjuhën angleze. Ky urdhër mbrojtje e përkohshme e humb atë farë autorizimin, të paktën kështu është në gjuhën angleze. Pra, nuk është se vlen për një kohë të gjatë por duhet të nesërmen menjëherë apo sa më shpejt të merret gjykata me rastin në fjalë.

Pastaj fjala “harsmond” në gjuhën shqipe është përkthyer si “shqetësim”. “Haresmond” nuk është shqetësim është më shumë se ajo. Domethënë nuk kemi të bëjmë me “apseting”, nuk kemi të bëjmë me “dister bends” që mund të jenë shqetësime por kemi të bëjmë... “harsmond” është një farë spektri në vete, spektër më të gjerë të sjelljes, agresive, ofenduese, agresive, fyese ndaj personit, andaj unë mendoj se duhet të jetë ashtu siç po i përdorim shumë fjalë tjera, duhet të jetë një “haras” edhe në gjuhën shqipe ta adaptojmë si të tillë për shkak se po them përsëri gama e sjelljeve negative ndaj personit tjetër “harasmond” nënkupton pak më shumë. Tirana është kah e përdor fjalën “molestim”, por më shumë në atë kuptimin e molestimit seksual që është edhe në gjuhë tjera, përdoret ajo. Por unë mendoj se fjala “haras” mund të adaptohet kjo është punë e gjuhëtarëve në debatet e tyre që do të vendosin sigurisht.

Pastaj te faqja 10. Kujdestaria e përkohshme e fëmijës do t’i besohet apo i besohet. Flas për pikën 2. Kujdestaria është kështu... “Kujdestaria e fëmijës përkohësisht i besohet

viktimës së dhunës në familje ndërsa e drejta prindore përkohësisht...” Pra edhe këtu duhet të përmirësohet, atë që e thash, për mos ta zgjatë.

Kemi këtu te neni 10, faqe 12, thuhet “masat mbrojtëse e marrjes së sendit”, gjersa në gjuhën angleze është “konfiskim”. Edhe në shqip e përdorim “konfiskim”, duhet të jetë “konfiskim”, pra masat mbrojtëse e sendeve të konfiskuara.

Pastaj në faqen tjetër, neni 11, titulli është “masat mbrojtëse pasurore”, kemi të bëjmë me pronë, jo me aset, po kemi të bëjmë me “property – proteheng, e tjera e tjera, tash po them mos t’i hy çdo fjale, çdo faqe, më falni, se ka shumë për t’u rregulluar kjo, mendoj po edhe shpresoj se në leximin tjetër komisionet gjegjëse do t’i kenë parasysh këto vërejtjet e mia. Faleminderit!

KRYESUESI: Mirë, faleminderit! Deputeti Hydajet Hyseni-Kaloshi e ka fjalën, të përgatitet deputeti Ardian Gjini.

HYDAJET HYSENI-KALOSHI: Faleminderit zoti kryesues!

Zonja e zotërinj deputetë,

Të nderuar ministra,

Zoti Kryeministër, zëvendëskryeministra,

Edhe unë i bashkëngjitëm atyre që e përshëndesin sjelljen në Kuvend të këtij ligji, e konsideroj të rëndësishëm, ndonëse nuk mund të pajtohem edhe me tendencat për ta ekzagjeruar fenomenin e dhunës në familje, shpesh në funksion të lehtësimit të përfitimeve të donacioneve për do projekte, herë të arsyeshme herë të paarsyeshme, ndonjëherë edhe nga qarqe të përziera të brendshme e të jashtme. Po e vërteta është se fenomeni i dhunës në familje është evident dhe ne duhet të përballemi me të. Ligji i sjell në Kuvend, është një kontribut i madh, mendoj i rëndësishëm edhe në parandalimin e dhunës në familje edhe në përpalljen me të, si të tillë unë e mbështes.

Por ligji është sponsorizuar nga Zyra e Kryeministrit dhe mendoj që këtu është rasti për të kërkuar që ligjet që sponsorizohen nga Zyra e Kryeministrit edhe të shërbejnë si model ndoshta edhe për ministritë se si bëhet ligji dhe kjo për fat të keq nuk ka ndodhur. Unë dua të tërheq vërejtjen sidomos për disa vërejtje që vazhdimisht bëhen në Kuvend dhe megjithatë nuk merren parasysh. Detyrohemi pastaj ose t’i gëlltisim disa anomali që duken nganjëherë edhe triviale, banale, ose të bëhemi edhe monoton duke i përsëritur ato.

Për shembull është thënë që ligjet në gjuhën shqipe të titullohen ashtu siç është në gjuhën shqipe, si duhet të titullohet, në emërore dhe në të pashquar – ligj dhe jo ligjin. S’mund të jetë titulli – ligjin. Shikoni për shembull në gjuhën angleze është saktë, në gjuhën serbe është saktë. Ose ta zëmë ajo që është bërë vërejtje sa e sa herë te përkufizimet gjithmonë e njëjta nënkupton edhe pse është sqaruar dhe askush s’e ka kontestuar se nënkupton nuk është shprehje juridike. Në serbisht është “znaçi”, në anglisht është “min....” dhe kjo është e saktë, pse të mos jetë edhe në shqip kështu?

Unë kam vërejtje madje edhe në vetë titullin kështu siç është edhe të korrigjuar – Ligj për mbrojtje nga dhuna në familje. Kam krahasuar me vende tjera, nuk e kanë këtë formë, sepse shtrohet edhe dilema Ligj për mbrojtje nga dhuna në familje, e kujt, e familjes nga dhuna në familje, si? Për shembull kam parë edhe këtë titull – Ligj për masat mbrojtëse kundër dhunës në familje, ka kuptim. Ligj kundër dhunës në familje ka kuptim, por së paku në titull do të duhej pak më shumë kujdes që titulli të jetë vërtet i përshtatshëm. Por vërejtjet e mia kanë të bëjnë edhe me, po e kaloj atë vërejtjen që e tha kolegu më përpara

për mospërputhje, shikoni ju lutem gjithë faqen 4 të Ligjit. Krahasoni vetëm në shqip, në serbisht dhe në anglisht. Është e çuditshme, në versionin shqip ka më së shumti pasaktësi dhe mosharmonizim me gjuhët tjera. Krijohet domosdo përshtypja se ligji është përkthyer nga ndonjë nga gjuhët e dyta dhe treta që janë në kolona këtu, në cilat janë të sakta, por në gjuhën shqipe jo. Unë kam parë edhe ndonjë ligj në gjuhën serbe apo gjuhët sllave të jugut dhe kam parë pastaj se në të vërtetë nuk është respektuar as ajo që është në Kroaci e në Bosnje e Hercegovinë, sidomos këto përvijat e Bosnjës janë shumë problematike kur vjen puna për implementimin në kushtet tona.

Megjithatë për mua është domethënëse, sidomos edhe synimi i ligjit për parandalimin e dhunës në familje, kurse nëse kemi parasysh faktin se ligjet bëhen për t'u zbatuar, për mua është e zorshme ta kuptoj si do të zbatohet një gamë aq e gjerë e fenomeneve që janë përfshirë këtu dhe nuk janë në ligjet tjera, krahasojeni ju lutem dhe do të bindeni? Do të ndodhemi pastaj në situatë ose të kemi ligjet të cilat nuk zbatohen, ose po të zbatohen ashtu siç janë shkruar, nuk do të ketë vende ku do të vendosen njerëzit që do të merren me mbrojtje ose do të trajtohen siç është thënë, sepse ligji edhe ka obligim trajtimin e atyre që janë pjesë e dhunës, rehabilitimin e tyre e tjera. Si zbatohet kjo? Është përfshirë ta zëmë kategoria e të fejuarve në familje. A janë të fejuarit pjesë e familjes? Nuk është në ligjet tjera. Pse të jetë te ne? Është e ngatërruar ma merr mendja me bashkëjetuesit dhe nëse është kjo atëherë mund edhe të korrigjohet.... Ose kur është fjala te masat, përshkruhen masa të rënda, për raste të veçanta edhe të justifikueshme për mendimin tim, por nëse nuk specifikohet në cilat raste ta zëmë mund të dëbohet dikush nga banesa, në cilat raste dikush mund të detyrohet që të paguajë qiranë për tjetrin e tjera, por kjo bëhet në mënyrë të përgjithsueshme dhe kjo i referohet të gjitha paragrafëve të pika e parë, praktikisht ligji bëhet i pazbatueshëm? Për të mos e zgjatur më shumë kam edhe shumë vërejtje tjera, konsideroj se Komisioni duhet të punojë shumë në përshtatjen e këtij ligji, megjithatë mendoj se ligji i duhet Kosovës dhe uroj që ai të përmirësohet dhe të miratohet në Kuvend sa më parë. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputeti Ardian Gjini e ka fjalën, le të përgatitet deputetja Drita Kadriu.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

Kryeministër,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Prapë, gjithsesi se e mbështes atë që tha në emër të Grupit Parlamentar, zonja Zylfije Hundozi, do të thotë edhe ne e votojmë ligjin si Grup edhe se është e domosdoshme për ta votuar, por prapë se prapë i kam disa pyetje unë, sikur zakonisht. Pyetja e parë është – a beson dikush që pasi që ta aprovojmë në këtë ligj dhuna në familje do të fillojë të ulët ose të zbutet? Unë dyshoj, dyshoj për shkak se Rregullorja e UNMIK-ut ka qenë në fuqi, Rregullorja e cila është përkthyer dhe po bëhet ligj, foli zoti Tali për përkthimin, e pata në plan po e sosi atë temë. Thotë a jo ka qenë në fuqi dhe kurrë s'ka ndodhur, realisht ka ndodhur ndonjë përmirësim i situatës te ne, njëjtë ka mbetur. Unë mendoj se sot ne, po edhe Qeveria e Kosovës e cila e ka hartuar këtë ligj e ka humbur shansin, e ka humbur shansin që shoqëria kosovare, shoqëria jonë për t' u marrë me këtë temë pak më seriozisht se sa që është marrë deri më tani. Ne e kemi kaluar ligjin krejt në rregull, ama shansin e kemi humbur. Çka po dua të them është kështu, është shumë stereotipe edhe e thjeshtë stereotipe kur prezantohet një ligj dhe, qoftë ministrat, qoftë zëvendësministrat, fillojnë me atë dhe thonë i ka 30 nene. Hiqni këto 30 nene ministër, e ki atë... hiqni 30 nene se e dimë ne sa nene i ka ligji se e marrim, e kemi përpara, i ka 30 nene 2 kapituj, është sa për ta mbushur kohën, për të humbur kohë duke thënë diçka. S'ka nevojë të na

kallëzoni sa nene i ka projektligji, por çka kemi nevojë ne si Kuvend është një studim, studim për krejt ligjet të cilat na vinë neve këtu, do të thotë, një studim pse hartohet ligji, çka synohet të bëhet me atë ligj edhe studimet të cilat na tregojnë neve se cila është situata aktuale, të paktën t'i referohen studimeve? Unë nuk dëgjova se dikush iu referua një studimi shembull ta marrim çështje kualitative jo vetëm statistikore, por kualitative, një studim kualitativ se statistikor nuk po i paraqesin njerëzit dhunën në familje, ne e dimë. Nuk besoj se ka njeri në Kosovë që nuk është ballafaquar me dhunë në familje, ndoshta jo personalisht po e keni parë ndonjë kolege që vonohet dy ditë dhe kur të del thotë jam rrëzua, ose e keni ndie edhe në restorant kur iu drejtohen bashkëshortët njëri-tjetrit me ato fjalët fyese që i përmendi shumë bukur zoti Hydajet Hyseni. Ne e kemi parë , na ballafaqohemi me këtë punë. Problemi është se nuk na pengon. Shumicën prej nesh nuk na pengon ky fenomen hiq edhe meqenëse nuk na pengon atëherë vetëm e bimë një ligj e përkthejmë dhe e provojmë me adoptua. Kjo tash ka qenë në projektligj shans që Kosova me u marrë me këtë temë. Një prej arsyeve që dola në foltore është kjo, është temë tepër serioze, është tepër serioze, nuk është temë vetëm për të diskutuar se ka dhunë në familje dhe a po reflektojmë sot... Po pyes me sinjeritetin më të madh, a po reflektojmë ne sot, Kuvendi i Kosovës dhe Qeveria e Kosovës a po reflektojmë me seriozitetin e kësaj teme? A ka bërë studim Qeveria e Kosovës pse ndodh dhuna në familje? Nuk jemi duke folur ne për dhunën sikur në Britani të Madhe ose në Suedi ku një tip me probleme psikopatike shkakton dhunë në familje. Jo, ne kemi problem me diçka tjetër, ne kemi problem se jemi pjesë e Ballkanit, kemi problem me do aspekte kulturore. Njerëzit janë mësuar dhe nuk iu pengon. A kemi ndonjë studim çka shkakton kjo dhunë në familje, çfarë niveli të kriminalitetit shkakton në shoqëri, çfarë niveli i delikuençës, çfarë frike shkakton te njerëzit, çfarë pasigurie? Rrisim njerëz të pasigurt, se e shohin dhunën në familje. Nuk i kemi parë këto. Nuk i kemi parë këto studime. Në fakt se t'i kemi këto studime ose referim të studimit kemi dëgjua sa nene i ka projektligji. Ju lutem, mendoni edhe vetë se çka është duke ndodhur? Çështje tjetër është, domethënë, e përmenda atë studimin kauzal pse, çka shkakton dhunën? Nuk e kemi, domethënë, dhe.... nuk mjafton që të merren u vetëm disa OJQ me këto studime. Nëse Qeveria e Kosovës e kupton çfarë problemi afatgjatë është për vendin tonë, atëherë ka qenë dashur, të paktën ta provojë , ta bëjë një studim çka e shkakton, cilat janë pasojat dhe cila duhet të jetë strategjia afatgjate? E di që nuk rregullohet kjo në afat të shkurt, kur s'kemi as iluzion, në afat të gjatë.

Çështje tjetër e fundit për këtë afatgjatë që po e përmend është, i kemi parë disa postera, disa bilborda të cilët i thonë - stop dhunës në familje. A ju kanë dukur edhe juve qesharakë? A mendoni ju se dikush që shkakton dhunë në familje do të ndalët pse e sheh një poster kur shkruan aty -stop dhunës në familje? Mua s'ma merr mendja. Nëse dikush beson, është krejt në rregull.

Në fund të fundit, pyetja është, domethënë, si ndihen njerëzit të cilët janë abuzuar si e ndiejnë veten? Si ndihen në shoqëri, si ndihen gjithkund? Edhe sinjerisht a besojnë ata kur të na dëgjojnë neve që në Kosovë dikush shumë seriozisht po merret me këtë punë.... është kah kalon edhe një ligj, shkon ky ligj atje dhe nëse e respektojmë strikt, qysh foli zoti Hyseni, mendoj se s'kishin për të na dalë burgjet dhe do të ishin mbushur gjykatat me lëndë, se është diçka shumë e përhapur.

Përfundimisht edhe një herë, po e thërras Kuvendin e Kosovës, Qeverinë, po e thërras krejt Kosovën për të mos e kaluar vetëm një ligj. Shans na ka ikur, por të provojmë ta kthejmë këtë shans që Kosova të merret pak më shumë me këtë problem, është tepër

serioz, nuk është problem i thjeshtë. Ka të bëjë në esencë me të ardhmen e vendit tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Drita Kadriu, të përgatitet deputeti Riza Smaka.

DRITA KADRIU: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zoti Kryeministër, ministra,

Kolegë deputetë,

Meqenëse koncepti për të cilin do të flas ka një përmbajtje shumë konkrete para se të vazhdoj do t'i kisha sugjeruar komisionit që harton Rregulloren e Punës të Kuvendit që mundësisht deputetët të na ndajnë në dy kategori – deputetë të mësuesve deputetë dhe deputetë të mësuesve të Qeverisë. Faleminderit për parafolësin!

Me rastin e shqyrtimit të projektligjit mjaft të rëndësishëm për mbrojtje nga dhuna në familje unë do t'i jap disa sugjerime konkrete në këtë projektligj. E para, meqenëse në memorandum shpjegues nuk ka asnjë shifër ose të dhënë që informon për shkallën e dhunës në familje duke qenë se deri më tani disa organizata jo qeveritare, por edhe vetë Agjencia për Barazi Gjimore kanë punuar në këtë fushë, mendoj se kjo mangësi ka bërë të pamundur që të përcaktohet kostoja e ligjit e që kjo do të ndikojë konkretisht në zbatimin e ligjit.

E dyta, Ligjin e përshkruajnë aline, që përcaktojnë detyrat e gjykatave e që mendoj se më mirë është t'i referohen ligjeve që rregullojnë fusha të caktuara për këto veprime.

E treta, neni 10 duhet të riformulohet sepse nuk është në kohezion me përkufizimet e nenit 2.

E katërta, te pika 1.2 e nenit të 2-të të përkufizimeve – pala e mbrojtur, përmendet fjala “vartës” në vend që të përdoret, kishte qenë shumë më në rregull “anëtarët e familjes”, sepse nuk besoj që në familje konsiderohen anëtarët si vartës.

Dhe, e fundit, te neni 27 ku përshkruhen qëllimet e programit të Kosovës kundër dhunës ë familje- është- propozoj t'i shtohet një aline me këtë përmbajtje:

“Programi i Kosovës kundër dhunës në familje ka për qëllim vetëdijesimin dhe edukimin e qytetarëve për ngritjen dhe zhvillimin e vlerave demokratike në familje”. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit deputete!

Fjalën e ka deputeti Riza Smaka, të përgatitet deputetja Donika Kadaj.

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri kryesues!

I nderuar zotëri Kryeministër, zëvendëskryeministër, të nderuar ministra,

Të respektuar deputetë,

Se ka dhunë në familje në Kosovë, në Kosovën tonë është e padiskutueshme, ka. Po ju lutem t'ju them edhe këtë që e di secili prej neve, ka dhunë në familje kudo. Ne me disa kolegë kemi qenë para dy ditëve në një udhëtim studimor në Mbretërinë e Bashkuar. Ishte aktual, kjo më intereson mua nga sfera e jurisprudencës, ishte një litigacion, domethënë, proces juridik civil shumë tronditës që me bisht të kazmës e kishte maltretuar burri gruan një kohë të gjatë e tjera, e tjera. Domethënë, ka edhe në Mbretërinë e Bashkuar se le më në Kosovë. Ama në Kosovë kjo është çështje pothuaj se e shumë e

shpeshtë dhe në forma më se drastike. Prandaj, ju lutem në kontekst me disa pikëpamje.... që mund të rezultonte se s'paska nevojë për ligj. Për ta luftuar dhunën në familje dhe kundër familjes duhet ta luftojmë në konformitet me ligjin. Nëse do ta kishim luftuar në mënyra tjera do të kishim dhunë prapë, prandaj veprimet kundër dhunës në familje në konformitet me ligjin nuk janë dhunë, por janë kundër dhunës. Prandaj ky ligj është i nevojshëm dhe i domosdoshëm dhe bile këtu në këtë kontekst kam kënaqësinë ta them se e kam iniciua këtë çështje unë, Kryesia e Kuvendit e ka miratuar, i ka preferuar Qeverisë dhe e përshëndes Qeverinë që e ka miratuar dhe ka përgatitur këtë dokument dhe e ka sjell para nesh këtë dokument.

Këtij dokumenti, në parim disa vërejtje. I mungon komponenta e autorizimeve ekzekutive, kryesisht çështjet po e zëmë të dhunës në familje i referohen gjykatës. Ne e dimë, sot mjerisht gjendja është e tillë, gjykatat janë in-efikase, krejtësisht. Janë mbi 250 mijë lëndë të pakryera, të paprekura me dorë, prandaj në qoftë se do ta lëshim këtë ligj kësaj të miratohej, do të thotë me të vërtetë do ta bëhim një ligj të mirë dhe me atë do të përfundonte seanca, sepse asgjë prej asgjëje nuk do të rezultonte, synimi i ligjit nuk do të sendërtohej. Prandaj unë angazhohem që, jam i bindur se do ta kemi përkrahjen e shumicës së paku, që të bëjmë, të gjejmë zgjidhje alternative, që po e zëmë disa entitete këtu që janë identifikuar në këtë dokument, bie fjala përfaqësuesi i autorizuar dhe mbrojtësi i viktimës, të kenë, me ligj do t'i kishim bërë amendamentet që duhet të kenë ingerenca edhe autorizime dhe juridiksion për të miratuar masa mbrojtëse ekzekutive se jo bie fjala e merr e çdo dikë deri në polici e jep një deklaratë dhe e kthen, ai më pastaj e vazhdon dhunën, superdhunën, ekstradhunën. Prandaj do të bëjmë aso... Mendoj se kjo mungon dhe këtë duhet ta bëjmë përmirësim, në parim po flas apo jo. Dhe, duhet ta komponojmë, ta integrojmë komplet një kaptinë, masat ndëshkimore. Pa masa ndëshkimore ky nuk do të ishte ligj, do të ishte grumbull i normave morale, të karakterit etik, duhet s'duhet, s'është mirë, është mirë, bën s'bën e tjera, e tjera.

Te neni 29, konkretisht po e zëmë ka shumë vërejtje të ndryshme, në terminologji aty, disa kolegë me vend i shtruan, nuk do të ndalem në to, se mjerisht kjo është një dukuri. Kjo është tepër keq zotëri Kryeministër, po na vijnë këto dokumente me të vërtetë dobët të përgatitura. Se çka është në pyetje, analizoni mirë, është mirë t'ia dedikoni një pikë të rendit të ditës çështjes, këto dokumente janë me të vërtetë, ama çdo nen ka gabime gjuhësore. Qysh, po sikur të ishin të huaj ata që e shkruajnë gjuhën shqipe. Bile njërën gjuhë ta shkruajshin mirë, po në asnjë gjuhë nuk është, as në shqip as në anglisht. Me të vërtetë këtë, nëse e gjeni të arsyeshme kishim me gjetur një termin dhe të shkojmë me dhjetëra e dhjetëra shembuj. Bie fjala ky ligj shfuqizon Rregulloren e UNMIK-ut dhe pikë. Po ky nuk është për ta shfuqizuar atë, po ky është për të hyrë në fuqi e hyrja e tij në fuqi e shfuqizon rregulloren dhe të gjitha dispozitat që ishin në aplikim e që do të ishin në kolizion me këtë.

Edhe ta them edhe këtë se ekziston një varg i vërejtjeve në shprehjet që nuk janë të karakterit juridik, terminologjik. Unë shpresoj se këtë do ta përmirësojmë në procedurën e ardhshme dhe ky ligj duhet të mbështetet, miratohet dhe më pastaj të presim që me akte nënligjore të precizohen shumë çështje dhe që të aplikohet.

Më lejoni zotëri kryesues edhe këtë, po kam dëshirë që është këtu edhe zotëri Kryeministër, që është kompetenti për ekzekutivin e Kosovës. Është mirë që krahas përgatitjes së projektligjit, ministrat respektiv, t'i përgatisin aktet normative nënligjore. Dhe tash po e zëmë në qoftë se pëson ky dhe duhet të pësojë në ato pika të amendamenteve, atëherë veç do t'i kishte bërë ndryshimet dhe do të ishin miratuar ato

aktet nënligjore se pa ato nuk mund të aplikohet praktikisht ligji. E kishim një rast atje, ku ishte dhënë aty komoditeti që brenda 2 vjetëve, brenda 3 vjetëve aktet nënligjore. Dhe, mos të bëhet ajo, bie fjala miratohet ligji brenda një muaj dite ministri që do të ishte plot energji dhe shumica janë të tillë që kam respekt të sinqerta, që do t'i kishin bërë ato akte nënligjore dhe do të ishte aplikuar ligji. Fundi i fundit, krejt këtë punë e bëjmë për tu aplikuar ligji. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit deputet! Fjalën e ka deputetja Donika Kadaj, të përgatitet deputetja Flora Brovina.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit i nderuar kryesues,

Kolegë deputetë,

Përfaqësues të Qeverisë,

Janë dy aspekte realisht të cilat duhet t'i rregullojë ky ligj dhe cilat është provua që t'i rregullojë por në fakt ka mangësi të shumta dhe do të provojmë të kontribuojmë në përmirësimin e tij duke ditur rëndësinë për qytetarët e Kosovës.

E para, është funksionimi i rendit dhe ligjit, realisht funksionimi i mekanizmave shtetëror siç janë policia dhe gjykata, pa të cilat ky ligj do të mbetet veç i shkruar në letër dhe asnjëherë nuk do të zbatohet.

Dhe, pjesa e dytë po e rëndësisë së veçantë është realisht funksionalizimi i qendrave apo strehimoreve për rehabilitimin e viktimave. Unë dua të them që si Grup i Grave Parlamentare nga të gjitha partitë politike kemi bërë vizita në terren të qendrave ku janë në rehabilitim e sipër viktimat e dhunës dhe nga vizitat në terren që i janë bërë këtyre qendrave është konfirmuar dyshimi që trajtimi i dhur i viktimave të dhunës familjare mungon dhe kjo për dy arsye. E para mungesa e kapaciteteve profesionale dhe e dyta mungesa e kushteve infrastrukturore nëpër qendra. Dhe, ajo çka po vërehet në këtë projektligj është se as tani nuk e kemi të specifikuar mënyrën e financimit të këtyre qendrave. Do të thotë janë dy aspekte kryesore të cilat nuk janë fort qartë të specifikuara në këtë ligj se si do të rregullohen. Domethënë nuk është paraparë rritja e kapaciteteve të strehimoreve dhe përkrahja financiare nga Qeveria e Kosovës. Ne propozojmë që të jetë një modul 51% të mjeteve të financohet nga Qeveria e Kosovës në mënyrë që këto qendra dhe strehimore më tutje të mos mbesin nën mëshirë të donatorëve sepse dihet që donatorët dhe donacionet në Kosovë përditë janë më të pakta, prandaj duhet të kemi një rregullim shtetëror në mënyrë që të kemi një zgjidhje adekuate dhe tu ofrojmë tretman afatgjatë viktimave të dhunës në familje. Domethënë ligji nuk argumenton të rregullojë qëllimin kryesor që është krijimi i mekanizmave për rehabilitimin e viktimave si dhe hartimin e programit kundër dhunës në familje.

Për fund, ka edhe mungesë të fakteve, do të thotë informatat e cekta kanë bërë që kostoja buxhetore që bartë implementimi i ligjit të paraqet pasiguri ose paqartësi rreth sigurimit të mjeteve për zbatim. Nuk është e qartë se nga cilët sektorë do të bëhet zbatimi i këtij ligji. Domethënë përmenden diku në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies që janë dedikuar 400 mijë euro për këtë qëllim, mirëpo nuk është specifikuar se, do të thotë, a do të shkojë kjo për qendra dhe strehimore, cilat do të jenë ato apo do të na ndodh ndonjë keqpërdorim sikurse me rastin e të kthyerve nga Gjermania. Po ju kujtoj verën e kaluar kur janë financuar përmes disa OJQ-ëve dhe ka ndodhur që qytetarët e Kosovës janë kontrabanduar brendapërbrenda Kosovës, kemi pasur shumë spekulime, ku janë ata njerëz dhe në fund ka ardhur në përfundim që dikush nga disa OJQ shumë të çuditshme ka marrë mjete nga buxheti i Kosovës për të ashtuquajtur rehabilitim dhe përkujdesje

ndaj këtyre njerëzve. Nuk kisha dashur që viktimat e dhunës për t' u ballafaquar me dhunë të mëvonshme, e cila vjen në mungesë të zbatimit të këtij ligji dhe në mungesë të gatishmërisë të shtetit që t'i përkrahë. Prandaj kërkoj që këto sugjerime që i dhamë, do të thotë, me fokus të veçantë në fuqizimin e strehimoreve dhe qendrave të merren parasysh nga Qeveria e Kosovës dhe të zbatohen përmes... apo të, në një formë, plotësohet ligji, me një specifikim të qartë për këto qendra. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Flora Brovina, të përgatitet deputeti Adem Hajdaraj.

FLORA BROVINA: Zoti kryesues,
I nderuari Kryeministër, zëvendëskryeministër,
Zotëri deputetë, kolegë,

Më vjen mirë që sot po diskutojmë për një çështje shumë të rëndësishme dhe që një ligj i rëndësishëm në mbrojtjen e të drejtave të njeriut do të aprovohet në Kuvendin e Kosovës e kjo është mbrojtja e viktimave ndaj dhunës në familje, një ligj që ka dashur të vijë edhe më herët pasi që fenomen i dhunës në familje, sado që nuk është karakteristik vetëm për shoqërinë tonë, ai ekziston dhe ne kemi prostitucion, kemi trafikim të qenieve njerëzore, incest, edhe ne kemi përbuzje në familje, kemi ofendim, rrahje ose torturë dhe shumë çështje tjera që lajmërohen, sidomos tani kur shoqëria dhe familja po pëson transformim.

Ligji që ndodhet para nesh ka qenë shumë i mirëpritur, por pas leximit të parë të këtij ligji më duket se ai nuk i plotëson të gjitha kërkesat dhe nevojat për këtë çështje, sepse ligji merret me një komponentë më shumë dhe me të tjerat shumë pak, e kjo është komponenta më e dobët në shoqërinë tonë dhe e cila nuk ka funksionuar edhe me Rregulloren e UNMIK-ut e është gjyqësia. Ligji parasheh gati 80% obligimet që i ka gjyqësia. Është e vërtetë se gjyqësia duhet të ishte më efikase sa i përket dhunës në familje dhe ajo nuk i është përgjigjur deri tash kësaj çështjeje, shpeshherë dhunuesi nuk është dënuar fare dhe viktimat është dhunuar për të dytën herë, para gjykatësit, duke u munduar që ta dëshmojë dhunën që i është shkaktuar. Por kujtoj se ka qenë dashur që edhe komponentat tjera efikase t'iu kushtohet një vëmendje më e madhe ose 'u jepet përgjegjësi më e madhe. Pikërisht po flas për Policinë e Kosovës e cila ka shumë merita që deri tani ka arritur besueshmërinë e viktimës, sepse viktimat ka një adresë kujt t'i drejtohet, domethënë, një adresë dhe ajo është përgjigjur shumë në mënyrë të mirë. Disa shtete madje Policisë ia kanë dhënë obligimet që të përgjigjet për tërë ligjin e dhunës ndaj familjes, për shembull në Zvicër dhe kjo funksionon në mënyrë shumë efikase.

Në anën tjetër, një komponentë që nuk është theksuar sa duhet është çështja e preventivës. Ligji merret me preventivën, por nuk i cakton detyrat dhe bartësit e detyrave të preventivës. Dhe, këtu e kam parasysh edukimin këshillimor, hapjen e këshillimore para martesore se ne po formojmë një shoqëri të re, pastaj këshillimoret për martesat dhe sistemin e ndërhyrjes ose të pajtimit në konfliktet martesore, prandaj po na ndodhin edhe çështje të cilat nuk kanë qenë dukuri në familjet tona.

Një dukuri tjetër që nuk theksohet këtu është çështja e dhunës ndaj moshës së tretë, një fenomen jo karakteristik për shoqërinë tonë të kaluar, por i shfaqur për herë të parë. Sigurisht ky ligj parashtron nevojën për shumë amendamente, për diskutime dhe debate pas kësaj seance, por edhe nevojën e ndryshimit të ligjit penal. Gjithashtu, kërkon nevojën e formimit të Institutit për Çështje Gjinore dhe për Familjen për t'u marrë me fenomenin çka po ndodhë me familjen dhe në mungesë të Ministrisë për Çështje Gjinore dhe për Familjen, që e kanë disa shoqëri të avancuara dhe që kanë pasur mundësi të

kenë më shumë ministri. Gjithsesi që neve do të diskutojmë dhe do ta plotësojmë duke e përkrahur këtë fazë të miratimit të ligjit, ne do ta plotësojmë ligjin më tutje si Grup Parlamentar i Grave të Parlamentit të Kosovës, së bashku me shoqërinë civile dhe me gjithë mekanizmat tjera që funksionojnë për këtë çështje. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputete!

Fjalën e ka deputeti Adem Hajdaraj, të përgatitet deputeti Gani Buçinca.

ADEM HAJDARAJ: Zoti kryesues,

Deputetë të nderuar dhe Qeveri,

Unë pikësëpari dua të them se kam kënaqësinë pse sot është aq e durueshme Qeveria dhe rrinë me ne këtu, se shpeshherë po ngjet që të mbeten vetëm nga dy ose një ministër dhe të flasim ne kot. Prandaj, për sa i përket ligjit, do të përpiqem të jap ndihmesën time sado të vogël përkitazi me këtë dhe po them qysh tash se ligji duhet të kalojë në lexim të parë, pavarësisht nga mangësitë që i ka dhe që i theksuan deputetët e mëparshëm.

Po një gjë që dua ta theksoj këtu është çështja e titullit të ligjit që unë po përpiqem ta them pak më mirë këtë titull. Titulli do të ishte sipas mendimit tonë – Projektligji për parandalimin dhe mbrojtjen e familjes nga dhuna, jo dhunës nga familja dhe kjo pjesa parandalimin e kupton edhe preventiven që e përmendën këta, domethënë, ato masat e përparshme që mos të vijë deri te dhuna, sepse kur vjen te dhuna tani s'ke çka bën. Domethënë, gjithkund masat parandaluese janë shumë të rëndësishme dhe duhet të theksohen me ligj.

Çështja tjetër është ajo dilema ime se a thua ia kemi përshtatur rrethanave në Kosovë këtë ligj? Jo nga aspekti se nuk duhet ligji sepse e tumir dhe ka dhunë në familje që është shumë e theksuar këtu, por modelet nga shtetet tjera, domethënë, nuk janë në përputhje të plotë me atë që është në Kosovë, qoftë nga shkalla e lartë e dhunës, qoftë edhe nga shkalla më e ulët e dhunës. Çështje tjetër që unë mendoj, neni 22 ta zëmë thotë: “Urdhri për mbrojtjen e përkohshme emergjente” dhe po të lexohen këto pika 1, 1, 1, 2 e tjera e tjera, paragrafë del se ai dhunuesi ose i supozuari për dhunë ose i dyshuari për dhunë, se deri sa të dënohet nuk është, nuk mund të merret me ligj si i tillë, lëshohet në shtëpi pa u mbajtur 30 ditë. Çka u bë aty? Domethënë duhet ai 30 ditë t'i bëjë aty nëse konstatohet dhe dyshohet se ka bërë dhunë, qoftë edhe në familje.

E treta çështje është shumë me rëndësi që më duket mua, ndoshta nuk është për dikë, por për mua është te marrëdhëniet familjare, neni 3, shkruan me pikën 1.1. marrëdhënie familjare dhe nëse krahasohet me tekstet në anglisht dhe serbokroatisht shihet se është përkthim, siç thanë edhe disa kolegë të nderuar, përkthim i drejtpërdrejtë. Për shembull thuhet këtu – “marrëdhënie familjare konsiderohen personat nëse”, domethënë me kusht, “nëse janë të fejuar apo janë ose ishin të fejuar”, e në serbokroatisht “ako su vereni ili su bili vereni” krejt përkthim. Këtu nuk duhet nëse, por duhet të jetë “marrëdhëniet familjare konsiderohen me një fjalë lidhore, ato të cilat, këtë, këtë, këtë, këtë e jo nëse. E dyta, nuk ma thotë mendja, nuk jam plotësisht i bindur se është thënë mirë në këto pika “janë të fejuar apo ishin të fejuar”. Nuk krijohen marrëdhëniet familjare nëse ishin të fejuar, për mendimin tim. Nuk janë marrëdhënie familjare ato më. Janë të martuar apo ishin të martuar. Nuk janë marrëdhënie familjare edhe pse ai që është martuar nëse ka lënë fëmijë, ka obligime për fëmijë e tjera, e tjera, por nuk janë marrëdhënie më familjare dhe kjo po ma merr mendja se duhet të formulohen më mirë, të eliminohen deri në leximin e dytë. Sa për “nënkupton” edhe këtu që po përdoret dhe thanë, 100 herë po themi po e njëjta gjë. Dhe, në fund vetëm neni 1, ju lutem ta shihni se si është formuluar, as

gjuhësisht as në mënyrë të ligjshme nuk është në rregull, nesër nuk do të di gjykatësi çka do të bëjë me këtë nen. Qe, po e lexoj: “Qëllimi i këtij ligji është mbrojtja nga dhuna në familje me anë të masave të posaçme ligjore”. Tash nëse thua me anë të masave, po mirë është thënë nga dhuna në familje, po me anë të masave të posaçme, mandej kalon në dhanore krijimin, krijimin e mekanizmave, e tjera, e tjera. Këto dy fjali në këtë periudhë nuk janë lidhur mirë dhe nuk e kanë kuptimin, sepse është shpërputhje e rasave, është shpërputhje e mendimeve dhe duhet ndryshe. Do ta shohim atje në komision ose diku, do të përpiqemi ta japim kontributin tonë që kjo të formulohet më mirë. Jo vetëm kjo, por edhe çështje tjera që janë më tutje... Ju faleminderit!

KRYESUESI: Dhe vazhdimisht po kemi të lajmëruar për fjalë. Fjalën e ka deputeti Gani Buçinca, të përgatitet deputetja Nekibe Kelmendi.

GANI BUÇINCA: Ju falënderoj zoti kryesues për fjalën e dhënë!

I nderuar Kabinet qeveritar, dhe ju kolegë deputetë,

Padyshim ligjin të cilin po e trajtojmë sot është i një rëndësie të veçantë dhe siç u tha këtu pajtohem me të gjithë dhe shënon një ngjarje të veçantë, ndoshta edhe vetë për punën e Parlamentit, për arsye se ligji prek një sferë shumë të ndjeshme të jetës emocionale të qytetarëve të Kosovës. Padyshim, fenomeni i dhunës prek të gjitha shtresat e shoqërisë duke filluar nga fëmijët, gratë, pleqtë, moshat dhe gjinitë, të gjitha. Dhe, është një prej ligjeve që ndoshta duhet trajtuar me shumë ndjeshmëri dhe duhet pasur kujdes sidomos në zbatueshmërinë e këtij ligji dhe krijimin e institucioneve përkatëse të cilët do të bënin të zbatueshëm dhe do të parandalonin dhunën në familje.

Ligjit i mungojnë disa aspekte, sidomos i mungon aspekti i parandalimit të dhunës, i cili do të duhej që në ligj të ishte shumë më qartë i definuar, ndoshta më shumë se vetë trajtimi i viktimave të dhunës në familje. Në shoqëritë tashmë moderne evropiane ekzistojnë institucione të ndryshme të cilat problemet familjare që në shfaqjen e tyre – problemeve familjare, qoftë bashkëshorti, qoftë fëmija, qoftë babai apo gruaja ka ku të drejtohet dhe të paralajmërojë fazën kur familja fillon të dezintegrohet ose kur ka probleme familjare, qofshin të natyrës sociale, qofshin të asaj emocionale.

Dhuna në familje zakonisht paraqitet në ato familje ku vështirësitë ekonomike janë shumë të mëdha, do të thotë, mungesa e mjeteve të jetesës në familje, pastaj konsumimi emocional i lidhjes martesore dhe sidomos në ato familje ku njëri prej bashkëshortëve vuan nga ndonjë patologji sociale ose nga ndonjë shprehi e keqe siç janë: alkooli, tradhtia në familje, bixhozi e shumë shprehi të tjera. Krijimi me këtë ligj i institucioneve ku njëri nga bashkëshortët ose vetë familjarët, fëmija do t'i paralajmëronte këto probleme në familje duke u siguruar edhe privatësia e familjes, për arsye se një problem që duhet të kemi parasysh, megjithatë duhet pasur kujdes kur aprovojme ligje – a do të mbrohet privaciteti i familjes që është megjithatë shumë sferë e ndjeshme emocionale?

Unë besoj se ligji në procedim të mëtutjeshëm do të pësojë ndryshime, do të pësojë plotësime dhe do të bëhet një ligj i cili do t'i përshtatet edhe kushteve tona në Kosovë, që të ndryshojnë rrënjësisht nga kushtet e shteteve euro-perëndimore. Duhet pasur parasysh tipet e familjeve në Kosovë, çfarë janë ato. Ne në Kosovë ballafaqohemi me një tip të familjes ekstreme tradicionale, një familje gjysmë-tradicionale dhe një familje demokratike që shfaqet në pjesët urbane ku në sociologji trajtohet si familje demokratike, ku individualiteti i pjesëtarëve të familjes është shumë më i madh dhe ku respekti i ndërsjellë është shumë më i madh dhe kur toleranca ndaj karaktereve të individëve, të pjesëtarëve të familjes është shumë më e madhe.

Duke pasur parasysh këto rrethana sociologjike, kulturore dhe ekonomike në Kosovë ma merr mendja se ligji ka nevojë të shqyrtohet mirë në Komisionin funksional, të konsultohen sociologë – psikologë dhe t'i kemi parasysh të gjitha rrethanat që janë këtu dhe ligji të bëhet një ligj i aplikueshëm dhe një ligj nga i cili do të përfitojë familja si një institucion shoqëror. Gjatë amendamentimit të ligjit duhet pasur parasysh që ky ligj nuk duhet të stimulojë dezintegrimit e familjes por përkundrazi duhet t'i ketë ato dispozita ligjore dhe ato institucione profesionale të cilat bëjnë përpjekje edhe pas shfaqjes së dhunës në familje që familjen prapë ta ruajë, të arrihet pajtueshmëri në mes aktorëve të dhunës në familje, që megjithatë familja të riparohet nga aspekti emocional dhe familja të ruhet. Çdo dezintegrimit i familjes paraqet probleme të mëdha dhe dezintegrimit... së familjeve që është si fenomen i shoqërive moderne e traumatizon mjaft shoqërinë. Dhe, në këtë kuptim unë besoj që ky ligj do të ketë përmirësime dhe ekziston vullneti i mirë edhe në Parlament, po edhe në Komisionin funksional që ligji vërtet të jetë i zbatueshëm dhe të jetë i dobishëm dhe në funksion të ngritjes së përgjithshme të kulturës dhe edukatës në përgjithësi në Kosovë. Ju falënderoj për vëmendje!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Nekibe Kelmendi dhe i fundit të përgatitet deputeti Bahri Hyseni.

NEKIBE KELMENDI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar zëvendëskryeministër, ministra,

Mendoj se sot para nesh kemi një ligj të një rëndësie të veçantë për faktin se shumë çështje që ndërliken me këtë ligj janë të evidentuara si sfidë në Raportin e progresit të vitit 2009, për Kosovën.

Para se gjithash, rëndësia e këtij ligji qëndron në atë se ne tani po bëjmë një ligj tonin, ligj vendor, që do të thotë nuk po e zbatojmë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji një rregullore të UNMIK-ut, e cila nuk e ka rregulluar në tërësi këtë materie, këtë fushë, pra fushën e dhunës në familje, por vetëm në mënyrë parciale apo sipërfaqësore. U përmend këtu çështja e strehimit dhe vizitat që janë bërë në disa strehimore. Unë ju them se ne kemi strehimore të cilat janë institucionale, udhëhiqen nga institucionet, konkretisht nga Divizioni për Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit dhe të Dhunës në Familje në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë. Në 5 qendra të Kosovës ekzistojnë këto strehimore. Ajo që nuk është e kënaqshme është se këto strehimore nuk janë të ndërtuara sipas standardeve dhe disa bile-bile janë të vendosura edhe në shtëpi private. Do të ishte shumë e preferueshme dhe shumë e mirë dhe unë kam kërkuar edhe mjete nga IPA programi që ta ndërtojmë një strehimore në Prishtinë si qendër e pastaj të kemi edhe në disa degë nëpër qendra të tjera të strehimoreve. Në strehimore punon psikologu, pedagogu, aty ruan policia pa uniformë për 24 orë, përkujdeset për viktimat e dhunës në familje, përveç viktimave tjera që thash, të trafikimit e tjera, kështu që strehimi që është bërë në organizata joqeveritare është strehim që udhëhiqet prej atyre organizatave e që ato financohen nga donacionet. Strehimi institucional financohet nga Qeveria.

U përmend këtu se duhet të ndërhyhet me qëllim të pajtimit. Ne tash nuk po i riparojmë marrëdhëniet që janë çakorduar kushtimisht po them, marrëdhëniet e prishura brenda familjes, por po merremi me dhunën në familje dhe dhuna në familja, u përmend këtu, nuk po parashihet parandalimi. Çka do të thotë tjetër pos nëse nuk konsiderohen sanksionet dhe të gjitha masat që janë paraparë me këtë ligj ndaj kryerësit të dhunës, ushtruesit të dhunës në familje, pos parandalim, sikur të sanksionet penale, që sanksionet

penale nuk kanë për qëllim vetëm hakmarrjen ndaj individit, por ato veprojnë edhe në mënyrë preventive dhe pastaj me këtë ligj ne po merremi tani me pasojat. Ministria e Drejtësisë, të gjitha rastet e dhunës në familje jo vetëm që i strehon aty që është e nevojshme kur rrezikohet personi që është viktimë, por ajo ndihmon edhe në përfaqësim falas nëpër gjykata. Përveç këtij ligji me problematikën familjare merren ligjet tjera të pajtimi nëse bën për ruajtjen e martesës, është qendra për punë sociale e cila brenda afatit prej 6 muajsh bën provë t'i pajtojë bashkëshortët dhe atëherë kur nuk mund t'i pajtojë për 6 muaj, atëherë vendosin vetë bashkëshortët për fatin e tyre, për fatin e martesës e tjera, e tjera.

Dhe si përfundim konsideroj se ky ligj është ligj i shkruar dhe përmbajtja e tij plotësisht në harmoni me standardet ndërkombëtare. Shërbimi që punon te ne ka marrë pjesë në hartimin e këtij ligji dhe ai i ka pasur modelet dhe praktikën, i ka marrë praktikën e vendeve më të zhvilluara me rastin kur ka dhënë kontributin në hartimin e këtij ligji. Duhet t'i dallojmë raportet familjare, ligjin për familjen dhe këtë si dhunë, si një diçka që nuk është e lejueshme, prandaj mendimi im është që ky ligj duhet të kalojë në lexim të parë, unë e mbështes dhe do ta jap votën time. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuari zëvendëskryeministër, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Do të jem shumë i shkurtër, mirëpo meqë shumica e deputetëve diskutuan që projektligji në titull të ketë parandalimin, konsideroj që u dha një qartësim nga Ministria e Drejtësisë sepse qëllimi i ligjit nëse është kuptuar drejtë i ka dy aspekte, dy qëllime. Qëllimi i parë është për ta sanksionuar dhunën në familje, që është objektivë dhe është çështje parimore, sepse për këtë po e nxjerrim ligjin, kurse qëllimi tjetër është, përveç duke sanksionuar ato të cilat shkaktojnë dhunë në familje kryen preventivë për të tjerët që të mos përsërisin veprat. Prandaj ligjet nuk mund të nxjerrën me preventivë, por ligjet nxjerrën për ta normuar një çështje që të jetë preventivë të mos përsëritet në të ardhmen. Është çështja e parë.

Çështja tjetër me interes është ndoshta... Këtu është diskutuar edhe për çështjen se kur konsiderohet vepër penale e kështu me radhë. Kjo çështje edhe po të mos ishte paraparë fare kjo është e paraparë në Kodin penal dhe ne nuk po nxjerrim ligj për me emërua tash një vepër penale me këtë ligj sepse dhuna mbi familjen është e paraparë në Kodin Penal dhe ajo është dënuar edhe deri më tani, por ne po e nxjerrim një ligj për t'i plotësuar standardet dhe ndoshta për t'i identifikuar edhe disa çështje të cilat në Kodin Penal janë paraparë në mënyrë gjenerale, ne kemi shkruar më larg, ofendimin e disa çështje tjera të cilat konsideroj se ndoshta është mirë që janë bërë në ligj, mirëpo ndoshta ngapak kanë për ta vështirësuar edhe çështjen sa i përket procedurave në organet e drejtësisë, sepse ky ligj asnjëherë nuk do të ketë mundësi të bie ndesh me dispozitat themelore që janë për veprat penale që ushtrohen në dhunën ndaj familjes dhe ne mund të parashohim gjithçka këtu – ofendimin, fjalë të ndyta, mirëpo nëse bie në kundërshtim me Kodin Penal, natyrisht se nuk do të zbatohen në praktikë. Çështja procedurale që është paraparë është paraparë, është ... çështje e organizimit të gjykatave dhe konsideroj se prapë është çështje e panevojshme. Bile këtu u kërkua, unë mendoj që ajo çështje që është paraparë është mirë, sepse është dhënë një praktikë se si mund të vijë deri te ajo për t'u zgjidhur problemet, mirëpo pat mendime që disa deputetë që edhe më tutje të shtohen procedurat,

domethënë, nuk kemi nevojë, sepse gjykatat i kanë procedurat në rast kur ngritët një kallxim penal për dhunën në familje.

Dhe, krejt në fund, u kërkua që për strehimore është normal, duhet të ketë strehimore, i kemi nëpër të gjitha vendet e Bashkimit Evropian. Bile për dallim nga vendet tona atje është vështirë të kuptosh ku gjenden strehimoret, sepse është një konfidencë për ta ruajtur pikërisht njerëzit të cilët janë prekur nga dhuna. Mirëpo ne nuk po bëjmë ligj për buxhetin dhe nuk kemi mundësi me këtë ligj të themi ndajmë që kaq mjete për atje apo... Është në kuadër të strategjive që kemi, në kuadër të buxhetit me nda në të ardhmen kurse sa i përket preventivës që u fol shumë, preventiva duhet të bëhet por jo me ligj, preventivat bëhen përmes programeve, edukimeve të ndryshme mandej çështjeve tjera edukuese që i kemi qoftë nëpër shkolla dhe unë mendoj që Komisioni funksional është mirë më tepër që në të ardhmen kur të fillojë me amendamentu ta merr një ekspert ligjor dhe të mos përqendrohet shumë në atë që është thënë në seancën plenare. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Kërkoj nga deputetët deklarin me votim për miratimin në parim të Projektligjit. Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 65 vota “për”, 1 abstenim Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për mbrojtjen nga dhuna në familje.

Në sallë ishin të pranishëm 66 deputetë.

Në bazë të Rregullores së Punës Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione,
- Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
- Komisionin për Buxhet e Financa,
- Komisionin për Komunitete, dhe
- Komisionin për Integritet Evropian

Që brenda dy muajve nga shqyrtimi i parë Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime. Ju faleminderit!

Kalojmë në pikën e nëntë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për energjinë

Konstatime hyrëse. Në bazë të Rregullës 35 pika 1 të Rregullores së Punës janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji.

Ftoj ministren e Energjisë dhe Minierave, zonjën Justina Shiroka-Pula që para deputetëve të Kuvendit të paraqet Projektligjin.

Ministre, e keni fjalën!

MINISTRJA JUSTINA SHIROKA-PULA: I nderuari kryesues,
I nderuar zëvendëskryeministër,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë,

Në emër të Ministrisë së Energjisë dhe Minierave paraqes për miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës Projektligjin për energji.

Ky projektligj është rezultat i punës dhe përkushtimit të vazhdueshëm të Ministrisë së Energjisë dhe Minierave për kompletimin e infrastrukturës ligjore në sektorin e energjisë i cili është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës në dhjetor të vitit 2009 dhe po i paraqitet Kuvendit të Republikës së Kosovës për miratim në parim.

Miratimi i këtij projektligji është i një rëndësie të veçantë, sepse do të mbështesë zhvillimin e gjithmbarshëm ekonomik të vendit. Ligji në fuqi për sektorin e energjisë e ndër to edhe Ligji për energji numër 2004/8 të miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe të shpallur nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm në qershor të vitit 2004, përmes rregulloreve përkatëse, megjithëse kanë dhënë kontribut shumë të madh për ndërtimin e një baze infrastrukture të sektorit të energjisë kanë pasur edhe paqartësi në delegimin e përgjegjësiave dhe autoriteteve si dhe relacioneve ndërmjet tyre. Këto mangësi të evidentuara gjatë zbatimit të këtij ligji kanë bërë që të ketë edhe hezitime në vendimmarrje të rëndësishme si dhe kanë shkaktuar debate të panevojshme. Duke i shtuar kësaj edhe faktin se që nga viti 2004 e këndeje është plotësuar baza legjislative për shumë fusha që janë të ndërlidhura në sektorin e energjisë. Konsiderojmë si të domosdoshme që të zëvendësohet ligji i cili është në fuqi me ligj të ri si një domosdoshmëri për rregullimin edhe më të plotë dhe më cilësor të sektorit të energjisë.

Një motiv tjetër për zëvendësimin e legjislacionit ekzistues është edhe qasja e Bashkimit Evropian për integrimin e plotë të tregut të energjisë me të ashtuquajturën pakon ... legjislative, ku edhe Kosova do të jetë një anëtare e rëndësishme e këtij tregu dhe duhet të jetë sa më parë e përgatitur për t'i përmbushur kërkesat e reja.

Ne jemi të përkushtuar të përfitojmë nga përvojat e komunitetit evropian në lidhje me rregullat e përbashkëta për tregun e përbashkët të energjisë si kontribut i dhënë nga Komiteti Evropian drejt krijimit të një tregu funksional konkurrues të brendshëm për energjinë.

Qëllimi i Projektligjit për energji përcakton parimet dhe rregullat e përgjithshme përmes të cilave drejtohen aktivitetet në sektorin e energjisë në Republikën e Kosovës me qëllim të garantimit të furnizimit të sigurt, të qëndrueshëm dhe të cilësisë më të lartë të energjisë për të krijuar kushte të një tregu funksional të energjisë dhe krahas kësaj edhe promovues për shfrytëzimin e efijencës së energjisë, rritjen e burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe bashkëprodhimin si dhe përmirësimin në mbrojtjen e mjedisit nga veprimtaritë energjetike.

Fushëveprimi i këtij ligji përcakton zhvillimin dhe implementimin e strategjisë së energjisë, përfshirë parashikimin e balancave të energjisë dhe politikave për efijencën e energjisë, burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe bashkëprodhimin.

Projektligji për energji përmban 10 krerë dhe 34 nene.

I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Projektligji për energji, është hartuar në përputhje me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Kosovës numër 1/2007. Projektligji ka formën dhe strukturën standarde në pajtim me

Udhëzimin administrativ numër 14/2008 për hartimin e projektligjeve dhe të akteve nënligjore.

Në hartimin e këtij projektligji kanë marrë pjesë ekspertë nga institucione të rëndësishme vendore si Zyra e Kryeministrit të Kosovës, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Korporata Energjetike e Kosovës, Zyra e Rregullatorit të Energjisë si dhe Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe tregut. Përveç institucioneve vendore, gjithashtu në hartimin e këtij projektligji janë angazhuar ekspertë nga Brukseli ku më parë ky projektligj u është dërguar edhe institucioneve tjera ndërkombëtare si ISO, Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian, konsulentëve të USAID-it si dhe Traktatit për Komunitetin e Energjisë, me ç'rast janë marrë parasysh dhe janë inkorporuar komentet dhe sugjerimet e tyre që do të thotë se ky projektligj është në harmoni të plotë me direktivat e fundit të Bashkësisë Evropiane për sektorin e energjisë. Po ashtu, ky projektligj nuk cenon ndonjë nga parimet e përgjithshme të Acquis communautaire sipas deklaratave të lëshuara nga Agjencioni për Koordinimin e Zhvillimit të Integritimit Evropian.

E gjithë puna e hartimit të Projektligjit është bërë në frymën e transparencës, bashkëpunimit institucional.

Të nderuar deputetë, ju propozoj që ta miratoni në parim projektligjin i cili do të jetë në funksion të kompletimit të infrastrukturës ligjore në sektorin e energjisë në Republikën e Kosovës. Ju faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI I KUVENDIT: Faleminderit! Kryetarët e komisioneve a donë fjalën? Atëherë në emër të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit parlamentar të Partisë Demokratike kush e kërkon fjalën. Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Të gjithë ju të pranishëm,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka analizuar pakon e projektligjeve që kemi në shqyrtim e të cilat rregullojnë sferën energjetike në segmente të ndryshme.

Me këtë rast e përgëzoj Ministrinë e Energjisë dhe Minierave, përkatësisht ministren Justina Shiroka-Pula, për punën e bërë duke iu dhënë mbështetje në parim këtyre projektligjeve. Meqë tani Kosova është në një fazë më të avancuar se në kohën kur këto ligje janë hartuar e miratuar në vitin 2004 tani pra Kosova është shtet i pavarur dhe sovran që synon integrimin në institucionet ndërkombëtare si në Bashkimin Evropian e tjera. Natyrisht që ka qenë nevojë e kohës të ndryshohen, plotësohen e kështu me radhë këto projektligje. Ndërkaq, dihet, edhe rregullat, përkatësisht konventat e Komunitetit Evropian në këtë sferë ka ndryshuar nga viti 2004 e gjer më sot, andaj ne jemi të obliguar të përafrohemi me to edhe në aspekte ligjore. Projektligji i energjisë të cilin po e shqyrtojmë sot, në nenin 3, kreu II ka të rregulluar strategjinë e energjisë, përfshirë programin e zbatimit dhe balancat e energjisë. Ndërkaq, ne si komision parlamentar e kemi në shqyrtim strategjinë e energjisë si dokument themelor që përcakton politikat e energjisë dhe të planifikimit për zhvillimin e sektorit të energjisë në Kosovë, andaj ne si

Komision parlamentar kemi rastin t'i harmonizojmë këto dokumente shumë të rëndësishme në qoftë se nuk janë të harmonizuara në masën e duhur. Kreu III i këtij draftligji rregullon eficiencën e energjisë, qëllimi i politikës së eficiencës është përmirësim i eficiencës së energjisë dhe shfrytëzimi i potencialeve për kursimin e energjisë me qëllim të arritjes së nivelit optimal të eficiencës së energjisë në Kosovë. Kështu ne patëm rastin të shohim jo më larg se dy ditë më parë një projekt të tillë që filloi në QKUK të cilin projekt e promovoi Ministria e Energjisë, përkatësisht ministrja Justina Shiroka-Pula. Janë shumë të rëndësishme edhe kapituj që rregullojnë burimet e ripërtëritshme ose burimet alternative, mjedisin e tjera, të cilat janë edhe obligime që dalin nga konventat e komunitetit për energji.

Krejt në fund, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës e mbështes në parim. Kontributin tonë do ta japim në komision parlamentar gjatë fazës së amendimit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit deputete!

Në emër të LDK-së kush e kërkon fjalën? Deputeti, Fatmir Rexhepi.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, zoti kryetar,

Përshëndetje kolegë deputetë,

Përshëndetje për Kabinetin qeveritar,

Grupi Parlamentar i LDK-së në kuadër të debatit që ka pasur lidhur me paketën e këtyre projektligjeve në sektorin e energjisë..... autorizuar po ashtu që të paraqesim vlerësime të opinionit dhe vërejtjet tona, më lejoni që po ashtu të paraqes vlerësimin në parim të Grupit Parlamentar.

Sa i përket rëndësisë së paketës së këtyre ligjeve nuk kemi çka flasim shumë, mendoj atë që e tha zonja ministre qëndron, sepse këtu në këtë projektligj, pra po kodifikohen të gjitha aktivitetet në sektorin e energjisë që kanë të bëjnë me politikën dhe me synimet, po ashtu që këto politika të jenë në kuadër të makro-zhvillimit ekonomik të vendit, duke u nisur nga planifikimi dhe vetë zhvillimi i sektorit të energjisë në të gjitha fushat që ka të bëjnë me energjinë elektrike, në sektorin e ngrohjes qendrore, sektorin e gazit dhe të energjisë alternative, prandaj të promovojë të gjitha ato strategji dhe politika të investimeve në kuadër të këtyre synimeve.

Po ashtu, duke filluar që kjo strategji ka edhe... ky projektligj kërkon pra po ashtu që në kuadër të strategjisë kemi strategjinë pra afatshkurtër dhe afatmesme, prej balancës energjetike në vend dhe përshtatja e tij me nevojat dhe tregu regjional deri te eficientia, operatorët, institucionet dhe rregullatorët përkatës.

Një çështje që po ashtu është ngritur në Grupin Parlamentar të LDK-së bashkë me debatin në kuadër të këtij projektligji e që do të ishte pra si një vërejtje parimore, por që nuk lidhet drejtpërdrejt tash është edhe nevoja pra e debatit për të pa strategjinë si pjesë integrale që do ta kemi në debat nesër për energjinë lidhur me potencialet, me kapacitetet e reja energjetike që realisht ato t'i harmonizojmë, t'u japim një harmonizim të plotë pra me interesin strategjik dhe zhvillimor të vendit. Këto të mos vonohen, përndryshe, në parim ne e përkrahim këtë projektligj për energjinë për shkak të vetë rëndësisë që e ka, pra "pro" atij zëvendësimi se vërtet qëndron fakti që është plotësuar dhe është ndryshuar dukshëm dhe normalisht ka provuar të harmonizojë me direktivat të cilat janë dhënë dhe standardet që kërkojnë pra nesër në fushën e sektorit të energjisë, kështu që me atë vërejtje parimore pra ne e përkrahim në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit deputet! Në emër të AAK-ës deputeti Et'hem Çeku e ka kërkuar fjalën.

ET'HEM ÇEKU: Faleminderit, zoti kryetar!

Kolegë të nderuar,

Realisht sot kemi për të diskutuar një pako ligjore për fushën e energjisë që për neve është një nga pakot më të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të vendit tonë. Dëgjova me vëmendje parafolës se në parim mbështesin për të bërë ndryshime apo të them rishkruarjen e plotë të ligjit të ri nga ai që ka qenë në 2004. Do të thotë kemi 5 vjet që kemi pasur një ligj të aprovuar nga ky Parlament i cili ligj ka funksionuar sipas konceptit tonë dhe bindjes tonë pa asnjë telashe, pa asnjë pengesë. Unë do të shprehja vetëm disa pyetje, a mund të identifikojmë cilat janë problemet që i ka sjell ligji paraprak që nuk ka mundësuar funksionimin e sistemit energjetik në Kosovë? Në parim them se ka pësuar ndryshime për shkak se janë bërë edhe rregulla të reja në kuadër të BE-së dhe a na nevojitet tani ne të fillojmë nga pika zero, do të thotë, që një ligj ta rishkruajmë nga fillimi që të përshtatim një ligji tjetër. Dhe problemi tjetër që është shumë i madh, besoj që edhe kolegët deputetë do të pajtohen. Ne kemi filluar hartimin e strategjisë, do të thotë, Strategjinë e energjetikës, që është obligim ligjor për ta rinovuar, mirëpo e kemi në Parlament, që duhet ta diskutojmë. Kemi pakot ligjore që duam t'i bëjmë ndryshimet dhe ne të njëjtën anë kemi hapur procesin e ndërtimit të termocentralit të ri "Kosova e Re" dhe u ofrojmë investitorëve mundësinë për investim pa strategji të aprovuar, me ligjet të cilat janë duke u rishkruar dhe kështu mendoj se nuk jemi duke sjellë mundësinë për të investuar në Kosovë dhe atë që është potencuar, kështu nuk jemi duke i ndihmuar vendit tonë që të kemi një progres në fushën e zhvillimit të sektorit energjetik. Prandaj, si Grup Parlamentar ne kërkojmë që ky ligj t'i rikthehet Qeverisë dhe le të përgatitet, le të shkruhet ashtu si duhet, sepse aq shumë ka degradim nga ligjet të cilët i ka aprovuar dhe i ka miratuar dhe janë hartuar nga Komisioni parlamentar për Ekonomi, Industri, Tregti, Energji në mandatin e kaluar. Mendoj që ne si Grup parlamentar nuk do t'i mbështesim ndryshimet në këto momente të ligjit, kur jemi në fazën e implementimit të strategjisë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Sipas radhës, në emër të AKR-së, deputeti Ibrahim Makolli e ka kërkuar fjalën.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Ashtu sikur i thatë, këto ligje janë të një rëndësie të veçantë, sepse rregullojnë një fushë dhe një materie shumë të rëndësishme për vendin. Ne në Grup Parlamentar kemi vlerësuar që ligji në fjalë ka defekte të cilat do të jenë të vështira për komisionin që t'i harmonizojë dhe t'i eliminojë këto defekte që ka. Po ashtu, në ligj në shumë pjesë hetohen fjalët: "duhet", "do të", "mund" e tjera, që në ligj nuk do të duhej të figuronin, sepse nuk mund të mbeten, nëse do dikush ose nuk do ose nëse duhet ose nuk duhet, sepse ligji duhet të precizojë dhe të përcaktojë në mënyrë të qartë obligimet, kompetencat që mund t'i ketë dhe duhet t'i ketë dikush. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet!

Në emër të LDD-së, deputeti Lulzim Zeneli e ka fjalën.

LULZIM ZENELI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

E nderuara ministre e Energjetikës,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i LDD-së, e konsideron të nevojshme ndryshimin e Ligjit për energjinë, mirëpo kjo nevojë rrjedh si rezultat i realitetit të krijuar në Kosovë pas dy vjetëve të pavarësisë, kurse sot kur e kemi këtë dokument përpara dhe e kemi për bazë njëkohësisht edhe dokumentin, Ligjin e miratuar në 2004 për energjinë, atëherë shtrohet një pyetje: Çka ndryshon në kursin politik dhe në qasjen e institucioneve të vendit karshi resursit strategjik të Kosovës, siç janë kapacitetet energjetike. Ne themi se kjo qasje e cila është aktualisht në raport me këto resurse, këto kapacitete energjetike, duhet të ndryshojë. Ky ligj nuk ka për bazë interesin shtetëror të Kosovës në raport me këtë resurs. Ligji përpos që nuk e ka për bazë interesin e Kosovës, ligji është edhe i formuluar dobët në kuptimin e përmbajtjes dhe të adresimit të kësaj materie. Duhet ditur se kemi të bëjmë me një ligj bazik dhe të gjitha dokumentet tjera në fushën e energjetikës, duhet të jenë derivat i këtij dokumenti, atëherë shtrohet pyetja: ky dokument cilin interes e ka për bazë? Të gjitha vendet të cilat sot janë anëtare të BE-së, por edhe ato të cilat janë me një këmbë në anëtarësimin në BE, kanë disa objektiva të cilat i kanë parashtruar në ligjet e tyre bazike sa i përket energjetikës.

Objektivi kryesor, çka ne po na mungon në gjithë legjislacionin që kemi, është interesi shtetëror i vendit. Pastaj, të gjitha dokumentet të cilat derivojnë, strategjia për zhvillimin e energjetikës, programi qeveritar për implementimin e strategjisë së energjetikës, programi për eficiencën apo kursimin e burimeve të energjetikes, që nuk janë as nuk mendohen të jenë, është për shqetësim në raport me qasjen që po e demonstroi Qeveria e Kosovës. Ky ligj nuk merr për bazë parimet e qëndrueshmërisë, balancën ndërmjet prodhimit, konsumatorit - blerësit dhe mjedisit, që është parim bazë dhe standard për integritet evropian. Ky ligj nuk merr për bazë interesin e konsumatorit. Është i vetmi ligj nga të gjitha ligjet e shteteve në rajon, që nuk ka masa ndëshkimore sa i përket fushës së energjetikës dhe ky ligj nuk mund të ketë masa ndëshkimore për arsye se është ligj teorik, i thatë, pa përmbajtje substanciale. Ne konsiderojmë se është humbje kohe të merremi me këtë dokument, është humbje kohe derisa disa krerë të këtij dokumenti, kemi të bëjmë edhe me disa objektiva të cilat nuk duhen të jenë pjesë e këtij dokumenti. Mirëpo, në prapavi, në begrandin e këtij dokumenti, është një interes dhe cili është ai interes? Ka të bëjë me investimet, ka të bëjë me kalkulimet e politikave ditore në fushën e energjetikës. Po e citoj vetëm një çështje e cila, nëse miratohet ky ligj, do të imponohet si pikë në ndërtimin e strategjisë së energjetikës në vend. Strategjia thotë e energjetikës, duhet të bazohet në fleksibilitetin në mes kontraktorëve, mund ta merrni me mend. Ajo çka duhet të ketë për bazë interesin e konsumatorit, që ky nuk e ka, dhe do të duhej të ishte, është çmimi. Të gjitha vendet e BE-së e kanë në Ligjin për energjetikë çmimin e energjisë elektrike dhe ky çmim i energjisë mund të jetë i rregulluar, por edhe i lirë dhe në qoftë se...

(ndërhyrje nga salla)

... po, ta përfundoj unë e pastaj (duartrokitje). Sa i përket pjesës tjetër, që është bazamenti i këtij ligji dhe në fokus, ka të bëjë me investimet në fushën e energjetikës. Konsiderojmë se çështja e investimeve dhe e privatizimit në sektor të energjetikës duhet të rregullohet me ligj të veçantë, ashtu siç i kanë rregulluar të gjitha vendet tjera. Nuk duhet me dy formulime të precizohen investimet apo privatizimi apo çështje të tjera në fushën e energjetikës. Prapë konsiderojmë se ky ligj i tillë është i dëmshëm, nuk ka për bazë interesin nacional, ka për bazë interesin e grupeve përbrenda kësaj Qeverie dhe duhet të kthehet mbrapa. Për këtë ligj, ne e kemi ligjin e vjetër. Edhe një çështje. Derisa të gjitha vendet e rajonit dhe të gjitha vendet e BE-së promovojnë kursimin apo shfrytëzimin efektiv të burimeve të energjetikës dhe kjo duhet të vihet në fokus. Ne e

kemi shfrytëzimin maksimal të burimeve të energjisë. Mund ta marrim me mend se cili është kursi i kësaj qeverisjeje, prandaj kjo duhet të ndryshojë. Ne konsiderojmë se ky ligj duhet të kthehet mbrapa, duhet të ndryshohet ligji aktual, por ligji aktual do ta ketë në çdo kapitull një nen, një nen të caktuar që ka për bazë interesin e shtetit të Kosovës në raport me këtë resurs strategjik të vendit dhe aktualisht nuk e ka. Askund në këtë ligj nuk merr për bazë interesin e shtetit të Kosovës, por si do të promovojmë investime dhe si do të kontraktujmë me fleksibilitetin maksimal që afon ligji, që afrojnë institucionet e vendit. Konsiderojmë si Grup parlamentar se duhet t'i jepet fund një praktike të tillë dhe të gjitha ligjet në fushën e energjetikës dhe sidomos në këtë fushë, që është interes strategjik, duhet ta ketë për bazë interesin e qytetarëve dhe të shtetit të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Unë ua jap fjalën për të folur. Ju lutem, realisht përqendrohuni në ligjet konkrete. Lulzim, mirë e pate, shumë mirë, por Lulzim, a ke dëgjuar për atë tregimin e shkurtër me qe, që e kishin pas lënë qerren. Në emër të Grupit “7+” kush e do fjalën? Myfera Shinik

MÜFERA ŞİNİK:

Teşekkür ederim.

Sayın Başkan, Bakanlar, Milletvekilleri

Enerji Yasası bilindiği gibi ülke için çok önemli bir yasadır. Bundandır Enerjiyle ilgili Yasa Tasarısının dikkatle incelenmesi gerekmektedir.

Bu Yasa Tasarısını 7+ Parlamenter grubu incelemiş ve araştırmıştır. İyi hazırlanmış bir Yasa Tasarısı olarak görülmektedir.

Enerji Yasasına göre, enerji sektöründe güven ve kalite açısından şartların yaratılmasıyla birlikte yaşam ortamının korunması da gerekmektedir.

Enerji Yasası elektrik enerjisini, ısı enerjisini, doğal gaz ve geri dönüşümlü enerji kaynaklarını kapsamaktadır. Bu yüzden enerjiyle ilgili daha uzun vadeli planlamanın yapılması da gerekmektedir.

Dil konuları yerine ben biraz daha fazla yasanın içeriğiyle ilgili tartışılmanın gerektiğini düşünüyorum. Ancak yine de dikkat çeken bir konu vardır ki, Yasa Tasarısının açıklamaları verilirken, 2. maddenin 1.20. alt maddesinde doğal gazın karbonhidratların karışımından oluşan bir bileşik olduğu geçmektedir. Ancak burada terminolojide bilimsel bir hata görülmektedir, ki bilindiği üzere doğal gaz hidrokarbonların (Metan, Etan, Propan gibilerinin) karışımıdır. Karbonhidratların değil, çünkü hepimizin bildiği üzere karbonhidratlar-şekerlerdir. Bunlara da özellikle dikkat edilmesinin gerektiğine inanmaktayız.

Onun dışında Enerji Yasa Tasarısının birinci okunuşunu 7+ Parlamenter grubu olarak kabul etmekteyiz, ikinci okunuşuna kadar katkılarımızı ve önerilerimizi fonksional komisyonlara sunacağız.

Teşekkür ederim.

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të SLS-së, a e do dikush fjalën? Jo. Vazhdojmë. Për fjalë është lajmëruar deputeti Driton Tali.

DRITON TALI: Ju faleminderit!

Ndonëse u thanë shumë gjëra këtu nga parafolësit, por të nderuar të pranishëm këtu dhe ju qytetarë që na përcillni përmes televizionit, unë do t'i them disa fjalë të bazuara nga analiza që e kam bërë në mes këtij ligji dhe që edhe parafolësi e ceku, të ligjit

ekzistues, në realitet të këtij Projektligji që na e keni seruar dhe të Ligjit ekzistues të cilin ky Kuvend i nderuar e ka miratuar para nja 4 apo 5 vitesh apo sa? Jam nisur nga ajo se kur duam diçka të re, diçka që ekziston, ne duhet ta bëjmë me qëllim të përmirësimit të asaj, të përfitimit diçka tjetër. Unë, për aq sa e kam lexuar këtë Projektligj dhe Ligjin ekzistues, nuk kam parë diçka të veçantë që ia ka vlejtur për ta formuluar këtë Projektligj dhe sjellë këtu, për të krijuar grupin punues. Unë ende nuk e kam të qartë dhe pyes pse është bërë ky ligj, do me thënë, pyes logjikisht cilat ishin mangësitë e Ligjit të njëjtë ekzistues, pra të atij që ky Kuvend, po e ceku edhe një herë, e miratoi në vitin 2004, çka kemi përfituar si shoqëri nga ky ligj apo çka do të përfitojmë? Pse është paguar grupi punues, pse janë paguar drekat, darkat e tyre, shkuarjet në Ohër, po them edhe pse nuk e di, por 100% kanë shkuar në Ohër, se është bërë modë për të shkuar në Ohër...

KRYETARI: Driton, jemi kah flasim për Ligjin, ju lutem, po flasim për ligjin, a?

DRITON TALI ... se sa që po shkojnë nëpër katundet e veta, pikërisht për ligjin jam duke folur.

KRYETARI: Jo, je kah flet për dreka e darka, e këtu ne sot e kemi në rend dite ligjin, ti fol për rend dite, të lutem!

DRITON TALI ... po për t'u bërë ky ligj, janë paguar dreka e darka, unë nuk di pse është bërë ky ligj? Një ligj e kemi ekzistues, është në fuqi, por ne jse ekspertët e dinë më mirë, veç unë po them, e kam lexuar atë ligj dhe e kam lexuar këtë, ti e paske lexuar, hajde shpjegoma çka është ndryshimi i Ligjit ekzistues që është. Në vitin 2004 ke qenë deputetë, e ke votuar. Tregomë, këtë pyetje e kam, pse ky ligj, çka ndryshon, mbasi e paske lexuar dhe unë po flas jashtë ligjit, tregomë pse është bërë grupi punues, shpjegoma mua dhe qytetarëve të Kosovës, nëse po e dijshe dhe ndërhyre.

KRYETARI: Ty po ta shpjegoj se ligji nuk bën fjalë, asnjë nen nuk e shkruan për dreka e darka.

DRITON TALI: Çka thua, shih ti. ... nuk di çka qenka, atëherë pse i keni çuar, pasi me ligj nuk qenka të çohen atje, pse i keni çuar? Po është bërë njëfarë mode, çka të bëjnë diçka, të shkojnë në Ohër për të punuar këto grupe punuese, se këtu në Kosovë nuk kanë vend ku punojnë! Shkojnë atje në Ohër më shpesh se nëpër katundet e tyre. Sidoqoftë, unë po e them të vetmin ndryshim, tash po kthehem në ligj, të vetmin ndryshim që e kam parë, është te faqja 36 fillon, pra e kemi kreun IV, këtu u prek pak, pra investimet, që unë pajtohem me ata që e kritikuan nga fakti se shumë gjëra në vend që t'i qartësojë ky paragraf, më shumë i mjegullon, sepse kemi të bëjmë me investimet private, pra me privatizim të sistemit energjetik dhe këtu domosdo lind pyetja: - Pse kjo Qeveri, në vend se të na e sjell Ligjin për privatizimin e sektorit energjetik, një ligj që nuk e kemi e që po e presim, siç thonë goja mbas veshit na ka dal, edhe shoqërisë civile, duke e kërkuar këtë ligj për privatizimin e sektorit të energjisë. Nuk na sjellë, por na dyfishon një ligj i cili veç ekziston, ligj që nuk sjell, nuk bien prurje. Pastaj me atë Ligjin për privatizimin e sektorit të energjisë, ne do ta dinim, qytetarët e Kosovës do ta dinin se sa saktësisht dhe si do të lejohej investimi privat në këtë sektor, duke marrë parasysh se e kemi sektorin më të rëndësishëm ekonomik, e kemi pasurinë e vetme pothuajse. Pastaj, edhe Qeveria do ta dinte se në blloqet e radhës apo në Termocentralin e radhës sa përlind të aksioneve do t'i kishim, do të dinim edhe ne qytetarët e Kosovës, e jo të bazohemi në këta "ekspertë", që po na vinë të hunit e të konopit këtu në Kosovë e

na shesin mend, po them këta farë këshilltarët e huaj ndërkombëtarë, ekspertë që po i thonë vetës dhe e kanë gjetur edhe një fjali tjetër, si po i thonë - këshilltarët e transaksionit, a? Do me thënë, këshilltarët e shpëlarjes së parave, kështu diçka e ka njëfarë... dhe të korrupsionit. Na mbyten duke na marrë para, veç huqin, kurrë nuk kanë pru dritë. Edhe këtë strategji të cilën e ruanin apo e mbronin me mish e shpirt deri në nëntor të vitit 2009, në dhjetor i ranë pishman, thanë se kriza globale, shih ti, kriza globale ka ndikuar që të mos ndërtohen më ato kapacitete që para një muaji i mbronin 2000 megavate, e tash na thonë se kriza globale, shih ti, kriza globale ka ndikuar, kriza globale në dhjetor 2009, dy vite e gjysmë pasi që ka filluar ajo krizë që, për ironi, veç janë këto sinjale të para të rimëkëmbjes së ekonomisë globale. Po e marrin si kontekst. Këto matrapazllëqe janë për shkak se nuk e kemi ligjin konkret, të cilin Qeveria duhet ta sjell këtu, të na e përpilojë Ligjin për privatizimin e sektorit të energjisë, e jo të mbesim peng të huqjeve të shumta të ekspertëve, po them edhe një herë, e të këshilltarëve ndërkombëtarë, që një Zot e di se çfarë ekspertësh janë ata. Veç kaq desha të them zoti speaker, se di a të pëlqeu a jo. Ju faleminderit!

KRYETARI: Veç shiko çka ti mund të thuash, mua më pëlqen. Realisht, këto monitorimet e KDI-së në vend që të na lehtësojnë punën e Kuvendit, na e kanë vështirësuar. Fjalën e ka deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: Zotëri kryetar,

Të nderuar kolegë,

Konsideroj se do të ishte e justifikuar që të prezantohej skopi i shkaqeve pse, si u bë që një ligj në aplikim, komplet të abrogohet në mënyrë implicite. Kjo nuk është praktikë legjislative. Do të duhej të jepeshin, zotëri kryetar, mirë është të ketë rend, fundi i fundit e kemi detyrë elementare edhe kushtetutare edhe ligjore për t'u angazhuar në kapacitetet tona, pavarësisht vlerësimeve, valorizimeve, estimimeve të cilave do NGJO apo institucione tjera. Këtë do ta kisha bërë edhe sikur të mos ekzistonte organi apo autoriteti vlerësues. Po flas për veti. Do të thotë, ju lutem, e kemi ligjin në aplikim, asnjë fjalë për abrogimin total të tij të menjëhershëm. Më pastaj, me të vërtetë irituese janë, ekspertët e kanë bërë. Po na ekspertët mund t'i numërojmë në pesë gishtat e dorës, mjerisht. Kisha pasur dëshirë të ishin me qindra mijë. Nëse janë profesionalistë, do të ishte mburrje e mjaftueshme se, ja tash po e zëmë, me dy shembuj tregohen 200 rastet e dështimeve elementare. Qe po e zëmë konkretisht, ky dokument përmban formulime shumë problematike. Konkretisht, neni 28, paragrafi 1, që çka thotë: "Kriteret dhe kushtet e kompensimit rregullohen me Ligjin për procedurën kontestimore të Republikës së Kosovës". Po kjo është absolutisht keq edhe absolutisht gabim material, konceptual, nocional. Po kush është ai apo kush janë ata ekspertë që e paskan bërë këtë? Për këtë bihet në provim në lëndën e parë, në provimin e parë në fakultet juridik, do me thënë, nuk është mirë kësioj me të vërtetë edhe bëhen shpenzime marramendëse të panevojshme.

Rasti i dytë, zotëri kryetar! Neni 31, paragrafi 7, alineja 3, ja çka thotë te mbikëqyrja dhe inspektimi administrativ: "t'i propozojë Zyrës së Rregullatorit për Energji të vendos gjoba administrative dhe dënime tjera sipas ligjit". Po ku janë ato? Nuk janë askund, do me thënë nuk janë askund ato, nuk ka gjoba, nuk ka dënime, fundi i fundit gjobë është një term që nuk përkon me gjuhën shqipe e tjera, por po e lëmë termin, se këto në çdo dispozitë, zoti kryetar, ka gabime gjuhësore, po keq është, sikur të ishin të huaj ata/ato që i bëjnë këto projekte të ligjeve. Madje, madje, për të qenë e keqja më e madhe, në të tri gjuhët ka gabime paralele, por këto po e lëmë anash. Ama është fjala te ligji, nuk është fjala gjuha, vetëm terminologjia, por në bazë të terminologjisë, këto duhej të aplikohesh,

edhe atje do të haste sharra në gozhde. Ja, po e zëmë, Ligji për zgjedhje çfarë probleme shkaktoi, sepse ka defekte pikërisht gjuhësore. Prandaj, zonja ministre, ju jeni bartëse, titullar i këtij dokumenti, me të vërtetë të kujdeseni edhe personalisht para se ta veni këtu, ju personalisht ta shikoni njëherë. Kjo vlen për secilindo ministër. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet! Radhën e ka deputetja Edita Tahiri.

EDITA TAHIRI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Mendoj se disa diskutime që u thanë këtu lidhur me atë se kemi nevojë për ligje a jo, veç një përkujtim që Ligji 2004-isht ka të bëjë me një periudhë kur Kosova ishte nën administrimin ndërkombëtar dhe natyrisht që ne jemi tash në një shtet të ri dhe duhet pasur ligjet e shtetit tonë. Kjo është sa për fillim. E dyta, mendoj se Ligji për energjinë, por edhe të tjerët që po presin sot për diskutim në fushën e energjisë, kanë rëndësi të veçantë për shumë arsye, por një arsye më e madhe është që strategjia dhe ligjet e energjisë në këtë vend prej vitit 1999 kanë dështuar. Vetë fakti që ne nuk kemi mund ta zgjidhim krizën energjetike që 10 vjet, tregon që jo vetëm që duhen ligje, por duhen strategji, duhen mendime, duhen opinione, rekomandime edhe mendoj se së paku ne deputetët, në vend se të dalim me tema marginale e me do, do të thosha, ndërhyrje irelevante, do të ishte mirë që sot që të japim ndoshta rekomandime që e avancojnë këtë ligj.

Unë nuk besoj që është kjo humbje kohe, përkundrazi, koha ka humbur që 10 vjet, ndërsa sot është një fillim i mbarë, shpresoj, dhe në këtë kuadër kontributi im do të ishte ky. Unë mendoj se Ligji duhet po ashtu të përmbajë politikat e diversifikimit të energjisë, që nënkupton se përveç atyre që janë në listë, pra si burime të energjisë që do t'i shfrytëzojë Kosova. Tashmë kemi një zhvillim më të madh në planin e diversifikimit të energjisë dhe janë edhe disa burime tjera alternative, të cilat natyrisht mund të ndihmojnë që çështja jonë, pra, të marrë një rrugë të drejtë.

E treta, mendoj se burimi ynë kryesor për energjinë elektrike është thëngjilli dhe plani për ndërtimin e termocentralit të ri ka të bëjë, natyrisht, me atë që ne mund ta bëjmë, meqenëse e kemi lëndën e parë në shtëpinë tonë. Mirëpo, në këtë kontest duhet parë me kujdes standardet evropiane si dhe ju kisha lutur juve, zonja ministre, që të keni shumë kujdes në aspektin e filtrave, në mënyrë që ambienti mos të vazhdojë të dëmtohet, siç është vazhduar këto 20 vjet e më shumë. Po ashtu, dua të them se në kuadër të implementimit të ligjit, është shumë me rëndësi që të gjithë aktorët që janë pjesëmarrës në zhvillimin e një strategjie të qëndrueshme dhe zbatimin e saj, duhet të jenë në nivel të përgjegjësisë. Këtu e kam fjalën, pra, të gjithë aktorët, qoftë institucional, deri te qytetari. Mua më pëlqeu këto ditë që kishit filluar një pilot projekt për zbatimin e ndriçimeve me kursim, që mendoj se është ndoshta një faktor modest, por është një fillim i mbarë që të hapim perspektiva për ide të ndryshme që kontribuojnë, pra, që ta tejkalojmë këtë situatë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputete! Diskutuesi i fundit është deputeti Zylfi Merxha.

ZYLFI MERXHA: Ju faleminderit, zoti kryetar i Parlamentit, doktor Jakup Krasniqi. Ju përshëndes juve dhe stafin e juaj. I përshëndes, edhe pse pak kanë mbetur ministra, por të vyeshëm janë, ata pak na kanë dashtë, kanë ndej me ne. Një send është. Tha zonja më parë, në vitin 2004 kush kemi qenë ne Kosova? Askush. Kush ka ardhur veç për të na hëngër, për të na pirë, për të na plaçkitur, e ne krejt kemi kujtuar që kanë qenë njerëz të

mirë. Tash e kemi Republikën tonë më të re, e kemi Kosovën e lirë, e kemi Qeverinë e vyeshme. Ky ligj që e ka pru tash Qeveria, sidomos zonja ministre, është shumë, shumë i vlefshëm, por na jemi ata që ligjet tona që i bëjnë njerëzit e tonë, i bëjmë asgjë, por kur të na i bë dikush i huaji, na duket kush e di çka u bë. Unë po them se në emrin tim edhe në emër të Grupit “7+”, jo vetëm që do ta përkrahim, por edhe do ta votojmë këtë ligj, se kur një ligj si ky s’e kemi pasur. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Melihate Tërmkolli, shpresoj e fundit, ndoshta.

MELIHATE TËRMKOLLI: Ju faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Nuk desha të diskutoj, por po më duket që disa gjëra nuk po i kuptojmë në koncept dhe ma merr mendja që ka nevojë për t’u sqaruar dhe ka nevojë për t’u shpjeguar. Parlamenti i Kosovës që nga viti 2001 nxjerr ligje dhe të gjitha ato ligje që i kemi nxjerrë, kemi thënë - po bëjmë mirë se po i nxjerr institucioni i Kosovës, pavarësisht statusit dhe po aprovohen rregulloret e UNMIK-ut. Çka do të ndodhë nëse ky Parlament dy-treqind ligje që i ka nxjerrë që 7-8 vite, që është duke funksionuar, fillon t’i bëjë prej së pari, prej fillimit. Më falni, të jemi shumë korrekt në vetveten, ka nevojë ndoshta të bëhen ndryshime në ligje dhe nevoja për ndryshime është shumë reale, ndoshta ka nevojë të të gjitha të bëhen ndryshime, por të bëhen ligje prej fillimit, secila legjislaturë që vjen në këtë vend të bëjë ligje prej fillimit, kjo është më shumë se marri, ma shumë se marrëzi, do ta quaja. Do me thënë, ne thjeshtë, Kuvendi, nëse veç bash duam të shkojmë hala më tutje, ky Kuvend ka mundësi të nxjerrë një vendim, me të cilin edhe një herë i fuqizon krejt ato ligje të cilat janë bërë para shpalljes së pavarësisë dhe, natyrisht, me nevojën dhe kërkesën për t’i ndryshuar, çdo herë që ka nevojë të ndryshohet secili ligj. Ne po kemi nevojë për t’i ndryshuar madje edhe ligjet që i kemi nxjerrë para një viti, e para 5-6 muajve, e mos të flasim për ato që janë nxjerrë para 5-6 vjetëve. Ju lutem shumë, mos krijoni situata të paqena, mos krijoni situata të cilat e dezinformojnë dhe dezorientojnë jo veç këtë Kuvend, por të gjithë qytetarët e Kosovës. Ne edhe atëherë, edhe sot njësoj jemi zgjedhur dhe ky Kuvend është rezultat i atij sistemi zgjedhor. Ne nuk kemi bërë hiq një Kuvend të ri, as zgjedhje të reja, as një sistem krejt tjetër të përzgjedhjes së deputetëve, prandaj edhe të këtij Parlamenti. Kështu që është mirë të jemi korrekt me vetveten, me qytetarët edhe është mirë të mësohen sendet pak më mirë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Po e marrim një pauzë deri në ora 14:00 dhe pastaj e vazhdojmë. Kur t’i diskutojmë ligjet tjera, votojmë në pako ose veç e veç i votojmë, por tash po shkojmë në pauzë.

Drejtimin e seancës e merr zoti Naim Maloku, anëtar i Kryesisë

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

Ju lus që t’i zini vendet e punës. Vazhdojmë me rendin e ditës të seancës së sotme plenare. Ne e kemi një kërkesë që të vazhdojmë me pikën 10 dhe 11 dhe pastaj të shkojmë në votim veç e veç për secilën pikë të rendit të ditës. Pra, votimi do të bëhet veç e veç në fund të tri ligjeve për shkak se janë 59 deputetë në sallë dhe nuk e kemi kuorumin për votim.

Vazhdojmë me pikën e nëntë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për energjinë elektrike

Unë e kam, kërkesa për fjalë është në emër të Nexhat Daci, e nuk po e shoh se është këtu.

SEKRETARI: (Sqarim, nuk dëgjohet)

KRYESUESI: Nuk e di unë, është çështje procedurale. Urdhëro! Fjalën e ka Nexhat Daci.

BESA GAXHERRI: Sa për sqarim, zoti kryesues, fjalën e ka Besa Gexheri, por është kartela e kryetarit Daci këtu.

KRYESUESI: Por, regjia atje e ka emrin.

BESA GAXHERI: Ju po e shihni që nuk është këtu dhe nuk ke nevojë ta pësjtjellosh këtë punë.

Zoti kryesues, këtu pasi që nuk i ke deputetët për të marrë vendim, për të votuar, ti prapë duhet të marrësh vendim prej deputetëve a të diskutohet edhe ligji tjetër, pastaj të shkohet në vendim ose në votim për të dy ligjet, kështu që nuk mund të ecësh tutje në këtë formë. Ne duhet ose të votojmë tash ose, realisht, nuk po funksionon koalicioni dhe duhet të shkojmë. Ne opozita nuk mundemi gjithmonë t'ua bëjmë juve kuorumin.

KRYESUESI: Vazhdojmë. Ne kuorum kemi, 64 deputetë janë. Kërkoj deklarinimin me votim për miratimin, në parim, të Projektligjit për energjinë. Lus deputetët dhe regjinë që të bëhen gati për votim dhe votojmë tash.

Ju faleminderit! Konstatoj se me 37 vota “për”, 21 “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për energjinë.

Në bazë të Rregullores së Punës, Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion,
- Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
- Komisionin për Buxhet dhe Financa,
- Komisionin për Komunitete dhe
- Komisionin për Integritet Evropian, që brenda dy muajve nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime. Ju faleminderit!

Në sallë ishin 64 deputetë.

Kalojmë në pikën dhjetë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për energjinë elektrike

Konstatime hyrëse.

Në bazë të Rregullës 35, pika 1 të Rregullores së Punës, janë mbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji.

Ftoj ministren e Energjisë dhe të Minierave, zonjën Justina-Shiroka Pula, që para deputetëve të Kuvendit të prezantojë projektligjin. Ministre, e keni fjalën!

MINISTRJA JUSTINA SHIROKA PULA: I nderuari kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Në emër të Ministrisë së Energjisë dhe të Minierave paraqes për miratim para Kuvendit të Republikës së Kosovës Projektligjin për energji elektrike. Ligji në fuqi për sektorin e energjisë, e ndër to edhe Ligji për energji elektrike, numër 2004/10, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe të shpallur nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, në qershor të vitit 2004, përmes rregulloreve përkatëse, megjithëse kanë dhënë kontribut shumë të madh për ndërtimin e një baze infrastrukturore të sektorit të energjisë, kanë pasur edhe paqartësi në delegimin e përgjegjësive dhe autoriteteve, si dhe relacioneve ndërmjet tyre.

Qëllimi i Projektligjit për energji elektrike është të zhvillojë një treg konkurrues dhe të qëndrueshëm të energjisë elektrike, të garantojë kushte për prodhimin, transmisionin, shpërndarjen, furnizimin e sigurt të qëndrueshëm dhe të përhershëm me energji elektrike, duke iu përmbajtur parimeve të eficiencës së energjisë, të përcaktojë procedurat për dhënien e licencave për veprimtari në sferën e energjisë elektrike dhe për autorizimet dhe tenderimin e kapaciteteve të reja. Të sigurojë që të gjithë konsumatorët shtëpiak dhe në rast kur është teknikisht dhe ekonomikisht e arsyeshme, konsumatorët jo shtëpiakë të gëzojnë shërbime universale në bazë të tarifave të arsyeshme dhe të sigurojnë masa përkatëse për mbrojtjen e konsumatorëve fundor, në veçanti masat adekuate për mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë dhe të konsumatorëve në zona rurale, përfshirë masat me të cilat u ndihmohet për të shmangur shkyçjen.

Me këtë ligj përcaktohen rregulloret e përgjithshme për kryerjen e aktiviteteve të prodhimit, transmisionit të shpërndarjes, furnizimit dhe qasjes së interkoneksionit, organizimin në qasjen ndaj sistemeve të transmisionit dhe sistemit të shpërndarjes, si dhe për funksionimin dhe qasjen ndaj tregut të organizuar të energjisë elektrike. Projektligji për energji elektrike përbëhet prej 12 krerëve, 39 nene. Projektligji për energji elektrike është hartuar në përputhje me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Kosovës, nr. 01/2007. Projektligji ka formën dhe strukturën standarde në pajtim me Udhëzimin administrativ nr. 14/2008, për hartimin e projektligjeve dhe të akteve nënligjore. Në hartimin e këtij projektligji kanë marrë pjesë ekspertët nga institucionet e rëndësishme vendore dhe ndërkombëtare.

Projektligji nuk cenon ndonjë nga parimet e përgjithshme të ... sipas deklaratave të lëshuara nga Agjencioni për koordinimin e zhvillimit dhe integritetit evropian. Gjithë puna e hartimit të projektligjit është bërë në frymën e transparencës dhe të bashkëpunimit ndër-institucional.

Të nderuar deputetë,

Ju propozoj që ta miratoni, në parim, këtë Projektligj, i cili do të jetë në funksion të kompletimit të infrastrukturës ligjore në sektorin e energjisë në Republikën e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Hapi debatin për diskutim, në parim, të këtij Projektligji. Në emër të komisionit funksional nuk ka të lajmëruar. Kryetarët e komisioneve të tjera nuk janë paraqitur. Në emër të grupeve parlamentare, ftoj në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, zonjën deputete, Sala Berisha Shala, ta marrë fjalën.

SALA BERISHA SHALA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë dhe ju të pranishëm,
Projektligji për energjinë elektrike është një ndërvarësi me Ligjin mbi energjinë nr. 2004/8 dhe Ligjin për Rregullatorin e energjisë nr. 2004/9, të cilat janë në fuqi.

Nuk është e tepër të përsëritet dhe një herë qëllimi i këtij Projektligji, i cili është që të zhvillojë një treg konkurrues dhe të qëndrueshëm të energjisë elektrike me rregullat e përbashkëta sa i përket prodhimit, transmisionit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike dhe për qasjen në treg dhe në mes tjerash, qëllimi i tij është të sigurojë masa përkatëse për mbrojtjen e konsumatorëve fundor, në veçanti masa adekuate për mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë dhe konsumatorëve në zona rurale, përfshirë masat me të cilat ndihmohet që t'ju shmangen shkyçjeve. Këtë e ritheksova me qëllim se në Ligjin paraprak që u shqyrtua, disa nga kolegët deputetë i ngatërruan ligjet njërin me tjetrin.

Të nderuar, kolegë deputetë.

Sigurisht që gjatë hartimit të këtij Projektligji, hartuesi ka marrë për bazë praktikën më të mira në fushën e energjisë. Ky Projektligj është hartuar duke u bazuar në direktivat relevante të Bashkimit Evropian që kanë të lejuar në fushën e energjisë dhe është në përputhje me kërkesat e direktivave të komunitetit evropian për energji me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike. Në fund, në emër të Grupit të Partisë Demokratike e mbështes në parim dhe ju ftoj, të nderuar deputetë, që këtë draft ta mbështesni edhe ju. Kontributin e mëtejshëm, vërejtjet dhe sugjerimet do të jenë të mirëseardhura në komisionin parlamentar gjatë fazës së amendamentimit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Ftoj që në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, fjalën ta marrë Fatmir Rexhepi.

FATMIR REXHEPI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Edhe Projektligji për energjinë elektrike, në kuadër të pakos së projektligjeve për energjinë është në këtë grup dhe po kërkohet, pra, zëvendësimi i ligjit në fuqi, normalisht me plotësimet dhe ndryshimet të cilat i ka ofruar Qeveria në kuadër të këtij projektligji, bashkë me qëllimet të cilat u thanë edhe nga ministrja këtu, por edhe të cilat kanë qenë pjesë, po ashtu, e strukturës më të madhe, pra të përmbajtjes të projektligjit të kaluar, siç u thanë këtu, qoftë zhvillimi i tregut, konkurrencës dhe, duke u nisur nga prodhimi e deri te furnizimi me energji elektrike.

Një qëllim tjetër i këtij, pra, është edhe plotësimi ose ajo që shkruan në projektligj, që është natyrshëm, pra, për afrimin tash me standardet dhe direktivat e BE-së në fushën e energjisë elektrike, si dhe ristrukturimi i sektorit të energjetikës, që ka të bëjë me KEK-un, me të gjitha ndërmarrjet në kuadër të asaj çka planifikohet dhe iu duhet, pra, për një konkurrencë të gjitha këtyre korporatave të reja, ashtu qysh edhe është përfshirë në Projektligjin për energjinë elektrike. Një vërejtje parimore që mbetet për t'u shqyrtuar gjatë procedimit tonë, është që pas leximit edhe pas analizës të shohim se mos ndoshta diku ka ndonjë konflikt apo kompetenca të cilat kanë të bëjnë, sidomos te kapitulli i 8-të, kur është tregu i energjisë elektrike dhe operatori i tregut dhe institucionet e pavarura, sikur që është Zyra e Rregullatorit të Energjisë Elektrike. Pra, mbetet për t'u parë, për t'u analizuar, në mënyrë që të eliminohet ndonjë konflikt në mes këtyre dyve ose mos ka bartje të kompetencave në kuadër të operatorit të tregut më tepër se sa që i takojnë, ato që kanë qenë ose duhet të mbesin te Zyra e Rregullatorit për Energji Elektrike. Kjo është, pra, një vërejtje në parim, e cila mbetet për t'u parë, për t'u

analizuar dhe më thellë gjatë procedimit të mëtutjeshëm. Përndryshe, në emër të Grupit Parlamentar, ne e përkrahim.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, ftoj deputetin Et'hëm Çeku ta marrë fjalën.

ET'HEM ÇEKU: Ju faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë,

Ne e kemi po ashtu të njëjtin qëndrim sa i përket edhe të këtij projektligji. Mendoj që ndryshimet eventuale që kanë mundur të vijnë për shkak të zhvillimit dhe nevojave kohore që mund të ishin, duhet të ishin vetëm në aspektin e amendamentimit të ligjit që ishte. Në qoftë se është dashur të kemi ndryshime në ligj, është dashur që të bëjmë ndonjë amendamentim dhe të mos fillojmë gjithçka nga fillimi, nga pika zero. Ky është një problem shumë i madh në aspektin e zhvillimit të sektorit të energjetikës, sepse vazhdimisht po kthehemi në pikën fillestare, aty ku kemi qenë para disa viteve. Në qoftë se është kërkuar që të bëhet amendamentimi, të bëhet ndryshimi dhe t'i përshtatet direktivave të BE-së, duhet t'i shohim cilat ishin ato direktiva të cilat nuk ishin paraparë në Ligjin 2004, kur kemi qenë edhe atëherë në traktatin e komunitetit energjetik, do të thotë, nuk ka mundur as atëherë projektligji, ligji i atëhershëm të aprovohet në qoftë se nuk ka qenë me direktiva të njëjta. Në qoftë se kanë ndryshuar ato direktiva dhe që kanë ndryshuar, ato kanë mundur të vijnë përmes amendamenteve dhe ne mos të humbim shumë kohë në procesin ku kemi zhvillime në sektorin e energjetik.

Problemi tjetër, flasim për konkurrencën. Sipas koncepteve të cilat po lansohen, ne nuk kemi të bëjmë më me konkurrencën. Konkurrenca është shndërruar në një monopol energjetik dhe po shndërrohet në një monopol energjetik. Nuk ka këtu fare më konkurrencë dhe problemi i tretë madhor, që është në këtë projektligj, e shohim koston buxhetore. Shikoni vetëm koston buxhetore si është dhënë në këtë projektligj dhe pastaj të ndalemi a duhet ta mbështesim këtë projektligj dhe kostoja buxhetore se si do të implementohet projektligji. Prandaj, këto janë ato vërejtjet esenciale që ne si Grup Parlamentar jemi duke i bërë në funksion të zhvillimit të sektorit energjetik, jo në funksion të pengimit apo të ndalimit të sektorit energjetik, prandaj mendoj që janë gabime të mëdha që janë duke u bërë në këtë fushë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, ftoj deputeten Myzejene Selmani ta marrë fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Përsëritje për të gjithë!

Duke marrë parasysh se nuk isha prezent për Projektligjin e parë, i cili kaloi këtu dhe këto projektligje vijnë në pako për çështjen e rregullimit të sektorit të energjisë, i cili është problem që 10 vite në Kosovë. Projektligji për energjinë elektrike dhe Projektligji për energjinë dhe Projektligji për Rregullatorin e Energjisë, mund të them se janë direktiva të cilat as nuk janë harmonizuar njëra me tjetrën. Duke marrë parasysh se sektori i energjetikës është sektori më i rëndësishëm në Kosovë që përballet me reduktimet e energjisë elektrike edhe në këtë shekull, ky Ligj është total përkthim i direktivave në të cilat nuk mund të gjen zbatim Kosova dhe bazohet në ligjet 2004/8, Unë nuk di çfarë termash dhe çfarë koncesioni paraqet Ministria këtu, ku kjo fjalë mund të përdoret edhe mbipopullim dhe absolutisht nuk ka të bëjë me Ligjin e energjisë.

Më vjen shumë keq, por këso ligjesh nuk të pranoj për arsye të etikës profesionale timen, as në emër të Grupit Parlamentar. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, fjalën e ka deputeti Naser Rugova

NASER RUGOVA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Unë konsideroj se ne sot kemi shqyrtuar tri pika të rendit të ditës tejet të rëndësishme, të cilat kanë të bëjnë me rregullimin dhe ristrukturimin, orientimin e politikave dhe mbulimin me ligj të sistemit apo të sektorit të energjisë në vend. Shihen diskrepanca, vakume, mospërputhje, interferime kompetencash deri në paqartësi absurde të kësaj pakoje ligjore që ka të bëjë me sistemin energjetik të vendit.

Ne, si Grup Parlamentar i LDD-së, e kemi shqyrtuar me vëmendje, kemi konsultuar edhe ekspertë të shquar të lëmisë qoftë vendor, qoftë ndërkombëtar dhe, realisht, vetëm po ta lexojmë me vëmendje arsyetimin se pse është hartuar ligji i ri kur e kemi pasur një ligj jo më shumë se para 5 viteve. Arsyetimi për Projektligjin. Ky Projektligj zëvendëson Ligjin për energjinë elektrike, numër 2004/10, i cili është në fuqi dhe qëllimi i Projektligjit është përafrimi me direktivat e BE-së në fushën e energjisë, të cilat e obligojnë MEM-in për përmbushjen e kërkesave që dalin nga marrëveshja e nënshkruar e Traktati të komunitetit të energjisë. Dihet që politikat e Traktatit të Athinës ose të Traktatit të komunitetit për energjinë nuk ndërrojnë çdo dy muaj dhe këtu është dashur para organit më të lartë legjislativ të vendit, para të zgjedhurve të qytetarëve të ceket në mënyrë eksplicite cilat janë ato direktiva, sepse këtu po tentohet të shitet mjegull për arsye krejt tjera, që opinionin e di mirë dhe është krijuar kjo mjegull që nga dy vitet e fundit dhe është tentuar që të ndryshohet një koncept pothuajse pas lufte '99 – 2006-7, është tentuar të ndryshohet plotësisht dhe të vihen bazat e një qasjeje të re ndaj këtij sektori dhe po shihet që e keni humbur rrugën dhe nuk po mund ta gjeni rrugën adekuate dhe tani duhet që të vijnë pako ligjore të pastuduara, të pa analizuara, që shkaktojnë konfuzion, konflikt interesi dhe interferime brenda pakos së këtyre tri ligjeve dhe kemi edhe arsye mjaft serioze tjera që këtij ligji t'i themi – jo.

Unë dua të bëj apel tek deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, mos të bien pre të interesave ditore, të klaneve të caktuara politike dhe të grupeve të caktuara të interesit, sepse po bëhet fjalë për sistemin energjetik të vendit. Andaj, ne kërkojmë nga Qeveria që në mënyrë profesionale dhe në mënyrë procedurale ta informojë Kuvendin e Republikës së Kosovës. Pse nuk kemi shkuar në faza që kanë ndodhur me ligjet e tjera të sektorëve tjerë, plotësim, ndryshim ose riamendim, por ndërrohet koncept një infrastrukturë e tërë ligjore e një pako të ligjeve mu tani dhe në një seancë plenare dhe kjo lë shumë dilema edhe te njerëzit e zgjedhur, te deputetët që e kemi përgjegjësinë para qytetarëve dhe para popullit për ecjen tutje dhe zhvillimin e këtij sektori dhe, ju lutem, nuk zhvillohet ekonomia e Kosovës vetëm me dhënien me koncesion të një termocentrali apo me shitjen dhe gjenerimin, pa e debatuar në mënyrë profesionale dhe në mënyrë ligjore, siç duhet, të pasurisë kombëtare të këtij vendi. Janë gabim, krijohen kushtet për një klimë, për një ambient më të favorshëm për investitorët. Asnjë shtet nuk e ka zhvilluar ekonominë apo bruto produktin e vet vendor përmes shitjes apo gjenerimit të burimeve natyrore që i ka për energjetikë dhe ju e dini mirëfilli të gjithë këtë. Andaj, zonja ministre, duhet të jepni sqarime adekuate profesionale dhe jo të tentohet që me ligje të tilla të pakuptimta, të komplikuar, që kanë interferenca në mes veti dhe nuk

dihet qartë se një amendament i njërit ligj nga pakoja ligjore, interferon me amendamentin e ligjit tjetër, sidomos te kreu VIII e tjera e tjera dhe duhet në mënyrë eksplicite, se këtu po shihet thjeshtë qëllimi, që përmes udhëzimeve administrative pastaj të anashkaloni thjeshtë substancën, materien bazë të këtyre ligjeve. Kjo është e papranueshme dhe kjo po shihet sheshazi.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë nuk do ta votojë këtë Projektligj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, deputeti Zylfi Merxha e ka fjalën.

ZYLFI MERXHA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Ju përshëndes juve,

Përshëndes zëvendëskryeministrin,

Përshëndes ministrat,

Zonja e zotërinj deputetë,

Krejt kjo çka po flitet, po flitet për ligjet e 2004-shit. Na tash jemi më 2010. Për atë arsye, këto janë ligje të reja. Në qoftë se kanë ndonjë mundësi, ne do t'i rregullojmë nëpër komisione, se ky është leximi i parë.. Në emrin tim dhe në emër të Grupit “7+”, ne jemi “për”.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Kalojmë në diskutimet e deputetëve që e kanë kërkuar fjalën, sipas radhës. Deputeti Driton Tali e ka fjalën, le të përgatitet deputeti Riza Smaka. I lus deputetët që të kthehen në sallë, janë vetëm dy të lajmëruar për fjalë.

DRITON TALI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar atë pranishëm dhe të nderuar qytetarë që na përcillni përmes televizionit, Atë që e thashë për ligjin paraprak, po e përsëris edhe këtu. Po e bëj të njëjtën pyetje. Ky ligj çfarë prurje bën? Pse na është sjellë këtu? Dhe po ashtu po ia përkujtoj Qeverisë, po e pyes përsëri Qeverinë, pse nuk na e sillni Ligjin për privatizimin e sektorit të energjisë, ligj i cili është më se i domosdoshëm, aq më shumë kur kemi parasysh këtë procedurën që po kalojmë për privatizimin e sektorit të energjisë apo edhe për ndërtimin e kapaciteteve të reja.

T'i bëjmë këto kapacitete, ashtu siç i ka bërë bota me ligje, e jo me vlerësime, me mendimdhënie, me “ekspertiza” kush, qysh kujt t'ia merr mendja.

Sidoqoftë, sa i përket këtij ligji, do të flas diçka që po ashtu u fol edhe për ligjet tjera, në realitet gjithnjë po flasim për terminologjinë, e cila gjithnjë po na sfidon në këto ligje, jo vetëm në këtë sektor, u mor vesh, edhe në fushat tjera. Do të filloja që nga kreu i parë, pra këtu e kemi faqen 2. Më la përshtypje se këtu përdoret fjala: “Interkoneksion”, nuk jam kundër kësaj, por në gjuhën shqipe është ndërlidhje, është bashkëlidhje dhe pyetja ime është: - Nëse e përdorim interkoneksionin, që kurrë nuk ka të keqe, e jep njëfarë kuptimi të veçantë. Pastaj, nëse e përdorim fjalën: “kongestion”, po ashtu që kurrë këtu nuk ka të keqe, atëherë unë pyes specialistët - pse mundohemi disa fjalë që në gjuhën shqipe nuk e japin atë kuptimin puro, kuptimin e mirëfilltë, ashtu siç e japin ato origjinale dhe këtu e kam këtë me “distribucion”. Do me thonë, “distribucioni” herë përdoret “distribucion” e herë “shpërndarje”. Po them, kjo duhet të jetë “distribucion” për shkak se në gjuhët e huaja apo në anglishte, se këtu gjithnjë po përdoret,

“shpërndarja” nuk është përdorë në atë kuptimin disperse apo spread apo scattering apo dispel, do me thënë të gjitha këto fjalë që në një formë apo tjetër përkthehen “shpërndarje”, por është fjalë shumë profesionale, është “distribution”, që duhet të jetë distribuim, po them, kur i përdorim disa fjalë të tjera, them mbase në gjuhën shqipe japin më shumë kuptim se sa që kur i përkthejmë, gjithmonë po flas, se sa që jep “distribuimi” kur e përkthejmë në “shpërndarje”.

Pastaj, këtu do të ndalem te pika 1.4 - Kontrolli, ku thotë: “Nënkupton të drejtat, kontratat apo mjetet tjera të cilat ndaras apo në kombinim...”. Nëse është përkthyer apo nuk është adaptuar ashtu siç duhet, sepse do të duhej të ishte: “Kontrolli nënkupton të drejtat, kontratat apo mjetet tjera, të cilat”, do me thënë, duhet shtuar fjala këtu ose “ndaras” ose “në kombinim”. Nëse e lexoni, do ta shihni se kështu jep kuptimin pika 1.4.

Pastaj, te rrjedhja ndërkombëtare, pika 1.5, thuhet: “Rrjedhja ndërkufitare, do të thotë rrjedhja fizike e energjisë elektrike në sistemin e transmisionit përtej kufirit të Kosovës dhe një shteti tjetër”, që do të duhej të ishte “në mes kufirit të Kosovës dhe ndonjë shtet tjetër”, jo përtej, është “between Kosovo and another country”.

Pastaj, te pika 1.7, faqe 6, te dispaingu, mendoj se kjo formë e shkruar do të duhej të ishte ndryshe “scheduling” është adaptuar keq në gjuhën shqipe, do të duhej të ishte ndryshe. Pra ajo nuk nënkupton përcaktimin, scheduling nuk është përcaktimi është programimi, do me thënë “programimin paraprak” do duhej të ishte “të sistemit të energjisë elektrike për të siguruar se prodhimi i energjisë elektrike do të përmbushë kërkesën e parashikueshme”. Kështu jep kuptimin dhe jo në këtë formë siç është shkruar, nuk po e lexoj për mos me humbur kohë.

Pastaj, te përparësia ekonomike, mendoj se presidnt (president), nuk është përparësia, është por duhet të adaptohet në një fjalë tjetër, në fund të fundit të përdoret ashtu për shkak se përparësia ekonomike, economic advantage... është një fjalë që në vokabularin afarist përdoret më shumë dhe e jep atë konotacion që në këtë rast nuk e jep këtë konotacion, nëse e lexoni 1.11, jep një kuptim krejt tjetër apo është shkruar për kuptim tjetër.

Pastaj e kemi 1.12, këtu është bërë një mish-mash i derivateve financiare, nuk janë të energjisë elektrike, disa adaptohen apo shqipërohen, të tjerat tentohen të përkthehen dhe e humbin kuptimin, kështu që edhe ata që i njohin këto instrumente financiare, nuk e dinë se për çka po flitet. Ja është tentuar që futurat të përkthehen në gjuhën shqipe që është, mendoj, shumë e gabueshme. “Mundësitë në të ardhmen...” e tjera, tjera, ato janë futura, ashtu siç janë opsionet, ashtu siç janë swaps, pastaj kemi floor e collar, cylinder e tjera, e tjera, të cilat në gjuhën shqipe duhet t’i shqipërojmë suaps, flor, kollar, silinder etj, ashtu siç po e shqipërojmë “kongjestionin” apo “interkoneksionin” e tjera e tjera. Po them, për mos t’u futur edhe më shumë për shkak se pothuajse shumica e paragrafëve kanë kështu lëshimesh, unë do të ndalem, ja për shembull, e kemi këtë: rryma elektrike a prodhohet apo gjenerohet. Rryma gjenerohet!. Merreni, shikoni të gjitha enciklopeditë, qoftë britanica, qoftë hutchinson, qoftë Enciklopedinë Akademike Amerikane, aty shkruhet shumë mirë se rryma elektrike gjenerohet nga energjitë tjera, pra nuk prodhohet por rryma elektrike gjenerohet. Po them, duhet që t’i spastrojmë gjuhën shqipe. Përsëri po e ceku se në të gjitha lëmitë e kemi këtë sfidë të terminologjisë, por ja që mendoj se pak nga pak, me kohë do t’i tejkalojmë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet!

Fjalën e ka deputeti Riza Smaka, le të përgatitet i fundit, deputeti Naim Rrustemi.

RIZA SMAKA: I nderuari zotëri kryesues!

Qeveritar të nderuar,

Deputetë të respektuar,

Në parim, shkurtimisht. Nuk është praktikë legislative e mirë që një akt ligjor komplet të shfuqizohet pa asnjë fjalë. Bile, bile ekziston një teori që quhet negacioni negacionit, ka libra për këtë. Do me thënë, nuk është kjo në rregull, bile as nuk përkon as me komponentin e ekonomisë. Shpenzime diskutabile, kjo është një. Dy, ka ky dokument aq lëshime, sa që nuk ia vlen për t'u komentuar, sepse do të duhej të organizohej një tryezë e rrumbullakët, më së paku, por unë po e marr vetëm një shembull prototip, ju lutem. Që neni, po e zëmë, 38, ja çka thotë: "ky ligj fuqizon Ligjin për energjinë elektrike, nr.2004", ndërsa të gjitha aktet, vendimet, rregullat dhe dokumente tjera të miratuara apo të shpallura, sipas Ligjit 2004/10 mbeten të vlefshme, nëntë muaj pas hyrjes në fuqi. Figurativisht, kjo i bie kësi soji, një lis le të jetë frashër apo ah apo bung, kur e presim, ligji është trangu, degët bien më përpara se sa trangu. Po dua të them, aktet nënligjore ato automatikisht shfuqizohen në qoftë se ligji shfuqizohet, se ligji është bazamenti. Kjo, do me thënë, aspekt juridik, material, krejtësisht i gabuar, dallash. Zonja ministre apelohej në ekspertë që kanë marrë pjesë në hartimin e këtij dokumenti. Unë nuk e di atëherë, në qoftë se janë ekspertë, qenkan ekspertë për të shkruar diçka që nuk e njeh as doktrina, as praktika.

Paragrafi 2 i nenit të njëjtë, nëntë muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, të gjitha aktet, vendimet, rregullat dhe dokumentet tjera të miratuara apo të shpallura sipas Ligjit 2004/10, duhet të harmonizohen me ligj. Sipas këtij diksioni, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, nëntë muaj më pastaj do të duhej aktet nënligjore, që absolutisht, do me thënë, nuk ia vlen as për ta komentuar, se dalin interpretime shumë qesharake edhe kontraverze. Tek e fundit, aktet nënligjore do të duhej të miratoheshin sa parë që është e mundur, por kurrësi më vonë se 9 muaj. Sipas këtij formulimi del se tek pas 9 muajve duhet të bëhen ato dokumente. Unë, do me thënë, duke i akceptuar të gjitha ato që i tha kolegja jonë në emër të Grupit kuvendor të AKR-së, edhe këtë dokument nuk do ta kisha miratuar, në parim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputeti, Naim Rrustemi e ka fjalën!

NAIM RRUSTEMI: Ju faleminderit, kryesues!

Së pari, thashë, desha ta korrigjoj pak deputetin Tali, se ndoshta nuk është përkthyer prej anglishtes në shqip, ndoshta është përkthyer prej shqipes në anglisht, e kanë gabuar ata në anglisht. Po, se ka pasur mundësi kjo të jetë gabim dhe sigurisht që ligjet që bëhen në Kosovë, bëhen edhe prej ekspertizës vendore, ekspertët e kanë bërë, por edhe ata përkthyesit, është faji i përkthyesve që e kanë bërë shqip, në anglisht e kanë bërë keq. Kjo ishte sa për korrigjim të deputetit Tali, kurse unë do të ndalem vetëm te një nen i këtij ligji, që është neni 7, në të cilin flitet edhe për tarifën e rregulluar.

Të nderuar, është shumë me rëndësi të kemi parasysh se tarifën e rregulluar reflektojnë në kost-efektivitetin. Reflektojnë çmimin, kost-reflektiv. Ke parasysh se tash për tash sot, Zyra e Rregullatorit të Energjisë e ka të aprovuar - 9.4 euro centë. Nëse ne i lëmë këtu tarifën e rregulluar, atëherë kjo nuk nënkupton se është tarifë e rregulluar, sepse në këtë çmim nuk është i llogaritur qymyri, nuk janë të llogaritura subvencionet që bëhen

nga Qeveria. Me fjalë të tjera, nëse llogaritet qymyri dhe llogariten edhe subvencionet që i bë Qeveria, neve na bie energjia elektrike më shumë se dyfish. Në rast se ky ligj kalon kështu siç është, ky nen, atëherë presim të kemi rritje të energjisë elektrike 100%. Tarifat e rregulluara, ministër, kështu e reflektojnë, se nuk e keni llogaritur çmimin e qymyrit kur janë llogaritur tarifat. Nuk janë llogaritur as paratë, paraja publike që subvencionon KEK-un. Nuk janë llogaritur as të hyrat e investimeve kapitale. Në rast se të gjitha këto llogariten qysh llogariten në krejt Evropën, atëherë energjia elektrike në Kosovë bëhet shumë më shtrenjtë se në secilin vend në perëndim. Kjo ishte ajo profesionale, unë çka mendoj se është dashur të rishikohet, sepse gjatë llogaritjes së tyre është mirë të merret edhe dimensionin social parasysh. Kosova gjendet në një gjendje jo të mirë sociale. Nëse shkruajmë tjetër çka në ligj edhe më pastaj fillojmë me subvencione për të pasur konsideratë ndaj grupeve të rrezikuara sociale, atëherë kemi për të ardhur në një situatë ku do të kemi një ekonomi të planifikuar edhe sigurisht që nuk kemi për të pasur më pastaj kritika se po rreshtohemi nga një ekstrem i majtë, që ka kaluar koha e ekonomisë së planifikuar, tani mos po kthehemi në ekonominë e planifikuar. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Të nderuar deputetë, kërkoj deklarinimin me votim për miratimin, në parim, të këtij projektligji. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash. Mos ka deputetë që nuk ka kartelë? Nuk ka.

Konstatohet se me 29 vota “për” dhe 29 vota “kundër”, Kuvendi nuk e miratoi, në parim, Projektligjin për energjinë elektrike.

Kalojmë në pikën 11 të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Rregullatorin e Energjisë

Konstatime hyrëse:

Në bazë të Rregullës 35, pika 1 të Rregullores të Punës, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim, në parim, të këtij projektligji.

Ftoj ministren e Energjisë dhe të Minierave, zonjën Justina Pula - Shiroka, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë projektligjin. Ministre, e keni fjalën!

JUSTINA PULA- SHIROKA: ... paraqes për miratim, në parim, Kuvendit të Republikës së Kosovës Projektligjin për Rregullatorin e Energjisë.

Projektligji për Rregullatorin e Energjisë rregullon funksionimin e Zyrës së Rregullatorit për Energji si agjenci e pavarur e Republikës së Kosovës, e themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, sipas nenit 110.5 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Ky ligj përcakton kompetencat, detyrat dhe funksionet e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, përfshirë kushtet për dhënien e licencave për kryerjen e aktiviteteve në fushën e energjisë, procedurat për dhënien e autorizimeve për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese, krijimin dhe funksionimin efikas të tregjeve konkurruese të energjisë, si dhe kriteret për rregullimin e çmimeve dhe kushtet për furnizim me energji.

Gjithashtu, me këtë ligj përcaktohen përgjegjësitë e Zyrës së Rregullatorit për Energji për përkujdesjen e funksionimit transparent dhe jo diskriminues të tregjeve të energjisë, bazuar në parimet e tregut të lirë sa i përket aktiviteteve konkurruese dhe rregullimit të aktiviteteve të monopolizuara. Gjatë ushtrimit të funksioneve të veta,

Zyra e Rregullatorit të Energjisë, duhet të ketë parasysh zbatimin e masave të duhura për përforsimin e kohezioneve sociale dhe ekonomike në tërë Republikën e Kosovës.

Projektligji për Rregullatorin e Energjisë përbëhet prej 15 krerëve dhe gjithsej 52 neneve. Po ashtu, ky projektligj nuk cenon ndonjë nga parimet e përgjithshme të ... sipas deklaratës së lëshuar nga Agjencioni për koordinimin dhe zhvillimin dhe integrimin evropian. Gjithë puna e hartimit të Projektligjit është bërë në frymën transparencës dhe të bashkëpunimit ndërinstitucional.

Të nderuar deputetë, ju propozoj që ta miratoni këtë projektligj, i cili do të jetë në funksion të kompletimit të infrastrukturës ligjore në sektorin e energjisë të Republikës së Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja ministre!

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që për shkak të heqjes së dilemave për pikën e parafundit, para kësaj pike, në sallë ishin 63 deputetë prezentë, pra ne kemi pasur kuorum për votim, përkundër faktit që në votim kanë marrë pjesë me elektronikë 59 deputetë, për atë unë pyeta se a ka dikush pa kartelë, nuk pati do të thotë deputetë.

Më lejoni që ta hapi debatin për diskutim në parim të këtij Projektligji. Në emër të komisionit funksional, nuk ka të lajmëruar, të komisioneve, jo. Në emër të grupeve parlamentare ftoj deputeten, zonjën Sala Berisha Shala, që në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, ta marrë fjalën.

SALA BERISHA SHALA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë dhe ju të pranishëm,

Para se të filloj me analizimin e Projektligjit për Rregullatorin e Energjinë, më lejoni t'i them disa fjalë, se edhe kjo është në pakon e ligjeve të energjisë, po më nxitën diskutimet e disa kolegëve të mi deputetë, që ngritën shumë pikëpyetje dhe shumë dilema, të cilat pikëpyetje dhe dilema i bënë më shumë për opinionin publik, të cilin opinion e terrorizojnë duke e shfrytëzuar foltoren e Kuvendit dhe nuk kanë qasje konstruktive ndaj strategjive e drafteve, që jemi të obliguar si deputetë të kryejmë punën tonë në Parlament si përfaqësues të popullit.

Me fjalë tjera, dikujt i është ndalë ora në kohën e UNMIK-ut, prandaj dhe hedhin lot krokodili, kanë nostalgji për atë kohë për vitin 2004, pse po ndryshohen këto ligje, kjo pako e ligjeve të energjisë, pastaj ngrihen dilema, ato ligje kanë qenë shumë të mira, por të cilat direktiva nuk janë përfshirë në ato ligje. Përgjigja është se nuk janë përfshirë direktivat të cilat janë nxjerrë pas vitit 2004. Kjo është një përgjigje shumë e thjeshtë, që besoj që edhe kolegët e mi deputetë e dinë shumë mirë. Prandaj, ata nostalgjikët e UNMIK-ut, që dikur kanë shkëlqyer në kohën e tyre dhe tash kanë rënë dhe Kosova nuk kthehet mbrapa, nuk kthehet mbrapa për shumë arsye, edhe për arsye se ne jemi këtu dhe koha e tyre ka përfunduar, prandaj mos e shfrytëzoni, po e përsëris edhe njëherë, foltoren për ta terrorizuar opinionin publik. Këtu u fol nga një kolegë i yni, tha se për hir të etikës profesionale, nuk mund t'i pranoj këto projektligje dhe unë e pyes atë kolegë apo kolege, cila etikë profesionale, për cilën etikë bën fjalë, për etikën teorike profesionale, të cilën e ke, vetëm atë e ke. Etika profesionale praktike të mungon, zero është, prandaj nuk ke të drejtë të thirrësh në etikë profesionale. Edhe një tjetër qasje ndaj kësaj. Njëri nga kolegët deputetë tha se nuk duhet të shfuqizohen normat ligjore apo

juridike, sepse është komplet me disa rregulla që thirret si ekspertë që i di, por duhet bërë plotësim-ndryshime dhe unë ia shtroj pyetjen: Deri dhe, do me thënë, vitin 2004, kishim institucionet e pavarura, institucione vetëqeverisëse (IPVQ). A mendoni ju se duhet bërë plotësim-ndryshim në atë koncept për hir të asaj që nuk duhet të ndryshohet diçka. Tani Kosova është shtet i pavarur dhe sovran. Nëse dikujt nuk i pëlqen kjo edhe nëse mendon t'i mbledhë votat në opinion, e ka shumë gabim se do të mbetet tërë jetën në opozitë, por do të rrezikojë ta sigurojë edhe ulësen në Parlament.

Tani po i kthehem projektligjit në fjalë. Projektligji për Rregullatorin e Energjisë zëvendëson Ligjin nr. 2004/9, i cili është në fuqi. Qëllimi i këtij projektligji është përafrimi me direktivat e BE-së, të cilat obligojnë Ministrinë e Energjisë për përmbushjen e kërkesave nga marrëveshjet e nënshkruara të Traktatit të komunitetit të energjisë. Ne, si grup parlamentar e kemi analizuar këtë pako të projektligjeve, edhe ligjin të cilin po e diskutojmë tani. Kemi vërejtje, në parim. Gjatë analizimit të këtij drafti, natyrisht që kemi hasur edhe në disa dilema, si bie fjala tek neni 11, ku është e rregulluar konsulenca. Këtu mendojmë se duhet precizuar si të angazhohen konsulentë, mund të jenë konsulentë ish-punonjësit e ZRE-së edhe pas afatit kohor prej kur e kanë lëshuar këtë institucion e tjera, nga se e kemi praktika jo të mira, sidomos në agjencionet e pavarura, ku investohet në profesionalizmin e tyre dhe pastaj ikin nga aty për t'u kthyer si konsulentë. Këtë në komision parlamentar do ta kemi shumë parasysh dhe do t'i marrim edhe sugjerimet dhe vërejtjet e tjerëve.

Mandej, mbrojtja e konsumatorëve, mendojmë se duhet të ketë vëmendjen më të theksuar në këtë ligj. Te kreu i katërt, ku parashihet financimi, mandej shfrytëzimi i fondeve, buxheti vjetor e tjera. Edhe këtu kemi disa vërejtje parimore, kështu që duhet të kemi kujdes. Tek neni 28, ku rregullohen aktivitetet që nuk kërkojnë licencë, edhe këtu mendoj se duhet analizuar me kujdes kapacitetet prodhuese, cilat janë ato, çfarë kapacitetesh duhet të kërkojnë licencë apo jo, mandej kohëzgjatja e licencave e tjera.

Me fjalë tjera, me gjithë këto vërejtje dhe dilema, ne si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e mbështesim në parim dhe ju ftoj të gjithë juve, kolegë deputetë, që të kontribuoni me vërejtjet dhe sugjerimet e juaja gjatë fazës së amendamentimit në komisionet parlamentare përkatëse. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, faleminderit, deputete! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, ftoj deputetin Fatmir Rexhepi ta marrë fjalën.

FATMIR REXHEPI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë,

Të nderuar ministra,

Nga paketa, ky është ligji i tretë që po e shqyrtojmë, pra, Projektligji për Rregullatorin e Energjisë elektrike. Është thënë edhe në Projektligj se e zëvendëson edhe e plotëson apo rishkruhet kështu si është përmbajtja e këtij projektligji, me arsyetimet që u dhanë nga zonja ministre dhe ajo që është dhënë nga Qeveria, dhe natyrisht që ai përcakton, pra, funksionimin, kryesisht ka tri qëllime të veta, pra, funksionimin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, si agjencion i pavarur, po ashtu kodifikon pra këtë organizim me gjitha kompetencat, detyrat, fushëveprimtarinë e këtij institucioni, si dhe përgjegjësitë e tij.

Është, po ashtu parësore në kuadër të tij se plotësohen me ndryshime, normalisht edhe krijimi dhe ndërtimi i primeve të funksionimit të tregut, të konkurrencës, sektorin e

energjisë bashkë me kriteret, standardet dhe rregullimin e kushteve të furnizimit me energji elektrike.

Çështja e tretë është, pra, mbikëqyrja apo monitorimi i zbatimit të rregullave të kësaj çka kodifikohet në kuadër të aktiviteteve dhe të sistemit energjetik që ka të bëjë me autoritetin e pavarur, në këtë rast, pra, agjencioni, Zyra e Rregullatorit, e cila duhet të punojë me këto katër projektligje, siç është Ligji për energjinë, Ligji për energjinë elektrike, Ligji për ngrohjen qendrore dhe Ligji për gazin natyror.

Ajo që u pa pak më herët, pra, megjithatë, unë mendoj që do të dalë një defekt tash, meqenëse nuk u aprovua Projektligji me ndryshime dhe plotësime, që ishte në rend dite pak më parë për energjinë elektrike. Unë e ndaj mendimin tim se ka qenë më mirë të aprovohej dhe të ecet në pako, në parim, kështu që komisioni të punojë, ta plotësojë, ta ndryshojë dhe t'iu përshtatemi këtyre ndryshimeve të reja, të cilat kanë pasuar. Por, vullneti, verdikti është ky, prandaj e respektojmë.

Diçka tjetër që do të veçoj, këtu do të ritheksoj në fund të fjalisë time, pas shqyrtimit ..., nga ajo çka u dëgjua këtu, unë do të veçoj se ne e kishim për shqyrtim, si deputetë në Parlament, pakon e tri projektligjeve dhe unë mendoj që shpeshherë i ngatërroam çështjet nga vlerësimi në parim i projektligjeve, dolëm te tema dhe dilema që krijuam këtu dhe nuk e bëmë ndarjen korrekte mes asaj të analizojmë faktet, të analizojmë eksperiencën, përvojën tonë parlamentare dhe ta bëjmë në funksion këtyre projektligjeve, por unë mendoj, pra, që ishte debati për projektligjet, por dolëm te një temë tjetër. Në rend dite projektligji, ndërsa ane debatin e fokusuam, e zhvendosëm në strategjinë për energji, pra në strategji e cila do të vjen në Parlament. Unë, jo rastësisht e përmenda në fillim. Ne e kemi debatuar edhe në Grupin tonë Parlamentar, si thashë a do të ishte më mirë të aprovohej Projektligji e pastaj strategjia, por meqenëse kanë ardhur kështu në renditje, ne i dhamë përparësi kësaj, me bindje se deri në leximin e dytë, do të ulemi e ta shikojmë strategjinë dhe të gjitha ato çështje që u shtruan këtu nga deputetët, e që strategjia është ajo kryesorja për të cilën duhet të flasim, pra, çka do të ndodhë në sektorin e energjetikës në të gjitha proceset, qoftë me investimet, me kapacitetet e reja, me strategjinë lidhur me privatizimin, me shumë çështje që kanë të bëjnë me strategjinë, qoftë bilancin energjetik ose balancën dhe pasuritë, potencialin, investimet, strategjia, pra, e cila duhet të përshtatet dhe të përputhet me nevojat të cilat i duhen zhvillimit makro-ekonomik të vendit. Pra, ajo mbetet dhe ne mbetemi konsekuent, si grup parlamentar, që sa më shpejt që është e mundur, pra, në Parlament të vjen në debat, se edhe ashtu janë rregullat, ashtu është procedura e parlamentare dhe vërtet ta bëjmë një debat parlamentar, të përgatitemi që ta japim kontributin tonë në ndërtimin e një strategjie dhjetëvjeçare, e cila sektorin e energjisë e orienton në interes të zhvillimit ekonomik të vendit. Pra, i heqim të gjitha ato dilema, së paku si debat parlamentar. Prandaj, presim dhe kërkojmë dhe do të punojmë si Grup Parlamentar që të biem sa më shpejtë strategjinë për energjinë, kështu që pakoja e projektligjeve, unë mendimin tim e ndaj që ma mirë ka qenë të shkojë, por është si është, ecim tutje dhe shohim se çka po ndodhë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, ftoj deputetin Et'hem Çeku ta marrë fjalën.

ETHEM ÇEKU: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Ne sot po e diskutojmë, do të thotë, është Projektligji i tretë edhe ndoshta me keqardhje që duhet të them që po ndajmë opinione mjaft të ndryshme sa i përket çështjes së këtyre projektligjeve.

Ky projektligj është nga ata më të rëndësishmit. U fol më herët, u theksua nga kolegët që projektligjet apo ligjet duhet të ndryshohen, do të thotë askush nuk ishte që t'i ndalim orët, por të gjithë ishim për të shtyrë, për të ecën përpara, mirëpo gabimet që janë duke u bërë në këtë sektor, në infrastrukturën ligjore, në strategjinë që e përmendi kolegu më herët. Unë, nuk deshëm ta shtrojmë dilemë a duhet të ishte strategjia të aprovohet dhe pastaj t'i hedhim në diskutim projektligjet të cilat duhet të jenë në harmoni me strategjinë zhvillimore të sektorit të energjetikës në Kosovë.

Ne, edhe një herë po e theksojmë me plotë bindje se kjo formë e cila qoftë, është nga ministria apo qoftë e shtyrë nga ekspertët e ashtuquajtur konsulentët javorë, që vinë në Kosovë dhe imponojnë një koncept të tillë për të ndryshuar urgjentisht një ligj, urgjentisht për të ndryshuar, mendoj se është një qasje e gabuar, sepse them edhe një herë, Ministria ka mundur shumë lehtë të sjellë amendamente, duke i plotësuar me direktivat e reja, sepse në esencë këtu nuk paraqet burmë të madh dallues, përpos që e them, ka bukur shumë ndërhyrje në disa sektorë apo në disa fusha të cilat nuk bëjnë qëndrueshmëri për sektorin. Ky ligj tek Zyra e Rregullatorit, ne duhet të definojmë një herë qartë a dëshirojmë të kemi rregullator të pavarur ekonomik, do të thotë, rregullator të pavarur ekonomik. Unë e di që edhe kolegët nga pozita, në diskutime dhe në tryezat e rrumbullakëta e kanë mbrojtur idenë që ne duhet të kemi rregullator të pavarur ekonomik. Më vjen keq që sot nuk është një pjesë e tyre, se nuk besoj që ndajnë opinion të kundërt me opinionin që unë sot e prezantoj këtu. Prandaj, ky projektligj mendoj se nuk do të shkojë prapë në favorin e zhvillimit dhe të arritjes së objektivave për furnizimin e qytetarëve me energji elektrike. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit të AKR-së, ftoj deputeten Myzejene Selmani ta marrë fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Duke marrë parasysh se Kuvendi po shfrytëzohet më shumë për publicitet politik, atëherë edhe unë do të jap publicitetin tim politik në lidhje me këto pako të projektligjeve të energjisë, duke marrë parasysh se të gjithë jemi këtu për interesin e qytetarëve dhe jo për interesin e mbi tokës dhe nëntokës dhe duke marrë parasysh se titulli im është inxhinier e energjetikës dhe nuk është inxhinier e minierave dhe inxhinier lloj-llojesh xehetarisë dhe duke marrë parasysh se profesioni im ka qenë profesion dhe është shumë etik në lidhje me ligjet përkatëse, mund të them se edhe nga opozita i është ndihmuar ... së kësaj Qeverie, mirëpo në këtë aspekt, me këto ligje të cilat nuk janë me direktivat e BE-së dhe nuk janë për zhvillim ekonomik, le të harrojë që voton AKR-ja. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

(Reagime në sallë)

Deputetë të nderuar, vazhdojmë seancën. Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, ftoj deputeten Synevere Rysha ta marrë fjalën.

SYNAVERE RYSHA: Ju faleminderit!

Pra, është ky Projektligji i tretë nga pakoja për Rregullatorin e Energjetikës, të cilin projektligj Lidhja Demokratike e Dardanisë, që në fillim do t'ju themi se nuk do ta votojë. Arseja pse nuk do ta votojmë, është se projektligji është hartuar dhe është sjellë në Kuvend në mënyrën më të keqe të mundshme. Arsyeshmëria për Projektligjin ka qenë një arsye shumë e thjeshtë dhe shumë e papranueshme për neve si Lidhje Demokratike e Dardanisë dhe thuhet - përafrimi me direktivat e BE-së.

Duke pasur parasysh se përfaqësuesja nga PDK-ja, e cila është edhe pjesë e Qeverisë, e tha nostalgjinë për UNMIK-un, unë them, lirisht mund të konstatoj, nëse kurrëgjë tjetër nuk ka bërë UNMIK-u, të paktën direktivat e BE-së i ka pasur shumë parasysh dhe ka bërë harmonizimin, të gjitha ligjet që i ka përgatitur, të paktën këtë direktivë e ka pasur parasysh. Mirëpo, këtu po del diçka kontraverse, prandaj nuk di a t'i besoj Qeverisë, a mos t'i besoj. Nga kjo po del se ky ligj më tepër është hartuar për nevojat dhe interesat e zyrtarëve të lartë të Qeverisë. Janë disa fakte që e argumentojnë këtë thënie. Sido që të jetë, janë edhe vërejtjet tjera nga pjesa financiare apo kur është në pyetje buxheti i ndarë për Rregullatorin e Energjisë, mënyra e inkasimit, taksat apo janë disa nene të papranueshme që vërtet ndoshta duhet të rishikohen.

Të hyrat e inkasuara, në nenin 21 parashihet buxheti vjetor për të punësuarit në Rregullatorin e Energjetikës dhe pika 5, të hyrat e inkasuara, nëse janë të pamjaftueshme, do me thënë ata, Rregullatori kërkon nga Buxheti i Republikës së Kosovës që të plotësohen. Por të hyrat e tepërta nuk i parasheh dhe ndoshta do të ishte mirë që ato teprica që të destinohen dhe të derdhen në Buxhetin e konsoliduar, që kjo nuk është paraparë. Mandej, te neni 23, pagesat e taksave. Edhe këtu duhet pasur parasysh se në pikën 6 thuhet se taksat vjetore janë 2% të qarkullimit të përgjithshëm dhe duhet të bëjmë ndoshta një dallim në mes taksave dhe tatimit dhe kush ka të drejtë të inkasojë tatim dhe kush taksë. Nëse shkojmë në 2% të qarkullimit, atëherë kjo kalon në tatim dhe kjo ndoshta është mirë të harmonizohet dhe të shikohet me Administratën Tatimore, sepse do të ishte një diçka që është e papranueshme, sepse taksat janë taksa fikse vjetore, ndërsa tatimi është për qarkullimin që e bën biznesi.

Sido që të jetë, janë edhe disa vërejtje tjera, por në përgjithësi ne kemi vendosur të mos e përkrahim. Ky është mendimi i Lidhjes Demokratike të Dardanisë.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar "7+", deputeti Zylfi Merxha e ka fjalën.

ZYLFI MERXHA: Ju faleminderit, zotni kryesues i nderuar!

Ju përshëndes juve dhe stafin e juaj,

I përshëndes ministrat, se zëvendëskryeministri nuk qenka aty ose unë nuk po e shoh,

Zonja e zotërinj deputetë,

E dëgjova zonjën e parë dhe zonjën e dytë, nuk po dua t'i emëroj për t'ju dhënë replikë, mirëpo ata po flasin, prapë po ju them, për 2004-shin, ne jemi duke folur për 2010-shin. Shumë ndërrime janë bërë, mirëpo mbasi nuk është lëmia ime, mos t'i shti hundët gjithkund, unë, po më pëlqen mua ky ligj dhe në emrin tim dhe të Grupit "7+", do ta votoj me zemër. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, nuk ka të lajmëruar. Kalojmë te deputetët sipas radhës së paraqitjes. Fjalën e ka deputeti Naim Rustemi, le të përgatitet deputeti Ibrahim Makolli.

NAIM RRUSTEMI: Ju faleminderit, kryesues!

Unë do të dal me disa propozime konkrete lidhur me participimin apo me emërimin e anëtarëve në Bordin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë. Unë kam propozim konkret, kam propozim që anëtarët e Bordit, ashtu e kështu janë përfaqësues të partive politike, të ceket edhe në ligj që anëtarët e Bordit do të jenë përfaqësues të partive politike. Kurrëgjë të keqe nuk ka, veç është e ndershme, ato çka e shohim që është prezentë, të bëhet ligjore. Ky është propozimi konkret dhe do të vazhdoj me tutje me disa, sepse edhe ashtu, për shembull, në pikën 3.2, nuk mund të jenë anëtarë aktiv të asnjë partie politike. Ne e dimë se Zyra e Rregullatorit të Energjisë elektrike është politike, e dinë krejt, e di secili që merret me punë në fushën e sektorit të energjisë. E kemi pikën 3.3, edhe këtu kam një propozim konkret. Këtu nuk mund të jenë ata vetë, nuk mund të jenë bashkëshortë, aty e këtu, nuk mund të jenë të afërm të ngushtë. Unë propozoj që ky nen të zëvendësohet edhe që të jetë – duke respektuar Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit.

Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit kishte për t'i rregulluar edhe në njëfarë forme dalëngadalë po vijmë në një situatë ku i harmonizojmë edhe legjislacionin, e harmonizojmë këtë ligj me ligjet e tjera, kështu që nuk ka nevojë për t'u cekë të cilët e të cilët, kur e kemi një ligj që tregon kush nuk është dashur të jetë prej zyrtarëve, që të trajtohen si zyrtar, nëse duam ta respektojmë, ne ashtu e kështu Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit nuk jemi duke e respektuar, se s'është duke e respektuar kryesisht udhëheqja dhe ajo mu në Kuvend.

Gjithashtu, në nenin 7, Statusi dhe pagat e anëtarëve të Bordit dhe stafit. Anëtarët e Bordit do të paguhen me paga mujore dhe mëditje në pajtim me Ligjin për pagat e zyrtarëve të lartë publikë. Unë propozoj që mos të shkojë kështu, se nuk ka ligj për pagat a e zyrtarëve të lartë publikë. Nëse nuk ka ligj për pagat e zyrtarëve publikë, është prejjudikim, hala pa e ditur qysh ka për të qenë ligji, na po e shtim njëherë, sipas ligjit që do të jetë, kështu që propozoj, ata që merren më pastaj gjatë leximit të dytë apo kurdo që të merren, që të vendoset një pagë apo edhe që të shërbej ky diskutim i imi për të filluar një iniciativë për t'i harmonizuar pagat e anëtarëve të bordeve të agjencive të pavarura, se Zyra e Rregullatorit në njëfarë forme është institucion i pavarur ose, së paku, do të duhej të jetë institucion i pavarur. Formalisht është, por edhe jo formalisht ishte dashur të jetë sepse ka të bëjë me rregullimin e shumë sektorëve, sektori më i rëndësishëm se sektori i energjisë.

Edhe pikat 1.3, 1.4 dhe 1.5 gjithashtu ishte dashur të rishikohen. Çka do të thotë kjo – “miraton nivelet e kompensimit dhe kushtet dhe afatet tjera për të punësuarit e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë”. Ne e dimë që Zyra e Rregullatorit të Energjisë i mbledh do mjete, i mbledh se kur aplikojnë për licenca, grumbullohet një sasi e mjeteve. Po, të miratohen nivelet e veta të kompensimit, nuk kishte qenë e ndershme, ishte dashur të ketë politika adekuate për të qenë të barabartë edhe me institucione të tjera.

Gjithashtu, do të koncentrohem te konsulenca. Në pikën ku parashihet për konsulencë, e përmendi edhe dikush tjetër, aty thuhet se do të bëhet me Ligjin e prokurimit publik. Nuk ka nevojë të përdoret Ligji i prokurimit publik, sepse ne përmes pyetjeve parlamentare shumë herë i kemi parë ministrat që nuk ka nevojë. Nëse kanë thënë ata që nuk ka nevojë, ata e kanë ditur që s'paska nevojë. Pasi nuk paska nevojë, mund ta përdorin kontratën mbi veprën, që është integzistente, që nuk ekziston, ose le të përdorin kontratën mbi vepër, që nuk ekziston, që për ta ekziston, le ta përdorin edhe këtu. Pse të përdorin Ligjin për prokurim publik veç sa për t'i ngatërruar sendet, të

shkojnë 8 javë, 9 javë, ndoshta edhe 3 muaj ditë derisa ta pranojnë konsulencën, kështu që mirë kishte qenë të rishqyrtohet edhe këtë pikë. Unë me cinizëm po e them, po e them, por të trajtohet se si me të vërtetë do të kompensohet konsulenca dhe si do të angazhohen në konsulencë. Këto ishin disa prej vërejtjeve të mia. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ibrahim Makolli, le të përgatitet deputeti i fundit për këtë pikë të rendit të ditës, Naser Rugova. Tash u lajmëruar edhe një, në rregull.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë,

Unë do të përqendrohem te neni 18 i draftligjit. Ne jo rrallë herë kemi debatuar për Zyrën e Rregullatorit për Energji dhe unë do të mbështetem te neni 18, sipas të cilit i jepet të drejtë Zyrës që taksat e inkasuara nga licencimi dhe aktivitetet e tjera, të jenë në të hyrat e dedikuara të zyrës.

Sikurse shihet me këtë ligj, Zyra e Rregullatorit për Energji ka financim nga buxheti, prandaj nuk do të duhej të llogariteshin këto mjete si të hyra të përdorshme për Zyrën e Rregullatorit për Energji. Po i përmendi disa prej pikave që janë. Thuhet, ndër të tjera, që shërbejnë për financimin e aktiviteteve të zyrës, përfshirë shpenzimet operative, pagat, mëditjet dhe benificionet e anëtarëve të Bordit, të punëtorëve dhe të personelit, shpenzimet për studime, analiza, vlerësime e tjerë, përmirësimin e kualifikimit të anëtarëve të Bordit, të menaxhmentit dhe të anëtarëve të tjerë të stafit. Atëherë, sipas kësaj logjike, në nenin 5, anëtarët e Bordit duhet të jenë njerëz profesional dhe në këtë vend, përpos anëtarëve të Bordit, pra, të Rregullatorit për Energji, të cilët po krijuakan të hyra vetanake dhe mund t'i përdorin për vete, për këtë avancim, pra pse mos të përdoren edhe agjencionet e tjera që krijojnë të hyra. Ta zëmë, Policia e Kosovës inkason diku të hyra nga dënimet 7 deri 8 milionë euro në vit. Pse, pra, të mos i përdorë edhe policia ose edhe shëndetësia, edhe të tjerët, këto të hyra për shpenzimet e veta për ngritjen e efikasitetit e tjera, e tjera. Do të thotë, në asnjë rast këto agjencione të cilat krijojnë të ardhura, nuk do të duhej t'i shfrytëzojnë për nevojat e veta. Po pajtohem me parafolësin që e tha, ne kemi disa borde të pavarura në vend, të cilat do të duhej të kishin një trajtim të njëjtë të pagave. Ju keni, Zyra e Rregullatorit për Energji është më e privileguara prej të gjitha agjencioneve të pavarura dhe duhet përfundimisht të ketë një ligj, i cili e përcakton pagën e këtyre, e anëtarëve të bordeve. Përpos pagës, këtu thuhet edhe mëditjet nga takimet. Këtu, këto çështje duhet të përmirësohen në këtë ligj, në mënyrë që të mos shkaktojmë tash përplasje dhe shkelje të bordeve tjera të cilat janë në funksion. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Naser Rugova, le të përgatitet deputeti Driton Tali.

NASER RUGOVA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Po e nënvizoj edhe një herë, jemi duke diskutuar për një pako të ligjeve që e rregullojnë një nga sektorët më të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të vendit tonë dhe për krijimin e një ambienti normal për investimet e huaja direkte që, në prag të shënimit të dyvjetorit të pavarësisë, ende asnjë cent investim i huaj direkt nuk është bërë në këtë vend. Duke e ditur gjendjen e rëndë edhe të këtij sektori, por edhe gjendjen ekonomiko-sociale të popullit dhe të Kosovës në përgjithësi, duhet të jemi të kujdesshëm, duhet të

jemi serioz, duhet të bëjmë debat analitik, ashtu siç i takon një përfaqësuesi të zgjedhur të qytetarëve.

Projektligji për Rregullatorin e Energjisë, në radhë të parë ky Kuvend, pa marrë parasysh presionet politike, interesat e fokus grupeve të caktuara të komunitetit të biznesit apo edhe të klaneve politike, e ka një përgjegjësi krejt tjetër, shumë më larg se ato interesa, e ka përgjegjësinë e hartimit të një legjislacioni adekuat e sidomos kur është çështja për projektligjet e sektorëve të ndjeshëm, që kanë rëndësi vitale për zhvillimin ekonomik të vendit. Po diskutojmë për Projektligjin për Rregullatorin e Energjisë, një rregullator i pavarur. A kemi autoritete, agjencione rregullative të pavarura në Kosovë? Fatkeqësisht, këto 10 vitet e fundit janë dëgjuar akuza të ndërsjella qoftë të një grupi politik që ka qenë në pozitë apo në opozitë, se po e bën këtë dhe po e bën atë. Emëruesi i përbashkët i dy viteve të fundit del se këto njësi dhe kategori kushtetuese, këto borde apo agjencione të pavarura, këto trupa rregullative, këto dy vitet e fundit janë super të politizuara, nuk ka problem që janë të politizuara, sepse tek e fundit jemi dy milionë qytetarë dhe është normale, por janë joprofesionale. Kjo shihet edhe në nxjerrjen e dokumenteve, hartimin e politikave, planifikimin e politikave, mos të flasim për strategjinë.

Një koleg i nderuar këtu e përmendi çështjen e Strategjisë nacionale të Kosovës për energji. Unë konsideroj që më mirë do të ishte që të hartohej një strategji, të analizohej, të përcaktoheshin objektivat afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë dhe në bazë të asaj strategjie dhe dinamikës kohore të zbatimit të saj, të nxirrej kjo pako e rëndësishme ligjore dhe jo të vijë para strategjie një pako e tillë, zonja ministre, e pa artikuluar si duhet, e pa qëndrueshme, me vakume, me dilema dhe që interferon njëri ligj në tjetrin. Dhe, unë frikoj, sikurse që janë hartuar ligje edhe në kohën e UNMIK-ut plotë fat, unë nuk jam deputet i legjislaturave të UNMIK-ut, jam deputet i një legjislature të një kohe më të re pak, janë mu këta deputetë tani që po e përmendin UNMIK-un. Fatkeqësisht, janë koalicionet qeverisëse ku UNMIK-u, Rezoluta 1244 dhe do plane tjera 7-pikëshe, 9-pikëshe po i zbatoni dhe po ua përmendin çdo ditë dhe këtu duhet të jemi kujdesshëm. Jemi duke folur për sistemin energjetik të vendit dhe për Bordin e Rregullatorit të Energjisë, sepse po kalojmë në plane tjera.

Dhe, tani, ky projektligj për Rregullatorin e Energjisë është një ligj tejte i rëndësishëm, i cili përcakton kompetencat, detyrat, funksionet e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, përfshirë kushtet për nxjerrjen e licencave, për kryerjen e aktiviteteve në fushën e energjisë, do të thotë, të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë në fushën e energjisë. Procedurat për dhënien e autorizimeve për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese, krijimin dhe funksionimin efikas të tregjeve konkurruese të energjisë dhe kriteret për rregullimin e çmimeve dhe kushtet për furnizimin me energji. Do të thotë, është bërthama, është skeleti i mbarëvajtjes apo edhe i shpresës për konsolidimin e sistemit energjetik të vendit. Për këtë arsye, unë thjeshtë më bëhet qejfi dhe unë jam i lumtur që deputetët e kanë lexuar me vëmendje këtë pako ligjore dhe nuk po votojnë ad-hok, apo siç ju ka thënë dikush nga udhëheqësit e partive të tyre apo nga grupet e tjera të interesit.

Për shembull, te neni 31, kufizimet të disa llojeve të licencave. Unë frikoj që bie ndesh me konkurrencën e tregut të lirë. Paragrafi 2, vetëm një licencë, thotë, do të lëshohet në tërë Kosovën për operatorin e bartjes së gazit natyror. Këtu duhet shqyrtohet dhe po më vjen keq që në komisionin funksional nuk janë debatuar në mënyrë analitike apo nëse nuk kanë ardhur ligjet fare, i nderuar kolegë, në komisionin funksional, pse po luhet me deputetë dhe me këtë Kuvend. Si kanë ardhur ligjet, me parashutë i ka lëshuar ligjet

dikush në këtë seancë? Kjo atëherë tregon që nuk jemi në rrugë të duhur. Përkundër, këtij Kuvendi gradualisht po i humbet vlera. Nëse dikush nga jashtë ka sugjeruar që kjo pako ligjore të vijë pa kaluar nëpër komision, zonja ministre, jeni profesorëshë e universiteti, duhet të keni kujdes, të konsultoheni sepse edhe Presidentin, edhe Qeverinë i ka zgjedhur Kuvendi dhe ekzekutivi i jep llogari legjislativit. Këto janë gjëra që... Do të vazhdoj tutje te paragrafi 3. “Vetëm një licencë do të lëshohet në tërë Kosovën për furnizimin publik të energjisë elektrike”. Unë frikoj që ligji për partneritetin publiko-privat, që Qeveria po e trumbeton me të madhe, pastaj edhe operatorët dhe prodhuesit e tjerë, qoftë me koncesion, qoftë si investitorë privatë, do të bien ndesh me parimet e konkurrencës së tregut të lirë dhe këtu duhet ne si deputetë ta themi fjalën tonë.

Paragrafi 4, “vetëm një licencë do të lëshohet për çdo rajon të licencuar të Kosovës për shpërndarjen e energjisë elektrike”. Për çfarë rajoni? A është ky ligj që nënkupton funksionimin në tërë Republikën e Kosovës apo janë rajone të bazuara në organizimin e sistemit energjetik? Po, ju lutem, çdo qytetarë që i bie në dorë ky ligj, çdo profesionistë, çdo njeri që kupton diçka nga terminologjia juridike, nga legjislacioni, po edhe nga përgjegjësia politike, këtë nen do ta riformulonte. Përndryshe, po biem në pozitë shumë jo serioze si njerëz të zgjedhur dhe si institucione.

Do të thotë, edhe një herë po e potencoj, zonja ministre, vetëm një licencë do të lëshohet për çdo rajon të licencuar të Kosovës. Cilat rajone dhe për çfarë rajonesh. Kjo po lë dilema shumë të mëdha edhe për mua si deputetë, por edhe për opinionin. Për shpërndarjen e energjisë elektrike, të ngrohjes apo të gazit natyror, mund të ekzistojë një apo disa rajone të licencuara për shpërndarjen e energjisë elektrike, të ngrohjes apo të gazit natyror. Cilat janë ato rajone? Për çfarë rajonesh bëhet fjalë? Ky është shqetësim shumë serioz. Nëse bëhet fjalë për pjesën ku “Elektroprivreda” e Serbisë vepron lirshëm dhe për 30% të territorit të Republikës së Kosovës ku kjo qeveri s’ka dorë fare, atëherë kjo është shumë shqetësuese.

Dhe, unë kisha propozuar tani, si deputet, që këto pako të projektligjeve ishte dash ministrja tash ta propozojë, të tërhiqen mbrapa, të riformulohen si duhen dhe mos të na sjellin në pozicione të tilla të palakueshme edhe politike, edhe kushtetuese, edhe morale, edhe institucionale. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Driton Tali, le të përgatitet, tani po kuptoj, si deputet, Fatmir Rexhepi.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë do të jem i shkurtër kësaj radhe, do të ndalem te neni 11, ku nuk pajtohem fare me kolegun tim të nderuar, zotin Rustemaj, ku tha se puna e konsulencave, të injorohet Ligji mbi prokurimin publik dhe sugjeroi që kjo të rregullohet me kontratën mbi veprën. Unë e kundërshtoj këtë, sepse kontratë mbi vepër legjislacioni i Republikës së Kosovës, qoftë ai i vitit 2001, apo 2000, apo ky pas pavarësisë, nuk e njeh. Pra, çdo punësim me kontratë mbi vepër e shkel Ligjin mbi prokurimin. Unë mbase do ta lesa mundësinë që kjo terminologji, që e kanë farkuar qeveritarët tanë, të legjislatohet, por me një farë rregulle, sepse Ligji aktual për prokurimin publik shumë mirë thotë se çdo vepër, çdo projekt, aktivitet që e tejkalon shumën 100 euro brenda vitit financiar, pra 1 janar – 31 dhjetor, duhet të shkojë nëpërmjet të paktën tri ofertave dhe shumat më të mëdha, duhet të hapen tenderët.

Ne e dimë që nëpër këto ndërmarrjet publike tonat, qoftë në PTK, ishte shuma 800 vetë që janë punësuar me kontratë mbi vepër, e që shuma e atyre kumulative i kalon milionat, që është shkelje drastike e Ligjit të prokurimit. Ngjashëm është edhe në KEK, është në RTK, pra të gjitha ndërmarrjet publike kanë keqpërdorur këtë terminologji të kohës së monizmit, ndonëse edhe në monizëm, atëherë shumë mirë, pra, kur s'ka ekzistuar prokurimi, është qartësuar, është shpjeguar se çka është kontrata mbi vepër, nuk mund të punësosh dikë me afate të përhershme nën ombrellën e kontratës mbi vepër. Mendoj se kjo është diçka që EULEX-i duhet të merret më seriozisht, të shoh se çka po ndodh aty.

Po ashtu, zoti kryesues, unë do të ndalesha për shkak se nga natyra jam egaletarian dhe kam qejf t'i respektoj këto gjërat dhe t'i sanksionoj me ligj. Këtu pjesërisht pajtohem me zoti Rustemi, kur tha se kam fjalën për te anëtarët e bordeve, t'i legalizojmë për shkak se në këtë mënyrë ne ata i kemi bërë, po e thyejnë ligjin, është fjala ... të gjitha bordet. Pra t'i legalizojmë, t'i bëjmë me ligj që anëtarët e bordeve të jenë domosdo anëtarë të partive politike, ashtu që mos t'i shtimë edhe ata në siklet, po edhe Qeverinë, që ta dimë paraprakisht se në bordet e ndërmarrjeve publike janë dhe duhet të jenë anëtarë të partive politike për ta mbajtur baraspeshën politike, për shkak se edhe për atë qohen atje. Kaq desha të them, faleminderit, zoti kryesues!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Fatmir Rexhepi e ka fjalën. Në bazë të Rregullores, pra, keni të drejtë tani si deputet, më parë keni folur në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së.

FATMIR REXHEPI: Edhe ashtu ka kohë që s'kam folur si deputet, e po ma qesin këta njësh (1) atje, po tutem, kështu që më mirë të flas pak, ta plotësoj.

Atëherë, si deputet, unë mendoj që ka qenë në interesin tonë, megjithatë, kjo pako e ligjeve të kalojë në parim, për arsye të punëve dhe të rëndësisë së madhe që ka kjo pako e ligjeve të mos ndahet. E them këtë, se nuk kemi pasur nevojë gjatë debatit të biem shumë argumente dhe në mes asaj se a është dashur të amendamentohet apo ligji i ri. Mua nuk më ka mbetur hatri pse është rishkruar ligji në tërësi, me ndryshime dhe plotësime të nevojshme, edhe pse unë kam qenë kryetar i Komisionit parlamentar për Energjetikë dhe Ekonomi në vitin 2004. Pra, po e pranoj atë, po e them që ne kemi pasur mundësinë tjetër që si komision parlamentar, bashkë me Ministrinë, vërtet, ta plotësojmë dhe ndryshojmë në procedura deri në leximin e dytë. Mendoj që ky ka qenë varianti më i mirë. Do të shohim më vonë se do të kemi pengesa sa i përket realizimit të projektit dhe të programit të vetë Ministrisë dhe të Qeverisë.

Arsyeja tjetër që e mora fjalën është edhe kjo, se unë dje nuk kam qenë në seancë për arsye objektive, ta jap një sqarim të vogël edhe një mesazh t'ia përcjell deputetit Et'hem Çeku, për fjalimin e tij dje që e ka mbajtur këtu lidhur me komisionin e pavarur, nga ato njoftimet që i mora unë.

KRYESUESI: Deputet, ne e kemi fjalën për ligjin, të lutem!

FATMIR REXHEPI: Qe, po e përfundoj, po e përfundoj, pavarësisht, është vazhdim i seancës, unë po e replikoj Et'hemit për arsye se e ka përmendur çështjen e kandidaturës së zotit Ibush Jonuzi, se në komision ose Fatmir Rexhepi nuk është dashur ta përkrah atë që i ka humbur zgjedhjet. Unë po i them mesazhin tim Et'hemit se ai nuk i ka humbur, nuk i ka fituar, ai s'ka pas çka të humb, nuk u ka qenë në pushtet atje. Dhe, unë mendoj që zoti Ibush Jonuzi, si kandidat për komisionin, është njëri ndër inxhinierët me

eksperiencën më të mirë të xehetarisë dhe të metalurgjisë dhe me kontributet qoftë politike dhe parlamentare, prandaj mendoj se reagimi është i drejtë, se në seancë ka qenë mirë kur të jem unë me të flasë, jo kur s'jam unë. Faleminderit!

KRYESUESI: Për replikë, deputeti Et'hem Çeku, 2 minuta.

ET'HEM ÇEKU: Këtë çështje e kam shtruar dje por bordin, edhe sot për Zyrën e Rregullatorit. Unë mendoj që këtu problemet janë tepër të ndejshme dhe të mëdha. Ne duhet ta definojmë me ligj, a duam dhe si duam ta rregullojmë. Unë e kam parë Ibush Jonuzin, jo si në vijën, nuk e kam trajtuar problemin në vijën profesionale, se e njoh shumë mirë Ibushin edhe kur kam qenë në pozitën e ministrit dhe si deputet, mirëpo është shtruar problemi, se ata i kanë sjellë me veti biografite, ku i tregojnë të gjithë anëtarët e bordit që janë në hierarki politike të lartë. Prandaj, ishte problemi ky, a duhet të kemi borde të cilat në aspektin ligjor, nuk ju mundëson të jenë anëtarë të bordeve, kurse në aspektin çfarë po vendoset këtu në praktikë, po kemi emërime në aspektet politike. Prandaj, unë, kolegu Fatmir, këtë e kam shtruar në raport me ligjin, se në të njëjtën mënyrë kemi vepruar për Bordin e Hekurudhave, i kemi eliminuar për shkak se i kanë takuar vijës politike, kemi thënë nuk bënë. Prandaj, të kemi disa parime dhe ato parime të kthehen në aspektet ligjore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Nuk të lajmëruar të tjerë për fjalë. Ju lutem, të nderuar deputetë, kërkoj deklarinimin me votim për miratimin, në parim, të projektligjit. Në sallë janë 67 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Konstatoj se me 35 vota “për”, 30 “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për Rregullatorin e Energjisë.

Në bazë të Rregullores së Punës, Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion,
- Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
- Komisionin për Buxhet dhe Financa,
- Komisionin për Komunitete, dhe
- Komisionin për Integritet Evropian, që brenda dy muajve nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime. Ju faleminderit!

Kalojmë në pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Mjekësinë Ligjore,

Konstatime hyrëse. Në bazë të Rregullës 35.1 të Rregullores së Punës, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim, në parim, të këtij projektligji.

Ftoj ministren e Drejtësisë, Nekibe Kelmendin, që para deputetëve të Kuvendit të prezantojë projektligjin. E keni fjalën, zonja ministre!

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: I nderuar kryesues i seancës,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë ministra,

Në emër të Ministrisë së Drejtësisë sot para Kuvendit të Republikës së Kosovës prezantoj Projektligjin për Mjekësi Ligjore, të cilin e kanë hartuar ekspertët e Ministrisë së Drejtësisë, në bashkëpunim me ekspertët ndërkombëtarë dhe ekspertë të tjerë që kanë mund të kontribuojnë në këtë fushë.

Me këtë projektligj, përndryshe, kompletohet infrastruktura ligjore në fushën e mjekësisë ligjore. Ky projektligj është në harmoni të plotë me dispozitat e legjislacionit të BE-së dhe të shteteve të zhvilluara, që dëshmohej edhe me deklaratën e pajtueshmërisë me legjislacionin e BE-së, të lëshuar nga Agjencia për Integritet Evropian.

Me këtë projektligj rregullohet procedura, vendi dhe afatet kohore për kryerjen e ekzaminimeve mjekoligjore nga ana e ekspertëve mjeko-ligjorë, patologëve të Departamentit për Mjekësi Ligjore, si institucion i vetëm kompetentë në këtë fushë.

Patologët, gjatë punës së tyre janë të detyruar të kryejnë ekzaminimet mjekoligjore në mënyrë profesionale, objektive të pavarur, të paanshme dhe jo diskriminuese, duke ju përmbajtur parimit të fshehtësisë profesionale lidhur me të dhënat e mbledhura, analizat dhe të gjeturat tjera, siç është përcaktuar me këtë ligj.

Pra, me këtë projektligj krijohet baza ligjore edhe për zhvarrosjen e kufomave. Qëllimi i këtij ligji është që nëpërmjet ekzaminimeve mjekoligjore të ofrohen dëshmi për t'u përdorur në hetuesi dhe në procese gjyqësore në çështjet penale e civile.

Me këtë projektligj përcaktohet që ekspertët e mjekësisë ligjore, pra patologët, duke përdorur metoda dhe rregullat e shkencës së mjekësisë, e në bazë të procedurave të përcaktuara me ligj, të kryejnë autopsinë dhe zhvarrosjen e kufomave me qëllim të ofrimit të të dhënave lidhur me shkaqet e vdekjeve jo natyrore, ndonjëherë zbulimin e rasteve të vdekjes gjatë mjekimeve të pandërgjegjshme, përcaktimin e kohës së vdekjes, identifikimin e kufomave, konstatimin e lëndimeve, llojin e lëndimeve, kohën e shkakut të tyre dhe të pasojave që ato lëndime lënë për njeriun dhe shëndetin e tij.

Ky projektligj do të ndikojë në shtimin e efikasitetit të prokurorive dhe gjyqësorit për zbulimin e veprave penale dhe të kryesve të tyre, përcaktimin e shkallës së përgjegjësisë penale të tyre dhe në këtë mënyrë do të kthehet edhe besimi i qytetarëve tek prokuroritë, gjykatat si në çështjet penale, ashtu edhe në çështjet civile. Për shkak se Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar vitin e kaluar Ligjin mbi themelimin e departamentit të mjekësisë ligjore, ky projektligj nuk është aq voluminoz, ka gjithsej 4 kapituj me 20 nene, të cilat paraqesin tërë kompozicionin e tij.

Të nderuar deputetë,

Për të qenë e sinqertë dhe korrekte ndaj jush, dua t'ju informoj se ky projektligj është i kushtueshëm, pra zbatimi i tij kushton gjithsej 290.240 euro. Ky projektligj është miratuar në Qeveri, më 4 dhjetor 2009, do të thotë para miratimit të Ligjit për Buxhetin e Kosovës. Ndërkaq, me Ligjin për buxhetin e Kosovës nuk janë përfshirë këto mjete financiare për zbatimin e këtij ligji, ndonëse i kam kërkuar me kohë edhe për këtë ligj, sikundër që kam kërkuar edhe për ligje të tjera që janë në strategjinë legjislative për Ministrinë e Drejtësisë, të miratuara nga Qeveri dhe Kuvendi i Kosovës.

Megjithatë, për faktin se ky projektligj është me interes të përgjithshëm shoqëror, sidomos për identifikimin e personave të pagjetur, që për disa prej tyre nevojitet të bëhet edhe zhvarrosja apo ekshumimi, e cila nuk mund të bëhet pa urdhrin e gjykatës kompetente dhe pa procedurat që janë përcaktuar me këtë ligj, kurse çështja e zhvarrosjes është rregulluar pikërisht me këtë ligj, meqë ky ligj është edhe pjesë e sfidave të ngritura në Raportin e progresit për vitin 2009, për kompletimin e infrastrukturës ligjore në fushën e mjekësisë ligjore, ju lus që ta miratoni në lexim të parë, në parim, kurse mjetet financiare për zbatimin e tij, siç më është premtuar nga Qeveria, do të ndahen me rastin e rishikimit të buxhetit, i cili do të bëhet në gjysmën e këtij viti dhe unë shpresoj se deri atëherë ligji nuk do të hyjë në fuqi. I mirëpres të gjitha sugjerimet dhe komentet e juaja në funksion të përmirësimit dhe të mënjanimin të mangësive eventuale të këtij ligji.

KRYESUESI: Faleminderit, zonja ministre!

Më lejoni të hap debatin për diskutim, në parim, për këtë projektligj.

Në emër të Komisionit funksional për Legjislacion dhe Gjyqësi, ftoj kryetarin e komisionit, Bahri Hyseni, ta marrë fjalën.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përsëritet, të nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Do të flas edhe në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës.

Edhe Komisioni, edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e kemi shqyrtuar Projektligjin për mjekësinë ligjore, në parim, dhe gjatë shqyrtimit kemi konstatuar se Projektligji për mjekësinë ligjore, siç tha edhe ministrja e Drejtësisë, i ka dokumentet e domosdoshme që të lexohet në parim, natyrisht e ka edhe deklaratën financiare dhe ministrja e sqaroi, është një deklaratë financiare që buxheti nuk është paraparë për vitin 2010, mirëpo është një buxhet i cili është konstatuar se është i përballueshëm për buxhetin e Kosovës dhe shpresoj që do të ketë zgjidhje në rishqyrtim të buxhetit.

Projektligji është i hartuar mirër, është një konstatim i përgjithshëm, mirëpo vlen të përmendet se, natyrisht, me rastin e hartimit ka edhe disa çështje për të cilat ndoshta është mirë ta njoftojmë seancën plenare për disa sqarime që t'i marrin në seancën plenare.

Sqarimi i parë, ndoshta me interes, është rreth afateve që janë paraparë për ekzaminimet mjekoligjore. Natyrisht që neni 5, paragrafi 1, thotë, të gjitha ekzaminimet mjekoligjore duhet të kryhen pa vonesë. Mirëpo, realisht nuk është përcaktuar një afat kohor, i cili ndoshta do të ndihmonte që të ketë organi apo departamenti përkatës efikasitet me rastin e ekzaminimeve mjekoligjore. Është përcaktuar një afat 6 mujorë, mirëpo ky është rast i jashtëzakonshëm, atëherë kur nuk arrijnë departamenti t'i sigurojë të dhënat për ekzaminimin në rast, atëherë kërkohet varrimi dhe kjo pjesë nuk iu ndihmon çështjeve të përgjithshme. Jo 6 orë, po flas për diçka tjetër, për 6 muaj kur nuk gjendet, nuk identifikohet rasti, atëherë jepet mendimi që të varroset dhe është çështje normale.

Një çështje tjetër me interes vlen të përmendet, për shembull, në nenin 11, është një çështje që mund të përmirësohet dhe nëse e lexoni, për shembull, nenin 11 thotë: departamenti i kryen të gjitha ekzaminimet kliniko- mjekoligjore, të cilat përfshijnë, por nuk kufizohen për të përcaktuar, nuk ndërlihen. Ndoshta është mirë që së paku të shkojmë ashtu siç është në versionin në gjuhën serbe dhe angleze, sepse atje është mirë. Shpresoj që kjo do të rregullohet.

Është një çështje që ndoshta është me interes të diskutojë seanca edhe për orarin e punës, të diskutojë edhe për pagesat që janë paraparë, sepse do të na sjell në dilema a kemi të drejtë ne të shkurtojmë orarin e punës, sepse është një ligj i përgjithshëm, i cili e përcakton orarin e punës, edhe pse flitet për diçka që është specifike, mirëpo kjo çështje do të mbetet që ne do të konsultohemi edhe me ministren e Drejtësisë gjatë punës së mëtutjeshme.

Ndërsa, neni 17, kur flet, thotë - deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji do të zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi. Konsideroj që është e panevojshme, sepse ndesh e shkruam, ndesh se shkruam, pa hyrë në fuqi ligji, nuk do të zbatohet asnjë dispozitë, por janë çështje që nganjëherë edhe ekspertët ligjorë mund të bëjë lëshime të tilla.

Edhe neni 19, ndoshta është shfuqizimi. Ky ligj shfuqizon të gjitha dispozitat ligjore që janë në kundërshtim me te. Ndoshta është mirë të përcaktohet, sepse dispozita ligjore mund të ketë në shumë ligje, por ne të përcaktohem se me hyrjen në fuqi të ligjit, shfuqizohen ligjet që kanë qenë në fuqi dhe e kanë rregulluar këtë çështje, sepse me dispozita ligjore, vetvetiu, në praktikën juridike ligjet më të reja i shfuqizojnë ato dispozita të cilat bien në kundërshtim me dispozitat aktuale të ligjit.

Si përfundim, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, por edhe komisioni konsideron se projektligji është i shkruar jashtëzakonisht mirë, me disa vërejtje që i bëmë, që janë vërejtur, jo edhe shumë ndoshta përmbajtësore dhe e përkrahim që të aprovohet, në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, ftoj deputeten Fatmire Berisha ta marrë fjalën.

FATMIRE BERISHA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar ministra,

Deputetë të respektuar,

Projektligji për mjekësinë ligjore, është një alternativë më e mirë se sa ligji ekzistues, rregullon procedurat për kryerjen e ekzaminimeve mjekoligjore nën autoritetin e Departamentit të Mjekësisë Ligjore.

Në parim, ne si Grup Parlamentar i LDK-së, e mbështesim këtë projektligj dhe për këtë fazë të shqyrtimit të projektligjit, paraqesim këto vërejtje:

Në nenin 9, që i referohet procesit të zhvarrosjes, është mirë të specifikohen qartë rregullat, procedurat e zhvarrosjes, si dhe çështja e zhvarrosjes masive, që për vendin tonë është ende një çështje e ndjeshme dhe e dhimbshme, njëkohësisht. Këtij neni mendojmë se duhet shtuar një paragraf, që do t'i përmbante autorizimet, procedurat dhe rregullat e zhvarrosjes.

Një çështje që nuk vërehet në këtë projektligj, është se në çdo spital që ka mbi 200 shtetër duhet të rregullohet me ligj që të kemi mjekoligjorë dhe patologë. Dihet që në spitalet e Kosovës ka mjaft raste që varrosen pa u konstatuar shkaku i vdekjes, po edhe plot raste të vdekjeve në shtëpi, pa u ditur po ashtu shkaku. Informatat e tilla për shkaqet e vdekjes së popullatës, krijojnë një bazë reale për orientimin e politikave dhe të strategjive të veçanta të shëndetësisë.

Në këtë projektligj paraqiten kategorizimi i pagesave shtesë dhe puna jashtë orarit për punën dhe ekzaminimet mjekoligjore nga ana e ekspertëve. Kompensimet projektohen veç e veç nga gjykata, e cila kërkon ekspertimin mjekoligjor në pajtim me aktin e veçantë nënligjor, që e nxjerr Qeveria. Neni 15 e thotë kështu, ndërsa Departamenti i Buxhetit thotë se kjo çështje rregullohet me akt të veçantë nënligjor, të cilin e nxjerr Këshilli Gjyqësor i Kosovës, pra vjen në kundërshtim me nenin 15. Kjo duhet rregulluar me siguri në komisionin funksional.

Nuk mund pa i përmendur, sado që u përmendën edhe nga parafolësi, neni 5, 6, si dhe neni 11, jo vetëm në aspektin gjuhësor, por edhe përmbajtësor, sidomos ky neni 11, me paragrafët dhe alinetë e tij ka nevojë për do përmirësime.

Si Grup Parlamentar, pra, ne do ta japim kontributin tonë me punën e anëtarëve të komisioneve funksionale. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, ftoj deputeten Zylfije Hundozi ta marr fjalën.

ZYLFIJE HUNDOZI: Faleminderit, zoti kryesues!

Kjo veprimtari mjekësore edhe pse ka rëndësinë e veçantë në mjekësi, shumë kohë është përcjellë me probleme të llojllojshme. Shpresojmë se tani, me formimin e bazës ligjore për këtë lëmi, do të eliminohen problemet ekzistuese.

Qëllimi i projektligjit është që të rregullojë procedurat për kryerjen e ekzaminimeve mjekoligjore nën autoritetin e Departamentit të Mjekësisë Ligjore.

Miratimi i këtij projektligji është përgjigje në rekomandimet konkrete të Raportit të progresit të Komisionit Evropian për vitin 2009, në të cilin thuhet se nuk ka Ligj për Mjekësi Ligjore dhe nuk ka Departament për Mjekësi Ligjore. Në opinion ligjor të Agjencionit për koordinim dhe zhvillim dhe integrim evropian thuhet se ky projektligj nuk është i rregulluar në nivelin e Bashkimit Evropian, gjegjësisht nuk ka ndonjë akt normativ i cili e rregullon këtë çështje. Nëse e marrim parasysh se ky opinion është shkruar në fund të gushtit, në ndërkohë legjislacioni i Bashkimit Evropian ka bërë përparim në këtë drejtim duke miratuar vendimin e Këshillit të Evropës 2009/905, të 30 nëntorit për akreditimin e punëtorëve që kryejnë shërbime mjekoligjore, kryesisht aktivitete laboratorike, kështu që Komisioni për Integritet Evropian do të propozojë që komisioni funksional të inkorporojë këtë direktivë të Këshillit të Evropës në projektligj.

Unë i kam edhe disa vërejtje për çështjen e psikiatrisë ligjore, çështje e cila është tejet delikate dhe e rëndësishme sa i përket aspektit juridik të Kodit penal dhe kërkon një tretman të veçantë nga psikiatria e përgjithshme, por edhe nga mjekësia ligjore, me të cilën e lidh vetëm aspekti juridik. Psikiatria ligjore është fushë e psikiatrisë e cila përfshin të gjitha aspektet e trajtimit, observimit klinik, ekzaminimit dhe evaluimit me metoda të veçanta biologjike, psikologjike dhe sociale dhe përpilimit të raportit - ekspertizë përfundimtare me urdhëresë të gjykatës.

Psikiatria ligjore është tani në kuadër të Klinikës Psikiatrike dhe aty duhet të mbetet për shkak të trajtimit profesional të pacientëve, të observimit i cili kërkon hospitalizimin e pacientëve dhe trajtimin e tyre, gjë që është në kohezion me punën klinike në psikiatri.

Objekti i vlerësimit në Psikiatrinë Ligjore është vetë individi i cili duhet të jetë prezentë, duhet të trajtohet, të observohet dhe të vlerësohet në aspektin mendorë dhe në bazë të kësaj të jepet edhe mendimi përfundimtar.

Prandaj, Psikiatria Ligjore tani funksionon në kuadër të Psikiatrisë dhe është e pakuptimit të bëhet dyfishimi i saj me një tjetër departament, me ç'rast do të bëhen shpenzime të panevojshme dhe për shkaqe që i numërova më lart, puna nuk do të jetë e suksesshme. Kështu që mendoj që funksionimi i Psikiatrisë Ligjore duhet të precizohet në këtë projektligj, kështu si është formular – do të krijohen edhe probleme të mëtutjeshme.

Por, sa i përket projektligjit në përgjithësi, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah këtë projektligj dhe do ta japë kontributin e vetë në komisionin funksional. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, ftoj deputetin Adem Salihaj ta marrë fjalën. Ju nuk keni sjellë me shkrim se kush... Ibrahim Makolli e ka fjalën, pra.

IBRAHIM MAKOLLI: Njëjtë, nuk prish punë.

Ju faleminderit, zoti kryesues!

Ky ligj hyn në pjesën e ligjeve të mira që i ka ofruar Qeveria Kuvendit dhe i plotëson në përgjegjësi kërkesat dhe nevojat që parashihen dhe parashtrohen. Ndoshta një diçka që nuk është e paraparë në këtë projektligj, e që besoj që do të duhej të ishte, janë edhe punët private që mund të kryhen ,përveç autopsisë, siç janë analizat e ADN-së, ekspertiza mjekoligjore gjinekologjike, të komunikacionit nuk parashihet në këtë ligj, nuk parashihet praktika private, sikurse ekziston në vendet e tjera të perëndimit, në shumicën e vendeve ekziston, natyrisht, përcaktohen se në cilat shkallë.

Përndryshe, besoj te neni 17, është gabim teknik, ka mbetur gjatë draftimit të tij. Ky ligj i plotëson kushtet dhe do ta ketë mbështetjen e Grupit Parlamentar të AKR-së. Natyrisht, ne besojmë që në procedurat e mëtutjeshme do të pasurohet edhe me idetë të cilat janë dhënë këtu. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, ftoj deputeten Mufera Shinik ta marrë fjalën.

Më falni, zonja deputete! Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Adem Salihaj e ka fjalën. Më falni, ishte ky gabimi im.

ADEM SALIHAI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Anëtarë të Qeverisë,

Edhe Grupi Parlamentar i LDD-së mendon se ky projektligj është një projektligj relativisht i hartuar mirë dhe mund të shkojë në procedurën e mëtutjeshme. Kemi disa vërejtje që do t'i përmendim edhe sot, por që në procedurë do ta japim kontributin tonë për amendamentim.

Mendojmë që do të duhej të kishte përkufizimet, që termat dihen çka nënkuptojnë. Pastaj, mendojmë që duhet t'i kushtohet një rëndësi rregullimit të statusit të ekspertëve të Mjekësisë Ligjore, të cilët e dimë, edhe në Kosovë kanë kryer trajnime dhe janë aftësuar, por për mungesë të rregullimit të statusit, ndoshta ikin shkojnë dika tjetër.

Mungesa e buxhetit është një hendikep dhe pa këtë buxhet nuk mund të fillojë implementimi apo zbatimi i këtij ligji dhe kjo çështje duhet të rregullohet në mënyrë urgjente, ndoshta para aprovimit në leximin e dytë.

Diku-diku ka nga pak paqartësi logjike dhe ne mendojmë që në proces mund t'i zgjidhim këto çështje. Siç thashë edhe në fillim, Grupi Parlamentar i LDD-së, në parim e përkrah këtë projektligj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Edhe njëherë kërkoj falje për renditjen e grupeve parlamentare, që ishte gabimi im.

Të nderuar deputetë, me Rregullore ne nuk mund të vazhdojmë për shkak të kuorumit, jemi 38 deputetë në sallë, edhe një po del, - 37. Unë i ftoj deputetët që të kthehen në sallë, mendoj që është ligj i cili duhet të kalojë dhe do të kishte qenë mirë të kalojë për shkak të problematikës me të cilën përballlet Kosova, e që ky ligj është shumë me rëndësi, mos të bëjmë tash fushatë. Deputetë, kuorumin e kemi për debat.

Të nderuar deputetë, vazhdojmë me debatin.

E kemi kuorumin për debat. Në emër të Grupit Parlamentar "7+", ftoj deputeten Mufera Shinik ta marrë fjalën.

MYFERA SHINIK: Faleminderit zotëri kryesues. Unë jam Myfera Shinik. Faleminderit!

Adli tip Yasa Tasarısını 7+ Parlamenter grubu olarak incelemiştir. Uygun iyi bir yasa olarak görülmektedir. Tabi ki öneri ve uyarılarımız olacaktır. Bu uyarılarımızı komisyonda, ilgili komisyonlarda sunacağız.

Teşekkür ederim.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete!

Për vërejtjen tuaj, këtu në ekran del Mufera dhe ju duhet të intervenoni në regji, që në dokumentacionin e deputetëve të figurojë ashtu siç thatë ju, nuk isha fajtorë unë.

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, nuk ka të lajmëruar.

Kalojmë te deputetët e paraqitur sipas radhës. Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Sylja, le të përgatitet për fjalë deputeti Shkumbin Demaliaj.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryesues!

Kosova ka nevojë për plotësimin ose komplet infrastrukturën për Mjekësinë Ligjore, sidomos duke marrë parasysh që ne ballafaqohemi ende me një çështje shumë të ndjeshme, siç është çështja e personave të pagjetur. Prandaj, me këtë projektligj krijohet korniza ligjore për rregullimin e procedurave mjekoligjore, pra, nën autoritetin e Departamentit të Mjekësisë Ligjore. Ligji është i përpiluar mirë dhe përfshin, gjithashtu, jo vetëm definimin e këtyre procedurave, por gjithashtu edhe se kush do ta kryej dhe nën cilin autoritet.

Unë dëshiroj të veçoj, sidomos, se në projektligj është cekur se specialistët mjekoligjorë mund të kryejnë procedurat, por edhe specialistët, nën mbikëqyrjen e specialistit mjekoligjor. Gjithashtu, janë përcaktuar parimet në të cilat këta duhet të kryejnë punën e vetë, do të thotë, atë të objektivitetit, të paanshmërisë, të pavarësisë, të fshehtësisë profesionale e tjerë.

Një çështje me rëndësi që shqyrtohet në ligj, është edhe autopsia mjekoligjore, e cila duhet të kryhet me urdhrin e gjykatës kompetente. Çështja e zhvarrosjes është e përfshirë, megjithatë këtu e kam një vërejtje në nenin 9, se te çështja e zhvarrosjes duhet shumë më saktë të përcaktohen procedurat e zhvarrosjes, duke marrë parasysh prapë, sidomos, çështjen e tanishme të personave të pagjetur.

Megjithatë, shqetësimin më të madh e kam te neni 14, pika 2, 3 dhe 4, që ka të bëjë me çështjen e pagesës së personalit në gatishmëri të shtesës dhe kategorizimit të ardhurave personale. Këtë më tepër e shtroj, sidomos duke marrë parasysh faktin e zbatimit në praktikë të këtij projektligji, të mungesës së buxhetit, por edhe të kostos shtesë buxhetore. Jo vetëm që mungon buxheti prej pak më shumë se 290.000 euro për tri vite 2010 – 2012 dhe nuk është përfshirë në buxhetin e vitit 2010, por s'është përfshirë as në Kornizën afatmesme të shpenzimeve, atëherë vihet në dyshim se si do të zbatohet në praktikë projektligji. Nga ana tjetër, me qenë se me këtë nen është paraparë numri shtesë i personalit, por edhe pagat shtesë, atëherë kjo do të jetë edhe një kosto shtesë buxhetore. Prandaj, kjo dilemë dhe paqartësi lidhur me koston duhet të qartësohet, në mënyrë që projektligji gjegjësisht ligji të gjejë zbatimin në praktikë.

Sa i përket përputhshmërisë me BE-në, kjo më tepër është çështje e shteteve të veçanta anëtare të BE-së, se sa që rregullohet me legjislacionin e BE-së.

Megjithatë, ligji është i nevojshëm për Kosovën dhe unë në parim e përkrah. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Shkumbin Demaliaj, le të përgatitet deputeti Naser Rugova.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,
Kolegë deputetë,

Duke mos i përsëritur parafolësit, kolegët tonë deputetë edhe duke parë të nevojshëm se me të vërtetë ky ligj i duhet shumë Kosovës, iu ka dashur edhe më herët për t'u bërë dihet trajtimi ndërkombëtar si ka qenë edhe kemi ende nevojë si vend për këto ekzaminime për të gjitha çështje që deri tash kanë mbetur pa zgjidhur edhe ato mbetje mortore, të cilat i kemi në vendin tonë edhe donë ekzaminim.

Unë kisha pasur dëshirë të lidhem konkretisht, nenet e këtij projektligji i cili ka ardhur, është i hartuar në mënyrë profesionale, mirëpo ka shumë mangësi që duhet të trajtohen për shkak se mos tejkalohen, sepse më shumë ndoshta në të gjitha dispozitat apo nenet e këtij projektligji. Pra, më shumë hapësirë iu ka dhënë çështjes shpenzimeve edhe pagesave, se sa atyre që duhet të trajtohen kryesisht duke përfshirë këtu obduksionin apo autopsinë, ekzaminimet klinike mjekoligjore, por edhe zhvarrimin apo **eskhumin** që hyn në kuadër mjekësisë ligjore.

Isha ndalur te neni 2 menjëherë, ku thuhet të gjitha ekzaminimet mjekoligjore kryhen nga një specialist ekspert i certifikuar mjekoligjor. Kisha thënë të mos lokalizohet, nënë një, sepse ne e dimi se është numri i vogël brenda hapësirës territoriale po të thuhet edhe më shumë se mund të ketë raste shumë të jashtëzakonshme që ndoshta duhet të tërheqim edhe ekspertë të tjerë, sepse si është e rregulluar çështja e shpenzimeve me një ekspert mjekoligjor, besojmë se edhe mund të humbin edhe më shumë.

Neni 3, vendi i kryerjes së ekzaminimeve mjekoligjore, unë kisha vendosur që edhe në këtë nen vetë ky kapitull thirret -vendi i kryerjes së ekzaminimeve dhe autopsisë mjekoligjore se të kryhen dyja në një vend se dikur fillon një ndarje se ndanë ekzaminimi klinik edhe autopsinë, po në këtë rast të jetë si krye kapitull i përbashkët.

Edhe në pikën 2, kur thuhet se duhet të kryhen vetëm brenda lokaleve të Departamentit të Mjekësisë Ligjore, pika 2 thotë se në rastet e jashtëzakonshme gjykata mund të urdhërojë kryerjen e ekzaminimeve mjekoligjore jashtë lokaleve të Departamentit të Mjekësisë Ligjore, pasi që të sigurohen kushtet e përshtatshme për një gjë të tillë, mirëpo këtu duhet shtuar se është më se e domosdoshme edhe është më e sigurt që të gjitha këto të kryhen edhe në prani të një gjykatësi hetues apo kryeprokurori, sepse kur kryhen jashtë edhe mund të shkelen apo prishen ato ekzaminime edhe mund të marrin kahe tjetër hetimet për më tutje. Do të thotë, në prani të një gjykatësi hetues.

Te neni 4, autopsia mjekoligjore kryhet vetëm në bazë të urdhrit të lëshuar nga gjykata kompetente. Është mirë të caktohet se cila gjykatë e qarkut apo ajo, sepse dihet se Departamenti është në kuadër të një Ministrie. Ne e dimë se Ministria e Drejtësisë e ka bërë kërkesë për marrjen në kuadër të saj, brenda këtij dikasteri edhe pse më vonë do të flas për këtë çështje. Është mirë të caktohet se me cilën gjykatë se gjykata kompetente, gjykata komunale nuk mundet, ndërsa kur shkojmë te neni 6 flitet për shpenzimet, thotë: “Shpenzimet e autopsisë bien barrë e organit apo subjektit me urdhrin apo kërkesën e cilit është kryer autopsia”. Gjithmonë në këtë rast kur thuhet se duhet marrë urdhëresë nga gjykata po dihet që gjykata duhet t’i paguajë këto shpenzime. Do të thotë, përcaktohet shumë më mirë se e tha kolegu më herët për ne që e kem ligjin për licencimin e subjekteve private shëndetësore që funksionon brenda territorit të Republikës së Kosovës edhe një ekspert mjekoligjor mund ta licencojë veprimtarinë e tij për raste të arsyeshme të ekzaminimeve, po në këtë rast po shihet këtu se gjithmonë këto shpenzime duhet t’i heqë gjykata.

Te neni 7 pika 3, të gjitha të dhënat e mbledhura nga Departamenti i Mjekësisë Ligjore duhet të mbështeten në ligjin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave, do të thotë këtu është ... personale në këtë ligj ende e kemi në procedim u tha edhe më herët që të mos prejudikojmë edhe më tutje, po me qenë se edhe ajo është në procedim edhe shumë shpejtë besojmë se do të vijë në lexim të dytë në Kuvend të Kosovës, mirëpo është përcaktuar edhe pse i njëjti ligj ende nuk është.

Kemi nenin 14 ku përfshihet orari i punës. Ne kemi një ligj i cili përcakton orarin e punës për shërbyesit civilë apo tash administratën publike shtetërore. Edhe pse është punë e karakterit të veçantë ekzaminimeve dhe është punë e lodhshme si autopsia ose të gjitha këto, por besojmë se orari i punës duhet të jetë 8 orë edhe të hiqet kjo pjesa tjetër që mbulohen nga personaliteti tjetër në gatishmëri, sepse atëherë kur thuhet nga eksperti pjesa tjetër e personalitetit në gatishmëri s’mund të jenë ekspertë ose duhet mos të kufizohet nga një ekspert. Kështu që për çështjen e pagesës edhe për personalin, por edhe me rastin e ekzaminimeve nuk besoj që për secilin veç e veç thuhet se duhet të nxjerr Qeveria një akt nënligjor për pagesën e tyre, mirëpo edhe kjo të përkufizohet me ligjin për pagat e shërbimit civil të dispozitat ku paguhen mëditjet edhe mos të ketë ndonjë pozicion ndaras për disa shërbyes civilë me mëditje më të mëdha apo më të vogël t’u i përfshirë enorme edhe pse puna është e veçantë, mirëpo në këtë rast duhet gjithçka të jetë ligjore edhe ato mëditjet paguhen në bazë të ligjit që e kemi për mëditjet e shërbyesve civilë sepse edhe pse është degë e veçantë në këtë rast, ne kemi edhe pjesën tjetër mjekëve edhe shëndetësinë në Kosovë që edhe ashtu sot i kanë kushtet mizëri. Faleminderit! Po në këtë

rast harrova diçka ministresh, askund në tërë tekstin e projektligjit nuk ka asnjë dispozitë që përcakton se në kuadër të cilit dikaster do të veprojë apo kujt i jep llogari vetë Departamenti edhe pse dihet që lidhen dy dikastere dy ministri ajo e Shëndetësisë edhe e Drejtësisë, mirëpo as nuk shkruan me anë të një memorandumit këto se do të thotë asnjë dispozitë nuk shkruhet me një marrëveshje këto dy dikastere, dy ministri se si do të bashkëpunojnë lidhur me vetë Departamentin e Mjekësisë Ligjore, as nuk përshkruhet se me një akt nënligjor do të rregullohen këto çështje të bashkëpunimit. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Naser Rugova, le të përgatitet deputeti Lulzim Zeneli.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Po e diskutojmë një ligj jashtëzakonisht të rëndësishëm që rregullon një fushë të ndjeshme, sidomos për këtë 10 vjetshin e fundit në Kosovë dhe dua të them që në fillim është një ligj i mirë, është një ligj pragmatik i cili ngërthen në vete atë substancën që thjesht ka qenë e parregulluar me ligj adekuat, sidomos në këto 10 vjetët e fundit në Kosovë.

Qëllimi i këtij ligji është rregullimi i procedurës për kryerjen e ekzaminimeve mjekoligjore nënë autoritetin e Departamentit të Mjekësisë Ligjore.

Janë disa nene këtu që mund të plotësohen, të precizohen dhe të saktësohen, por materia në esencë është e përpunuar shumë mirë, renditja e kapitujve dhe e neneve të ligjit është në harmoni të plotë me fushën që e rregullon ky fah i cili nuk nënkupton vetëm mjekësinë ligjore, ekzaminimet mjekoligjore që ndihmojnë në shumë raste, qoftë të lëmit të shëndetësisë, të jurisprudencës, prokurorisë, hetuesisë, gjenetikës, biologjisë e të tjera, por rregullon edhe aspektet të tjera që kanë të bëjnë edhe e potencoj kolegja Hundozi edhe me psikiatrinë ligjore të cilës në Kosovë nuk po i kushtohet vëmendje e veçantë, duke i ditur trendet socio-ekonomike dhe stresin posttraumatik që do të përballen edhe institucionet e Kosovës në shumë raste me të, do të duhej zonja ministresh, të zinte vend të merituar edhe një nen apo paragrafë të veçanta që kanë të bëjnë me këtë çështje.

Tek autopsia, përkundër që disa kolegë shprehën disa doza të caktuara, do të thotë, apo rezerva mendoj që në rastet e jashtëzakonshme duhet të bëhen edhe autopsi kur gjithnjë kjo është me urdhër të gjykatës kompetente. Unë pajtohem që të quhet gjykatë kompetente dhe të mos emërohet gjykata, sepse kemi të bëjmë me prokurorët ata të cilët nisin procese të tilla.

Definitivisht është një ligj dukshëm më cilësor se sa një draft që na pat ardhur para disa muajve i cili nuk është marrë me këto çështje kyçe që e kanë për bazë rregullimin ligjor të kësaj fushe, por më shumë ishte marrë me organizimin dhe organogramin e Departamentit të Mjekësisë Ligjore. Dhe, tani duhet të nënshkruhet një memorandum i mirëkuptimit dhe duhet të precizohet në aktet nënligjore pasi që ky ligj të hyjë në fuqi, në mes të Ministrisë së Drejtësisë, gjegjësisht Departamentit të Mjekësisë ligjore dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Qendrës Klinike Universitare. Kurse sa i takon neneve që kanë të bëjnë me ekspertët apo specialistët e mjekësisë ligjore edhe unë pajtoj me mendimin e disa kolegëve që ekzaminimi mjekoligjor duhet të kryhet. Pse të mos jetë në shumës nga specialistët e mjekësisë ligjore, sepse këtu nuk kemi të bëjmë vetëm me

ekspertë mjekoligjorë? Pra, kemi të bëjmë: me patologë, histologë, kirurgë, internistë, me konzorciume të tëra të ekspertëve, puna dhe ekspertiza e cilëve është jashtëzakonisht e rëndësishme për raste të caktuara dilikate, qoftë të spekteve të fushës së shëndetësisë apo edhe të fushës së gjyqësisë dhe aspekteve të tjera që thjesht i hasim në praktikën e përditshme, qoftë të gjyqësorit, qoftë të spekteve të shëndetësisë.

Zonja ministresh, dihet që Departamenti i Mjekësisë Ligjore edhe pse është themeluar rishtas dhe i ka marr kompetencat tani si Departament i Mjekësisë Ligjore, po e bëjmë edhe një ligj shumë kompetent, duhet pajisur me laboratorin e ADN-ës për faktin që kemi një numër të madh të familjeve që presin për fatin e personave të pagjetur. Dhe, laboratori i ADN-ës nuk nënkupton vetëm atë kategori të qytetarëve të Kosovës, por i ndihmon shumë edhe balistikës edhe shumë hetimeve dhe investigimeve tjera që do të ndërlihdeshin tani me hetuesinë, gjyqësinë dhe me Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Edhe ky ligj po vjen në vazhden e ligjeve që nuk janë paraparë në kornizën afatmesme të shpenzimeve. E kanë potencuar disa herë mjaftë kolegë këtu edhe nga pozita edhe nga opozita. Ju lutem planifikimet e tilla të ligjeve bazike siç është ky ligj, duhet të planifikohen në kornizën afatmesme të shpenzimeve. Sa i takon shkurtimit të orarit është e vërtetë një specialist i mjekësisë ligjore, me urdhër të gjykatës kompetente apo prokurorit të qarkut mund të thirret në orën një pas mesnate edhe në qoftë se e ka krye orarin nga 8 deri ora 17,00 dhe këtu këta njerëz që nuk janë shumë në Kosovë, duhet të kenë kompensime të veçanta. Por unë insistoј që ato kompensime të veçanta të hynë në Ligjin për shërbyesit civilë apo mbase dua të besoj që në një ardhme jo të largët, do të bëhet kategorizimi i pagave dhe këta njerëz nuk do të konsiderohen shërbyes civilë, kjo vlen tani edhe për ministrin e Administratës Publike, por si nëpunës të lartë shtetëror që vërtetë kanë punë specifike dhe përgjegjësi.

Krejt në fund është një ligj i mirë dhe besoj që e fuqizon edhe më shumë Departamentin e Mjekësisë ligjore. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Lulzim Zeneli, le të përgatitet deputeti Riza Smaka.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ajo çka desha të theksoј dy fjalë lidhur me këtë projektligj, shumë parafolës i potencuan në fjalët e tyre, por konsideroj se së pari është një ligj i mirë, do të thotë. Janë precizuar gjërat kyçe sa i përket lëmit të mjekësisë ligjore, respektivisht Departamentit i cili pretendohet të funksionalizohet pas hyrjes në kuptimin e operativës edhe funksionimit të laboratorëve përkatës. Mirëpo ajo çka është neve po na përcjell dhe është bërë praktikë, pas luftës ka pasur një investim në kuptimin e kuadrove të cilët janë ngritur dhe janë specializuar në fushat e caktuara si në lëmin e toksikologjisë, po ashtu edhe të ekzaminimeve histopatologjike po edhe antropologjike dhe gjitha laboratorët, qoftë mjekësisë ligjore, qoftë edhe të kriminalistikës, sot jemi dëshmitarë të asaj që janë jashtë funksionimit. Pse kemi një gjendje të tillë kur është investuar në kuadro dhe kanë ndihmuar edhe faktori ndërkombëtar përmes programeve të caktuara?

Këtu bëhet fjalë për gjendjen aktuale në sistemin e stimulimit dhe të pagave të kësaj kategorie që është deficitare në shoqërinë tonë dhe mund t'i numërojmë me numra. Dhe, ky ligj besojmë se jo vetëm që do të ofrojë do të hapë dritare në funksionalizimin e kësaj fushe, mirëpo do të nisë një procedurë në kthimin e një bazamenti që do të mundësonte në ofrimin e prurje e kuadrove në këtë fushë, në mënyrë që kjo fushë të funksionalizohet

duke ditur se nuk kemi të bëjmë vetëm me mjekësi ligjore në kuptimin klasik, kemi të bëjmë parafolësit e shprehën fushat mjaft deficitare si në lëmin e toksikologjisë, histopatologjisë, biologjisë molekulare, u fol edhe për neuropsikiatrinë dhe të gjitha këto, të gjitha këto nevojitet një përkujdesje dhe një përkrahje maksimale nga institucionet e vendit. Në qoftë se kjo kategori nuk specifikohet qartë si kategori deficitare dhe të hyjë në sistem të stimulimit, atëherë e kotë është të ndërtojmë legjislacion dhe rregullore se përfundimisht nuk do të kemi për kënd. Prandaj, kërkohet nga Ministria, nga Qeveria e Republikës së Kosovës, t'i ketë në prioritet kuadro deficitare specialistë të fushave të caktuara, në mënyrë që të stimulohet dhe ta kemi një departament dhe një sektorë funksional. Ajo çka kërkohet sot është një përkujdesje më e madhe. Ne e kemi gjendjen alarmante në këtë fushë dhe në qoftë se funksionalizohet kjo atëherë do të funksionalizohet i tërë zinxhiri i sistemit që ka të bëjë edhe me hetuesinë, edhe me sigurinë dhe me kriminalistikën.

Prandaj, kërkohet në një mënyrë që të ketë parasysh në politikat qeverisëse dhe sidomos kur bëhet fjalë në gjashtëmujorin e dytë në ribalansimin e buxhetit. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Fjalën e ka deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: Përfaqësues, ministra dhe deputetë,
Fillimisht aludoj që të më meditohet referuar titullit të ligjit, a Ligji për mjekësinë ligjore apo për mjekësinë gjyqësore, siç është thënë në serbisht e boshnakisht. Tek e fundit në Fakultetin Juridik, apo në fakultetet juridike moderne, ekziston një lëndë, disiplinë që quhet mjekësia gjyqësore. Në anglisht është thënë ashtu, ndoshta do të ishte zgjidhja më e mirë që ta quanim mjekësia forenzike, për këtë mutatis, mutandis, në procedurë të amendamenteve.

Te neni 1 paragrafi 2, të te gjitha aktet ligjore të mira, përdoret njëjësi edhe duhet të përdoret njëjësi ja pse, ja pse, pese aktet ligjore para se të aplikohen duhet medoemos të interpretohen e ka metoda të ndryshme po kryesorja është argumentum acontrario që është kontra e analogjisë, e tash sipas këtij interpretimit do të delte një rezultat tjetër fare që do ta përjashtonte njëjësin po e zëmë, se do të kërkohej ajo kjo punë- ekspertët jo, eksperti. Pra, është vërejtje parimore referuar metode si me thanë, në këtë rast njëjësi.

Neni 2 paragrafi 2 është për, konsideroj gjykoj se është problemore që, zoti kryesues është mirë pak të mbahet qetësi se jem Kuvend i Republikës së Kosovës edhe jem në etapë të punës serioze edhe nuk është pamje e mirë që bëhen qeshje, përqeshje e tjera e tjera.

Paragrafi 2 i nenit 2, është problemor ja pse, ekzaminimet mjekoligjore mund të kryhen edhe nga specialisti. Specializanti është asistent apo jo ani pse thuhet nën kujdesin e mbikëqyrjen e tjera e tjera, po e marrë analogjinë se është kjo e saktë specialisti është mjeku që ende nuk është specialist, është punë serioze. Prandaj, do të ishte tepër barrë e madhe për specializantin që më pastaj edhe rezultatet do të ishin gjithmonë të diskutueshme.

Do të ishte zgjidhje e mirë që te neni 6 të shtohet, po e zëmë paragrafi i dytë ku do të thuhet që: "Shpenzimet natyrisht, fillimisht do t'i mbarte, do t'i paguante organi, autoriteti që do të kërkonte autopsinë, ama do të duhej riimbursimin nga fajtori se

zakonisht është fjala për fajtori që duhej përgjigjej përpos komponentët po e zëmë penale edhe materiale.

Te neni 14 është bërë një elaborim sa i përket orarit të punës, kjo çështje është e rregulluar bile për çudi mjaftë të mirë me Rregulloren për Ligjin për punë, edhe çështje e ligjit për punë. Prandaj kjo do të duhej të hiqej, sepse do të rregullohej në konformitet me Ligjin për punë me akt nënligjor edhe më mirë do të rregullohej apo jo se sa me ligj edhe nuk është praktikë që orari i punës me ligj të rregullohet .

Te neni 16, ku thuhet:” për shkeljen e këtij ligji bile është shkruar me (l) të vogël ekspertët e mjekësisë ligjore i nënshtrohen masave disiplinore “ që është e ditur apo jo, madje thotë : ”edhe sanksioneve penale” e shkruar apo s’e shkruar, Kodi Penal është ai që i referohet kujdo që e cenon Kodin Penal, prandaj është një çështje e panevojshme. Dhe, do të isha angazhuar që ky projektligj që do të bëhet ligj, që t’i përmbajë edhe definimet e nocioneve fillestare, sepse janë të nevojshme për komentimet ligjore edhe do të duhej të kishte kapitullin për masat ndëshkimore.

Përfundimisht e suportoju zonjën Kelmendi, ministren që e ka bërë këtë dokument për diskutim. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, zonjën ministre, ta merr fjalën.
Ajo e ka kërkuar fjalën.

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: Faleminderit!

Nuk dola këtu për të replikuar , por vetëm për t’i qartësuar disa gjëra lidhur me diskutimet, komentet që u bënë, që për mendimin tim ishin mjaftë të mira, por po dal vetëm për t’i qartësuar disa gjëra.

Së pari u kontestua neni 13, sepse thanë nuk është paraparë edhe procedura, përkatësisht lidhur me zhvarrosjen. Neni 13 ka paraparë të gjitha procedurat për ekzaminime mjekoligjore. Në ekzaminime mjekoligjore bëjnë pjesë: autopsia, zhvarrosja, mjekësia klinike apo shikimi klinik e tjera e tjera, të gjitha këto përmbledhen në mjekësi ligjore në ekzaminim mjekësor.

Nga ana tjetër rregullat i bie vetë Departamenti i Mjekësisë Ligjore dhe e rregullon punën e brendshme se si do të procedojë më tutje me ato ekzaminime. Ajo që është më e rëndësishme është se sipas këtij ligji të gjithë ekspertët që marrin pjesë në ndonjë veprim apo ekzaminim mjekoligjor duhet t’u përmbahen metodave të shkencës dhe etikës së mjekëve.

Komisionet punojnë, komisionet i formon Departamenti i Mjekësisë dhe nuk pretendojmë që ne tash ta ngrenë një institut të tërë forenzik shtetëror ku do të përfshiheshin edhe do të grumbulloheshin të gjithë ekspertët, por për nevojat të një ekspertize konkrete ky Departament i Mjekësisë Ligjore ka autorizim të angazhojë edhe ekspertë të fushës së psikiatrisë, edhe fushave tjera që tash nuk i di unë, sepse nuk jam eksperte e asaj fushe. Por sido që të jetë me funksionimin e Institutit për Mjekësi Ligjore, i cili ka shumë ekspertë dhe të Departamentit për Mjekësi Ligjore kompletohet plotësisht infrastruktura për kryerjen e të gjitha ekspertizave mjekoligjore.

Klinikat private nuk është e lejueshme të bëjnë ekspertiza mjekoligjore, sepse të gjitha ekspertizat mjekoligjore kur të hartojnë procesverbalin për një ekspertizë ai procesverbal ka fuqinë e dokumentit publik e dokumentin publik nuk mund ta formojnë klinikat private.

Nga ana tjetër u përmend këtu gjykata kompetente, gjykatë kompetente është ajo gjykatë në territorin e së cilës gjendet një trup i cili duhet t'i nënshtrohet obduksionit, autopsisë, përkatësisht ose zhvarrosjes. Dhe, zakonisht gjykatësi nuk është hetues, por është gjykatës i procedurës paraprake, sepse gjykatësit më nuk i bëjnë hetimet, por i bëjnë prokurorët.

Shumë ishte vërejtje me vend mungesa e laboratorit të analizave të ADN analizave, por tani për mungesë të këtij laboratorit po përdoret një metodë shumë më e sofistikuar për identifikimin e mbetjeve mortore e kjo është metoda e kalsifikimit, por gjithsesi duhet të pajiset Departamenti i Mjekësisë ligjore edhe me laboratorin e ADN të analizave, sepse ato nevojitet edhe për vërtetimin e atësisë, amësisë edhe për çështje tjera statusore.

Si do që të jetë kur është fjala për pjesën që e rregullon orarin, kohëzgjatjen e punës së ekspertëve dhe pagesën, t'ju them se ky është ligj special dhe i lejon vetit që ta rregullojë një materie në mënyrë të veçantë ndaras nga materiet tjera. sikur që do të kemi më vonë ndoshta edhe një ligj tjetër për Policinë ku do të përdoret stazhi beneficuar, për minatorët e tjerë e tjerë.

Sido që të jetë të gjitha këto vërejtje i kemi parasysh ne dhe do të kontribuojmë në Komisionin funksional, në rast se do të jetë nevoja që të japim kontributin tonë.

Sa i përket kostos financiare, kostoja financiare ka qenë e ndarë në tri vjet, domethënë, është paraparë për kashin, për periudhën afatmesme të shpenzimeve. Për vitin e parë për këtë vit 2010 kemi kërkuar 114 mijë. Unë besoj se me që nuk është shumë e madhe do të miratohen 290 mijë, po në mos 290 mijë, atëherë 114 mijë gjithsesi do të pranohen nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave, përkatësisht nga Qeveria, në mënyrë që ky ligj të fillojë të zbatohet.

Ka pasur vërejtje nga ndërkombëtarët aty quhet ligj për autopsinë, a të quhet Ligj për ekshumim, aty quhet ky, aty quhet ashtu, mirëpo me që forenzikja që në fjalën latine nënkupton ekspertizat mjekoligjore i përmbledh të gjithat, atëherë e kemi pa të arsyeshme që edhe titulli i ligjit të jetë ligji për mjekësi ligjore? Faleminderit për durimin!

Drejtimin e seancën e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Faleminderit!

Prezent janë 64 deputetë, do të thotë, të përgatituni për votim ju dhe regjia, dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 61 vota “për”, asnjë “kundër” dhe një abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për mjekësinë ligjore.

Në bazë të Rregullores së Punës së Kuvendit ngarkohen këto komisione:

- Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi,
- Komisioni për Buxhet dhe Financa,
- Komisioni për Komunitete, dhe

- Komisioni për Integritet Evropian.

Komisionet duhet që brenda 2 muajve nga shqyrtimi i parë Kuvendit t'i paraqesin raportin me rekomandime.

Dhe, kalojmë në pikën e fundit të kësaj seance:

- **Shqyrtimi i Raportit të Komisionit Parlamentar ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës**

Komisioni Parlamentar ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, në pajtim me Rregulloren nr. 2008/12 për ndryshimin e Rregullores nr. 2001/36 për Shërbimin civil, ka intervistuar kandidatët për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit civil të Kosovës dhe Kuvendit i paraqet raportin me rekomandime.

Raporti i Komisionit, së bashku me dokumentacionin u është shpërndarë deputetëve. Ftoj kryetarin e Komisionit ad-hoc, zotin Hydajet Hyseni, që para deputetëve të Kuvendit të arsyetojë raportin me rekomandime, nëse ka nevojë. Regjia, fjalën Hydajet Hysenit.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit zoti kryetar!

Zonja dhe zotëri deputetë,

Komisioni ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, në bazë të konkursit të shpallur në pajtim me procedurat e parapara me ligj, ka bërë përzgjedhjen e kandidatëve dhe Kuvendit të Kosovës i rekomandon këta kandidatë:

- Naim Abazi, 97.42 pikë, dhe
- Ali Dragusha, 96.83 pikë,

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Me zgjedhjen e sotme përfundon procesi i tranzicionit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, procesi i plotësimit dhe funksionalizimit të tij në pajtim me realitetin e ri në Kosovë dhe në këtë mënyrë përmbushet një nga rekomandimet e Raportit të progresit për Kosovën.

Komisioni ad-hoc ka pasur gjatë gjithë procesit ndihmën dhe bashkëpunimin e partnerëve dhe Organizatës për Siguri dhe për Bashkëpunim Evropian, të cilëve dua t'ua shpreh falënderim dhe mirënjohje.

Komisioni ka punuar gjatë gjithë punës në frymë konstruktiviteti, kolegjaliteti e parimësie dhe shpreh besimin se edhe votimi i sotëm do të zhvillohet në këtë frymë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti deputet!

Në mbështetje të nenit 65, paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 1 të Rregullores nr. 2008/12, për ndryshimin e Rregullores nr. 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës, Komisioni votues, i formuar me vendim të seancës plenare, të datës 29 janar 2010, në përbërje nga një përfaqësues nga secili grup parlamentar.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, kënd po e caktoni? Safete Hadergjonaj, e ka fjalën. Regjia, fjalën deputetes Safete Hadergjonaj.

SAFETE HADERGJONAJ: Në emër të Grupit Parlamentar për Komision propozojmë Elheme Hetemin.

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, e ka fjalën deputeti Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: faleminderit, zoti kryetar!

Në emër të Grupit tonë, deputetja Anita Morina do të jetë. Po iu kisha lutur të konstatoi a kemi kuorum për votim?

KRYETARI: E kam konstatuar, 64 deputetë janë.

Në emër të Grupit të AAK-së, deputeti Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, kryetar!

Deputeti Ibrahim Selmani, në emër të AAK-së.

KRYETARI: Mirë, faleminderit!

Në emër të AKR-së, deputetja Rita Hajzeraj e ka fjalën.

RITA HAJZERAJ: Faleminderit, kryetar. E propozojmë deputeten Njomza Emini.

KRYETARI: Mirë, faleminderit!

Në emër të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, Lulzim Zeneli e ka fjalën.

LULZIM ZENELI: Në emër të Grupit të LDD-së, propozoj deputeten Drita Maliqi.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit “7+” Myfera. Myfera Shinik, mirë, faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së. Hajt njëra nga ato dy deputetet. Le të jetë Kosara Nikoliq.

A keni nevojë të deklaroheni ju shefat e grupeve parlamentare? Jo. Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes së Dardanisë, po do Gani Geci.

GANI GECI: I nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Kur flasim për rekomandimet e Komisionit ad-hoc për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, medoemos duhet të ndalem në punën e Këshillit. Ne kemi votuar para sa kohe anëtarët e Këshillit dhe tash do ta votojmë edhe një prej anëtarëve, po sa vlen kjo, kur vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës nuk vendosen aty ku e kanë vendin apo nuk zbatohen?

Unë do ta marr vetëm një shembull, nuk kam qare pa e marrë një shembull që e kam pa në dokumentacionet që na kanë ardhur neve si deputetë. Është fjala për Komitetin Komunal të Prizrenit, Drejtorinë e Arsimit, një arsimtar i gjuhës frënge konkurren në një nga shkollat për gjuhën frënge në shkolla që ka punua 9 vjet, dhe në vend të tij merret një arsimtar e biologjisë. Nëse dëshironi unë po ja u lexoj. Me datën 14.10.2008 rishpallet konkursi në të cilin ankuesi e konteston vendimin e punës si profesor i gjuhës. Fjala është. Organi i punësimit ka pranuar në vendin e punës të profesorit të gjuhës frënge zonjën me përgatitje profesionale biologe. A është kjo në rregull, atëherë sa vlen që ne t'i

votojmë anëtarët dhe ata vendimet mos t'u zbatohen? Kjo është puna që e bëjmë ne në përditshmëri, kjo është puna që e bëjmë ne në komunat tona. Ne në komunat tona, edhe në komunën e Ferizajt, dhe në komunën e Vitisë, edhe në komunën e Gjilanit, edhe në komunën e Prishtinës, edhe në komunën e Skenderajt largohen njerëzit nga puna për arsyen se i përkasin një partie politike. Po na përkujtojnë vitet e 90-ta. Dhe Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës me vendimet që janë këtu përmbi 70 , i merr vendimet i kthen, ndërsa komunat nuk i zbatojnë. Çka na vyen ai Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës, kujt duhet t'i raportojë ai, a duhet komunës t'i raportoj a duhet që komuna që ka përjashtua nga puna njerëzit prapë të marrë vendime t'i largojë siç kemi pasur në rastin në komunën e Vitisë ku ka ndërhyrë policia?

KRYETARI: Gani, kur ta debatojmë Raportin e Komisionit të Pavarur, sot kemi diçka tjetër.

GANI GECI: Ne do ta debatojmë edhe raportin, po kjo është për faktin se ne po e votojmë kot këtë. Faleminderit, zoti kryetar!

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Është formuar Komisioni me këta deputetë: Partia Demokratike, Elheme Hetemi, Lidhja Demokratike, Anita Morina, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Ibrahim Selmanaj, Aleanca Kosova e Re, Njomza Emini, Lidhja Demokratike e Dardanisë, Drita Maliqi, "7+", Myfera Shinik, dhe SLS-së, Kosara Nikoliq. Komisioni ndihmohet nga dy punëtorët e administratës.

Ju njoftoj se në pajtim të nenit 8.5 të Rregullores për ndryshimin e Rregullores 2001/46 për Shërbimin civil, Kuvendi emëron njërin prej dy kandidatëve të rekomanduar me shumicën e votave të deputetëve që janë të pranishëm dhe që votojnë. Meqë janë dy kandidatë për një pozitë, atëherë do të mbahet votimi i fshehtë.

Për zbatimin e procedurës së votimit, ju veç u tregoni shefave të grupeve, anëtarëve të komisionit t'i zënë vendet e tyre dhe Naim Maloku, anëtar i Kryesisë i fton me emra deputetët që të votojnë.

Drejtimin e seancës e merr anëtari i Kryesisë, zoti Naim Maloku

KRYESUESI NAIM MALOKU: (Fton të gjithë deputetët e Kuvendit, një nga një, që të votojnë me vota të fshehta).

(Pas përfundimit të votimit, Komisioni votues numëron votat e deputetëve)

KRYESUESI: Lexoje Raportin, Elheme, të lutem!
Të nderuar deputetë, të dëgjojmë raportin e Komisionit. Elheme Hetemi e ka fjalën.

ELHEME HETEMI: Komisioni votues për zgjedhjen e një anëtari të këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës raporton për rezultatet e votimit për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës.

Në mbështetje të nenit 65 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 1 të Rregullores nr. 2008/12 për ndryshimin e Rregullores nr. 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës, Komisioni votues, i formuar me vendim të seancës plenare, të datës 29 janar

2010, në përbërje nga një përfaqësues nga secili grup parlamentar, ka konstatuar se në votim kanë marrë pjesë 66 deputetë.

Për Naim Abazin kanë votuar 39 deputetë, ndërsa për Ali Dragushën kanë votuar 20 deputetë, të pavlefshme kanë qenë 7 fletëvotime. Në bazë të rezultateve të votimit në pajtim me rregullën 31.3 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe të nenit 1 të Rregullores nr. 2008/12 për ndryshimin e Rregullores nr. 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës, konstatohet se Naim Abazi është zgjedhur anëtar i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Republikës së Kosovës me mandat pesëvjeçar.

KRYESUESI: Faleminderit! Ju lutem deputetë, vetëm një njoftim.

Ju njoftoj se në pajtim me Rregulloren e Punës dhe të marrëveshjes së deputetëve nga radha e komuniteteve jo shqiptare dhe jo serbe, për përfaqësim me rotacion në Kryesi të Kuvendit të Kosovës, radha dhe kohëzgjatja e mandatit është caktuar, si në vijim:

Në vitin e parë, më 2008, përfaqësuesi i VAKAT-it, Xhezair Murati. Në vitin e dytë 2009, përfaqësuesi i KDTP, Myfera Shinik. Viti i tretë, më 2010, nga 6 muaj, si në vijim: PDAK - 6 muaj, prej 1.2. deri më 30.7.2010, SDA - 6 muaj, prej 1.8.2010 deri më 31.1.2011. Viti i katërt 2011, nga 6 muaj, si në vijim: IRDK, - 6 muaj, prej 1.2. deri më 30.7.2001 dhe PREK, - 6 muaj, prej 1.8.2011 deri në përfundim të mandatit të kësaj legjislature. Sipas kësaj marrëveshje, që nga data 1 shkurt 2010 deri më 30 qershor 2010, anëtar i Kryesisë së Kuvendit është përfaqësuesi i PDAK-së. Ju faleminderit. Pra, me kaq seanca përfundoi.

Përgatiti: Njësia e Transkripteve